


# ANASTAS KONDO

# PORTAT EDIELLIT

tregime



814-32

K87 Anastas Kondo

**PORTAT E DIELLIT**

Tregime

49552

## NE JEMI BOTA

Në Bunovën tonë po ndodhin gjëra të çuditshme.

Në fillim erdhi plaku australian. Kurbetçi nga Australia, nga fundi i botës, që nuk e mbante mend njeri fare, as më të moçmit e pleqve tanë. Mbeti në fshat duke kërkuar nuse. Pastaj erdhi ai djali i ri nga Shkodra, shkodriani, thanë pleqtë tanë, dukagjinasi — sqaruan më të gjezdisurit nga ne, arsimtarët, dhe mori nuse për vete. Si i pari dhe i dyti mbetën në fshat. Plaku i duruar priste dhe bënte telegramet e shkurtra në Sidnejin e largët, që të mos mërziteshi fara e tij për këtë mungesë kaq të gjatë. Kurse i dyti, djali nga Shkodra, nuk priti shumë, por u martua

dhe u trashëgua me vajzën tonë. Ky ishte kollovari i parë dhe asnë nuk e merrte me mend atëherë, që pas këtij do të vinin të tjerë. Harrohim ne që ishim derë e madhe. Ishte moti kur kooperativa jonë në Breg të Jonit u bë fermë. Midis këtyre dy ardhacakëvë, plakut të duruar dhe djalit të nxituar, u dukën te ne dhe kineastët e huaj. Ata kërkonin të bënин film për televizioni e tyre dhe u mbetën sytë te vajzat tona. I harruan kamerat. Kishte rrezik që dhe ata të na mbeteshin në derë, kollovarë. Nuk u mor vesh ç'pëlqyen më shumë, detin, ullinjtë, malin apo vajzat. Por ata qenë që thanë se, përderisa ne jetonim në një bukuri të tillë (vajzat apo vendi, nuk u sqarua kurrë), ne patjetër duhej të ishim njerëzit më të lumtur në botë. Të gjithë ç'vinin, binin në sevda me ne dhe kishin merak të madh. Thua se graviteti kishte humbur qendrën e tij dhe Bunova jonë ishtë bërë kërthizë e botës.

\* \* \*

Ai erdhi në fshat me taksi. Me taksi, zakonisht, te ne vijnë nusët, por më shumë dhëndurët. Ne marrim pak e japim shumë nuse. Vajzave tona u kë dalë nami i mirë, jo vetëm në gjitoni, por dhe më tej. Dhe, t'u japim hakun, ato i bëjnë vëtë vend e nder vetes, kudo qofshin, për bukuri e për punë. Dhe takxia është pak për to...

Në, fshatarët e tjerë, vemi e vijmë nëpër halle e miq me autobusët e «postës» a të «kundrapostës». Në këta autobusë nuk ke ku hedh mollën. Janë gjithnjë plot e përplot, dëng, me udhëtarë dhe mall, si në mot të mirë dhe në mot të lig. Nga Bunova jonë, kur vjen dimri, nisen për në të katër anët e Shqipërisë dengjet me portokalle e limonë, enët me vaj e ullinj, vargjet me çepële

e bukëfiqe kallamate dhe shishet e bidonët me raki. Në këtë stinë gjëja që çmohet më shumë në Bunovë janë mjetet e ambalazhit. Për ne më tepër vlejnë ato sesa malli që kanë brenda, si puna e kornizave që shiten më shtrenjtë sesa pikturat. Biem keq për to, po ne jemi manastiri madh e kallogjerë gjejmë. Gjithçka që ka shpikur njëriu për të siguruar prodhimet e veta haset të nënë ditët e dimrit, që nga thasët e trastat, shportat e arkat, llatat e shishet, damixhanët, e termuset, deri te valixhet e qeset e plastmasës dhe celofanit. Gjithnjë këto ikin plot dhe, kur më të rrallë na kthehen, vijnë bosh. Bile dhe në behar kjo puinë është. Ne dërgojmë fiqtë taze e rrushin stafidhë, dardhat si ftua dhe pjeshkët zémérkau dhe marrim falmeshëndetet e botës.

Plaku, që ndaloj taksinë në mes të fshatit, ishte një përjashtim. Çdo ligj ka përjashtimin e vet. Plaku vinte me taksi dhe me valixhet plot. Prore, ata që vijnë te ne, vijnë për të marrë, qoftë nuset, qoftë prodhimet tonë, që nuk sjellin gjë me vete kurrë.

Merre me mend, dhe arbitrat e futbollit, pa folur për përgjegjësit, ikin me trastat ngarkuar, jo me gola, matyrisht, se golat i hanë të tjerët, kuptohet, futbollistët miq. Është fakt i njojur botërisht që, përndeshjet në fushën tonë, hahen në Federatë se kush do të gjykojë. Fiton me short më fatlumi. Jemi i vetmi ekip i kategorisë së dytë që s'kemi nevojë për miq e ndërhyrje në Tiranë, për sa u përket arbitrateve. Nuk jemi mollë sherri, por pite mjalti. Të gjifhë ç'vijnë, mbeten të kë-naqur e probleme s'dalin ndonjëherë. Në fushën tonë s'mundemi kurrë, vetëm fitojmë. Dhe kjo është si një aksiomë që s'ka nevojë për vërtetim. Madje dhe teoremat e grëkut të shqiptar, Pitagorës, apo frëngut të mençur, Fermës, mund t'i

vësh në dyshim, por fitoren tonë, në fushë të Bunovës, nuk e diskuton njeri, as në ditë të ligë.

Vetem te ne ndodh që, në vend të topit, mund të bësh gol me kokërr portokalle ose bukëfiqe. Më placin sytë në ju gënjej! Këto i heahim ne, tifozet, në tuşnë, qe tu prishim mendjen bonjakëve, lojtarëve të skuadrës kundërshtare. Se sa pér djemtë tanë, ata kurrë nuk e ngatërojnë topin e futbolit me agrumet. Të tjerët hanë portokallët apo bukëfiqet tona, kurse tanët bëjnë gola tamam.

Le më, ç'tju flas pér atë që ndërkokë besoj se e keni përfytyruar disa herë. Kur, ndonjë çun i vocërr, një grusht njeri, yni, i qepet nga pas portës, portierit kundërshtar dhe në sy të tij përtyp gjithë qejf limonin, tjetrit, domethënë portierit, i lëshon goja lëng. I thërret çunit të largohet, çuni bën sikur nuk merr yesh që i thërrresin atij, thua se s'di shqip, rrufjanë, atëherë portieri i varfër ankohet tek arbitri. Po ç'ti bëjë, i ziu arbitër, që e di mirë se as Federata Botërore e Futbollit nuk e ndalon dot që spektatori të hajë limon në stadium. Edhe këtë gjë, pra rregulloren e futbollit, ne e njohim në majë të gishtave, më mirë se kodin agroteknik! Ju siguroj dhe vë dorën në zjarr që të gjitha skuadrat mund të dalin nga kategoria, vetëm jona nuk del as pér një mijë vjet. Ne jemi kala që s'luajmë hiç nga vendi. Veç në raftë tërmët. Po tërmët në fshatin tonë s'mbahet mend ndonjëherë.

I tillë, si çdo gjë jona, u bë dhe plaku nga Australia më vonë. Kala e shkuar kalasë. U karfos dhe zuri rrënje te ne.

Atë ditë që ai erdhi, si gjithë të porsaardhurit, ndaloj në klub. Ai pas dhe shoferi përparrë me dy valixhet e mëdha, si sënduqe, të plakut. Ngja-

tjetuan bujtësit e klubit dhe bufetieren hazërxhevape dhe zunë vend.

— C'urdhëroni, zotrote? — pyeti rrët e fët bufetierja plakun dhe pastaj shtoi: — Mirë se na erdhët, barba!

Në vend të plakut foli e porositi shoferi:

— Dy kafe. Një pa sheqer e tjetrën të zakonshme.

— Dhe nga një raki për miqtë, — shtoi njëri nga bujtësit.

*bukuri* — Ekspres? — pyeti rishtazi zonja e banakut.

— Bukuri! — i tha shoferi dhe nuk u kuptua për çfarë qe i kënaqur, për rakinë e papritur apo për ekspresin e fshatit.

— Turk, — ndërhyri urtazi plaku dhe kështu bujtësit e klubit e dëgjuan për herë të parë që fliste.

Shoferi u habit se kafe turke ai s'kishte pirë asnjë gjatë gjithë rrugës.

— Aha, — tha bufetieria, — prokopia vetë. Filluan të na vijnë dhe turqit. Vetëm turq s'kanë ardhur te ne.

— Jo, moj shoqe, — iu kthye shoferi, — c'ia fut kot. Plaku nuk është turk.

— Mos, more, na kandise! — u zemërua tjetra. — Po ç'është? Arab?

— As turk e as arab. Është shqiptar nga fshati juaj, — tha i sigurt shoferi.

Të gjithë ata, bujtësit e klubit, që dëgionin c'thuhej, u hutuan dhe u shushatën fare. U bë ajetësi për një çast dhe vetëm ekspresi shfryntë. Nikoqiria e ekspresit nuk u dorëzua përsëri:

— Po shqip a flet ndonjë cikë barba. o xhan?

— Pvet ajo si për një të sëmurë kur thuhet «a ka oreks»!

— Jo, nuk flet e as kupton shqip fare.

— Fare, fare?! — pyeti prapë kafexhesha.

— Hiç, tapë tōpi, — sqaroi shoferi. — Plaku ka ardhur turist. Shokët e tij ndaluan në Durrës, tië plazh, Kurse këtë, më thanë shokët e «Albtrizmit», çoje me kujdes, si televizor, në Bunovë. Le të rrijë se ka nevojë, të çmallet, dhe pastaj sille prapë në Durrës.

Burrat, ne, që pënim kafen e rakinë në klub, nuk e njihnim. As ai nuk njihte njeri nga ne. Ai vetëm dëgjonte, dhe kthente kokën herë pas here. Koka e plakut lëvizte si luledielli sa te injéri te tjetri.

Dukej, që plaku diçka kërkonte, por s'e shpreh-te dot. Dhe, tek surbte kafen, avash, avash, ple-qërishte hesapi, me sytë mbushur me lot, mbase i digjte 'kafja,' papritur tha një fjalë tjeter.

— Beno!

— I pëlqen kafja! — u gëzua banakierja jonë, që nga gjithë italishtja 'dinte' vetëm «bene».

— Jo, — tha shoferi, duke e shuar entuziazmin e bufëtieres sonë, — më duket se këshfu e ka emrin, Ben.

— Ou, — tha shkurtazi mësuesi i historisë, që tashmë duhej të kishte hapur muzeun e fshatit, — shih sa çudi! Ç'ma doli edhe një Arben plak nga Amerika.

— Nga Australia, — sqaroi shoferi.

— Jo, — kundërshtova unë, — Ben është emër i ri. Përpara nuk vijnin emra të tillë.

— Ku e di, ti, — ndërhyri kujdestari i muzeut. — Ti nuk je gjendje civile!

Dhe në këtë minutë u fut në lojë, në bisedën tonë; barba Piloja, plak, pensionist, ish-dyqanxhi i fshatit.

— Po, këshfu është, sic thua ti, — më përkrahу barba Piloja mua. — Po ky zotëria këtu duhet të jetë Beno. Bash ngas fisi i Benet, që kanë qenë poshtë, te Shëjani kryeprerë.

— Tek Ura e Benet? — pyeta unë.

— Nën të. Por s'janë më. Janë shuar, — i vuri pikat mbi «i» Foto Goxhoja, pa e fshehur dot keqardhjen. Foto Goxhoja është baba dëshmori dhe ka qenë ujk i deteve. Nostrom karavi. Është ai që dhe sot e kësaj dite mban kanotierë me vija si marinaret.

Plaku, mik nga Australia, nuk dinte shqip. Ne të tjerët s'dinim anglisht. Pleqtë e plakur, që dini gjuhët e botës, kishin vdekur. I fundit prej tyre, që dinte anglisht, amerikançë, siç thoshte ai, barba Kiçoja i Shantet, vdiq vjet. Turizmin e Sarandës, që ka përkthyes, e kishim larg dhe plaku australian mbeti si vuv në mes tonë, burrave dhe banakieres, që përpinqej të merrte e të jepte me të me dy fjalë italisht.

Dërguam kujdestarin e muzeut të thërriste Ish-priftin e fshatit. Prifti i dikurshëm zakonisht vjen më vonë në klub. Ai ka pasur librin e kishës dhe na ka pagëzuar.

Urata erdhi dhe i dha dorën plakut mik. Çoc i foli, por ai tjetri vetëm tundte kokën dhe diçka belbëzonte. U duk puna që po turpërohej Bunova. Ata s'u morën vesh!

Kapelja republikë e priftit të dikurshëm, e zezë si rasa që mbante njëherë motit, dukej sikur bisedonte atje mbi mësallën e tryezës e merrej vesh kollaj me kashtoren e bardhë, havajane, të plakut australian. Thua se kapelet ua bënин përinat dy pleqve. Ish-prifti ishte vërsnik me plakun, ndaj s'kishte pasur si ta pagëzonte. Me siguri duhej ta kishte pagëzuar arkimandriti i Ndrerëve, i ati i këtij ish-priftit tonë. Por, kur flasim për baballarët e pleqve shtatëdhjeteca-vjeçarë, qofshin këta dhe peshkopër, humbet kuptimin kujtesa dhe merr pushtet harresa. Ata kanë vite që nuk bëjnë hije mbi këtë dhë. Po le

t'i lëmë të vdekurit me të vdekurit dhe të vazhdojmë historitë e të gjallëve.

... Kafeneja ra në qetësi, aq sa dëgjohej «fafapi» që bënte rrecka e filxhanëve të bufetieres, tek përpiquej të vriste Mizat. Fap... Fafap!

— Mirë miku, që s'di gjuhën, po dhe Mizat na duhen! — tha mësuesi i historisë, i cili, ngaqë ishte munduar se kishte thirrur e përcjellë uratën, tani pinte rakinë bakshish.

Ne të tjerët s'e kishim mendjen tek ai. Ndihej thellë që neve, burrave të fshatit, po na vinte më shumë rëndë sesa keq që nuk ishim të zotë të lidheshim në fjalë me këtë plak të Australisë. Kjo s'na kishte ndodhur prej vitesh ndonjëherë, që të vinte tjetri mik dhe të mos kuvendonim dot me të. Të mos këmbenim goftë një. llaf sa përmall.

— E kanë fajin ata të «Turizmit», — e prishi qetësinë vrásëse banakierja jonë, — ç'na i dërgojnë këta të zez pleq pa njeri!

— C'faj ka «Turizmi», — u mbrojt shoferi. — Ai kérkoi të vinte vetë këtu në fshatin e lindjes. Kujt i shkon mendja që ky as njeh dhe as e njeh njeri përbë këtu.

— Hajde, mendje, hajde! — shfreu gjithë zemërim barba Piloja, që, si dyqanxhi që kishte pasë qenë, pak më parë u porositi rakinë miqve nga xhepi i tij, — po sa rrënjjëhumbur ka fshati ynë në dynja ku t'i njohë të gjithë!

— Jo, nuk them, po sidoqoftë... — diçka deshi të shprehte përsëri shoferi, por e ndërpren bufetierja jonë.

— Po ti, mor zotni, pse nuk di anglisht? Pale, je dhe shofer turistësh!

— Jo, moj shoqe, qne! Unë jam shofer taksie, ka të tjerë shokë të specializuar për anglishten të në.

— Plasi shkenca sheshit! — tha ish-dyqanxhiu plak, që kishte mundur pak më pare të zbulonte fisin e moshatarit të tij australian. — Që kur filluan të specializohen edhe shoferet në gjuhë të huaj, ra vlera e parasë. U benë profesorët pesë një lek.

— Nuk e kanë fajin arsimtarët, barba, — tha mësuesi i historisë. — Fajin e ka seksioni, që neve në shkollë na ka vënë të mësohet rusishtja. E kam ngritur kaq herë në analizat vjetore këtë çështje.

— Dhe s'të kanë dëgjuar? — e ngacmova unë.

— Po. Jo! — korrigjoi ai. — Vini, bre shokë, u kam thënë, anglishten ose frëngjishten, se na turpëruat fare. S'merremi dot vesh me njeri, që kur fshati ynë u bë Luvër, plot vizitorë të huaj.

— Ç'Lluvër, — tha Piloja, plaku i Taset, — Mekë e shkuar Mekës. Të gjithë vijnë për haxhillerë e marrin dorë më ne.

Urata, sa dëgjoi Mekën, harroi e bëri kryqin, pastaj u kujtua dhe filloi të zbërtente jolekun. Meka nuk është Patriarkana!

Ne të tjerët heshtnim, nuk donim ta cingërisnim historianin tonë gjuhëhuaj pa folur, se, po të tallje atë, në fund të fundit tallnim veten, se ai kishte mbetur nga intelektualët kryesorë të fshatit, përderisa përgjigjej për muzeun dhe historinë e tij.

— Edhe ti, mor i uruar, — iu kthyte Foto Go-xhoja, nostromi i deteve, mikut të largët. — Turp! Si e ke harruar gjuhën e mëmës dhe të tatës! Ja dhe unë kam bërë kurbet me karavë të Caros, në Detin e Zi. Flas rusçe po e po, por flas dhe vllahçe e çobançe po deshe. Por shqipen s'e harrova. Po të futemi më thellë, më natë akoma për zotrote. Ja, urata! Ka qenë në Patriarkanë të Kostandinopolit dhe vërtet mësoi greqi-

shthen, sa na meshoi një jetë, nget dhe turqishten, sa për t'u gjendur në muhabet, herë bëhet tebtile Krisht e herë Muhammed, por gjuhën e mëmës e flet hakçë. Dhe unë ia kam zili. Se vërtet ka qenë prift e derë prifti, por më përpëra kish lëre shqiptar.

Australiani dëgjonte, donte të fliste e s'fliste dët. Ai kishte një hall të madh, që i ndihej në sy, tek i lëvizte si t'i kishte të foshnjave. Ndihej në çip të buzës, tek i ngrihej e i ulej prerë, i ndihej në ballë, tek shtoheshin e hapeshin brazdat e rrudhave të thella. Por ja që goja s'ia thoshte dot. Ajo i rrinte e mbyllur si dera e kishës. Ai tundte kokën e madhe dhe dukej se i tumirte të gjitha kritikat.

— Eh, — psherëtiu thëllë Pilo Tasoja dhe u duk sikur rënkuan me të bashkë dhe mustaqet e gjata deri te veshi.

Besoj se e keni vënë re, që deri tanë ai dhe banakierja jonë gjenden më shumë në bisedë. Patjetër që ky duhet të jetë diçka si ves profesional, sepse, siç e dini tashmë, derisa doli në pension, ai ishte dyqanxhi i fshatit. Dhe si çdo dyqanxhi i zoti, një jetë të tjerë kishte qenë i detyruar t'i jepte xhevap gjithë fshatit.

“Ai vërtit tespihet koqe-koqe, sikur numëron paratë dhe jo fjalët.”

— Eh, — përsëdyti ai, — tashti dhe ne, pleqtë, që kemi imbetut, jemi, siç thotë kënga, si ai kau në brinjë, që i kanë dalë kokallat dhe as për punë e as për mish nuk vlen. Pse, pleq jemi ne, që s'dimë inglizçen? Pleq qenë ata, që vanë e prehen në Shënspiridhon: Ata qenë ç'qenë! Në dag, kuvendorin dhe me mbretëreshën e Anglisë dhe e shushatnin fare. E tërbonin e i shkulnин kapakun e truve. Nga anohin ata, anonte kandari. Ne s'jemi as për çoban mahari!

— Jo! — kundërshtoi i zemëruar Foto Goxhoja. — Jo! — dhe goditi fort me llullën plot tryezën, sa duhani u shua. — Ti zër hasha veten tënde, por jo burrat e fshatit. S'të ka vënë një tellall përmallin tonë. Ata që qenë, na lanë, patën radhën dhe vanë, ku do vemi të gjithë një ditë, a mos vdekshim kurë, o Pilo! Vec, mbaj vesh mirë, nëse nuk dimë në këtu, që pimë kafen e Gones (Antigone quajnë banakieren tonë), ka të tjerë burra fshati që e bilbilosin inglizçen. Po Peculin ku, e le, pse e harrove?

Peçuli është mjeku i fshatit.

— C'më thua, Goxho! — ia ktheu Piloja i Tësos. — Me një lule s'vjen behari, as vëtëm me gozhëdë nuk mbahet dyqani.

— Kur qeshë unë një viti dyqanxhi, dhe s'di a ishe ti këtu në Bunovë apo zije akoma peshk atje tutje, Shëngjinit, erdhë te ne një njeri i kartërave nga Franca. Gazetar i madh. Të kujtohet? — pyeti, kot Pilo Tasoja, se e dinte që dhe ai tjetri mbante mend mirë.

— Këtu kam qenë, por nuk mbaj mend a e mbylle ti dyqanin aherë, — mori hak Foto Goxhoja. — Por dhe në paç lënë dyqanin hapur a mbyllur, puna jote!. Por ç'ke, mor zot, që shan fshatin. Ti je gjuhëkarfosur përvete. Përveç bu novçes s'di gjuhë tjetër!

— E c'më duheshin gjuhët e botës mua. Tregti me amerikanin e ingлизin nuk bëja. Më mjaf-tonte gjuha e tatës përpazarin tim.

Nostromi i Goxhet nuk e ngau më. Le të vazhdonte tjetri të tirrte historinë e tij.

— Kur erdhë atë vit gali, francezi, — sqaroi Pilo Tasoja, — bënte vapë e madhe, sa të merrei fryma. Korrik ish dhe të korrte dielli. Ne luanim ballotë tek Ulliri i Gjikët, Pranë kishim klubin. Pak makina kalonin dhe na kishin zënë re-

hat veshët. Shoferët udhëtonin më shumë natën se ditën, që të mos i digj e piq si saç kofonua e maqinës. Mirë e kishin të varfrdit. Ish vapë që tërbohej cinxuri e pëllcit e çahëj si karpuzi, jo më njeriu.

— Ka qenë atë vit, me siguri, që thonë se mallkove fshatin, o barba Pilo! — mori hov banakierja si ato vajzat e teatrit. — Ka qenë atë vit që nëme e lastimise keqas: Akratata! Akratata! O fshat i djegur! O fshat i përvëluar! E c'pate, o gjerman, që vetëm e dogje këtë fshat?! Pse na le të vuajmë këtu? T'i kishe vënë tërmetin, të kishe shkulur shtëpitë nga themelet, të kishe përmbysur ullinjtë dhe fiqtë, të kishe gremisur malin e t'i kishe nxjerrë ujë të zi. Pse, fshatështëky, që digjet e piket njeriu në gür të thatë, si peshku në tigan? Akratata! Akratata! Një pikë ujë, një cerrë, që të ngjallet guri e druri dhe të mbahet shpirti!

Gjithë këtë mallkim, të gjatë, këtë monolog marramendës të barbës, bufetierja jonë Antigone e përcollë me një frymë dhe gjithë temperament rinor, aq sa u lodh dhe piu ujë. Jo një cerrë, ujë, por një apallalle.

— Ashtu, eshtë, bijë, më pac uratën. Njëfarsëoj mallkimi të tillë bëra, se më mirë në Jemen se tek ne atë behar e atë mot. Kuit i shkonte mendi që do bëhei rezervuari det dhe nga Gurra do të vinte uiët, ilaci i jetës, derë më dërë, në çdo shtëpi. Atë mot vërtet mallkimi na kish mbetur. Të shkuara e të harruara, bijë! Të gëzoc të ritë e tu! Mirë! Llaf me konak na the! — Sikur ato fialë të mos ishin, të tijat por të asaj. Llafet s'janë mall, ato as hahen as shiten. — Dhe, që thoni, ju, që s'thatë gjë hiç, erdhi frëngu i gazetës dhe qëndroi këtu. Ne e lamë një cast loiën në mes. Lamë ballotën dhe trapullat. U ngritëm

dhe i dhamë dorën. Ajt na u lut të mos e prishnim lojën për të. Dëshirë e mikut, úrdhër për ne. Vazduam ballotën. Ai u unj në potom përbri meje. Pyeti c'fshat ishte, i thamë emrin. Sytë i mbanim për trapullat, gojën për mikun. Pyeti pse ish i djegur ky fshati ynë, i thamë për lufftën që kish bërë. Domethënë, ne dëgjonim e flisnim, kurse përkthyesi përkthente. Për atë paguhej. Ish vapë, thashë, dhe ne prisnim të binte mugu i pasdrekes vonë, që të merrnim një çikë frymë rehat.

Ndaj rrnim nën ullirin e madh të Gjiket, që vlen sa njëqind kondicionerë bashkë dhe që, po ta keni vënë rrej me një pikë merak, në behar, njëjan si rrjetë, tendë e mbushur me sardele. Janë fletët e ullirit, që kthejnë në të nxehtin e keq janë e poshtme drejt qellit dhe duken si cironika që kanë kthyer barkun e argjendtë përpjetë.

Francezit nuk i shkonte mendja për këto që ju thashë. Ai donte të dinte c'ish ky fshat e deli fshat, i djegur e i përcëlluar më ligsht se Verduni. Por atë vit jetonin burra në fshat. Ishte lisi i madh me shumë degë, Kiçó Shantua, që kish llafosur me vetë presidentin e Amerikës, Uillsonin. Ishte Velua i Gjinet, që merrte pension nga Kanadaja dhe herë me paratë e saj paguante tellallin për shaka, të thërriste, kur s'é kish gruan në konak: «Mbani vesh, o fshat! Kush nuk e ka gruan në shtëni, ta kërkojë e ta giejë tek e ëma!» Në e pastë plakë, pa në pastë të re, nuk e siguroj dot! — Shtonte ai vefë pa tellall.

Ky, Velua i Gjinet, kish bërë kurbet në Kuebek e, tok me bagëtinë që kish therur e shitur në kasaphanat e Kanadasë, kish blerë dhe gjuhët e vendit, atë të galëve dhe të bretañeve. Velua ish ai që vuri një moti tellallin prapë edhe për ato llafet e nakatosurë, saqë shumë ia mörën për

ters e pér tē liga. Prej tij i kemi ato, kur thirri tellalli: «Mbani vesh, o fshat! Kujt ia kam ngrënë e ia kam pirë, le tē vijë sonte tē ma hajë e tē ma pijë!» E kish llafin pér drekat e darkat që i kishin shtruar e pér atë borxh që do t'i kthente fshatit atë darkë. Ngatérrohen dhe shenjtorët ngandonjëherë!

Papo ishtë Kokashi i parë, jo ky i sotmi, që me gjithëse gjithë Bregu e dinte që qe stërnip i Karl Thopisë, mbretit të parë të Krujës dhe Durrësit, nuk e mbante veten pér derë tē madhe e as tundte këmborën e saj. Nuk e zinte në gojë sojin e tij, por në muhabet, si ky që bëjmë tashti, kujtonte vitet që kishte luftuar në Spanjë me Internacionalen. Pastaj qe dhe Gjikë Strati, që kish gjezdisur botën me karav, dhe jo vetëm detin e rusit, Goxho vëllai, e që fliste jo çobançen, por dhe gjuhën e zhaponit. Të tillë burra qenë, q'të mollois më, se do t'i zërë lemza atje ku janë. Ane, ane, q'tret dheu!

— Mirë ata që i ha dheu, po ju, që ju mban dheu; nuk jeni burra? — ndërhyri si gjithnjë bu-fetierja jonë, që nuk e kishte gojën vetëm pér tē ngrënë.

— C'burra! Papo ne jemi burrecër! — ja preu Pilo Tasoja.

Banakieria buzëqeshi e kënaqur pér pohimin e zhburrërimit tē pleqve tanë tē klubit. Po Pilo Tasoja nuk ishte nga ata që tē linte tē gëzoje gjatë. qofsh dhe kafexhesha e vetme e Bunovës. ndai shtoi: — Burrecër, bashkë me atë Pavllaqin tënd (i shoqi, i banakieres), që është kryeburreci, pérderisa tē lë ty t'ia hipësh përsipër.

Banakierja u skuq dhe, sa t'i dalë turpi asai: po ju sqaroj nja dy gjëra që më duket se kanë nevojë. Do thënë që në fshatin tonë letrat e bixhozit i quajnë trapulla që, pér një kohë tē gja-

të, unë kujtoja se është fjalë korfiote. Por, siç ma shkoqiti mirë njëherë një profesor i shquar i shqipes, që mballari këpucët tek unë një ditë, trapulla rriddhka nga spanjishtja apo nga italish-tja e Napolit dhe u përktheka *gënjeshtër* apo *mashtrim*. ra atë pasdreke me vapë, kur erdhi gazetari francez në Bunovën tonë, pleqtë e parë luanin letrat, spasonin me to në ballotë, që ësh-të po kështu lojë e sjellë, importi, nga Parisi apo nga Montekarloja nuk e di. S'ju gënjej dot. Për të tjerat që ndodhën asaj dite, e ka fjalën përsëri Pilo Tasua ynë, dyqanxhiu i dikurshëm:

«Kur flit injeriu i kartërave nga Franca dhe përkthente Galon ai djali nga Tirana, ndërsa ne vazhdonim dorën e ballotës, erdhi plaka e Skuret. E fundmja e fisit të Skuret më kërkoi të hapja dyqanin së kish mabetur pa kafe, si kisha pa korë. Ungrita, llaf i saj ligj përmua, dhe i bëra më shenjë Galos ta vazhdonte lojën time, sa t'i jepja nikqires së Skuret kafen. Ia dhashë, më dha uratën. Kafja më kujtoi mikun e Francës dhe i bëra zë Vaso Dukës me një cilimi të vogël që të vinte të hapte klubin se kishim miq të huaj në fshat. Jo se s'kishim shtëpitë tona, që t'i jep-nim kafen mikut, por kush ish ai që prishte lojën, qoftë dhe për jabanxhi nga Franca.

Vaso Mayria, rrët e fët, erdhi. Paçka që e kish pushim atë ditë. S'kish orar përtë, o zemra ime, siç kërkon ti, Gone, sot.

Plaka e Skuret u ngatjetua me pleqtë dhe u bë gati të ikte në punë të saj, të piqte kafen taze në kullën e Skuret, me qebap të turkut. Atë çast Kiço Shantua i tha plakës: «O mëma e dje-met. A s'ia kthen një llaf këtij frëngut, se e kemi mik.» «Vau, korba, — tha plaka, — si s'e pashë!» — dhe u fut e fundmja e Skuret me francezin në újërat e gjuhës së atij vendi. Bon-

zhur mësje e bonzhur madamë. Fol ai e bilbilos ajo.

Një copë herë kështu. Përkthyesi s'përkthente më. Ku ai e ku plaka e Skuret! Pleqtë tanë dëgjonin e qeshnin sa përvete. Më shumë me sy e vetulla se me buzë, bash si lordët e Ingliterës.

Plaka e Skuret i kish pasë thënë frëngut: «Ç'të bësh, jeto! Fshat i djegûr dy herë. Hem nga Duçja e hem nga Hitleri. Fshat me pleq shumë jemi e djem pak kemi, se na u vranë në luftë, kapedanët. Pesë djem si dreri, njëri më i bëkûr se tjetri, humba unë e varfra. Vanë djemtë e riuam 'ne. Luffuan djemtë e mëmave dhe për ju bonjakët e Francës, që s'e mbajtët dot të ligun nië Mazhinonë tuaj. U bëmë ne këtu fërtele, Verdun e më keq se Verduni dhe për djemtë e mëmave tuaja. (Unë aherë e mësova këtë emër, Verduini e historisë së Francës.) Po zot rote a ke luftuar?» — e kish pyetur aqik ajo. «Jo, — kish thënë gali. Më zuri rob gjermani dhe s'proftasa.» «Më mirë të ishe vrarë si të tjerët, — i tha plaka, — se kështu për jermanin kë qenë i vdekur e i pakallur në dhé.»

Pleqtë tanë nuk prisnin të përkthente përkthyesi. Ata tashti qeshtin lehtë, apo vinin buzën në gaz, sa për të mbështetur e dhënë të drejtë plakës të Skuret. Por atë gjuhë që flit lirshëm e fundmjë grua e Skuret, ai tjetri, miku i porsaardhur, e dinte qysh kur kish lerë. Kurse qesëndinë e pleqve, atë ironinë pa zarar, kur paksa përvilen buzët e ngrihen një çikëz vetullat, me një fjalë atë buzëqeshjen mëshirëplotë të pleqve ai e merrte vesh dhe pa ditur asnje fjalë në asnje gjuhë të botës. S'kish nevojë për përkthyes. Atë e mora vesh dhe unë, bakalli i fshatit. Demede, burrat pleq të fshatit i thoshin kë-

~~Boli~~ mikut «Mjerë ti, o orëzi, që të zuri rob gjermani pa shkrehur makar një kobure!»

Dhe papritumas gazetari pyeti, kështu ma përktheu ai qjali nga Tiranë: «Ju ditkeni frëngjisht, zotérinj!?» Dhe Kiçua i Shantet i tha anglisht se po, kuptonte. Dhe Velua i Gjinët ia ktheu se po, e fliste. Dhe Kokashi, që ishte gjak me Karl Thopinë, i tha se po, kish jetuar në Francë nja dy vjet pas Luftës së Spanjës. Dhe Gjikë Stratioti i detérave i tha se po, kish pasur një të dashur në Marsejë dhe një mikeshë në Bordo. Dhe vetëm Thomai i Kokushtet, që s'kish folur fare deri atë minutë, i tha se kish punuar një jetë në minierat e Sënt-Etienit.

Aherë miku, me inat francezi, pyeti prapë: — «Kur, këtu qenkeni mbledhur nga gjithë departamentet e Francës, pse nuk më llafosët që në fillim frëngjisht, por më vutë këtë zonjë të vuajtur, të veshur kallogre me të zeza gjithë, të më përkthejë!»

Vërtet plaka e Skuret çdo gjë e kish të zezë në trupin e saj, veç shpirtit të bardhë borë.

Shoferi i tij, i mikut tonë, që ishte djalë nga tanët, më tha: «Ç'ia bëtë mirë. Ke parë, o njeri, që kur kaluam Llogoranë, u bë limon i verdhë e s'foli asnjë fjalë. As detin s'donte ta shihje. Dëngla-xhi, punë gazetash! Kurse këtu tashti shet mend. Dhe kujt po i bën karshillëk? Juve! Po ju jeni bota!» — tha shoferi me gëzim si Kristofor Kolumbi kur zbuloi Amerikën.

Kiçua i Shantet, më i urti i pleqve tanë, i ktheu përgjigjen gazetarit: «Mor zotni, po ne mejtuam se ti na erdhe nga Franca që ka luftuar shekuj të tërë për emancipimin e femrës. Si mund të gabonim duke të vënë për përkthyes burrë! Do ishte turp për ne të mos sajdisnim emancipimin frëng me emancipimin tonë.»

Të gjitha këto Kiçua i Shantet i tha frëngjisht.  
«Xham, — më tha përkthyesi, — splendito!»

Gazetari s'ishte budalla. Ai e shijonte humorin dhe e pranonte si çdo francez i mençur. Dhe atëherë u interesua të dinte ç'kish dashur zonja plakë e Skuret në Francë. Për kalin e shpirtit! Si? Për bukën e gojës! Dhe ajo rrëfeu pastaj që kish votuar për Elionë atje në Lyon dhe kish pritur për drekë Marsel Kashenin. «Kemi qenë me Frontin», e sosi plaka sqarimin e kurbetit të vet familjar në Francë.

Gazetari, si piu e shijoi kafen e Vaso Dukës tok'me ne, u ngrit dhe, si ato nuset tonë të hershme, i puthi duart plakës së Skuret. Ajo nuk ishte vjetërr e Francës, por ia la duart e vogla si të ciliminjve t'ia puthë. Mbase frëngu iu duk si nuset e djemet që nuk i gëzoi dot. Dhe si i tha shqip «Hallall», ia ktheu frëngjisht: «Na urdhëro nga shtëpia, or zot!»

Ja kështu qenë atë mot pleqtë burra dhe plakat zonja, që turpëronin një botë të tërë, jo më Francën, me gjuhët që dinin e i flisin. Kurse sot kemi dy orë që s'gjejmë dot gjuhë për të lidhur dy llafë me këtë plakun tonë, që na vjen bujtës nga Australia. Vate, kaq e patëm. Sosëm e biti-sëm!

Australianët kishte pirë dhe rakinë dhe kafen e dytë turke. Atij i qenë mbushur sytë me lot. Dha e mori prapë me gjuhën e tij plot «du» dhe «shë», sa të shkonte mendja se po kërkonte dush për t'u larë. Megjithëse tanët ia kthyen prapë me shqipe dhe greqishte, rumunçe e turce, italishtë dhe rusishtë, ai prapësrapë mbeti i vetëm me veten e tij.

Pastaj ai bëri shenjë me gisht duke na treguar baulet, domethënë, kish të thosh që po i linte pak këtu. U ngrit. Pas i vajti shoferi, që

ish paguar për këtë udhë dhe mësuesi i historisë. Më pastaj u ngrit dhe Pilua i Taset, ish-dyqanxhiu ynë dhe u bënë kështu një bylyk pas tij. Paçë ç'paçë dhe rrët bëra dhe unë pas tyre dhe e lashë pa vajtur të mballosja shandallat e fshatit në dyqanin tim. S'mbetej, fshati zbathur për dy orë punë.

Plaku australian mbajti poshtë udhës së fshatit. Kaptoi urën e gurtë, që e ka ngritur Ali Pashai, zbriti e kërceu në arat e majoret dhe u hodh te kisha e Shënepremtes, që e kemi monument kulture, se ka pritur e përcjellë Çerçiz Topullin me trimat e tij. Pastaj doli te Buza e Malisë; Atje pushoi. Atje u ul. Prej andej duket deti si në pëllëmbë të dorës. Duket Portopalerma përbri dhe kundruall shihen nisitë e grekut: Dimali, Strakënaja, dhe Othonusi. Në kohë të mirë, tutje, tutje duket edhe Italia, por rrallë shumë.

Nga pas, si në skenën e teatrit, duket fshati ynë, kuti-kuti, si zgjua bletësh.

Australian i kish futur kokën midis duarve dhe qante. Ne u trembëm se mos gremisej nga buza e përposh. Dhe kjo na duhej, të na vdiste pa këmbyer një fjalë. Ne prisnim majekun, tonë që të vinte të përkthente e të mësonim ç'e mirë a hall e kish zënë plakun, e jo t'i bënte autopsinë. Ne iu afroam me të urtë dhe Pilo Tasua i dha një cigare të dredhur, jo aq sa përtat qetësuar, por t'i hiqnim mendien nga buza e humbëtira e sai. Ai duhanin s'e mori. Qante dhe i pikonte loti i madh sa një bërthamë ulliri. Dicka foli në nga shërim e sipër. Mësuesi i historisë tha se foli shqip. «Të gjorit dhaskal, ngaqë s'di gjuhë tjetër dhe australiana i duket shqip», — tha Pilo Tasua. Ne të tjerët sikuptuam që. Po mësuesi përsëri nguli këmbë që plaku kish thënë «Maria. E

re». Për kë ta kish fjalën? Për retë mbi det? Për vajzat e reja te stalla e llopëve matanë? Apo kushedi, mbapse për kishën, që dukej e re fare, se e kishin meremetuar ata djemtë e monumeteve? Për kë vallë?

Mësuesi ngulmoi të na mbushte mendjen:

— Me siguri flet për Malinë, atë dëshmoren që u hodh këtu për të mos rënë në duart e bashibozukëve të Xhaferr Devës. Ndaj i ka mbetur dhe emri Buza e Malisë.

Mësuesi i historisë kish marrë huqet e ciceronit të muzeut. Ai harronte se ne ishim gjirë të gjithë me Malinë dhe e njihnim si bijën a motrën tonë. Sos ishim turistë, që të na bënte biografinë e vajzës sonë.

— Jo, — kundërshtoi me forcë Pilua i Tasset, — kët e ke. Ky nuk ka qenë këtu gjatë luftës që të dijë historinë e saj. Ndaj s'ka si të qajë e të flasë për Malikon.

— Po! — tha mësuesi mendueshëm. I dha të drejtë Pilo Tasos me atë trajtën përkëdhelëse «Maliko», apo imbeti në mendimin e tij, nuk e morëm vesh dhe as pyeti njeri për këtë.

Australianit nxori nga xheri i brendshëm i xhaketës një kuti sa një paketë cigaresh. Ishte aparat fotografik. E drejtoi xhamin nga buza. Shkrepit dhe u vulos përijetë kio humbëtirë në kuadër. Mua më pikoi shpirti. M'u kuitua Malia. Ishim rritur bashkë. Dhe s'di si më erdhi dhe ia thashë këngës vaj:

*Tek shkoje udhës tënë,  
Bijë, bijë, o Mali.  
Mercenari, qën, i qënet,  
Bijë, bijë, o Mali.  
Të tha ndal, no ti s'ndalove,  
Bijë, bijë, o Mali.*

*Nëpër plumbë shkele, shkove,  
Bije, bijë, o Mali.*

*More krahë e fluturove,  
Bijë, bijë, o Mali.*

*Permbi gryka, përmbi hone,  
Bijë, bijë, o Mali.*

Vajit tim ia mbajti Pilo Tasua e ia ktheu mësuesi i historisë. Plaku i largët qante me lotin pikë-pikë.

Kerryem mallin për motrën dhe bijën tonë dhe u ngremë.

E morëm plakun australian me vete dhe vamë për atje ku qemë, atje tek kishim lënë baulet e mikut në klub.

Mbase ka ardhur doktori, mendonim tek ktheheshim. Dhe ja, vërtet kish ardhur. Ù poqëm me jatruan te ura e gurtë e Aliut. Kish dalë të na prit. I foli plakut në gjuhën që dinte. I ndritën sytë australianit, sikur takoi të birin. Dhe biseduan shpejt e shpejt, si ca që nxitojnë kur përtypen në davetet e fshatit se mos mbeten pa hise.

Në klub na prisnin banakierja Antigone dhe bujtësit e zakonshëm. Tashti ishim çiruar, siç na sqaroi mësuesi i historisë, nga kompleksi i inferioritetit që na kish pushtuar ca më parë. Me një fjalë tashti kishim shpëtuar nga poshtërimi a turpi që nuk flisnim dot gjuhën e mikut. Kishim djalin tonë, doktor Peçulin, që flit e shkruan anglisht.

Pimë prapë rakinë. Uruam tamam e ù kup-tuam me taban për gjithçka. Na qerasi jatroi.

Bashkë me qerasinë e mirësinë ai na sqaroi ç'ish dhe pse kish ardhur plaku nga ana e anës.

— Plaku mik është Boni i Benet. Ka ikur këtej nga ne pesë vjeç. Shqipen e ka harruar se është

rritur pa nénë. La kanë vrarë të émën te Buza e Malisë. La ka vrarë jo babai, por i ungji. Ai paska ardhur nga kurbeti enkas pér kétë dhe e paska vrarë. Me porosi të véllezérve. Pra dhe me lejen e të shoqit të mémës së tij.

— Me urdhér të tatës i kanë vrarë mémën! — ndérhyri Pilua i Taset. Nuk ishte faji i doktorit që muhabeti i pérkthyer ngjante shpesh me një türkuze gombo-gombo. Varej nga leshi i türkuzës, herë i dhirtë e herë i delet, sipas asaj, si e thosh fjalën plaku nga Australia.

— Shih, shih! — thirri prifti i dikurshëm. — Qenka i' biri i hallë Shinës. E dini dhe ju historinë, — na u drejtua neve të gjithëve. — E vran i kunati si pér punë nderi. Mëma më ka thënë se hâpën Palajt fjalë që gjoja shkon me një djale të fshatit. Puna ish që të ikte dhe kjo, o më atë botë, o më këtë botë, jashtë vatanit, që të merrnin mulqet, ullinjtë dhe nerënxit. Burrat ishin të tére në kurbet, ajo e mavrisura grua e mbante zjarrin dhe llambadhën e shtëpisë.

— Po, — tha Pilua i Tasos, — éshtë dhe ajo kënga pér kunatin: «Sorkadhi që shkel mbi mëndra, s't'u drodh as dora as këmba.»

— Jo! — tha plaku i Goxhet, që kish bërë kurbet në Rusi e në Det të Zi. — Jo! Kënga e vërtetë éshtë: «Sorkadhja që shkel mbi gjëmba, s't'u drodh dora, s't'u drodh këmba.» Se ajo u vra, e varfra, dhe s'inxori zë fare.

Mjeku i pérkthente australianit Bonit të Benet i ndriste bebjë e syrit. Atij i pëlqeu kënga e Goxhos pér të émën.

— Ish si ish kënga, që si që ajo, s'ka rëndësi. Palajt ia arritën qëllimit. Shpifën si deshën dhe gruaja u vra! Kurse djalin, zotin Beno, e mori me vete xhaxhai vrasës. Ikën Benajt të gjithë dhe mulqet u mbeten Palajve si shpérblim, që u

kishin shpëtar nderin Benet! — e sosi historinë e fisit të plakut prifti i dikurshëma që dy djemtë i ka komunistë.

Australianin, Bonin e Benet, e mori për mik plaku i Goxhet, që kish nip doktorin dhe në shtëpi kish akoma plakën gjallë e hiçnjeri tjetër.

Dhe në Goxhaj u mor vesh që vërtet i ardhuri te Buza e Malisë kish pasë thënë «E re». Dhe se mësuesi ynë i historisë, që ngatërron gjithë historitë e fshatit se nuk ka taban në libra, e kish dëgjuar tamam plakun. Tashti kujdestari i mëzeut s'pushonte më dhe mund të thoshte pa mërak për të tashti «hingëllin e s'mbahej kali»!

Benua i Benet paska përsëritur atje te Buza e Malisë, pas shtatëdhjetë vjetësh, fjalët e xhaxhait tëtij që, pasi vrah të kunatën, e vrah gjaku i saj dhe tha: «Mavria! Kaq e re!» Dhe këto fjalë nuk i harroi ky miku ynë i largët sa qe jëta! Kudo që ish e kudo që vajti.

Nejse, historira të shkuara e të harruara. Për plaku i urtë erdhi e s'tundej më nga Bunova jo-në. Deshi ta shkulte Australia, që bëri protestë me anë të një legate në Tiranë, se po i mbanim me pahir shtetasin e saj Bonin e Benet. Atë asnjieri nuk e mbante me zor e as me detyrim. Jo!

Ai, si u njoh me fshatin, si u njoh për gjak e gjiri me mëhallën e tij, hapi zemrën e tregoi chall i madhe kish sjellë kaq vonë në dhë të lindjes. Plaku, atje, në Melburn të Australisë, kish një djalë pesëdhjetëvjeçar, në "lule" të burrërisë, që i kish mbetur pa martuar. Dy të tjere i kish trashëguar, një me japoneze e tjestrin me çifute të Spanjës. Për këtë të tretin donte nuse nga Bunova, nga fshati i mëmës së tij.

Ju thashë unë qysh në fillim që nuk i ka dalë kota nami fshatit tonë! E shihni tashti, deri në fund të botës!

S'kish nevojë pér tellall pér ta marrë vesh hallin e plakut Boni gjithë fshati. Derë më derë e gojë më gojë lajmi mori dhenë. Por asnjë nga vashëzat tona nuk e kish atë mall. Ditet iknin, muajt kalonin. Boni plak rrinte e priste t'i mbushte mendjen ndonjërs. Vajzat e dëgjonin sa pér t'i bërë qejfin, i qanin hallin dhe martoheshin me djemtë e vendit njëra pas tjetrës.

Boni plak, në mug të jetës, mësoi dhe shqipen, gjuhën e mëmës, por nuse përf të birin s'gjeti. Babai, dhe djali kartékëmbeshin midis tyre dendur dhe çunave të mëhallës së Bonit në Bunovë iu shtuan pullat e Australisë.

Shkuan dy vjet dhe, pa ç'pa, Boni plak e vithisi mendjen që nuse përf të birin s'do të merrte dot. Atëherë të paktën të v'diste në vendlindje. I dhámë pastaj atij një nga shtëpitë e fshatit, se dhe sot ë kësaj dite ne kemi mjaft shtëpi të lira, që kanë mbetur pa zot që nga lufta. Mori shtëpinë, ia mbuluam me çati. I vimë dhë dhrinë dhe presim të ziejmë dhe rakinë. «Lërmë, o zot, të rroj!» — thotë Beno plaku. Australia s'kujtohet më përf të. Me siguri e ka shuar nga regjistrat e vet. Kurse ai, përf inat të saj, rron e gëzon shëndet të plotë. Ai mbeti te ne dhe është harruar pse ka ardhur...

Vetëm unë, kur i ndreq ndonjë palë këpucë, e pyes: «Shollë kangurësh, barba? Këpucë australie!» Ai qesh dhe thotë i qetë: «Shollë vendi, o bir! Këpucët dhe gruan merri nga vendi yt!» Dhe kjo të kujton përse erdhi e mbeti te ne plaku Ben!

## KASOLLJA DHE PATA

Kjo që do t'ju trëgoj nuk është përrallë. Kjo ndodh me njerëz të rrallë, për të cilët tërë jetën ke mall.

Bashkë më agronomin e kooperativës dhe mësues Kolën i vajtëm për vizitë Vasilit. Pranë shtëpisë së kulturës të fshatit unë bëja pu nën prodhuese. Me Kolën, mësuesin pensionist, themeluesin e muzeut të fshatit, sistemuam ato ditë, natyrish mbrëmjeve se ditën bëja pu nën prodhuese, dokumentet e historikut të fshatit. Kështu që diçka na bashkonte të dy, dashuria përlashtësinë. Agronomi, për çudinë time, ishte tifoz i «17 Nëntorit» dhe jo i «Traktorit», siç e

donte vendi; dhe përvëç kafes, që e pinim bashkë, vetvetiu na bashkonte edhe meraku për skuadrën tonë të futbollit, që ecte me hope.

Vasili kishte hyrë në letërsi, siç kam treguar édhe herë tjetër, si njeriu që ndiqte kuaj dhe, për më tepër, ato ditë pritej edhe grupi i kinastëve që do të xhironte filmin për historitë e Vasilit dhe të kuajve të tij. Halli më i madh i Vasilit ishte që a do të qe djalë i zoti, aq sa ai vetë, artisti që do të luante ndjekësin e kuajve, domethënë Vasilin.

Këtë hall kishte Vasili. Kurse unë me Kolën kishim si problem të ditës ngritjen e kasolles-muze për fshatin. Në këtë fshat, gjatë dhjetë vjetve të fundit, ishin ngritur rrëth tetëqind shtëpi të reja, me një fjalë gjithë fshati ishte i ri, me shtëpi të kuqe, si thëllëza fushe, ato s'qenë suvatuar, dhe me disa të bardha si rosa gjoli, natyrishët ato që qenë suvatuar. Fshati kishte shumë gjelbérime dhe këto ngjyra të shtëpive dhe të fushës i jepnin atij një bukuritë veçantë. Tamam qilim Kosove. Që të mos e zgjatim mhabitin, puna ishte që fshati dikur qe me kasolle me mure të thurura me kallama e të mbushura më baltë e bajga lopësh bashkë dhe me çati të mbuluara me kashtë. Kuptohet, pa dysheme, por drejt e në dhe ndizej zjarri, pa vatër. Zjarri ndizej në mes të kasolles dhe tymi dilte nga një baxhë sipër në çati. Kjo ishte kasollja tipike myzeqare dhe tanj, mua, si inxhinier, më kishin vënë detyrë, bashkë me Kolën, historianin e fshatit, të ngrinim përbri pallatit të ri të kulturës kasollen-muze.

Unë e kundërshtova kryetarin e kooperativës se një kasolle e tillë, artificiale në çdo gjë, e shëmtuar sa s'bëhet do të stononte shumë përbri pallatit të ri të kulturës.

— Le tē stonojë e tē shëmtojë dynjanë, — nguli këmbë kryetari. — Le ta shohin fëmijët tanë se sa e keqe ka qenë jeta jonë pa Partinë. Ndryshe, do tē kujtojnë se gjithë jetën kështu ka qenë ky fshat, i bukur dhe se është bërë vetvetiu i tillë.

Logjikën e kryetarit unë e kuptoja, por s'e pranoja dot deri në fund. Se, ta hajë dreqi, nuk shkonte hiç kjo kasolle e improvizuar në atë vend. Shëmtonte jetën.

— Nuk vete atje kasollja, — kundërshtova unë.

— Do tē vejë, — nguli këmbë kryetari. Inxhinier, do tē vejë se s'bën! Ja, do ta shohësh edhe vetë.

Atëherë ndërhyri agronomi, tifozi i «17 Nëntorit» dhe tha atë që u bë shkak i përshpejtimit të vajtjes sonë te Vasili:

— O kryetar, po na dëgjo edhe ne një herë! Ne ikemi edhe një kasolle në fshat. Ka mbetur ajo e Vasilit. Le ta kthejmë atë në muze, i bëjmë shtëpi Vasilit dhe kasollen e tij e ruajmë siç është, me të gjitha orenditë. Do tē ketë më shumë vlerë etnografike.

Kryetari nuk e priste këtë. Mbësë kishë harruar a mbësë, kushedi, i vinte rëndë, që në fshatin e tij prapë, si përdreq, kishtë mbetur një kasolle si ajo gozhda e Nastrandinit.

— Jo, — nguli këmbë kryetari në tē vëten, — ai Shorja i djallit duhet ta kish liruar me kohë atë kasolle e t'i kishim ngritur shtëpi tē rë. Por nuk do, se thotë që këtu i dha shpirtin plaka e tij, këtu dua tē vdes dhe unë. Por, me c'shoh unë, Vasili do ná hajë dhe mua dhe ty dhe do rrojë njëqind vjet. Jo, jo! Kasollen e Vasilit dò ta prishim një ditë, por pranë pallatit ná duhet ajo kasollja-muze.

— Po pse tē prishim njérën e tē ngremë tjetrën, — tha agronomi. — Pse tē harxhojmë paratë kot? Prish kova e bëj kënaçë!

Kuptohej, që argumenti i agronomit mund tē peshonte, po tē ishte çështja pér shtëpi tē re, por pér kasollet nuk kishe si e shtroje dot kështu problemin. Megjithatë kryetari pér një hop sikur u hutua, por pastaj e mori veten prapë, pa hyrë në polemikë pér leverdinë ekonomike me agrominin, tha:

— Atë e di unë, br çun! Kasollja do ngrihet atje ku thotë kryesia. Se, që ta marrësh vesh ti, inxhinier, ajo e Vasilit është larg. Dhe nuk e merr malli njjeriun as pér njëqind vjet, që tē shkojë deri atje tutje Vgjeshtës pér tē parë kasollen, ku paska jetuar dikur myzeqari. Jo, ore! Këtu në mes tē fshatit tē jetë, që, kush e harron ç'kemi qenë, t'i plasin sytë e t'i bëhet haram qumështi i nënës!

— Nuk është aq larg sa e bën ti, kryetar, — tha agronomi, duke treguar edhe ai tashmë kokëfortësinë e vet.

— E, e, mirë, mirë! — u përgjigj, prerasi kryetari, sikur t'i thoshte atij tjetrit «hajde, baba, tē tē tregoj arat».

Unë u kapa pas fjalës së agronomit dheni erdha në ndihmë atij duke i thënë kryetarit:

— Por, po tē mos jetë larg, ia vlen që kasollen e Vasilit ta kthejmë në muze. Ai le tē jetojë atje dhe t'u tregojë edhe njerëzve pér jetën në tē kaluarën. Nuk ka ciceron më tē mirë, apo jo? Dhe ca më tepër që edhe shtëpitë e braktisura e tē lëna shkretë, pa njerëz, shkatërrohen pér dy-tre vjet, jo më një kasolle në mes tē fshatit, pa njeri, që do tē vejë si dhjamë qeni, pér dy-tre muaj. Apo do tē vini rojë pér kasollen, — pyeta unë jo pa ironi kryetarin.

Ai tani mbeti vërtet keq. Nuk dinte si të kundërshtonte. Ai e dinte mirë, si fshatar që ishte, që shtëpitë pa njerëz venë dëm si malli pa zot. Kurse për rojë kasollesh nuk u jepte dot kush organikë.

— Më hëngrët me të pabesë, — u qa kryetari. — Shkoni, inxhinier, njihuni në vend me kasollen e Vasilit! Po të jetë që ia vlen, ta kthejmë atë në muze, le të bëhet juaja! Taksirati im që duhet hapur rrugë e re për në kasollen e Shores.

Unë qesha nën buzë. Agronomi më shkeli syrin. Betejën e fituam. Kola tha:

— Mos ki merak, kryetar, do të bëhet më e mira.

Ne nuk vajtëm dot atë ditë te Vasili, na dolën punë të tjera. Lajmi për diskutimin tonë me kryetarin, lidhur me kasollen e tij, kishte vajtur para nesh tek ai.

...Dhe ja, ne jemi ulur në shesh në kasollen e Shores. Lart kashta e shtëpisë. Anash muret me kallam e baltë e bajgë bashkë e më the e të thashë. Në mes të sheshit zjarri dhe në zjarr stikat e Vgjeshtës, që na i pjek Vasili. Stikat e pishave të buta, e veçmas ato të pyllit të Vgjeshtës, i kanë thelpinjtë sa një majë gishti cilimi, janë të shijshme më shumë se bajmet e pjekura. Dhe kjo është gostia numër një që ka për miqtë e vet Vasili. Pastaj të vë përpara gotat e rakisë prej dëllinje, që, po të zuri, duhen tri ditë ta marrësh veten.

Diku nga nënjashtëku, që është pranë zjarrit (dhe unë çuditem se si nuk digjet gjithë ai lesh apo pambuk kaq pranë zjarrit), Vasili nxjerr kutinë e llokumeve. Ia kthejmë llokumet. Rakia, cilado qoftë, pihet mirë me thelpinjtë e pjekur të stikave. Ne bëjmë muhabet për gjëra të ndry-

shme, kurse Vasili ka qejf të tregojë si ndiqte në rini të vet kuajt e Vgjeshtës. Dhe çdo gjë që tregon ai kur flet, duket sikur e miraton një patë e madhe, që vjen rrrotull brenda kasolles, herë në shtroje e herë në enët e Vasilit dhe bën herë pas here ga-ga-ga. Dikur kjo ga-ga-ga e patës mua më duket si ha-ha-ha dhe unë qesh me Vasilin. Atij i vjen mirë që miku nga Tirana ditë dëgjojë dhe ia beson të gjitha.

— Kam zënë në jetën time dhe peshk dhë shpendë. Se gjoli ynë i ka të gjitha. Po si kapja e kuajve s'ka. Sa herë zija kuaj të bukur, më dukej se zija vetë perëndinë. Gëzimi i kalit është më i madh se gëzimi i gruas. Se më të bukur se kali dhe njeriu asgjë tjetër nuk ka jardisur kjo dynja.

Pata vazhdonte të bënte ga-ga-ga dhe vettvetiu vazhdonte miratimin e saj për gjithçka që fhosh Vasili.

Ju thashë që lajmi për diskutimin tonë lidhur me kasollen e tij kish ardhur tek ai para nesh. Dhe ashtu, midis historive të kuajve dhe të peshqve, u fut si ngjala në kosh mendimi i Vasilit për kasollen.

— More çuna, më thanë gjitonët që po i ngrihet pjaca shumë kasolles sime. Ehe, di Vasili, pa rri këtu. I kam thënë kryetarit unë dhe më përpara, mos më luaj nga kasollja. C'më duhet shtëpia e re, kur njerëzit do të kenë mall tadinë si kemi jetuar ne. Doni të bëni kasolle tjetër? Nuk ka vlerë ajo! Jua thotë Vasili këtë. Ajo është si lato shapkoret me kuçëndra, që mbajnë kalamajtë në shkollë. Zogu e ka fuqinë e bukurinë kur fluturon dhe jo dordolec majë stapit (me sa dukej, e kishte fjalën për shpendët e balsamosur të shkollës). Kështu dhe kasollja e re e kryetarit është bythëzbuluar në mes fshatit.

Këlu tek unë bini gjithë rininë, edhe Evropën po deshët, t'u tregoj si ka jetuar myzeqari.

Nuk e di a kish mbajtur fjalim më të madh Vasili ndonjëherë, po mua m'u mbush mendja top që ciceron si ai nuk bëhej dot i dytë në Myzeqe.

Dhe pata përsëri bënte ga-ga-ga...

— Nxirre jashtë patën, o Vasil! — thà agro-nomi, që, me sa dukej, pata e bezdiste me atë zérin e vet të çjerrë dhe tallës.

— A, atë jo, agronom! Të kam mik dhe të dua, po pata e ka vendin me mua. Është jetime, e shkreta, dhe e kam amanet nga plaka.

— Si amanet nga plaka?! — u habita unë.

— Amanet tamam, — më thotë Vasili. — Para se n'është vdistë, më tha: «Kujdes patën, Vasil, se mezi e rr Rita kaq.» Ne nuk patëm fëmijë bashkë. Dhe ajo e bekuar e donte shumë çdo gjë të gjallë në botë. Si njerëzit dhe robtë e tjerë. Shumë huqe të miat ajo m'i bënte kabull, se unë tërë jetën kam qenë mik-i gjësë së gjallë. Si vdiq plaka, kisha dhe mëcen, por edhe ajo vdiq. Këlyshët ua fala gjitonëve se s'kisha kalamaj të m'i rritnin. Kuajt, po si kam shpërndarë më gjithë Shqipërinë. Kujt s'i kam dhënë kuajt nga Vgjessha jonë. Kurse pata një është, nuk e shpërndaj as e fal dot. Le që nuk e merr ashjeri, se është qorre, e varfra. Ndaj nuk e nxjerr dot jashtë, o agronom, se e ha sqifteri dhe e trembin qentë.

— Si qorre?! — u habit mësues Kola. — Që kur kështu, o Vasil?

— A, ka disa vjet, o mësues. Po ti merresh me historinë e fshatit dhe të njerëzye, po jo me atë të gjësë së gjallë. Prandaj s'ka si ta dish kur është verbuar. Por do vijë një ditë që do merresh edhe me të, se njeriu, pa gjënë e gjallë, nuk bën dot. S'i ka kënduar kot ai poeti i Fra-

shërit bagëtisë dhe bujqësisë. I di mirë unë këto. Dëgjo mua ti. Unë kam meram shumë për patën, se thashë që e kam amanet. Dhe amanetin nuk e tret as dheu.

— Sa vjeçë është, kur paska disa vjet qorre?  
— pyeta unë.

— Njëzet e tre vjeçë, — tha Vasilë. — Nuk është dhe aq plakë, jo. Më besoni mua. Vajta një ditë në Nartë të Vlorës, se më thanë që atje, një tjetër Vasil, si puna ime këtu, rriste një patë tjetër si kjo. Më thanë së e kishte tridhjetë e pesë vjeçë. Nuk besoni, a? Vajta atje. Dhe atje mësova që patat jetokan deri dyzet vjeç. Isha bërë kaq dhe isha rritur me gjënë e gjallë dhe prapë nuk e dija që kali jetonte më pak se pata. Le që, ç'them unë matufi, po gjer dje këtu tek ne edhe njeriu jetonte më pak se një patë. Hajde, bir. ç'bëhet sot! — thashë aso dite kur qeshë në Nartë.

...Ne kaluam atë mbrëmje me Vasilin. Patën e zuri gjumi. Kurse problemin e kasolles merret vesh si e zgjidhëm. Ju thashë që s'do të tregoj përrallë. Besoj se më besuat për të gjitha. Në nuk besoni, merrni udhën e ikni atje, po nuk e gjetët përsëri Vasilin, patën dhe kësollen-muze. Dhe tashti, siç thonë pleqtë në përrallat tonë, merreni, o djem, se jua lashë!

~~SHI ME QIELLI~~

Shi me qielli q' u nxi!

## «NATA ME SHI, QIELLI Ç'U NXI!»

Jashtë binte shi. Kishte një javë që s'pushonte dhe të dukej se nuk do të kishte më kurrrë ditë me diell e natë me yje. Shiu trokiste prore, si disa dhjetëra qukapikë, pa u lodhur fare, në eternitin e çatisë së barakës sonë dhe krijonte një monotonji aq të madhe, sa, megjithëse flinim tetë burra në një dhomë dhe me drithë ndezur, prapë-serapë na zinte gjumi top.

Kishte kohë që dikush i binte derës, por ne bënim gjumë të rëndë dhe nuk dëgjonim. Unë shikoja ëndërr sikur thekesha në breg të detit, në Spilë të Himarës. Dallgët lëpiheshin pas shkëmbit të madh, kurse goca dhe çuni im, si më kishin mbuluar të tërin me rërën e trashë, më shtyp-

nin e më shkelnin ku të mundnin. Ata janë të vegjël fare, kurse unë i madh shumë për ta. Ata janë të lumtur e të lehtë pendë, kurse unë i rëndë dhe me mall të madh për ta. Me siguri ishte ky mall që më shfaqeshin në ëndërr. Kisha kohë pa i parë. Pusi, ku punonim, nuk shkonte si sahat. Atij gjithmonë i vinin rrrotull avaritë. Ne shponim, po planin mezi e realizonim. Nuk kisha si ikja prej tij në këtë gjendje. Sos vetëm unë kështu, por dhe shokët e tjerë të brigadës.

Dera ushtoi akoma më fort. U zgjova. Kujtova atë çast se gjëmonin bubullimat e shkrepnin vetëtimat. Më vajti mendja te drita elektrike, që e kishim lënë ndezur. Duhej hequr priza, që të mos hanim ndonjë koqe rrufe.

U ngrita. Dhe atëherë dëgjova tamam trokitjen në derë dhe thirrjet nga jashtë:

— Hapni derën, o njerëz!  
— Hapni derën, shokë!

Unë nuk pyeta «kush është». Kjo pyetje s'kishte kuptim fare. Ata matanë kërkonin njerëz në mes të natës, shiut dhe vetëtimave. Ata që i binin derës, kishin hall të madh. Ishin tre veta. Një grua rrëth të dyzetave, e ndoshta dhe pak më e re, një burrë, ishte kryetari i këshillit të fshatit, e njihja se e kishim ndihmuar me catura të vjetër të pusit, për të rregulluar një çemë. Edhe një çun, jo më shumë se dhjetë vjeç, që përpinqej të dukej më i madh.

Në çast mendova se do të kishin ndonjë të sëmurë dhe kërkonin makinën tonë të pusit ta çonin në qytet. Kjo na kishte ndodhur atëherë të tjera. Dhe i kishim ndihmuar. Po kësaj radhe makina jonë kish thyer balestrat dhe e kishim dërguar për rimont. Unë nuk pata kohë të mendova gjëra të tjera. Ata nuk thanë as mirëmbëma, se gruaja ia shkruhu:

— Do na bëjë hatanë, i ziu!  
— Çfarë hataje? Ç'ka ndodhur? — pyeta unë mekanikisht.

— I shoqi i kësaj (tregoi me dorë gruan) ka ikur para ndonjë ore për në qytet, — filloi të shpjegonte kryetari i këshillit.

Ndërkaq u ngritën nga gjumi dhe shokët e tjerë të dhomës sime.

— E çfarë se ka ikur në qytet? — pyeti Beluli, kryesondisti ynë. — Udha mbarë. Apo keni frikë se mos ftohet?! — u tall ai. Është e qartë që nuk ishte ngopur me gjumë.

— Mirë thotë Beluli. Ç'dreqin keni, që na zgjoni në mes të natës, apo se kemi për të marrë turnin në mëngjes, — tha Jari, punëtori tjetër që flinte me ne, pa u dhënë kohë të porsaardhurë t'i përgjigjeshin Belulit.

Kolegu im, inxhinieri i shpimit të pusit, nuk foli.

— Na e bëni hallall, vëllezër, — tha gruaja, — por im shoq ka ikur të vrasë vajzën, që e vraftë zoti, e vraftë! Na e bëni hallall, vëllezër!

— Nuk e lë njeri ta vrasë vajzën, — tha i revoltuar Beluli me bindje, sikur të zotohej në mbledhje që planin do ta tejkalonim. — Nuk e lë njeri, dëgjon? Ka rregull te ne.

— Për ç'rregull flet, mor i uruar, — tha kryetari i këshillit. — Tjetri ka një orë që ndjek vajzën se i ka ikur me një nga punëtorët tuaj.

Beluli nuk foli.

— Me cilin ka ikur? — pyeta unë.

— Me Foton, me kë tjetër, — tha Jari. — Ia mori mendjen shkolla. — Fotua vazhdonte të mesmen natën.

...Dhe u nisëm...

— Duhen shpëtuar fëmijët, — tha gruaja.

Dhe tanë, si kishim dalë jashtë fshatit, ne e

kuptuam që po vinte me ne. Asnjë nuk ishte kujtuar t'i thoshte asaj të mos vinte. Ne e kishim pasur mendjen te vrasësi.

— Po ti ku vete? — pyeti i çuditur kryetari.

— Me ju, të zëmë atë marrëmendëshin tim!

— Kthehu! Ti me djalin kthehuni! — gati iu lut Beluli gruas. — Nuk janë punë pér gra këto.

— Ik, moj ti! — urdhëroi kryetari. — Ik! Ti ke lënë fëmijët vetëm. Kthehu dhe ti, djali i Manes! Ik me tét ëmë!

— Do vij me ju! — tha djali.

— Ik, ore, rrëmbythje, se ta dhashë! — tha Jari.

— Eja, xhan, eja! — tha gruaja.

Djali mbasë u tremb nga Jari, mbasë i erdhi keq, pér të ëmën, a mbasë u kujtua që s'duhej lënë nëna vetëm në mes të natës, kushedi, por u kthye.

— Aman, vëllezër, nxitoni, se mos vonoheni e bëhet marramendëshi im katil i fëmijëve! — thirri gruaja.

— Dhe ajo iku me të birin. Dhe shpejt, shumë shpejt i mbuloi napa e natës dhe e shiut.

Ne vazhduam rrugën.

Bisëda jonë ndërpritej shpesh nga bubullimat. Midis bubullimave dëgjoheshin plaqplluqet e çizimevë tonë në gropat me ujë.

— Ekuator, Kohë e poshtër, — tha kolegu im i shpimit.

— Nuk është njeri i keq, — tha kryetari pér Manen, duke iu drejtuar Jarit.

— I mirë, i keq, dreqi vetë është. Përderisa nuk e la tjetrin të martohet me të bijën.

— Ama dhe Fotua, — thashë unë. — Shumë misterioz është treguar me këtë rrëmbim. Gjithë enigma.

— Jo, inxhinier! Ai do t'i ketë lajmëruar sho-

kët e turnit të tij, — tha Beluli. — S'ka si të jetë ndryshe. Ai është djalë i mirë.

— Nuk besoj, — tha Jari. — Nuk e bëri kot shkollën ai. Ma merr mendja që është aq i zgjuar sa të kuptojë se një e fshehtë që e merr vesh një i dytë nuk është më e fshehtë, vetëm ai dhe ajo do ta kenë ditur ikjen e tyre.

— Dhe varri, — shtoi i menduar kolegu im.

— Mos u tall! — tha Beluli.

Vetëtimat po shtoheshin. Rruga po shkurtohej. Bubullimat gjëmonin si mina. Ne nxitonim të kapnim njeriun me pushkë. Unë përpinqesha të merrja me mend atë, njeriun që donte të vriste vajzën e vet. Dhe nuk e merrja dot. Më dukej e pabesueshme. Nuk e merrja dot me mend se si mund të kishte baba që vriste fëmijën e vet në shekullin tonë.

— Kur gjëmojnë bubullimat, do të thotë që do mbarojë shiu, — tha Beluli, duke më ndërprerë mendimet.

Po shiu vazhdonte. Parashikimet e Belulit ishin si ato të sinoptikës në Radio-Televizion. «Nata me shi, qelli ç'u nxi!» m'u kujtua befas një këngë e Neço Mukës. Vetëtimthi! Mbës që filluan përsëri zjarret e qillit të goditnin tokën.

...Ne ishim veshur me mushamatë e mëdha prej llastiku të zi dhe çizmet e gjata. Të tilla mbajnë punëtorët e shpimit dhe të tilla i kishim dhënë dhe kryetarit të këshillit të fshatit. Në këtë shi të neveritshëm, me mushamatë e zeza ngjanim si murgj me veladon. Thua se shkonim për kryeshëndoshë.

— Sikur të na shohë njeri kështu, — tha kolegu im i shpimit, — do të na marrë për ndonjë bandë diversantësh. — Beluli e pa me inat.

— Si ato të Ku-kluks-klanit, — tha kryetari

që, siç dukej, do të kish lexuar tashti shpejt në gazetë për bandat e Amerikës.

— Si Ku-kluks-klan është Mania juaj, — tha Jari. — Ai po shkon të vrasë njerëz. Ne, përkundrazi, po i shpëtojmë.

— Në i shpëtoshim dot! — tha kryetari me dyshim. — Po vonohemi.

— Ters i madh nga goja qenke, kryetar! — tha Beluli.

— Njëherë një fshatari i tha doktori se do vdiste natën, — tha kolegu im i shpimit, — do vdiste natën dhe brenda vitit.

— Pse natën? — pyeti kryetari.

— Ashtu e tregojnë historinë. Fshatari që atë ditë që i tha doktori bleu tabutin dhe natën vishej me rrobat më të mira dhe shtrihej në tabut. Ishte vetëm fshatari në shtëpi. Ishte plak dhe nuk kishte se kë të trempte me këtë marifet. Vinte nata e ai shtrihej në tabut. Një vit të tërë.

— Mos, more! — tha kryetari.

— Kaloi një vit. Fshatari punonte ditën dhe futej natën në tabut. Kaluan dy vjet dhe ai s'po vdiste. Dhe çuditej plaku i varfër se ç'të keqe kishte bërë që s'po i dilte fjala doktorit. Dhe kaluan kështu dhjetë vjet dhe ai nuk vdiq.

— Përralla me mbret, — tha Beluli.

Unë nuk fola, se m'u duk anekdotë ajo që u tregua.

Ne ecnim dhe shkëmbenim fjalë që shpesh s'kishin lidhje me vrasësin. Pastaj kolegu im sikur u kujtua për diçka dhe pyeti kryetarin:

— Pse nuk e ndaloj dot gruaja të shoqin? Pse?

— Nuk do jesh i martuar, inxhinier, — tha kryetari. — Nuk ka grua ta ndalojë dot burrin kur është me pushkë.

— Mirë e ka kryetari, — tha Jari.

— Varet se sa harmoni kanë, — ndërhyra unë. — Po të kenë harmoni të plotë, ndoshta dhe me pushkë mund ta ndalojë. — E ndjeva që duhej t'i thosha diçka më të saktë e më të thjeshtë.

— Pse e mori me kaq inat dashurinë e tyre? — pyeti Jari.

— Thua ai nuk e di se ç'bëhet në Republikë? Apo asnë në fshatin tuaj nuk është martuar më dashuri deri tani?

— Janë martuar, posa, ore, jo. Pak vërtet, por ama janë martuar. Veç brendaperbrenda fshatit, — tha kryetari.

... — Sa kohë kemi që ecim, inxhinier? — pyeti Beluli.

— Nja tre çerekë ore, — thashë unë.

— Edhe ca e arrijmë te xhadeja e madhe, — tha Jari.

— Ajo e shkreta u përpoq ta ndalonte, por ai e kish qëlluar keq. Ju nuk e vutë re se si e kish njërin sy të nxirë. Të majtin. Mu si fund filxhani kafeje, — tha kryetari.

— Kur vete puna për plumb, kush e vë re një grusht! — tha Beluli. — Ah, dreq, më shpon keq plaga, — shtoi ai papritur.

— Cfarë plage? — pyeti kryetari.

Ne dinim që Beluli kishte plumbin në shpatull që nga koha e luftës. Ai ishte plagosur në clirim e Tiranës.

— Të luftës, — tha Beluli.

— Si të luftës?! — u habit kryetari.

— Ja kështu: të luftës botërore, — tha Beluli, — partizan.

— Do lëdhem i sonte, — tha kryetari. — Kurse juvë nesër ju duhet të veni edhe në punë. Keq e keni.

— Libëjmë kabull të gjitha, veç të shpëtojnë njërëzit, — thashë unë.

— Zakone të pôshtra keni! — i tha Beluli kryetarit.

— Si gjithë vendi. Ca më shumë e ca më pak. Të mos kish qenë kjo kohë, as ju nuk do të vinit me mua sonte.

— Të mos kish qenë kjo Parti, — ndërhyri Jari.

— Ti i pari nuk do vije te ne, — tha Beluli.

— Hak ke, — tha kryetari, — ashtu vërtet. E di që ka zemëruar më shumë Manen, besoj, që vajza ikën nga fshati e vete në fshat. Sikur të shkonte në qytet, do të ishte ndryshe, — tha kryetari.

— Të nxitojmë, se erdhëm, — tha Beluli.

Kryetari hoqi çizmet dhe, si i futi ato njëren te tjetra, si doreza, i hodhi në sup.

— Janë të rënda shumë. Më lodhën! — tha ai. Dhe filloi të ecte zbathur.

— S'paske frikë nga reumatizmi, — tha kolegu im.

— Gjithë jeta ime reumatizëm ka qenë, — tha tjetri.

Beluli qeshi.

Pranë rrugës nationale ishte një repart i vogël ushtarak. Ne arritëm te rruga e madhe, por makina s'dukeshin.

— Asnjë makinë s'po kalon, — tha kryetari pas pak.

Ne ishim të lodhur dhe secili në heshtje priste aty anës rrugës makinat. Por makina s'dukeshin. Vetëm shiu bënte punën e vet.

— Sa kohë ka që presim? — pyeti Beluli.

— As gjysmë ore, — tha kolegu im.

— Më duket sikur po presim gjithë jetën, — tha Jari.

— Nga shiu, — thashë unë.

— Ama shi. Me siguri e ka tejkaluar këto ditë planin e gjithë pesëvjeçarit, — tha Jari.

— Kur do makinë, nuk gjen. Kur nuk do, të luten, — tha kryetari.

— Mos ia fut kot, — tha Jari. — S'të lutet njeri pér makinë.

— Ngas llafin, — u shfajësua kryetari.

...Një dritë, një fener po afrohej drejt nesh. Nuk ishte makinë, ishte një udhëtar i vëtmuar.

... — Mirëmbërëma, — foli njeriu i porsaardhur.

... — Mirëmbërëma, — thamë ne në kor.

Njeriu i porsaardhur na kish dalë papritur përpara. Kurse ne prisnim dritat e makinave. «Nga doli ai kështu?» — mendova unë. Po shiu, që tashmë kish filluar të më hynte në trup në-përmjet tegelave të qepjes të mushamasë, më kujtoi që atë natë ai ashtu duhej të dilte, papritur, si fantazmë.

— Ku do shkoni kështu, pér në qytet? — pyeti ai.

Qyteti ishte gati njëzet kilometra larg nga vendi ku ne prisnim makinën.

— Pér në qytet. Ashtu kemi një hall, — tha kryetari.

— Mos prisni kot makina, — tha i porsaardhuri. — Unë vij poshtë, nga lugina. Atje është shembur buza e rrugës dhe makinat nuk kalojnë dot. Po nuk pushoi shiu e nuk hapi dita, zor se do ta çelin rrugën.

— Punë dreqi, — tha Jari. — Sahat i keq!

— Kush do të jetë ters nga ne? — pyeti Beluli.

— Ters je vetë! — tha kryetari.

— Mania do jetë, — tha Jari.

— Keq e kemi! — thashë unë.

— Nga qyteti makinë nuk kemi ç'presim. Andej ato nuk nisen tashti. Mund të vijnë ndaj

të gdhirë. Zakonisht atëherë nisen, — tha kryetari. — Po u hap rruga nga ushtarët.

— Sikur të vinte ndonjë nga qyteti, e kthenim mbrapsht, pér në qytet, te Mane injoranca, — tha Jari.

— Nuk besoj se kthehet një shofer kaq larg mbrapsht! — tha kolegu im.

— Kthehet, — tha Beluli, — po ta dijë hällin tonë. Pór ç'e do se nuk niset tashti njeri nga qyteti. Tashti të gjithë kthehen pér atje. Ters fare.

— U duhet thënë ushtarëve, — tha Beluli. — Nuk kemi ç'bëjmë. Me siguri ata kanë telefon. Të njoftojmë Degën e Punëve të Brendshme dhe ta kapin Manen tuaj, — iu drejtua kryetari.

— Ja i thamë policisë. E pastaj? Ku ta marrë vesh policia se kush është Mania? — pyeti Jari.

— Ka pushkë, — tha Beluli.

— Sa gomarë buzëbardhë ka, o Belul vëllai! Sa njerëz me pushkë ka si Mania, aq të mira qofshin. Hajde ta gjesh se kush është Mania! — nguli këmbë në të vetën Jari.

— Nuk ka edhe aq shumë civilë me pushkë, — tha kolegu im.

— Budallallëqe, — tha Beluli. — Po ia futni me top.

— Sidoqoftë, në keni ndonjë çështje urgjente, njoftoni ushtarakët. Ata patjetër kanë telefon dhe me siguri do t'ju ndihmojnë. S'ka si bëhet ndryshe! — tha i porsaardhuri.

— Po ti kush je? — e pyeti kryetari. — Nga vjen? Ku vete nië mes të natës? Apo ke ndonjë hall si ne?

— Jam i Grumbullimit. Kam dalë të mbledh kërmijtë, bobojtë pér eksport.

Ne qeshëm. Sa larg ishte halli ynë nga i atij.

— Hajde, probleme që paske! — tha Jari.

— Varet si t'i kuptosh, — u përgjigj qetë i porsaardhuri.

— O shoku ushtar! — filloi të bërtiste parpritur kryetari. Atë e mërziti historia e kërmijve.

Kryetari i thirri duke iu drejtuar rojës, që me siguri duhej të ishte diku pranë kazermës.

— O shoku ushtar! — thirri ai përsëri.

Asnjë përgjigje.

— O shoku rojë! — thirrëm në kor, të gjithë bashkë.

Dhe përballë nesh, disa metra larg, u gjend ushtari me automatik.

— Ndal! — thirri ushtari.

— Ore, po ku je? — tha Jari dhe bëri t'i afrohej.

— Mos lëviz! Kush është atje? Ç'kérkon?

— tha ushtari.

— Kemi një hall, — tha kryetari. — Duam të bisedojmë me qytetin në telefon. Ashtu e kemi punën.

— Prit! Mos lëviz! — urdhëroi ushtari.

Dhe ne pritëm. Njeriu i grumbullimit të kërmijve vazhdonte të agjitonte për mallin e vet.

— Mblidhni kërmij se ia vlen shumë. Shtatëdhjetë lekë kilogrami. Ka kooperativa nga Myzeqeja që kanë fituar miliona, — i thoshte ai kryetarit.

— Mos gënje kot! — i tha kryetari.

— Më plaçin, në gënjej. Jo vetëm kërmijtë, por edhe bretkosat janë me fitim. Ato mblidhen natën me dritë.

— Ndaj del natën ti, — tha kryetari.

— Jo, — tha tjetri, që nuk e kuptoi shakanë.

— Jo. Po sonte duhet të vete në Malas (një fshat pranë pusit tonë), t'i sqaroj fshatarët për leverdinë e kërmijve. Po ju ç'hall keni? — pyeti grumbulluesi i kërmijve.

— Një i qmendur do të vrashë vajzën që i ka ikur me të dashurin. Ja pse kemi dalë.

— Mos, more! — thirri mbledhësi i kërmijve.

— Ç'më thua kështu!

— Ç'u bë ushtari? — pyeti kolegu im.

— Po zgjon oficerin e rojës, — thashë unë.

— Po vijnë, — tha Jari.

Drejt nesh po afroheshin tri hije. Në mes shjut dukeshin vetëm konturet e siluetave të tyre. Dy me automatikë dhe njëri pa armë në dorë. Oficeri me dy ushtarë.

— Ç'ka ndodhur? — pyeti oficeri. Ai ishte i ri si Fotoja, a mbase një çikë më i madh.

— Ashtu e kemi hallin, — filloi kryetari. Dhe i tregoi gjithë historinë tonë dhe ç'kërkonim prej tij.

— Jo vetëm të telefononi, — tha oficeri, — por t'ju japim edhe makinën tonë për në qytet. Qenka ngjarje e jashtëzakonshme. Them t'i telefonojmë Degës dhe ju menjëherë të niseni për qytet. Zgjoje shoferin! — urdhëroi oficeri njërin nga ushtarët.

— Qenke burrë i zoti, — tha Jari.

...Ne telefonuam.

Ata të Degës së Punëve të Brendshme na thanë mos u bëni merak. Manen me pushkë do ta gjejmë patjetër.

Pas pak ne u nisëm me makinën e repartit. Grumbulluesin e kërmijve e lamë me ushtarët.

— Ku u gjet ai idiot sonte! — tha shoferi për Manen.

Në qytet arritëm natën vonë. Po mbylleshin lokalet dhe kafenetë e fundit. Njerëzit prisin në stacionet e autobusëve me çadra në duar, si parashutistë. Fillonte ndërresa e tretë. Ajo e natës.

— Erdhëm vonë, — thashë unë.

— Të shkojmë në polici. Të pyesim njëherë,  
— tha Beluli.

— Ju shkon, — tha kryetari. — Unë do vete  
në agjencinë e kamionëve. Në mos pastë ndodhur  
vrasje atje, s'ka ku të ndodhë në vend  
tjetër. Andej do të kenë vajtur për të gjetur makinë  
vajza më punëtorin tuaj. Andej do të jetë  
edhe Mania.

— Mirë. Ndahemi, — tha Beluli. — Ju në  
agjenci, ne në polici.

Unë ika më kryetarin. Të tjerët shkuan me  
Belulin.

Në agjencinë e kamionëve ishte qetësi. Disa  
udhëtarë flinin në stolat.

Këtu s'ka ndodhur gjë, — tha kryetari.  
— Ndryshe do të ishte policia. Shkojmë pimë  
ndonjë kafe. Vajza shpëtoi! — shtoi ai i gëzuar.  
— Fshati që dëket, s'ka nevojë për kallauz.

Kafene «Transporti» ishte mbyllur. Kamerieri  
po pastronte. Ne i ramë derës. Ai e hapi dhe  
kryetari tha:

— Ja tek është, i poshtri!

Mbështetur në një tryezë, nga ato të lartat,  
ishte një burrë. Ai ishte Mania. Dukej sikur  
flinte. Ndoshë qante. Midis bërrylave, koka nuk  
dukej.

— Ngrehu, të ikim, — dëgjova që tha krye-  
tari.

— Ekspresi është ftohur, — tha kamerieri.  
— Ai është i dehur. Gallatë e madhe. Deshi të  
vriste një njeri. Por ai tjetri qëlloi i fortë dhe  
ia mori pushkën. S'është për pushkë lloj-lloj  
burri! — tha kamerieri.

— Pastaj? — pyeta unë.

— Hiç. E mori pushkën. Unë prita ta frikte,  
po nuk e rrahu. «S'duhej ta kishe bërë këtë,  
baba», — i tha i riu këtij burrit. Siç dukej e

kish baba. Pastaj erdhi një polic dhe ia mori erzin. E shau rëndë. Por ky burri thoshte që nuk deshi ta vriste atë, djalin. «Deshja ta tremja», nguli këmbë. «Ashtu është, — tha djali — deshi të më trembte.» Siç dukej, djali kish ikur nga shtëpia. Gjëra që ndodhin. Polici i tha burrit «Pushkën s'ta kemi dhënë të vrasësh njerëz, por të vrasësh armiqtë.» Ai nguli këmbë që deshi ta trembte. Pastaj polici iku. Dhe djali iku. Dhe ky burri ka dy orë që po pi këtu i vetëm. Mirë që erdhët, se do ta nxirrja jashtë në shi. Atje do t'i dalë rakia fare.

— Ti do lidhur! — i tha kryetari Manes.

— Burgu për burra është, — tha Mania, — po q'e do se nuk u tremb, rrufjani. Iku. Dhe ajo bushtra iku me të.

— Ç'u lodhëm kot, — u nxeh kryetari, — me një të marrë, gjithë këta burra!

— Ndoshta! — thashë unë. — Vajzë me fat!

— Shkojmë, — tha kryetari. Dhe e futi kokënen e tij në sqetullën e Manes. — Shkojmë! Mirë bëri! I lumtë!

Pas ca ditësh të gjithë ç'qemë asaj nate vajtëm krushq në dasmën e Fotos. Të shkuara e të harruara. Kush u trashëgua dhe s'u gëzua.

**JETA**

## PORTRETI I VITIT 1945

Miku im i vjetër, piktori Lekë, ka lënë pene-lin dhe punon me daltë. Merret me skulpturë. Në studion e tij tani punojnë saldatorët, dhe saldatriçja me zjarrin e saj të verbon. Nuk eshtë zor ta kuptosh këtë ndërrim zanati të Lekës. Kohët e fundit ai eshtë i pakënaqur nga tablotë e veta. Jo se janë pritur kaq punimet e tij në ekspozita, por në to diçka e mundon, diçka e shqetëson dhe ai kërkon mjete të reja shprehëse. Ai ka trajtuar shpesh ngjarje dhe figura epike, bile dhe në peizazhet e tij ka diçka dramatike, të rëndë dhe madhështore. E megjithatë Lekës tani piktura i duket tepër e rrafshët, tepër e brishtë për të dhënë Luftën. Skulptura eshtë tje-

tër gjë, ajo ka plastikën, ka volumet, që nuk ngopin vetëm syrin, po mund t'i prekësh dhe t'i kapësh fort edhe me dorë. Piktura punon vetëm për shqisën e të parit, skulptura dhe shihet dhe preket. Plaga në të është plagë dhe dhembja është therëse. Ajo thërret në të për ndihmë. Vetëm gjaku mungon, por aherë s'do të ishte më art. Po nuk e kam këtu hallin, për këtë s'më ha dhe aq meraku. Me mikun tim piktor shpesh ndodh kështu. Të krijohet përshtypja se herë pas here do të ndërrojë zanatin e mjeshterinë.

Leka vërtet vuan jorrallë nga spondiloartroza, por është ende i ri dhe i fuqishëm. Nuk të besohet kur e sheh si sot, që e kapin dhembjet dhe ai këputet në mes. Të duket sikur bën shaka ose përkëdhelet me sëmundjen e vet. I bllokuar keqas, ai më thotë gjithë seriozitet, që në këtë rast ngjan tepër qesharak:

— Dëgjomë mua! Të jesh i bindur që Gjergj Elez Alia ato nëntë vjet me ato nëntë varrat e tij është trill gojëdhënash, sajim legjendash. Jo, i shkreti Gjergj, të siguroj që ka vuajtur nga shiatiku, se, po të ishin gojë plagësh ato që këndon këngë, do ta kishin ngrënë me kohë. Nëntë vjet pa iu mbyllur do t'i qenë gangreni zuar.

Mbase ka të drejtë Leka. Por s'më mbushet mendja për sëmundjen e kreshnikut tonë të lashtë, po për vetë piktorin tanë filloj e i besoj krejtësisht dhe i qaj hallin. Tani nis ta marr vesh pse e ka lënë pikturën. Ajo punohet në këmbë, kurse skulptura bëhet dhe ulur, s'do t'ia dijë për shiatik.

— Ngushëllahu që të punojnë sytë; se mirë dora po të lë, — i them unë.

— Është shpejt akoma. Kur të bëhem sa profesori, dhe ajo do vijë, — thotë ai.

Profesori është kolegu plak, përballe studios së Lekës. Ata shpesh hahen si macja me miun, paçka se e duan njëri-tjetrin fort. Ata janë për njëri-tjetrin si babë e bir. Të dy gëzohen dhe hidhërohen për punët e maira apo të paarrira të shokut.

Kam ardhur te Leka për të parë q'bën për ekspozitën e re. Jam punonjës i Galerisë së Arteye dhe e kam për detyrë të di se q'po punojnë artistët. Leka punonte për këtë ekspozitë jubilare të Çlirimit të atdheut Nörën e Kelmendit me kokën e pashait osman në dorë. E qartë që në skulpturë, Gjithnjë ai bën të papritura në ekspozitë. Kur të tjerët bëjnë punëtorët, ai bën kreshnikët, kur shokët kujtohen për kreshnikët, ai bën metallurgët në studion e vet.

— E papritura e mban artin, — më thotë ai.

— Po jo kaq të papritura në një ditë. Të panjohurat në katror vlefjnë në matematikë, po në art dëmtojnë, — i them unë.

— Jo të panjohura, po të papritura në katror. Kjo s'është matematikë, është art, — kundërshtron ai.

— Mirë, mirë. Po do habitësh njerëzit. Presin pikture, do shohin skulpturë nga ti, presin pushkë, ti bën Nörën me jatagan.

Ai qesh dhe më thotë qetë:

— Kjo është tradita jonë. Ndërron arma në kohë, po shpirti një është, etja përliri. Po ti e ke zor ta kuptosh këtë. Unë jam me traditën, kurse ti je tradicionalist!

E shoh që sot e kam të vështirë t'ia mbush mendjen. E pranoj, dhe këtë «ist» të tij, vec puna të pëlqehet. Ndryshe, mungesa e tij në ekspozitë do të krijojë boshillëk të madh. E di që në Galeri shokët e komisionit do të më kritikojnë pse s'ngula këmbë që të ndërronte temën, si ndë-

rrojmë kostumin. E di që nuk e bën këtë. Kot të prishësh gojën me të. Ca më tepër dhe herët e tjera kështu ka 'ndodhur. Tjetër ka kërkuar komisioni prej tij, tjetër gjë ka paraqitur ai dhe në fund të fundit vizitorët gjithnjë e kanë pëlqyer. Ky nuk është lek i dalë qarkullimit, ky është Lekë me vlerë.

Jo vetëm për të ndërruar muhabetin e për të mos prishur miqësinë me të, i them që më duhet të vete te profesori, kolegu plak që e ka studion përballë tij. Vërtet, do të shkoja dhe tek ai dhe te të tjerët.

— Mos ia ki merakun. Sa të jemi ne, nxënësit e tij, ai do punojë si sahat. E kanë lënë ca sytë, po tashti sheh me sytë tanë. Kurse zemrën e ka pompë të fortë.

Leka troket në derën e profesorit me një ritëm si në filmat policorë.

— Është sinjal sekret, — më thotë ai në mënyrë misterioze.

Hapet dera dhe profesori plak ndërron gjyzlykët të më dallojë. Zakonisht pikturën e vet e sheh nga larg (të tjerë gjyzlykë), kurse njerëzit i do afër fare (gjyzlykët për të lexuar).

— Sa mirë që erdhe! — këto fjalë s'më takojnë mua, i përkasin Lekës.

— E, profesor, je bërë ilegal tashti. Si në këngën përmetare: «Shihemi, me gojë s'flasim, si durojmë që s'pëlcasim!» — i përgjigjet Leka.

— Nuk i le këto, Lekë, o shpirti i mohimit, — thotë profesori.

— Kështu na ke mësuar ti, o shpirti i pohimit! — ia ktheu Leka.

— C'thotë tabloja, profesor? — gjendem dhe unë në bisedë.

— Përpinqem nga pak, po s'kam vrullin e këtij,

— dhe tregon Lekën. — Ky ha me të dyja duart. Dy kunguj në sjetull mban.

— Ndaj kam dy sjetulla, profesor, — qesh Leka.

— S'e ke keq, bre. Nuk e ke keq, ç'të bëj unë që më lanë sytë. Pikturë pa sy s'bëhet dot.

— Ti i ngjan Bethovenit, profesor. Ai bënte muzikë pa veshë.

— Lére Bethovenin. Ai ishte gjeni.

— Jo kaq modest, profesor, — kundërshton Leka. — Atje në Galeri ti na bluan të gjithë me «Malet» e tua.

Plakut i vjen mirë për ç'dëgjon. Po përsëri thotë:

— Sytë, Lekë, janëjeta vetë!

Leka s'di si të ndërrojë bisedë. Nuk i pëlqen kjo hyrje kështu në studio. Dhë me gjithatë nuk gjen gjë tjeter të thotë, veçse:

— Mos u mërzit, profesor. A të kujtohet, kur fillove punën, ti ishe një i vetëm.

— Ashtu, po! Më thërritnin bojaxhi kur dilja me tavaloçë për të pikturuar detin.

— Pastaj na nxore ne, çunat e tu, në dritë, dhe të thirrëm profesor! Krijove brezin tënd të nxënësve, se, ndryshe, bojaxhi do të mbeteshe!

— Ju ma kaluat, bre Lekë. Ju s'mbaheshit dot.

— As nxënësit tanë s'numérohen dot. Ti na krijove, ne, ne krijuam një brigadë piktorësh të tjerë. Fara jote u shumua si ajo e grurit ose, siç thotë ky miku im këtu (miku jam unë), me progresion gjeometrik.

— Tamam, fjalë me konak, — miratoi i gëzuar profesori. — Shih ç'më ndodhi pardje, Lekë. Pija kafen te klubit i Lidhjes. Prisja të vinte ndonjë si puna jote që të shijoja kafen dhe lla-fin. Erdhën dy çuna më takuan. Nuk i njoha.

Zérat diçkà më kujtonin, ku i kam dëgjuar, mendoja, po nuk i sillja dot ndër mend. Nuk i njoha, thaşhë. E para, se nuk i dalloja dot më portretet e njerëzve, më dukeshin të gjithë njësoj, binjakë, e dyta se ishin të rinj, çuna, bre! Béra të ndërroja syzet. S'kishin faj ato të shkretat. Mbi hundë mbaja ato për afër, bash ato që duheshin. Ato që s'duheshin i kisha në xhep. Ata e panë që s'i njoha dot, me siguri u erdhi keq për plakun dhe më thanë që kishin pasë qenë studentë të mitë. Më treguan emrat. U kujtova dhe i mbajta me muhabet. U gëzova shumë, se, që plaku të mbahet i ri, duhet të kruhet me të rintjtë. U kënaqa me ta.

— Ndaj, kruhesh me mua; — i tha Leka.

— Vëri dy déma pleq në parmandë, ecin avash fare. Bëjnë punë të paqme, por të paktë. Bujkut të mirë kjo nuk i leverdis, koha është flori, dhë merr e vë në kular një ka të mocëm si unë e një tjetër që e ka qimen kadife të re. Të yshtë i riut të vjetrin e t'i mbajë hovin i mocimi të riut, si ti, që të mos dalë prej brazde, se i bën zarar. Kjo është dialektika, ekuilibër i natyrës.

— Ke filluar të filozofosh, profesor, — e ngacmon Leka.

— Jo, kam filluar të kuptojet jetën, — kundërshton tjetri.

— Profesor, ti je dem që s'plakesh kollaj, se përditë i kruan brinjët në derë të haurit, — i thotë Leka.

— Mirë e ke, miraton tjetri, — ashtu është. Dal përditë në punë. Ajo na mban gjallë të gjithë. Njeriu vdes, puna mbetet. I zoti ikën, pikatura ngelet. Mjerë ai që jeton në këtë dhë vetëm për të bërë hije. Hije bëjnë dhe gurët dhe drurët, por dhe ata harrohen. Hije bën dhë gje-

li, bile këndon dhe bukur, por të vjen një darkë miku dhe e ther të shkretin gjel, dhe s'kujtohet kush më për të. Njeriu nuk është gjel, njeriu është mal, njeriu është minierë.

Leka buzëqesh dhe më sheh mua në sy. Profesori e ndien dhe pyet:

— Pse qeshni? Mos po flas gabim?

— Jo, jo. Po kur ju pashë qëparë tek ndërronit me ngut gjyzlykët dhe sytë i kishit të hutuar si sy foshnje, thashë me vete se skleroza po bën të vetën. Kurse tashti e kuptoja që ju lartoheni e madhoheni çdo ditë, kurse ne nuk ju zëmë dot.

— Lëre këtë, Lekë! Kur të mos hoheni dhe ju si unë, do të keni ziliqarët tuaj, dashamiri im, — dhe profesori fërkoi duart, thua se tani gjeti shprehjen më të goditur.

Unë me Lekën bëjmë të ulemi në divanin e vjetër të studios dhe nuk kemi se ku. Divani është i mbuluar si me një çarçaf mozaiku, plot me fletë vizatimesh gjithfarë lulesh. Lule mbi divan, lule dhe në rrëzë të mureve të studios.

— E paske kthyer studion në dyqan lulesh, profesor, — përpinqem të futem dhe unë në bisedë.

Ai nuk e kap shakanë, e merr seriozisht dhe më thotë:

— Nuk kam shitur asnjë nga këto. I dua si fëmijët. Se çdo lule është si një portret fëmije. Punohen me qejf.

Profesori i rendit «natyrat e qeta» dhe na i tregon me merak, thua se bën klasifikimin e tyre sipas llojeve e gjinive. Pasioni i vjetër i paleobetonistit më sjell ndër mend ta krahasoj profesorin me Karl Lineun, që i sistemoi për të parën herë bimet. Profesori ynë nuk bën klasifi-

kim në latinisht, por, si një ciceron i kënaqur për atë çka rrëfen, ligjëron.

Megjithëse secila fshë vete është fort e bukur, kështu, me radhë, disa të molisin. Lule fushe, lule dardhe, lule mali, mimoza, lule në vazo, lule në saksi, lule në kavanoz, lule në predhë gjyleje, lule në kaskë gjermani, lule në gotë, lule të verdha, lule të kuqe, lule viole, lule të bardha... lule dynjaja!

Këtu janë mbledhur gjithë stinët dhe gjithë flora jonë. Këtu janë grumbulluar gjithë llojet e enëve që mbajnë lule dhe të kujtojnë shtëpi-të e sevdallinjve të Beratit. Janë këtu dhe gjithë ngjyrat e spektrit diellor. Profesori gëzohet me hutimin tim dhe nuk e vë re fare atë indiferencën me të cilën i shoqëron Leka shumë nga këto «natyra të qeta».

— Lulet i shoh me xham zmadhues, — thotë profesori, — dhe nxjerr nga xhepi i jekut një lente të trashë, të rrumbullakët. Kurse ty të shkon mendja se do të nxjerrë sahatin me qostek.

— Njerëzve nuk ua nxjerr dot xhamin zmadhues. Njerëzit nuk e durojnë dot lupën. Ata duan të shohësh me sytë e nënës. Por mua sytë e nënës po më lënë, duan ndihmën e xhamit të lupës.

— Po tjetër, ç'po punoni, profesor? — pyet më në fund Leka, gati i lodhur nga lulet.

— Hiç, lule. Kam kohën e luleve, — thotë profesori, pa u shqetësuar nga pyetja e Lekës, — lulëzoj!

Troket dera. Piktori plak lë lulet dhe ngrihet ta hapë. Jam unë më pranë saj dhe i dal përpara. Hyn një burrë i veshur mirë, çdo gjë në trup të tij shkëlqen. Pëmë shumë shkëlqejnë rrethi i florinjtë i sýzeve, dhe dy dhëmbë me

të njëtin metal. Përderisa i shoh dhëmbët, ai patjetër buzëqesh.

— Njatjeta, Lekë. Si jeni ju të tjerët? (Dikur këshfu përshëndeteshin bajraktarët. «Tungjatjeta, kapetan, si jeni ju të tjerët?»)

Leka përshëndet me kokë. Profesori i afrojn karrigen:

— Uluni, mirë se erdhët!

— Lekë, edhe ty po të pëlqekan lulet tashti?

— Thotë njeriu i veshur mirë, me një notë të qartë ironie.

Shoku im përsëri nuk flet. I porsaardhuri e ndien veten të tepërt. Dhe kujtohet përsëri ka ardhur këtu.

— Profesor, a keni shkrepëse?

— S'pi më duhan. Më falni, — thotë profesori më keqardhje.

Unë nxjerr çakmakuni dhe i ndez cigaren. Ai që hyri rrëmbimthi, falënderon dhe ikën përsëri me ngut.

Përpinqem të kujtoj ku e kam pârë këtë njeri. Patjetër duhet të jetë piktor, përderisa gjendet në studiot e këtushme. Më shifaqet portreti i tij. Mollëzat e faqeve të rëna poshtë, (patjetër yuan nga veshkat), flokët e rënë deri te kurora e nusërisë. I ka kaluar të gjashtëdhjetat, por përpinqet të fshehë vitet. Mbahet mirë dhe gjithnjë nxiton. Nxiton sikur s'ka kohë të humbasë asnjë minutë. Diku e kam parë. Duhet të jetë njeri i njobur. Më vjen turp të pyes Lekën apo profesorin. S'dua të tregoj paditurinë time. Vërtet, po sikur të jetë shumë i njobur?

Profesori kthehet te natyrat e qeta me lule dhe papritur propozon:

— Po deshët, po ju tregoj, kur më puhonte mirë syri, si i bëja njerëzit. Kam ca punë (më drejtohet mua, jo Lekës) që i mbaj. Këtu në stu-

dio, si miq tē vjetër pēr miqtē e rinj. Eshtë koleksioni im personal. Nuk ia kam dhënë Galerisë. Galeria eshtë si kafene e madhe, e shumta dy herë nē ditë mund tē pish kafen atje. Kurse studion e kam si shtëpinë, që pî sa herë tē duash kafe.

Vendosi veprën nē mbështetësen e karriges dhe filloi tē tregonte. Leka u përqendrua te puna që na serviri profesori, unë dëgjoja me cigare nē dorë atë që rrëfente ai.

— E shihni këtë plak malësor? E kam njuhur më 1945, nē Alpét. Portretin e tij e kam bërë dy herë nē njëzet vjet. Po, po. Eshtë i vetmi njeri që kam vizatuar dy herë. Në njëzet vjet. Pse? Ja se si:

(... Portreti i malësorit plak. Tepér krenar, pak i zymtë, duket i çuditshëm pranë tablove me lule. Plaku gati sikur i sheh ato me keqardhje. Sikur u thotë: «Të shkretat ju, lule, që jeni, sa bëni bujë vetëm një behar.» Plaku eshtë tepér i vetmuar midis këtyre luleve. Nuk eshtë hiç nē vendin e vet.)

Kam qenë njeri i hedhur, ca tuhaf, dhe pse jo, edhe guximtar. Të shkojë nē dyzetepesën nē Alpe ishte trimëri dhe tē bëje pikturë ishte gati marrëzi. Shokët e mi shkonin pēr pushime nē Pogradec ose búzë detit. Unë ngjitja Alpet. Aso kohe nuk e çmoja ç'po bëja. Dija që kishte banditë maleve tē Veriut, se më njerëzit jetojë; por kisha bindjen se ata s'kishin punë më mua. Le që s'kish ndodhur ndonjëherë tē merreshin njerëzit me pushkë me piktorët.

Dikka, pēr kurajën time e mora vesh që atë behar nga frati i atjeshëm, i cili u habit kur më pa vetëm, tē pashoqëruar nga ndonjë njeri i qeverisë me armë. Unë isha i popullit, dhe pulli ishte kudo. Ai më mbronte. Ndoshta ngaqë

frati pa që s'kisha me vete njeri të qeverisë, m'u afroa i pari dhe deshi të më bënte mik. Njeriu i perëndisë e njihet mirë artin.

Më vinte keq për të. Ai kish dijeni më shumë se unë për muzeun e Vatikanit. Thashë se pëlqente Xhoton dhe Mikelanxhelon. E admirova për ato që diinte.

Nuk kam urrejtje për asnje zanat, ca më te-për aherë, që isha djalë i ri. Por do dëshiroja që ai, frati me dije, të mos merrej me shpirtin e njerëzve në atë botë, por me jetën e tyre në këtë botë. Miq nuk u bëmë dot me të, muhabet bënim, por miqësi s'lidhëm. Ishte keqardhja ime për të, apo ndjenja e tij e madhështisë që na ndante? Nuk e di. Veq kafen ia pëlqeja shumë. Do doja që të kisha bërë mik mësuesin e fshatit, por fshati s'kish shkollë akoma. Ca muaj më vonë u hap ajo për të parën herë atje.

Atë behar kisha, prifti dhe unë qemë të vemit në atë fshat që na lidhët diçka me pikturen.

Mik me fratin ishte Frroku. Malësori plak. Aso kohe nuk ishte plak, ishte burrë tamam, që, midis shumë punëve dhe shërbesave të tjera, priste dhe drutë e dimrit për qelën e priftit. Tek ngrinte sépatën dhe çante frrap, firup, mes përmes trungjet e rënda, më hyri sevdaja ta pikturopa. Në këtë peizazh të rreptë malor, ai më ngjante si njeri i legjendave, diçka si Muji, diçka si Halili i ciklit të kreshnikëve. Ai afronte shumë me ta, por ishte vetëm Frroku. Qe nga ata njerëz që djersinin dhe në palcë të dimrit. Punëtor si ai, i pashëm si kurkush, në punë e në bukuri burri kish shok vetëm veten.

Kisha një javë në atë katund. Mëngjesi aty vinte vonë, se me ngadalësi solemne hapej sipari i maleve që lëshonte diellin të dukej në skenë. Atje nata është vërtet natë dhe dita po ashtu.

U ulëm të pinim kafen e zakonshme. Thashë që kafja e fratit qe një gëzim përmua. Nuk e di, e bënte vetë apo kish ndonjë motër që ia piqte. Ai na i sillte vetë, në tabaka të argjendtë (relikt, me siguri) dhe gotat e ujit akull. Unë i afroja cigaren, që e dija se nuk do ta pranonte. Ai spinte duhan. Por, unë bëja timen, Forcë e zakonit, si respekt për fratin, as Frroku nuk e ndizte i pari.

— Mbramë kanë ra pushkë në bjeshkë, — tha frati, tek gjerbte shtruar kafen.

— Do jenë cubat e malit, — ia ktheu Frroku.  
— Ia kanë me hile qevërisë.

— Ka dhe të gënjer nga ata, — thashë unë, duke përsëritur fjalët që kisha dëgjuar në këshill të katundit.

— A ia kanë me hile, a janë të gënjer, e di i madhi zot, — tha frati.

— Sështë punë zoti, — tha Frroku, — është punë njeriu.

— Është punë armiku, — thashë unë.

— Ka kush gjykon, — nguli këmbë frati.

Frati ishte i ri, i shpejtë në lëvizje, férre, i shkathët në gojë, por gjithë kohën përpiquej ta përbante veten. Ai kishte veshur zhgunin e zi, të rëndë dhe çdo gjë mundohej ta kryente me ritmin e tij, në mund të them se ka ritëm zhgnor, të zi.

— Kam qejf të të bëj një portret, Frrok, — i shfaqa dëshirën malestorit.

Ai tani kishte ndezur duhanin. Kishte pritur shumë. Nuk u përgjigji.

— Do me të ba nji basaret, — sqaroi frati.

— Nuk kam njeri ushtar, — u gjegj Frroku prerë.

Nuk e mora vesh, ç'donte të thoshte ai me këtë.

— S'ka njeri përjashta katundit dhe s'ka kujt me ia dërgue, — sqaroi përsëri frati.

— Unë dua ta bëj për qejfin tím, — i thashë.

— Për miqësinë dhe për kafen që pimë bashkë. Po më doli mirë, do ta çoj në ekspozitë.

Malësori hëشتë prapë. Vrisja mendjen ç'bluanante ai në kokë të yet.

— Do me të çue në pazar të madh, — ndërhyri frati.

— Jo, — kundërshtova unë, — jo. Në ku-vend të madh, në Tiranë.

— Bëj Fratin! — tha malësori. — Ai asht i gojës dhe i zoti.

Unë qesha. Si të mos qeshje me këtë propozim të çuditshëm. Mendoja, c'e papritur do të ishte sikur në ekspozitën e parë të cilimit unë të shkoja me portretin e priftit. Komeditë madhe do të bëhej, po portretin s'do të ma pranonin.

— Nuk më lejon zhguni, — tha frati i qetë.

— Frati nuk është Krisht, — thashë unë gati me inat.

— Po pse, thue, jam unë Jezu! — tha Frrokku dhe bëri kryqin.

— Jo. Ti je njeri, — pranova unë. — Njeri i mirë. Sot ne duhet t'u japim njerëzve njeriun e mirë.

— Nuk më takon mua të jem i tillë. Kam vijajt shumë, — shtoi Frrokku. — Jam i zemërue me njerëzit.

— Ai s'ka tokë që të martohet, — miratoi Frati.

— Ma bëj këtë nder! — iu luta unë malësorit. Dhe befas ai vendosi.

— Nder paç! — më uroi Frrokku. — Të bahet siç do ti!

Frati u uabit. Dhe unë po ashtu. C'e shtyu malësorin të thynej e të ndërronte mendje?! Ai

s'ishte Krisht. Ai ishte njeri që s'martohej dot. S'kishte as tokë as para të blente nusen.

...Dhé une fillova të hidhja portretin e tij në telajo.

Nuk ishte i vështirë të punohej. Ishte i tillë, që të thithët në çdo gjymtyrë të vetën, si sfungjer. Unë pothuajse e mbarova portretin e tij me një seancë. Herë-herë mbi telajo binte hija e fratit. Ai ikte, vinte dhe ikte përsëri. Më dukej se diçka e mundonte.

Pak gjë më kishte mbetur pa mbaruar në portret. Aty ku bashkoheshin buzët. S'dija ç'tu jepja më shumë atyre buzëve të shtrënguara fort: dhembjen apo krenarinë. Mustaqet e verdha më pengonin. Ato më ushqenin më tepër pér një lloj kënaqësie të tij. Por a ishte i kënaqur, a mund të ishte fodull ndaj jetës njeriu që skish tokë?

Frokut i pëlqeu portreti. Kjo dukej në sytë e gëzuar të tij, por ai nuk foli. Frati tha:

— Bukur fort, si apostull!

— Si Frrok, — thashë unë.

Çmontova këmbalecin, futa portrétin nën sqetull dhe ndjeva ngrrohtësi.

E lamaë që do ta' mbaronim të nesërmén portretin. Duhej dhe një seancë.

Të nesërmén shkova përsëri tek oborri i qelës. Hasa Fratin. Ai më bëri kafen. Unë prisja Frrokun. Frati më foli përsëri pér «Lahutën e Malësisë» dhe padre Fishtën. Më këshilloi ta rilexoja patjetër. Unë e pyeta pér Frrokun pse nuk po vinte.

— Nuk e ke ndie që Frroku iku në mal? — ishte ai që pyeste.

— Pér dru pér qelën? — thashë unë.

Frati buzëqeshi lehtë, sa pér vete.

— Ka dalë mbramë komit.

«Bën shaka frati», thashë një çast me vete. Po frati s'bënte shaka. Ai lëshonte bombë dhe jo fishekzjarre.

— Si komit?! — pyeta unë i trullo sur.

— Njashtu, thjesht, komit si gjithë komitet, tha ai.

— Po pse, c'pati? Kush e ngau?! — u interesova unë.

— Askush! Por gjithkush ka një hall me qeveritë.

— Jo me çdo qeveri, uratë. Kjo është qeveria e Frrokut, e popullit, — kundërshtova unë.

— Ju thoni kështu, zotni. Po Frroku nuk ka mendue kështu.

— E kanë gënjer, — u inatosa unë, — ai ishte njeri pa tokë.

— Pa tokë po, por jo pa kokë. Burri për këso punësh nuk mashtrohet. Ai bindet në lëkurë të tij, — tha i sigurt prifti.

Kafja ishte ftohur. Tani as ajo s'më pihej më.

U ndava me fratin. Ai qeshtë nën buzë. Ishte i gëzuar. Frroku qe arratisur.

Bëra disa peizazhe të maleve. Janë ato që kritikët shpesh i quajnë dramatike. Nuk është kështu. Ato janë të zymta disi, se unë nuk shkëputesh dot nga pyetja e përhershme e atyre ditëve: Pse iku Frroku? Portreti i tij më vajti dëm. Ai as nuk ekspozohej dot dhe as në shtëpi nuk ruhej. Ai ishte i arratisur. Ai ishte armik i vendit tim.

Piktori i moçëm tregon te shtruar. Ai kishte mall për këto kujtime. Dhe unë po vrisja mendjen tani se si portreti i armikut prapëseprapë gjendej në studion e tij. A nuk ishte ky portret shkaku i historisë që sapo tregoi? Erdhi përsëri njeriu me gjyzlykë me rrathë floriri a të lyer më flori. Qeskat e syve i qenë ulur më shumë. Ai dukej sikur qe plakur më shumë gjatë kësaj orë që në rrinim në studion e profesorit. Pyeti ç'bënte Leka akoma me veteranin, me profesorin. «Nuk u mërzite me të?» dukej se të thoshte pyetja e tij. «Po na tregon profesori historinë e portretit të malësorit», i tha Leka, sikur nuk e kuptoi qesëndinë e tjetrit. «Aha, ika unë, tha njeriu me gjyzlykë floriri, — historinë e priftit po ju tregon. Profesor, ka ikur koha e malësorëve, sot është koha e minatorëve», dhe iku vërtet, pa na dhënë kohë ta sqaronim. Profesori, sikur u kujtua që tregimi i tij s'kishte marrë fund, tha me një farë ngurrimi: «A doni ta merrni vesh si mbaroi puna e Frrokut?» Edhe pyeste akoma?!

...Kisha afro një cerek shekulli pa qenë në Alpe. Ishte rastësi kjo apo nuk e kisha joshur veten për ato anë? S'di ç'tju them, S'isha më i ri. S'kisha më këmbë për udhë të gjata. Por në Leqet e Drejt po hapte rrugën rinia. Shokët e gazetës «Drita» m'u lutën të bëja skicat për një reportazh të një mikut tim, shkrimitarit të tñohur... Ngurrova. Ma mbushën mendjen. Më dha-

në makinë. Dhe u nisëm me gaz te Leqet, lart në pllajë ndaluam. Shoferi ishte i kujdeshëm shumë. Ai na ruante nga aksidentet. Në pllajë na tha se s'shkohej më tej me makinë. S'them se u tremb, por dhe frikë pati. Poshtë lumi rrëzohej me rrëmbim. Pamë ç'pamë dhe u nisëm më këmbë. Lugina e lumiit sa vinte ngushtohej. Grykë e keqe, male. Male pa mbarim. Disa qindra hektarë male dhe vetëm dy dynymë qill.

Takuam vullnetarët. Të gjithë çuna e goca të vogla. Malit ata po ia hanin zemrën. Kë të vizatoje më parë! Njëri më i bukur se tjetri. Rini, bre! Vetëjeta!

Fillova të skicoja. Shpejt e shpejt po hidhja portretin e një skënderbegasi në karton. Kuqo ishte ky skënderbegas, sa dukej sikur ndiztë shkëmbin. Dhe emrin, e kishte të rrallë fort, Barlet e thërritnin. Do të kish qenë patjetër i ati, merakci pas lashtësisë. Karboni më punonte mirë. Barleti dinte, të pozonte hak. Kam frikë mos i ati punonte fotograf.

— Kur papritur fare ndjeva që një tjetër bënte hije në tavacocë. Nuk ishte hije më. Ajo dilte jashtë kartonit. «E po, kureshtar», thashë dhe vazhdova punën. Kurse ai tjetri, ai që bënte hije mbi karton, ngaqë e pa që nuk reagova hiç, a ndoshta ngaqë priti sa ta lija karbonin, më pyeti:

— A po lodhesh, or shog?

— Ka pak, — ia ktheva unë. I fola instinktivisht, pa e kthyer kokën nga ai. Kisha frikë mos e thërriste njëri Barletin dhe ma linte portretin batall.

— Jam dhe unë vullnetar këtu! — tha ai që bënte hije.

Po më bezdiste. Thua se e kisha pyetur çfarë ishte. Por mënyra si i tha këto fjalë, ishte imponuese. Zëri, ishte kumbues. Isha gati të tho-

sha «qofsh me shëndet», por u mëdysha. Ktheva kokën dhe e vështrova. Ishte një burrë i thinjur, malësor, i rreshkur, i mocëm. S'dukej për vullnetar.

— Çfarë vullnetari je ti! — i thashë unë, gati me përcëmim. Thashë që po më bezdiste si shumë. — Këtu është aksion rinie!

— Njashtu asht, — pohoi ai urtë, pa e prishur gjakun. — Nuk jam i ri, besa, po fuqi kam tamam. Sa 'të rri tue pritë kur po vjen xhadja tu na, po i ndih punës që ta sjellim me çunat bashkë. Dhe kur 'të kaloj nesër këtupari, t'i them vedit «ke hak, or Frrok, me ecë lirshëm, si në shtëpi tandë, se diçka ke ba dhe ti për këtë shose!»

Unë po 'ngatërröheshha me këtë përzierje të turqizmave më frëngjishten e plakut. Herë xhade e herë shose!

— Mos do të të bëjë ndonjë resme edhe ty piktori, or baca Frrok? — pyeti, jo pa ironi, skënderbegasi Barlet, që, me sa shihej, e njihte mirë malësorin plak.

— Jo, bre žabit i vogël! As në mend nuk e çoj këtë mfarre. Jam koritë nji herë, do vjet ma parë, me nji pikturist e më ka ngelë gozhdë në zemër.

— Si je koritë, bacë? — pyeti rishtas Barleti, tani me seriozitet të plotë.

— Asht histori më vedi, — tha plaku, që donte ta mbyllte me kaq.

— Amán, bacë, tregoje! — u lut skënderbegasi, të cilët i shkonte më për mbarë tani të pozonte dhe të dëgjonte ndonjë qyfyr a histori të këndshme.

— Por asht histori zhburrnimi, bre, ajo, — tha plaku me dhembje, me shikimin përgjérues të hedhur nga ana ime.

Histori zhburrnimi! Dhe aherë unë fillova ta

shihja më me kujdes këtë burrë gati plak, që paskësh dalë vullnetar tok me rininë. Emrin e paska Frrok, dikur paska bërë një turp me një piktor, qenkësh zburëruar para tij... Dhe atë çast, sa hap e mbyll sytë, u kujtova se ky duhej të ishte i arratisuri im i Alpeve në vitin 1945.

— A mos je ti Frroku i qelës? — pyeta befas plakun.

— Dora vetë, — ma ktheu Frroku, — a më njofte tashti, a?

— Paske dalë nga burgu e do t'ia lash të keqen pushtetit me punë vullnetare! — e ngacmova unë, jo pa një trill inati.

— Mos e thuej atë fjalë! — më këshilloi ai.

— Mos e ven qerren para qeve! Në burg s'kam genë e, për të la atë marren e kaçakut të atij behari, e kam la me kokë. E kam la, besa, me koka të sera diversantësh.

Ishte e qartë që Frroku kishte dalë malit, por, siç dukej, duhet të kish punuar më vonë me or ganet e Sigurimit. Janë të shpeshta rastet e tilla andej.

— Pse ma le portretin pa mbaruar aherë? Pse u arratise? — pyeta unë, sa për të shuar kureshtjen. Kurse Barlet skënderbegasit kureshtja po i ndizej si me dru pishe. Rrallë mund' të takojë një i ri si ai, vullnetar të moçëm që ka qenë i arratisur.

— Ma mbushi mendjen frati, — tha Frroku.

— Si ta mbushi mendjen? Ai për vete nuk u arratis.

— Eh, aty asht ustallëku, aty asht vallja e tij, me ba popullin anmik me pushtetin e vet. Për kësot lloj punësh frati ishte usta i madh.

— Megjithatë ti s'ishe i vogël. Si ta mbushi mendjen?

— Ani bre! Si ma mbushi mendjen! Ma gjeti

bosh e ma mbushi, si kotruven me ujë. Por ja, bre, ti, shok. Vjen frati në mbramje vonë, bekoni kullën dhe më uron jetë të lumtun. E pastaj po më thotë: «Ik, Frrok, në mal! Ik, o i bekuem i zotit; pa e mbarue ai piktori basoretin tand. Se ai do me ta varë në pazar të Tiranës, si Krishtin në kryq. Po ti nuk je Krisht, Frrok. Ai do me ta çue në Tiranë, që nesër të vijnë ata të Sigurimit me të kapë kollaj.» Unë u habita. Dhe ti, besa, s'më ishe dukë bukëshkalë me ma ba me të pabesë. I them fratit: «E pse do të më kapin, o atë? Vetë s'i kam ba gjë të keqe katundit e pushtetit!» Frati në të vetën: «Je i leshtë, Frrok. Gjithë jetë kështu ke qenë. Po pse ai, piktori, nuk qit një resme ata robtë e Tiranës, e vjen këtu në bjeshkët tonë të namuna me kryet në rrezik, apo ka pak njerëz Tiranë? Mirë, e paska zanë meraku me malësinë! Po pse zgjedh e të ban ty? A s'ka pleq e plaka, a s'ka kalamaj malësia? A s'ka njerëz të tjerë kësaj ane? Ka! Por atë e kanë dërgue bash për ty e për të tjerë si ti, që jeni robtë e vërtetë të zotit. A s'je ti besniku e punëtori i pajtuem i qelës?» Ashtu ishte vërtet, siç thoshte frati. Unë qeshë besnik i kishës dhë i zotit. Megjithatë, ma besnik se unë ishte vetë frati dhë po i them: «Po, besa! Veçse nuk po di pse nuk të ban ty, imzot, që je bariu ynë?» Frati më buzëqeshi si vllau vllait e po më thotë: «Më kanë ba me kohë. Kur t'u duhem, vijnë e më marrin. Lëvdue goftë Jezu Krishti! Nuk ka ardhë sahati im, Frrok, hala! Sot ka ra sahati për ty, o i bekuem!»

Dhe ika. Po më dhimbsej vedi me hupë kof. Dhe mora arratinë në bjeshkë. Kishte ardhë vërtet ora ime e keqe. Nuk munda të bashkoheshë me cubat e tjerë. Ndenjta i vetëm do ditë, si ujk i veçuem. Më ndihu fati e nuk i bana dam

kurrkujt ato ditë. Pastaj erdhën do miq të mitë, që i shin dhe miq të pushtetit e më thanë se ç'dreqin kisha që kisha d'älë cub e fletova maleve. Ç'më ndante mue nga katundi? Ç'më lidhë me ata të përtejdetit? Pasunia apo tokat e shumta!? As njana e as tjetra!

Prifti, u gjegja, më ka thanë që më kishte ardhë ora të më burgosnin. Atij i ka ardhë tamam sahati, thanë miqtë e mi. Dhe mbas dy ditësh priftin e arrestuen. Unë u dorëzova, në besë të dashamirëve, pa i ba dam njeriu. Dhe pushteti më fali. Pastaj luftuem e fituem me cubat e d'älë bese. Bamë kooperativën. Na erdhi elektriku. Jetojmë dhe na sot si gjithë ata që punojnë me mend e dashuni në zemër.

Barleti po e shihte i habitur fare. Unë po njihja mikun tim. Frroku kishte mbetur Frrok. Naiv dhe i pastër.

— A ta mbarojmë tanë atë punë që e lamë në mes para një çerek shekulli? — pyeta unë me ngurrim e me mall.

— A thue ia vlen? — pyeti ai. — A e kam hak këtë nder?

— Besa, po! — ia ktheva unë me armët e së folmes së tij.

Shihet që s'ka vlerë e madhe  
së "Bled" që nuk është  
qëndrueshme. Gjithashtu s'ka vlerë  
e madhe e "Balkan".  
Dhe përgjithësisht s'ka vlerë e madhe  
dhe shumë e madhe e "Tirana".  
Kështu që tashmë s'ka vlerë e madhe  
e "Balkan" që është vlerë e madhe  
e "Tirana".  
Dhe kështu që tashmë s'ka vlerë e madhe  
e "Tirana" që është vlerë e madhe  
e "Balkan".  
Dhe tashmë s'ka vlerë e madhe  
e "Balkan" që është vlerë e madhe  
e "Tirana".

## HALLË MARA NGA HIMARÄ

Dhe tashti do t'ju rrëfej për Marijen dhe italiinanin Xhentile.

Ne jetonim në katin e parë të pallatit të Aviacionit. Ata të dy jetonin në bodrum. Erdhën në pallat më vonë nga të gjithë ne të tjerët dhë apartamentet qenë zënë. Pas tyre në bodrum bujtën dhe disa familje çame. Këto ndenjën pak kohë dhe ikën, gjetën strehim më të mirë e mbase dhe më të lirë. «Çami çan detin», tha nëna ime atëherë. Kurse Marija me italiinanin atje na gjetën dhe atje i lamë.

Ata s'qenë njerëz të shkathët për të gjetur shtëpi më të mirë, në atë vit kur Tirana ishte mbushur me muhaxhirë. As para për sekserë

nuk kishin, Ndoshta duhet të jetë kjo arsyecja, por ndoshta edhe se në bodrum ata ishin të parët e vendit. Në këtë rast ata shkonin me parimin më mirë i pari në bodrum sesa i fundit në apartament. Ju e dini që është një çikë ndryshe ajo fjalë popullore (Më mirë i pari në fshat, se i fundit në qytet), po në thelb është e njëjta gjë.

Sa kishte mbaruar lufta - dhe shumica prej nesh, që banonim në apartament, tashti kishim dalë me ç'kishim veshur, nga lufta botërore.) Ne ishim të gjithë muhaxhirë dhe dukeshim si mysafirë në shtëpitë tonë, na dukej vetja si në hotel. Sot jemi, nesër s'jemi më këtu. Kështu që asnjë nga ne s'kishte nevojë për katoqe e hajate, për bodrume e kam fjalën. Ç'i donim, ç'të futnim atje? Hic gjë! Zahirë, jo; rraqe, jo, bilesë stivë drushë nuk kishim. Kurse ata të dy edhe zgjarrin e ndiznin më kollaj se ne, s'i bënin tym njeriu dhe parketin s'kishte rrezik ta digjin. Puna e tymit që bëla e madhe. Ojhakët nuk e di pse ishin zënë dhe, kur ndiznim zgjarrin, në fillim i bënim zë gjitonit të apartamentit të sipërm që t'i mbylli te drifaret. Harronim që dhe atij tymi nga drifarja i dilte, se dhe ai kishte të njëjtin hall. Çdo kat vuante nga tymi dhëncështja e tij në dimër bëhej reaksion zinxhir! Sidoqoftë me tymin u mësuam, më shumë vuanim me parketin, të cilin ndjenja e dashurisë për dhogat e lëmuara na bënte ta ruanim. Po, hajde! ruaj kucurat dhe rrënjet e shqopës të mos përshkënditnin parketin, paçka që zgjarrin e ndiznim mbi llamarinë.

Ne ishim gjithnjë në gjendje alarmi, si zgjarrfikësit. Aq, sa shpejt e lamë atë zanat dhe ndiznim zgjarr vetëm në banjë, sa për të gatuar dhe për të larë rrrobat. Këto halle, që nuk soseshin kurrë, pronarët e bodrumit nuk i kishin, por mbi të gjitha ata kishin një privilegj të rrallë fort

për atë vit urie, ata atje mbanin dhe derrin. Bodrumet e pallatit tonë ishin katonj të mirë përdosa dhe derra.

Marija me Xhentilen nuk kishin fëmijë që të zinin miq ose të prishnin miqësinë. Vetë qenë tepër të ftohtë, akull fare, sikur nuk ishin shqiptare e italian por angleze e norvegjez. Jetonin të veçuar e as ndiheshin e as përziheshin fare me kurrkënd. Si ata e mosnjeri.

Të krijohej bindja që ata s'ngitnin e as përziheshin me njeri, si ne të tjerët, që qemë nakatostur si vaji në lakra, se nuk donin t'i ngiste njeri. Dukej që do të kishin ndonjë frikë a të fshehtë të fortë që jetonin gati si ilegalë, gati si ish-ballistë. Sikur të mos ishfe derri i tyre, ata do të harroheshin fare e s'do të kujtohej njeri përtat.

Ndonjëherë, më të rrallë, kur ne kalamajtë luanim kukafshëfthi ose koman (luhej shumë aso kohe) në domenin e tyre, në bodrum, dëgjonim nga dera e hapur e dhomës së fjetjes (dhe të ngrënies) që Marija fliste shqip, kurse Xhentilja italisht. Ne quditeshim se si merreshin vesh në këtë mënyrë dygjuhëshe as mish e as peshk. Të dy ata ishte e qartë që merrnin vesh mirë gjuhën e njëri-tjetrit, por megjithatë s'kishin gjetur ende një emëruesh të përbashkët. Secili fliste në gjuhën e të parëve të vet, paçka se dhe gjuhën e babës dhe të nënës të njëri-tjetrit e kuptionin. Kuptohet që duhej të ishin tepër krenarë përgjuhën e vet. Po të jetonin në apartament lart, vete fjala në katin e tretë apo të katërt, me ato gjuhët e bëndryshme të tyre do të na kujtonin diçka kullën e Babilonit. Por ata s'ishin në kullë, punën dhe. Punën e kullës ne e mësonim në shkollë, në mësimin e fesë, tek këndonim «Ungjillin».

Natyrisht italianni, si burrë që ishte, nuk merrte pjesë në lojërat tonë dhe as ndërhynte të vinte drejtësi në hilet tonë të vocrra prej çiliminjsh. Ku çapkënllëqet tonë e ku meraku i tij! Hane Shan e hane Bagdad! Ai kishte vetëm një hall: si të kënaqte Marijen dhe derrin e majmë, të mbyllur të shumtën e hérës në thark.

Për italiannin gjyshja ime thoshte: «Eshtë bonjak orëziu e fatziu e s'duhet ngarë. Nuk ka jetim më të madh në jetë sesa ai që s'ka dhëun e tij për varr të vet.» Xhentilja që i ri e s'mendonte për varr tashmë, që kishte mbaruar lufta! Nga kjo anë, si bonjak, dhe mua më vinte keq për Xhentilen: Ai s'kishte dheun e tij, unë s'kisha babanë tim. Ai e kishte lënë mbasë vetë Italinë, mua ma kishin vrarë gjermanët tatën. Unë e kuptoja që gjyshja i qante hallin Xhentiles, që që në dhë të huaj, por shpesh më dukej se ajo më shumë qante hallin tim. Në fund të fundit unë dhe ai ishim bonjakë.

Lufta kishte mbaruar. Shumë prej hyzmeqarrëve italianni, ushtarë të djeshëm, po kthehen në Italinë e tyre. Ç'është e vërtetë, Marija e përdorte edhe tashti Xhentilen si hyzmeqar! Po cila grua në botë nuk përpinqet ta ketë burrin e saj dhe shërbëtor! Sidoqoftë, ajo e kish atë bashkëshort dhe bashkëjetonte e ndukej me të sii çdo burrë e grua të martuar. Kurse Hallé Mara nga Himara, gjyshja ime, kur nevrikosej me zhburrimin e Xhentiles a me burrerinë e Marijes; ngulte akembë si mushka: «Dosa Marije e ka Xhentilen përderës, lyspar të saj. As kurbatkat s'janë kështu, keq e mos më keq! Turpi i botës! I ke parë arixhofkat? Nuk i lënë kurrë burrat të lypin.»

Unë s'kisha arritur të studioja zakonet e arinxinje. Dhe, që të mos merrem me thashethet-

me e as me hamendje të kota, po vazhdoj të rrëfej pér ta.

Nuk e di a kishin vënë kurorë në kishë, apo ishin celebruar me ligjet e reja të shtetit të ri. Pér ne fëmijët s'kish rëndësi kjo dhe as pér tregimin tonë. Neve s'na hynte gjë në xhep, bile dhe Hallë Mara pak e vriste mendjen pér këtë. Por besoj se ata s'kishin bërë as njérën dhe as tjetrën. Punë e tyre. Pér dy veta që duhen vërtet, gjithë formalitetet e detyrueshme të martesës janë të kota. Siç janë edhe më të kota kur dy veta nuk duhen, por jetojnë nën një kulm pér sytë apo pér turpin e botës dhe pér fatkeqësinë e vet.

Shoqëria jonë, e kalamajve të pallatit, ishte nga mosha ime shtatë-tetëvjeçare dhe deri te çunat e gocat dymbëdhjetë-trembëdhjetëvjeçare. Të tjerët, më të rriturit, me ne nuk begenisnin të shoqëroheshin. Ata kishin tarafin e tyre dhe problemet e veta. Besoj se e keni marrë vesh që me ne çili miqërit shoqërohej dhe gjyshja ime. Cila gjyshe nuk i afron nipërit e mbesat e saj si klloçkat zogjtë e vet? Dhe shpejt ndodhi çudia: u bë mik pér kokë yni dhe Xhentilja! Po, mor, po, orëziu e fatziu Xhentile!

Por le të vëmë një çikëz rregull dhe t'i themi gjërat sipas sirasë. Së pari dua të rrëfëhem. Ajo, të cilën unë gjithnjë e quaj gjyshja ime, që në pallat e njihnin të gjithë dhe e thërritin Hallë Mara nga Himara dhe që kishte emër të njëjtë, adashe me Marijen e Xhentiles, nga Lezha, dhe me nënën e Krishtit, nuk ishte tamam-tamam gjyshja ime. Ajo ishte në të vërtetë motra e gjyshes, pra halla e nënës simë.

Kur kishte pasë qenë në bark të mëmës së saj, domethënë të gjyshes sime të vërtetë, mama-së sime i kishte vdekur i ati nga gripi spanjoll në kurbet të Argjentinës. Me siguri e dini se ky

gripi spanjoll i hëngri botës më tepër se njëzet milionë njerëz, pra gati dyfishin që çoi në botën tjetër vetë Lufta e Parë Botërore. Kështu që, kur do të lindte nëna ime, ajo që jetime nga babai qysh në bark të gjyshes sonë. Kur lindi, mbeti dy herë jetime, se i vdiq edhe nëna lehonë, gjyshja ime e vërtetë. Aherë Hallë Mara, motra e gjyshes, që ishte vajzë nure për të martuar, e lakuuar nga shumë dhëndurë, e zonja për shërbesa dhe ngarkesa, hoqi dorë nga martesa dhe burri, i la mëtonjësit të shushatur si Penelopa e Odiseësë në Itakë të Greqisë. Ajo lidhi, siç themi ne në fshatin tonë, destemelin mënjanë dhe fustanin e ktheu në poture. Pra mbeti virgjëreshë, që të rriste të shkretën mbesë, nënoken time.

Hallë Mara mori huqet e burrave shpejt. Duhnin e pinte me llullë si kaminë. Në kohë të Italisë së parë, kur fshati kish pak burra dhe kur te ne hapej rruga e madhe, ajo ia vinte me terezi fitilin dinamitit dhe ndizte minat më mirë se robërit austriakë.

Ajo s'kishte asnjë paragjykim e as vuante nga ndonjë lloj kompleksi ndaj burrave, qofshin ata të vendit, qofshin dhe ushtarë a robër të botës. Ishte e fortë si ata, punonte si ajo e mosnjeri, ngarkohej si mushkë maxhare e kuvendonte si plak kuvendi. Dhe s'kurseu asgië që të rritej si me mëmë e tatë ime më. E lidhi jetën me nënën time, e marto, e trashëgoi dhe, kur na u vra babai nga gjermani (në luftën tjetër botërore), ajo u lidh përgjithnjë me ne, nipërit dhe mbesat e saj. Nëna punonte në punë të shtetit në Strehën Vorfnore, Hallë Mara komandonte në punët e shtëpisë, në strehën tonë. «U jam veqile e shtëpisë, kurse ti veqile e qeverisë», e cingëriste Hallë Mara nënën time, që punonte thjesht rrobalarëse.

Ne ishim tepér tē varfér, tē këputur fare, boll tē them atë, që s'kishim as krevat, jo më tavolinë, dhe megjithëse pallati kishte dritë elektrike, ne mbanim ndezur, natën në errësirë e në muzg, kur nisej nëna pér punë, llambën me vajguri, që tē kursenim paratë e qirasë së korentit. Në mbrëmje, nën dritën e flakës së llambës, hiqnim mësallën e bukës dhe shtronim stromën në dysheme dhe fati ynë këtu kish qëlluar i madh, së dyshemë e kishim me parket dhe jo si bodrumi i Xhentiles, më cimento. «Kur fle në dërrasa, s'të bëhet kurrë guzguni, jeto», na ngushëllonte Hallë Mara kur ne s'na zinte dot gjumi dhe shtonte me solemnitet tē madh: «Këtë ma ka mësuar tatezot jatri, Nane Kostandini nga Bunova!» Doktori, mjeku popullor, që ajo e kujtonte me nderim tē veçantë, ishte gjyshi i saj, që shëronte njerëzit e detit, himarjotët, me ilaçet e malit. Ajo thoshte që qe aq i zoti, sa njëherë, kur e zuri verdhëza Ali Vezirin, Pashanë e Janinës, edhe atë e shëroi me jatritë e tij. Kushedi. Hallë Mara thoshte kështu dhe ne e besonim. Shpesh vrisja mendjen aherë se ç'doktor i çuditshëm do tē ketë qenë ky katragjyshi ynë i kohës së Ali Pashë Tepelenës, që zinte hasha krevatin pér tē mos u bërë gungaç a kurrizdalë njerëzit.

Nëjse! Thashë që qemë tepér tē varfér, bile edhe në kråhasim më atë varféri që qenë shumica e njerëzve tanë tē sërës sonë në atë vitin e parë tē Clirimit. Mund tē them pa frikë se ne qemë aq tē këputur, sa t'u dhimbeshim edhe gurit dhe drurit.

Vëçse dy gjëra nuک mungonin kurrë në shtëpinë tonë, vajguri dhe kripa. Sikur tē na mungonin këto, Hallë Mara çante dhe në fund tē dheut t'i gjentë dhe i siguronte se s'bën. Ne çdo gjë mund tē merrnim hua te gjitonët, qoftë një grusht

miell misri pér një bullëmaç të shkretë, qoftë një kartë manestër, qoftë dhe një rrrogjé me fasule, shton i ju po deshët dhe nevoja të tjera tonat, po pér vajguri dhë kripë ne i shimi derë e madhe e xhymertë të parë. Pér to faleshin te ne, te Hallë Mara, që, në këso rastesh protokolli e thërritnën «zonjë Mara» edhe hanëmet e bejlerëve që tashti zotërinjtë i kishin në burg. Kurse, aha, sa pér kripë, këtu qepeni gojën të gjithë. Sus! Pér kripë mbëteshin kripë fare gjithë gjitonëria. Edhe Marija e Xhentiles apo Xhentilja i Marijes. Derri i mëjmë i tharkut të tyre nuk e shijonte vaktin e vet pa kripë. Dhe ka pastaj kaqolë që thonë se s'qenkan derrat qibarë në të ngrënë!

«Po patë petrelo (domethënë) [vajguri] dhe kripë, — thosh Hallë Mara, e sigurt, — ke gjithë bötën. Mjerë ata që s'i kanë. Nikoqiri i mirë zjarrin duhet ta ketë gjithnjë në buhari (paçka që ne e ndiznim në llamarinën mbi dysheme, pallat hesapi) dhe kripën gjithnjë në kusi!»

Pér kripën dhe vajgurin fqinjët e hanini turpin me bukë para Hallë Marës. Ajo kënaqej që njerëzit ia kishin nevojën, kurse ne kalamajtë e shtëpisë mburreshim që kishim një gjyshe të tillë.

Ishte kripa pér derrin gjithë pretendime, që na bëri miq familjarë Marijen dhe Xhentilen. Miqësia u trash edhe më shumë kur Hallë Mara mori vesh që! Marija e Xhentiles ishte nga "Kallmeti dhe që ky Kallmeti bënte, pér çudi të Hallës sonë, dhe ullirin, dhe rrushin, dhe fasulen, bile dhe fikun, njësoj si Himara! — Si Himara?! — Mbësë, kushedi!!

— Po zonjë Marë, — tha Marija e Xhentiles; kishte hallin e zakonshëm të kripës dhë Halla jonë më magjinë e kripës bëhej zonjë. Gjyshja jonë ishte e bindur së ajo tjetra i shpikte nga

mendja këto gjëra për Kallmetin, por bënte sikur e besonte, sepse tashmë kishte mësuar nga goja e Marijes, që atje në Kallmet kish qenë murgeschë, por e kishte pasë hutuar ky i mjeri Xhentile dhe për birin e Krishtit, e kishte sakrifikuar vëtë Krishtin.

— E, burrat janë si mjalti, s'duron dot pa i provuar një herë, — i kish dhënë të drejtë Mara plakë Marijes së re.

— Po, zonjë! Dhe të vret zoti gjithë jetën! — kish thënë tjetra.

— Jo dhet aq, — e qetësoi Hallë Mara.

Sidoqoftë unë s'kam ndër mend ta zgjat terrickuzën për ta lidhur barrën e historisë së Xhentiles me Marijen. Është e qartë që ata të dy kishin pasur një puqje ylli të madh, përderisa njëri kishte lënë Italinë e tjetra perëndinë për njërit-tjetrin. Por, për sa i përket Kallmetit, që kish soj të mirë ulliri dhe rrush që bënte verë nga ajo që pinte vetë papa i Romës, Hallë Mara kishte kundërshtuar:

— Mbështetje, bijë, mbështetje, po në fund të botës jeni e diell si tek ne s'keni.

— Jo, zonjë, asht bash i vendit Kallmeti, — kish mbrojtur ish-murgesha fshatin e kuvendit të saj.

Ajo ngulte, këmbë kot, se për Hallë Marën dhe Tirana ishte në fund të botës dhe se kërrthiza e kësaj bote jallane ishte vetëm Himara. Atje dhe plehu, që është pleh, nuk kutërbonte, por kundërmonte erë qumësht. Natyrisht, Marija e Xhentiles për atë Kallmetin e bukur fitoi disi vlerë para syve të Hallë Marës. Por, meqë Kallmeti s'futej në hesap para Himarës, plaka i tha së resë:

— Po det a ke, o jetë, atje në Kallmet?

— Jo, zonjë, deti asht larg.

— Ama, i bukur vend! Kot që është. Kur s'ka det, s'është gjë hiç. Toka pa det është si gruaja pa burrë, më keq s'ka ku të vejë.

Marija ishte e shkathët, nuk kundërshtoi më, se rrezikohej të humbiste kripën e të ikte duarthatë. Se këtu në rastin tim kundërshtimi s'kish kuptim. Ajo mund t'i thosh gjyshes sime që «ti je virgjneshë e s'di ç'asht burri!».

Miqësia jonë vazhdoi ca kohë dhe arriti puna deri atje, sa Marija nga Lezha sqaroi se përpara Hallë Marës ishte si fatkeqja Marije Magdalena që e gëzoi Jezunë pas vdekjes. Këto histori gjyshes sonë nga njëri vesh i hynin e nga tjetri i dilnin. Ajo kishte një gjysmë shekulli pa vajtur në kishë.

...Si shumë gjëra në jetë, dhe miqësia jonë familjare me Marijen desh u prish për fare. Nuk qe shkaktar as vajguri, as kripa e as keqkuptimi që krijohej shpesh në bisedën e dy Marijeve për hir të dialekteve të largëta. Se ndodhë dhe kështu, që e reja i thosh së vjetërës «se asht marre» dhe e vjetra ia kthente së resë «as e marrë s'jam e as të marrë s'të lo!». Në këto biseda, si me telefon të prishur, përkthyesit më të saktë ishim unë dhe Xhentilja. Sado e pabesueshme që të duket, italiani e kish më lehtë të kuptohej me të dyja gratë sa ato me njëra-tjetrën.

«Tarxhuman i Otrëntit, — i thërriste Hallë Mara italianit, — shkoqitja llafin sat shoqje!» Tjetri përkthente italisht i lumtur dhe Marija nga Kallmeti qështe me të madhe përfjalët që dëgjonte.

... Kësaj here s'ishte punë për të qeshur. As vajguri e as kripa nuk ndihmonin. Marrëdhëniet diplomatike u prenë atë çast midis Hallë Marës dhe Marijes dhe, kur Hallë Mara tërhiqte ambasadoret e saj, aherë dhe ne, gjithë klani ynë fa-

miljar, ishim në gjendje lufte me palën tjetër. Lufta shpalley e armëpushim s'kishte. I pari që e pësonte nga këto mosmarrëveshje e acarime nuk ishte orëziu Xhentile e as Marija, por derri i derrave. Tamam derri i tyre, që mbetej pa kripë dhe të cilit i dendësoheshin shqelmat që hante nga ne, kalamajtë. Mirë ta pësonte, se ai ishte shkaktari i prishjes sonë, si Franc Jozefi i Luftës së Parë Botërore, siç na sqaronte me keqardhje Xhentilja i varfër.

Një ditë, qëmenatë, Hallë Mara mori shatin dhe filloj të punonte tokën e oborrit para pallatit tonë.

Madamë Detja, që banonte një kat mbi ne, e shoqja e ministrit të mbretit Zog, që ishte dënuar me vdekje dhe priste të falej e të shpëtonte me burgim të përjetshëm, «me njëqind e një» (kështu kishte shkruar dhe gazeta), e pyeti hallën:

— Zonja Marë, do çelni lulishte? Olala, sa mirë!

Hallë Mara nuk iu përgjigj fare. Ç'të merrej me zogisten! Por me heshtjen e saj të rëndë gur unë e kuptova që i tha: «Shiko punën tënde. Merru me hallët e tua dhe me njëqindenjëshin tënd!» Madamë Detja bëri si e «këshilloi» halla. Iku e s'foli më.

Koloneli i ri, që banonte dy kate mbi ne e që vinte gjithnjë shaluar mbi kalë të bardhë si xhind në pallat dhe që më vonë ra e u gremis nga kali, i tha ordinancës:

— Thuaj kësaj plakës se s'është në fshat këtu. Këtu i thonë Tiranë dhe jo Himarë! S'është vend përlakra!

— Ik, more kokëlakër! — tha Hallë Mara tek la tashti shatin dhe ndezi llullën. Nuk u mor vesh kujt i drejtohej: ordinancës që përsëriti

fjalët e kolonelit majë kalit, apo zotit të ordinancës dhe kalit.

— Kjo është e jashtëligjshme! — nguli këmbë koloneli, duke iá tërhequr fort yzengjité kalit, i cili, nga ana e tij, ngriti dy këmbët e para përpjetë si kalë pashai. Por púnën e lakraje koloneli nuk e ngau më.

Ordinanca nuk arriti të përsériste fjalët e tij.

— Ligjet i bën populli, — ia preu Hällë Mara me atë frazën e kohës, që halla e kishte dëgjuar para ca ditësh në mbledhjen e Frontit të mëhallës. — Unë jam popull, — shtoi ajo me inat.

Ordinanca, që kishte marrë kapistrën e kalit të bardhë nga dora e sigurt e kolonelit, buzëqeshi sa përi vete. Atë monedhë që nuk ia kthente dot ai kolonelit, ia ktheu Hällë Mara edhe për të.

Ashtu si ish-ministresha a ish-bejleresha e rënë nga dynjallëku, edhe koloneli, që nuk e vriste tashti këpuca, por që më vonë ra nga kalli, iku. Ç'të merrej një goxha oficer me një plakë me një këmbë në vatrë, që s'kish habër nga bota. Ordinanca, çun i ri, më shkeli mua syrin me gjësim dhe çau.

Pastaj erdhi Marija, ajo e Xhentiles. E treata e vërteta e pati, Ajo nuk e dinte se si qenë zbythur me bisht në shalë Fuqitë e Mëdha njëra pas tjetrës. Kur pa që oborri i madh para pallatit, pronë e derrit të saj zullumqar, po ngushtohej, i pikoi në shpint dhe me urtësi murgeshë e pyeti gjyshen. time:

— Zonjë e Madhe! (Kështu e thërriste ajo në çaste solemne. Zakonisht kur kërkonte kripë hua.)

— Jepi një mastrapan kripë Marijes! — më urdhëroi gjyshja mua, si për një aksiomë që skishë nevojë të vërltetohet.

— Jo, besa, s'po kam dert krype, por deshta me ju pyetë: A keni marrë leje në pushtet që po punoni tokën?

— Çfarë?! — briti gjyshja ime.

O, e shkreta Marije! O, i mjeri derr i Marijes! Ku 'e gjete këtë sahat të lig të sqarosh çështje të tilla të tokës me gjyshen time?

Hallë Mara përplasi e shkundi hirin e llullës pas shkopit të shtatit. E futi llullën në brez si kobure kaçakësh dhe, pa e parë fare Marijen, ia këputi:

— Harrova të të pyes zotrote!

Tjetra dëgja deshi të thoshte, por s'po e gjente fjalën dhe Hallë Mara vazhdoi:

— Po derri yt a ka leje qarkullimi?

— Si?! — u habit tjetra dhe sqaroi: — Po derriat sot stimulohen nga qeveria.

Unë nuk e kuptova se ç'do të thoshte stimulohen. Jam i sigurt që as gjyshja ime nuk e mori vesh, por dëgjova tek gjëmoi:

— Po, moj Marije, o xhane! Dosat sot marten me lëtirë nga Italia.

Ishte e qartë që bibla po kthehej përmbyss, dy Marijet s'do të linin shteg pér t'u gjetur në llaf, sepse vetëm kur nevrikosej sa s'thuhet, aherë Hallë Mara «lëtirë» quante gjithë të huajt që ka bota.

Thashë që as unë as gjyshja ime s'kuptuam foljen «stimulohen» të Marijes, por tashti ishte radha e saj që të mos kuptonte «lëtirët» — latinët e Italisë. Dhe tak-fak, jo si murgeshë, por si grua e re, e harbuar, hazërxhevap, iu përgjigj gjithë urrejtje Hallë Marës:

— Lëtirë je vetë, moj plakë matufe. Më

marrç pleshtat' e derrit se unë jam martuar me burrë Xhentil!

S'kisha dëgjuar kurrë epite të tilla. Isha i vogël dhe gratë e shtëpisë sonë, nëna me gjyshen, nuk e këputnin kurrë kulaçin në mes me fjälë, se s'ngjitej më. Hallë Marës, në inat e sipër, s'ia hante qeni shkopin dhe iu përvesh:

— Moj dosë e dosave, moj putënë e kishëve, merru me fitilin tënd e me derrin dhe mua më lëri rehat në punën time, se ndryshe ta theva shatin vitheve!

— Kjo punë do shkojë në pushtet, u hakërrua Marija, që e kuptoi se grarishte s'ia dilte dót gjyshes sime dhe se puna kish arritur aty, ku vetëm qeveria ta zgjidh hallin.

— Mbret e pushtet jam vetë! — mori zjarr Hallë Mara. — Po ik këtë çast, sei ta hapa kokën me cekure!

Nuk mjaftonte për Marijen shati që do të thyhej vitheve, por duhej dhe cekurja kokës. Cekurja ishte një sëpatë e vogël, që mbante gjithnjë në rrip të mesit Hallë Mara dhe me të priste ferrat e drizat, shqopat e shkarpat.

E treta e vërteta, por jo gjithnjë kështu, se dhe Marija iku. Mbetëm vetëm Hallë Mara dhe unë në fushën e betejës.

— Lipsu! — më urdhëroi edhe mua dhe ajo mbeti e vetme, trime në luftë.

Unë u largova i mërzitur. Zbrita në bodrum, jo tek ai i Xhentiles, por në krahun tjetër, te bodrumi i bombave (vërtet kishte qenë depo bombash të gjermanëve) dhe në majë të gishtave, nga dritarja e tij, ndiqja gjyshen time, trime të marrë.

Hallë Mara, e lodhur nga grindjet dhe shamatë, jo nga puna e shatit, u ul mbi shul të shatit, nxori qesen e duhanit, mbushi llullën, e ngjeshi me gishtin e madh sikur vinte imzanë dhe

e ndezime masát e uror. Kundérmoi deri tek unë, në bodrumin e bombave, era eshkë! Erë më të mirë se ajo e eshkës së ndezur nuk ka!

Hallë Mara thoshte kaq herë: «Të tymosësh duhan, është gjo e ligë si për burra dhe për gra. Por për plakë si ajo është gjo e paqme!» Paçka që vetë e kishte pirë që kur qe grua e re. Sido-qoftë; duhani i saj, megjithëse kaçak, nuk kuterbonte erë të rëndë, por kundërmonte era eshkë. Dhe eshka të shëron nga astma... Ajo pinte duhañ e vëtmuar dhe e harruar dhe unë, që s'isha më i zemëruar me të; gëzohesha tek kujtoja se si ajo i theu e i ktheu mbrapsht, njërin pas tjetrit, kundërshtarët e saj të fortë, si dikur në rini mëtonjësit, kandidatët dhëndurë të saj.

Natyrisht, isha krenar dhe i lumtur sa s'bëhet që kisha gjyshen më trimë të botës, që ishte mbret dhe pushtet bashkë.

...E punoi kopshtin dhe e gardhosi me driza e ferra. Mbollë domate me kalore të giata dhe fasule që u văreshin domatëve si akacie. Kopshti i saj qe për merak dhe në fëmijët e ruanëm si sytë e ballit nga njerëzit e ligj dhe derri i kurtitur i Marijes.

U zunë dhe herë të tjera Marija me Hallë Marën: aherë kur përpiqei derri i babëzitur të cante gardhin (sic duket edhe atii i vëlqenin barbunjat dhe domatet taze), dhe Hallë Mara i thyen të hunj mbi kurrizin e maimë. Paoë midis tyre s'pati më. Dhe dukei se s'do të vinte kurre. Kishte mbaruar Lufta e Dytë, Botërore, por nuk mbaronte dot akoma lufta jomë gjitonore. Këto zënka e gërnja grarishtë midis dy shënmërive ju mund t'i merrni vetë me mend dhe unë s'po ngas më fjalën për to. Ju dhashë nië model të tyre dhe miafton të provosh një lugë, që të dish së c'mjaltë ka ena.

Për çudi, në këto kontradikta të ashpra shenjtoresh, Xhentilja rrinte larg, rrinte mënjanë apo, siç thuhet shpesh, asnjanës. Megjithëse dy Marijet, plaka dhe e reja, i kishin larguar me kohë ambasadorët midis tyre, prapëseprapë, Xhentilja nga njëra anë dhe unë nga ana tjetër, ishim si të ngarkuar me punë, si përfaqësues shtetesh neutrale për hallet e tyre. I shkreti Xhentile, kishte punë më shumë nga unë, se për kripë ata prapë shpesh mbeteshin kripë. Kurse unë kisha detyra më të vështira, gjithnjë dërgohesha në bodrum me paralajmërimë serioze dhe kërcënime të tmerishme për derrin. Nxitoja me vrap sapo merrja urdhërin e Hallë Marës.

— Ik thuaj asaj dosës së manastireve që, po e la prapë derrin të më bëjë zarar në kopsht, do ta ther me cekure!

— Ekja dhe vrisja mendjen, tek uzbritja shkallët e bodrumit. Kë do të therte ajo: dosën Marije, apo derrin budalla, që ishte mollë sherri për dy shenjtoret?

Por do t'i lë për ca këto marrëdhënie të ndera më gjakra të ndezura mesdhetare dhe do të tregoj për ca gjitonë të tjerë, sidomos për Métin.

\* \* \*

Meti ishte gjitoni i parë që patëm kur hymë rië pallat. Ne mund të zgjidhnim c'apartament të dëshironim, gjithë hyrjet qenë tonat. Por si Hallë Mara dhe Dajë Liu, i ati i Metit, parapëlqyen katën e parë: «Si ngromë dot drutë lart», e motivoi Hallë Mara, «Më mirë poshtë, se të zera më pak», e shpjegoi Dajë Liu. Hallë Mara s'merrej dot vesh me Gjylen, ijen

e Metit. E para fliste në të folmen relikte të Buzukut, që eshtë ruajtur dhe sot e kesaj ditë në ismatin tone te largjet, buze Jonit, kurse e dyta fliste një tirange te thekur, nre ungjil hundore si trengjishtja, që më vonë do të bëhej e modës. Vëtem në foljet që në gegërishten e djeshme kanë «a» dhe në toskeriteshën «ë» për shembull «u ba» dhe «u be» ato të dyja kuptioneshin pa ndërmjetesinë, zakonisht, timen dhe më rraitë të meut. Në keto raste të dyja thoshin «u bo». Në të tjerat s'puqeshin fare, si dy paralele që s'takohen kurrë. Qellonte që Gjylja, e éma e Metit, kërkonte «nagaçe për të prerë drutë», Hallë Mara i thosh «skam, motero, se unë i pres drutë me cekure». Tjetra ikte duarbosh, paçka se flisnin për të njëjtën gjë.

Ishte kjo ndërmjetësi «përkthimi» që na lidhi më shumë mua me Metin nga Peza. Të tjera gjëra s'na lidhnin. Ai kishte shoqërinë e vët dhe nuk e ulte pazarin të merrej me ne çapaçulët e vegjël.

Ai kishte hyrë në punë saraç në Pazar të Vjetër, tek i ati, Kadriu, që nuk e di pse dhe vetë Meti e thërriste Dajë Liu. Topin prej lecke, çukthin, që ma kishte ormisur Hallë Mara, ai ma veshi me koperton lëkure. U bë si top i jashtëm. Për këtë Metin unë e kisha mik për kokë.

Meti ishte djalë fjalëpakë, ndoshta ngaqë kish dalë herët në punë. Ai kishte mbetur djalë i vëtëm si unë. Dy vëllezër i ishin vrarë, me Çetën e Pezës, të Babë Myslimit. Kishte tri motra, një më shumë se unë. Dy të nxjerra jashtë dere, të martuara pra, dhe tjetrën, Bedrijen, hazër për nuse. Ishte dhe Diu, shoku im tamam, që unë e kujtoja në fillim si vëllanë e Metit, por që ishte ose çun i vëllait të nënës së tij, çun daje pra, ose djalë xhaje. Këtë s'e mora vesh kurrë.

Diu bënte shkollën me ifua. Në Maknor, që ishte fshati i tij atje në Pezë, nuk ishte hapur shkolla ende. Ishte i përkëdheluri i shtëpisë së gjitonëve pezakë. Ishte djalë sevapi.

Por e kishim fjalën për Metin. Prej tij dëgjovë për të parën herë që në Tiranë u hap shkolla e kadetëve, shkolla «Skënderbej». Atij i pëlqente të shkonte atje, por e éma dhe dajallarët nuk donin. Boll mori lufta burra të kësaj shtëpie. Unë nuk kuptoja se për ç'luftë bëhej fjalë prapë. Lufta bërërore kishte mbaruar. Këtë e tha një ditë dhe radioja e Madamë Detes. Kurse usta Liu, babai i tij, ngulte këmbë që i biri të mësonte zanat. Ai nuk të lë pa bukë. Dhe Meti ishte djalë i bindur e nuk shkelte dot mbi fjalën e prindërve. Por, kur luanim luftash me çunat e mëhallës matanë lumit, kur mbeteshim kaq e rrëzikohësim të shpartalloheshim si ballistët, ne i luteshim Diut të thërriste Metin. Në këto raste të vështira për ne, Meti harronte që ishte më i madh dhe vinte me vraptë na ndihmonfë. Në këto ditë fatkeqësish Meti bëhej komandanti ynë dhe na shpëtonë rriderin.

Ai ishte shpikës i madh. Të ishte bëre inxhinier, do të qe konstruktor i mbaruar. Meti ishte ai që në këto lojëra luftash, që shpeshi nuk mbaronin pa vaj për ne ose për ata çunat matanë Lanës, sajoi njëherë topin me gjyle. Ishte top prej tamnami, me grykë, që ë bëmë me qyngjet e forfa të sobave të pallatit, që nuk i përdornim kurre. Guri, gjylja, kalonte nëpër të pasi kishte marrë shpejtësinë e parë nga një rrip llastiku i trashë, që e tërhoqni dy çuna bashkë. Nuk ka nevojë të them që rripin e trashë të llastikut e kishim nga dyqani i usta Liut. Me këtë top, që e hidhte gurin e madh sa një vezë pulëdeti nga tarraca e pallatit tonë deri matanë Lanës, ne u

bëmë të tmerrshëm. Topi ynë hyri në bisedat e familjeve të çunave matanë Lanës si top i muhxirëve. Se vërtet ne të pallatit shumica kështu qemë, të ardhur rishtas. Paçka se këtu bëhej një gabim, se harrohej që madamë Detja, koloneli e ca të tjerë të pallatit qenë denbabaden vendas. Vezet tona, domethënë gjylet tona nuk vranë njeri matanë Lanës, e as zi nuk pati ato ditë andej. Po për disa ditë armiku ynë u thye, u tërroq dhe nuk shpallte më luftë. Ne çamë rrëthimin dhe u bënim karshillëk çunave matanë, demede çunave të Rrugës Pal, siç e hiqnin ata vëten, sipas një libri që kish kënduar dikush prej tyre.

Veçse një ditë ndodhi çudia e vërtetë. Këtë nuk e bëri Meti ynë, por ata matanë Lanës. Njëri prej tyre, — tek u ripërtërinë luftërat tona, armëpushimi s'mbante dot gjatë midis nesh, — qëlloi drejt nesh, mos u trembni po deshët, me revole të vërtetë, me plumbë hakshe. Fishek «golli», sqaroi Meti kur i ra në dorë. Tashti nuk ishte më lojë luftash, tashti luhej për jetë a vdekje. Meti protestoi dhe tha se kjo nuk quhej. Mirë «nuk quhet», tha Meti, po hajde t'u mbushje mendjen, çunave matanë Lanës që e kishin me të vërtetë. Ata s'terhigeshin dhe revolveri në duart e tyre s'ishte më lodër. Nuk i bëje dot dredha plumbit e as fshiheshe dot pas gaxhoit.

Ne u siguruam mirë pas murit të fortë të tarracës së pallatit dhe andej herë pas here lëshonim në hapësirë zërin tonë të protestët dhe gurët. Shkallët e pallatit ata s'i ngjitnin dot, se nuk i linte hija e rëndë e autoriteteve që banonin në të. S'ishin pak po një deputet, një ministër (të dy «ish» vërtet, por ta këputnin bishtin) dhe një kolonel pa «ish». Autoritetet krijonin niëfarë sigurie për ne, por, mbi të gjitha, ata që i frikëso-

nin më shumë çunat matanë Lanës qenë bishtat e fshesave të grave, nënave tona. Do, të kishte ndonjë të mençur nga ata çunat matanë, që e dinte mirë q'do të thotë të merresh me gratë. Larg duart prej fëmijëve të tyre! Kështu që pas murit të tarracës ne bënim gallatë dhe qemë të bindur që nuk na zinte plumbi, si atë mitraljerin a snajperin gjerman, që e gjetëm të vrarë kur hipëm për të parën herë në tarracë. Ai qelbej i téri dhe e kishin ngrënë sorrat dhe e varrosëm, si gjermanët e tjerë, rrëzë murit të oborrit të pallatit.

Aherë kur ne bënim shaka me plumbat e tjekrit, Meti ndërhyri dhe na svaroi, duke na vënë në siklet të gjithë;

— Vërtet plumbi i revoles, qoftë dhe «golt» amerikan, nuk e çan dot murin, por ndonjë plumb qorr, me rikoshetë, edhe të kap, e shkon për dhjamë qeni.

Çfarë thoshte ai kështu?! Shpesh nuk e kam kuptuar gjuhën e të mëdhenjve, por kësaj radhe as Polivaq, greku s'kuptoi gjë.

Pamë ç'pamë dhe ne kalamajtë e vegjël zbrietëm e zumë vend pastaj në bodrum, te Xhentilja i Marijes, ose u futëm në apartamentet tona.

— U ngujujet në kullë; — tha atë pasdite Marija.

Me ne të ngujuarit në kullë ishte tashti dhe kapedani ynë pezak, Meti. Cudi e madhe me këtë Metin. Ai bëhei dhe na përkrahte ne të ardhurit, alloktonët e muhaxhirët e Tiranës dhe jo ata përftej Lanës, që ishin safi tiranas, autoktonë, denbabaden.

Në luftërat tona, natyrisht, nuk merrnin pjesë as diali dhe as vaiza e urtë e atij burrit të Madamë Detes, të dënuar me vdekje, as dy djemtë e sertë të atij ministrit që paskësh thënë nio

herë e një kohë se Shqipërinë po e prishin shkollat e shumta! Ata s'beginisnin të luanin me ne apo e dihin që s'i qasnim ne, nuk e them dot. Ata rrinin e bënин sehir. Për ta, kushdo që të fitonte, si ne më këtë breg dhe ata në bregun tjetër të Lanës, ishte njësoj. Ata prisnin dhe bënин sehir...

Më në fund, kur po errej, djemtë matanë u mërzitën e ikën dhe ne dolëm nga ngujimi. Me siguri revoles së tyre i mbaruan plumbat. Megjithëse mendja na shkoi dhe aty, që patjetër babai i revolvermbajtësit do të ishte ndonjë polic që tashti kthehej nga shërbimi. Hajde, c'dajak do të hante ai nga i ati! Për ndonjë arsyе tjetër, si për shembull bërja e detyravë të shkollës për nesër, nuk na shkonte mendja. Kur ne nuk e vrisnim për to, pse do të lodheshin «armiqjtë» tanë me to.

Dhe kështu, gati në të mugur, ne kujtuam, në bodrum, dhomën me municion. Ajo ishte një dhomë e madhe, që e kishim zbuluar me kohë, por që s'kishim ditur të hymim brenda. Gjatë luftës dikush e kishte djegur. Gjermanët apo partizanët, nuk e di. Nga dritarja e vogël e bodrumit duke shën ca si qysqi të gjata, që atë pasdite në mug, kur hvimë brenda, doli se ishin një thesar i vërtetë. E merrni me mend dot që ato ishin skelete metalike pushkësh? «Pushkë fosile», tha Polivaq greku.

Bëmë si bëmë, halli të jep forcë, dhe hymë në dhomën e madhe të bodrumit nga dritarja e vogël me hekura. Aty mësova se në cdo të çarë mund të hvjë trupi i njeriut, boll të futet koka. Po tu fut koka, ec përpara e mos u tërhia. Hyri Polivaqi i pari, pastaj unë dhe të tierët. Dera e hekurt e depôs, se ashtu ishte ajo dhomë, ishte e mbyllur dhe e rëndë. Atë s'e kishte hapur dot as Xhontilija, që kërkonte këmbë hekuri për të bërë krevatin bashkëshortor. Dera ishte e ndry-

shkur, e zënë prej kohësh (kuptohet, me bravë ushtrie) dhe s'lëvizte kurrsesi, për kiamet!

Metit ia kishë e qejfi të hynte, por atij nuk i takonte të hynte kështu si ne, hajdutçe, nga dritarja e vogël. Ai ishte burrë dhe ata s'merren me punë çiliminjsh. A thua? Ai's'e jepte veten pér ndonjë shkas tjetër, por u hë tashti jàm i bindur që ai nuk e kishte kokën të vogël si tonën. Troç, atë nuk e nxinin hekurat e dritares, e kishte kokën të madhe, prandaj s'hyri me ne-në depon e armëve.

Polivaq greku çau i pari, pas tij u kacavara dhe unë. Polivaqi ishte minoritar pòliçaniot dhe, megjithëse hante mirë, se vëllai i punonte kamierier në hotel «Dajti», me amerikanët, prapë-serapë ishte cipal i hollë, transparent! Kishte tenjën në bark!

Mbërritëm poshtë. Bëmë ujin e hollë. Polivaqi hoqi dhe rripin e pantallónave dhe u bë gati të ulej. Unë i thashë se s'ka lezet se po na pret Meti lart. «Kalla, kalla», tha ai dhe hoqi dorë nga mendimi i tij. Morëthi skeletet e pushkëve, ato që nga dritarja ngjanin si qysqi. Këto skelete, të zhuritura e të percëlluarë, kishin gjithçka prej çeliku që i duhet pushkës. Gjithë pjesët e saj. Veçse llozet ishin blokuar e s'lëviznin, kurse kondakët e drunjte ishin bërë blozë. Ishin djegur.

Polivaqi u ul galic, unë u ngjita mbi të dhe me skeletin e pushkës shtrënguar i dhashë dorën Metit. Dola në dritë, në oborr. Pas meje, po me ndihmën e pezakut, u ngjit dhe Polivaqi.

Meti nuk na e vari fare. Ai përkëdhelte ato çka prumë ne nga bodrumi.

— Çfarë mauzeri, xixë! — thirri Meti i ngazëllyer.

— Tashti të shohin tiranasit, — tha Polivaqi.

— Kace kalla, pedhimul!

— Çfarë, çfarë? — pyetëm ne.

— Ç'thotë, mre, ky kopil? — pyeti Meti, i hutuar me fjalët e Polivaqit, që s'i kuptonam dot.

— Hiç, bre guni. Hiç, bre Meti! — tha Polivaqi si i zënë né faj.

Nuk e ai ç'telepati e lidhi mendimin e Polivaqit me atë te Metit, por ky i dyti tha:

— Hak pushkë dō bajmë. Le' tē guxojnë lanaxhijntë të na shesin mend me pathake!

Dhe qysh tē nesërmen pa gdhirë, në mëngjes herët, Meti, si kish pyetur sì hiqet ndryshku i çelikut, patjetër babën e vet, usta Liun, erdhi dhe kërkoi te Hallë Mara vajguri.

— Oj nomëdaja e Sofijes! — thirri ai.

— Mërëmëngjesi, jeto, qysh u ditë? — pyeti Hallë Mara,

— A bëjmë një tramë kokë pér kokë bashkë. Të tē jap ca telyn, më jep pak vajguri.

Telynin, që ishte gjalpë pér tē, nuk e mori vesh Hallë Mara, por kujtoi që diçka donte tē lyente Meti me vajguri, me petrelon e saj. Sapo kishte dalë ato ditë morri i madh dhe epidemja e tifos së tij dhe vajguri i Hallë Marës ishte bërë me vlerë tē madhe shumë, pér gjithë pallatin, s'paguhej me flori. Bile edhe kripa s'peshonte më para tij. Njerëzit lanin kokën me vajguri, që tē ngordhnin e tē hiqnin qafe morrat. S'kish nevojë më as tē mburritje e as tē çqitje leshrat me çqitës. I ra vlera krehrit. Vajguri ishte dorë me një. Vetëm kur läheshe e lyheshe me tē, s'duhej tē thaheshe pranë zjarrit.

— Aha, — tha Hallë Mara e alarmuar, — plasi dhe tek ju! T'i lyeni, jeto, t'i lyeni! — miratoi ajo.

E kishte fjalën pér morrin, që paskësh plasur dhe te pezakët. Meti e kuptoi pér luftën që bënim me mëhallën tjetër dhe iu përgjigj i qetë:

— Ka kohë, nonëdaja e Sofijes, që ka plasë!  
U morën vesh! Ai mori vajgurin. Tëlynin u  
harrua. S'ishte koha për tregti.

Meti e pastroi gjatë atë mauzerin e tij. Dhe  
ne, të gjithë e dinim që çeta jonë e kalamajve të  
pallatit po bëhej me pushkë gjermane. Dëgjuan  
dhe ata, lanaxhinjtë matanë Lanës dhe ranë squkë,  
s'u bënë më për trima. Se Meti nuk ishte njëri  
dosido! Jo, ai ishte nga Peza, që për punë push-  
kësh shokë kanë veten.

Por ne prisnim kot tashti që ta vinim mauze-  
rin në punë. Kjo zgjati shumë, se nuk gjenim dot  
fishekë sagllam për të. Dhe aherë, kur nuk e  
prisnim dhe kur lanaxhinjve po u rriteshin pen-  
dët prapë, fishekët na i gjeti derri i Marijes. Tek  
gërmonte një ditë me noçkën e tij të fortë gro-  
pat e veta në shesh të pallatit (jo në kopshtin e  
Hallë Marës), ai zbuloi një arkë më municion.

— Xhephane e madhe! — u gjëzua Meti.

— Mjerë ju, të mjerët! — bëri Polivaqi me  
gisht në drejtim të Lanës.

Xhephania, arka e derrit, ishte më fishekë ma-  
užeri. Dhe ja, si vjen e rrrotullohet bota: kjo xhep-  
hane do të bëhej sebep për të keq të tij, vëte  
derrit të Marijes. Tek ai do të provohej sa vënte  
«măuxerri» i Metit. Vjen radha kështu të kthehe-  
mi prapë të marrëdhëniet e Hallë Marës nga Hi-  
marë me Marijen e Kallmetit, dhe Xhentilen, e  
Italisë.

Vonë, në të dalë të vjeshtës, atë vitin dyzete-  
pesë, rana një shi i madh që mbuloi dhënë. Hallë  
Mara, në mesovjeshtë kish shkultur furkat e fun-

dit imë domate zemërkau e fasule dibrane dhe kish mbjellë patatet e hershme në kopshtin e sherrit. Ajo shfrytëzonte mirë këdini e pashkruar agroteknik të fshatit tonë Bunovë.

Kur ra shiu i parë, ajo bekoi perëndinë për atë flori që u fali arave të botës dhe patateve të saj. Se, që ta merrni vesh ju, «patatja, që është ujë e tëra, ujë do, të rritet si bostani». Kur ra shiu i dytë, ajo s'mbahet nga hareja «dhe do të pëlcasë Marija nga mërial», profetizoi gjyshja imë atë ditë të shënuar shiu. Vëç kur u shkul e u shemb qelli e ra shiu i tretë e i vërtetë dhe dolën rrëketë e u frynë e u mbushën kanalet anës rrugëve si pérrenjtë, aq sa u përmbyt gjithçka e u shkul gjithçka e mbjellë, e me to bashkë dhe patatet e vçrra, akoma farë, sa një koqë vezë breshkë, Hallë Mara as bekoi e as profetizoi më, por vuri kujën dhe thirri:

— Katakлизмо! Akratato!

Të dyja këto fjalë ishin të panjohura përmua, por kishin aq shumë bashkëtingëllorë të lëdhshme, sa e ndieja që diçka e koshme po ndodhë për ne. Fundi i botës!

Dhe nëse nuk keni besuar ndonjëherë që hidhërimi i njeriut është gjëzimi i tjeturit, të jeni të sigurt që keni gabuar. Kur ra shiu i tretë dhe ne mbetëm pa kopsht, aherë vëtëm Marija e Xhentiles u gjëzua me fatkeqësinë tonë. Derri i babëzitur i saj i kishte patatet sheshit. Po gjëzimi i saj dhe i derrit të vet qe i shkurtër.

Shiu vazhdoi dhe për disa ditë të tjera dhe nga varret dolën gjermanët e parë. Ishin eshtrat e gjermanëve të varrosur cekët, anës murit të oborrit të pallatit, që ishin harruar fare e mbuluar me ferra. Xhentilja bëri kryqin për ish-ale-atët që notonin vijave të ujit bashkë me atë kopljin e hedhur nga një mëkatare e re. Atë ditë

kiaméti dhe Marija e Kallmetif u hutua, u shtang, u tremib dhe u kujtua të bënte kryqin. Dhe pastaj ndodhi vërtet kataklizmoi, fundi i botës, fundi i mëhallës sonë, kur bodrumet e Marijes u mbushën e u mbytëni më ujë. Dhe uji mibërriti deri te pragu ynë i katit të parë. Skollopati dhe shkallarja në hyrje të pallatit nuk dukeshin më, i varrosi uji. Niveli i ujit ishte ngritur një metër e ca nga rrëfshi i tokës kudo, dhe nëna ime mbeti e izoliuar, në anën tjetër të Tiranës, në lavanterinë e shtëpisë së fëmijëve.

Tashti ajo s'lodhej hiç për ujë, mendova unë, se ujë kish sa të dojë e s'kish nevojë as për kazanë e as për magje. Mjaftonte që ajo të dilte në parvaz të drifatës dhe çarçafët mund t'i lante si në pishinë. Këto që mendova, nuk i mbajta përvete, por ia thashë dhë Hallë Marës.

— Tuna! O zot! — tha ajo. — Mjaft de! — Ashtu siç thosh kur na mbushte më të rrallë çanakët me qumësh. Gjithmonë, tek shihte sytë tanë, që kërkonin, dhe më, ajo belbëzonte këtë fjalë të panjohur:

— Tuna, jeto! Tuna e ke! Ne në këtë kat që po rrezikohet të mbytej, dhe nëna në atë anë të Tiranës, mbetëmi të shkëputur nga njëri-tjetri. Më ne ishte Hallë Mara dhe, kur kishim atë, kishim gjithçka, por e shkretja nënë ç'bënte atje në atë lavanterinë e fëmijëve të botës, që unë e pëlqejta ngatëroja me «levando», sikur s'laheshin rrobat këllirë, por parfumoseshin njerëzit! Mjerë ajo! Ne kishim Hallë Marën dhe mund të ngjiteshim në tafracë të pallatit dhe këtë e bëmë shpejt. U ngjitim atje te vendi ku kishte vrarë partizani një snajper gjerman dhe kui gjaku dhe deri asaj dite s'ishte larrë akoma dhe pamë që mëhallë jonë që kthyer në det të tërë më ishujt e anije. Ishin shtëpitë e barakat

buzë Lanës që ngjanin kështu. Sebep i kësaj përmbytjeje të rrezikshme qe ajo qerrata Lanë, lumenë i thëngin, që u fry e u mbars e doli mbi brigjet e saj. Akoma atë mbarim vjeshte nuk ishin marrë me të ata robërit gjermanë, që i ndërruan drejtimin dhe e sistemuan Lanën nga lagjja e «Moskatit» (lagjja jonë, lagjja matanë). Dhe, tek çmeriteshim me Tiranën e përmbytur nga uji, Madamë Detja, që e kish harruar tashti hallin e ministrit, burrit të saj të dënuar me vdekje, në majë të tarracës na mësoi që «pallati ynë ishte Varka e Noes!»

... Erdhi, mbrëmja. Asgjë nuk dukej rrëth e qark, se korenti ishte prerë. Filloi, të frynte erë dhe Hällë Mara na zbriti poshtë në apartamentin tonë, që të mos ftoheshim. Zbritëm, poshtë, ndezëm zjarrin me kujdes mbi llamarinën tonë, me gjithëse rrezik zjarri tashti s'kishte më. Ne ngrohним gishterinxjtë e hapur e të mardhur, të mavijosur, si këmbë oktapodhi, shihnim gjuhët e flakës dhë s'u besonim syve që zjarri mund të ekzistonte ende në këtë tokë të kthyer në det.

Gjumi nuk na zinte, se kishim merakun e nënës, që mbeti atje tutje Laprakës, kurse ajo, me bindje, qante hallin tonë këtu brigjeve të Lanës. Dhe ja, në derën tonë u fanepsën Marija me Xhentilen dhe derrin, që mezi e tërhiqte bran. Derri i rëndë sa një hipopotam ulërinte i lemerisur, kishte parë llahtarë në tharkun e tij dhe, me sa dukej, uji dhe zjarri qenë gjérat më të tmerrshme edhe për të.

S'kishte nevojë të trokitnin në derë. Ajo qe hapur, ne prisnim nënën. Por dhe sikur mbyllur të qe ulërima e derrit ishte më e fortë se sinjalët e makinave zjarrfikëse. Ne u ngritëm nga zjarri dhe, nën flakët e tij, — se; kur ndiznim zjarrin, llambën e vajgurit e shuanim, — pamë që Marija

qante me dënesë si gocë e vogël, kurse orëziu Xhentile përpiqej e mundohej kot ta ngushëllonte, duke mbajtur fort e me zor derrin e lidhur. Ç'i thoshte Xhentilja Marijes, nuk e merrnim vesh. Ai fliste italisht. Kurse ajo qante, siç qajnë të gjitha gratë:

— Kuku, ç'na ka gjetë! — thërriste Marija. — Kuku! — tamam si qyqe.

— Mbylle, o korbëzeza! Mbylle atë kamare, — urdhëroi Hallë Mara, — se ç'qe pér t'u bërë u bo!

— Më hupën të tana! — u ankua Marija. Me siguri e kishte fjalën pér gjithë ç'kish atje në bordum, me plang e prokopi.

— S'të humbet gjo, bijo, — tha Hallë Mara, — uji do shterpojë e rraqet atje mbeten, po futuni brenda e merrni një afsh zjarr se tartallosët e kallkanosët si në mal të Çikës.

Dhe sikur nuk ishin ato që s'flisnin pér javë të tëra midis tyre! Unë u hutova dhe e humba fare. C'ishte kjo paqe e miqësi? Ata u ulën rreth llamarinës sonë. E kam thënë që s'kishim sobë, por ajo llamarinë e shkulur nga barakat e komandës gjermane ia shkonte çdo sobe.

— Kuku! — përsëriti Marija avazin e parë. — Të tana më hupën!

— S'të humbet gjo, jo! — tha prapë Hallë Mara. — Ja, do të pushojë ky i bekuar shi dhe çdo gjo, do zërë vendin e vet. Mua, po, që nuk i vë dot më patatet e shkulura, më preu krahët, se m'i lë ciliminjtë pa bukë. Erësëgjéri!

Xhentilja dhe ne fëmijët dëgjonim. Dhe s'kuptonim, as ne e as ai, se kush kish të drejtë, Marëplaka apo Marijenusja.

Kur papritur, patjetër meqë shqoi çekuren në brez të Hallë Marës, bashkëshortja e Xhentiles u përgjérua:

— Zonjë e madhe (Hallë Mara atë çast u bë zonjë e bile e madhe jo nga malli po nga halli që kish tjetra), po ju bëj një rixha, a po ma ther- ni nji këtë derr! — dhe tregoi nga Xhentilja, sepse derri i varfër vazhdonte të ishte i lidhur si manar pas italianit.

Hallë Mara qeshi. Qeshi dhe Xhentilja kur e kuptoi që derri ishte ai tjetri, që hungërronte pranë tij.

— Marije, o bijë, — tha Hallë Mara, — s'kam zemër pér të vrarë një mi, jo një derr, o korbë!

— A! — u çudit Marija bijë. — Po ti a nuk ke dashë me ma vra kaq herë atë të mallkuem?

— Llafe, jetò, llafe! S'vritet as njeriu as derri me llaf.

— Kurse unë kam kujtue...

— Lëre c'kujton ti! Pér llafe, si ti dhe unë s'biem poshtë, Shqipëri veten kemi.

Shiu s'pushonte.

— Pas Luftës së Dytë Botërore, kjo do jetë katastrofa më e madhe, — meditoi Xhentilja. — Mjerë Italia!

Kurse Hallë Mara vuri e zuri një mbëlatë brumë sa pér një kulaç të misërt. E poqi dhe e dogji në llamarinë, e mbuloi me hi dhe, kur e ndau me miqtë, kaptova pështymën kur e pashë sa i shijoi dhe. Xhentile italianit dhe Marije shkodrianes. Megjithëse Marija ishte nga Lezha, Hallë Mara, gjithë c'qenë nga Tirana e lart, i merrte pér shkodranë! Bashkë me të dhë ne fëmijët kështu e besonim gjeografinë. «Janë pashallëk i madh, — thosh shpesh ajo pér ta: — Pasha Shkodra!»

Si na erdhi radha e u kënaqëm secili me hisen e vet të kulaçit, Hallë Mara ndezi cibukun me një kongjill zjarri. Më pëlqente shumë kur ndizte duhanin me zjarr si tashti. Ajò nuk e më-

rrte kurri kongjillin me mashë, por drejt e me dorë. Masha nuk vlente një grosh në shtëpinë tonë. Kongjilli i zjarrtë zinte vend mbi çibukun e madh dhe ngjante si një poç llambe biciklete. Hallë Mara i hodhi qesen e duhanit dhe Xhentiles, por ai e falënderoi dhe e kujtoi që s'pinte duhan.

— Mirë bën zotrote, — e përkrahu Halla atë, — ç'e do shejtanin, helm është! Fumar duhan e firar dunjanë! — profetizoi ajo. Kurse për vete tymonte me qejf, dhe lezet të madh, si «Pasha Shkodra».

Cuditem dhe sot e kësaj dite si nuk e mësova dhe unë duhanin me Hallën, aq me kënaqësi e pinte, sa s'besohej të kishte tjetër gjëzim në botë.

Si piu duhanin dhe shkundi çibukun, Hallë Mara, e lehtë dhe e shpejtë, u ngrit e shtroi rrobat. Ajo me Marijen kallmetase dhe motrat e mia mënjanë, unë me Xhentilen më anë tjetër. Dhe në krah të Xhentiles hungërronte derri. Kish ftohtë a urt nuk e di. Gratë cuquritën një copë herë me njëra-tjetër, pastaj u bë qetesi. Dëgjohej më të rrallë derri dhe gjithë kohën shiu që u binte fort cative të shtëpive si karrocieri kuajve të karrocës së plehrave të pallatit. Ishin kuaj pleq e pa fuqi, që dhe kërbaçi nuk i shkathësonte dot. Por, sido që të jetë shiu, e rrahir karrocieri plak a e goditur kamxhiku kallorësi të ri, shi mbetet prapë. Dhe në mot me shigumi është mik i parë.

Tek po më mbylleshin sytë, ashtu përgjumësh, e pyeta Xhentilen:

— Pse nuk vajtët lart, te ministresha, Xhentile? Hallë Mara, me Marijen janë në luftë, kurse ata lart, — tregova me gisht tavanin, sikur tre goja qiellin, — janë në gjendje të mirë, të kamur e të majmur.

Ishte një pyetje e shprehur rrëmujëthi, siç janë gjithnjë mendimet para gjumit të një fëmije.

— Janë borgjezë, — tha Xhentilja. — Marija nuk i do hiç atë.

S'kish nevojë për sqarime të tjera. Borgjezët i dija mirë. Ata më kishin vrarë babanë. S'qenka kaq e keqe kjo Marija, kur nuk i dashka borgjezët! Ç'kanë që zihen, aherë, me Hallë Marën?!

— Natën e mirë, Xhentile!

— Natën e mirë! — më urroi dhe ai.

Xhentilja i kish ngrohur "shtrojet mirë, dhe, pa më zënë gjumi akoma, solla ndër mend Marrien. Me siguri ajo andaj e mbante në shtrat Xhentilen, se i ngrohte rrobat furrë, jo 'si Halla ime akull.

Më zuri gjumi shpejt, por dhe shpejt u zgjova. Njëra nga motrat, me siguri e vogla, që vuan te nga veshkat, kishte vajtur në banjë. U dëgjuan dy ulërima njëherësh. (Duet fantastik). Njëra e motrës dhe tjetra e derrit. Në errësirën e thellë të banjës motra e vogël kishte shkelur mbi dhjamin e derrit të madh. Ajo ishte rrëzuar përtokë, kurse derri qe zgjuar i hutuar dhe kërkonte shteg të çante. Nuk më shqetësoi dhet aq halli i motrës, derri ishte i butë e kanakar, por më çuditi fort fakti se si u gjerëd derri në banjë! Ç'donte ai atje? Kush e çoi? Harroja që Xhentilja ishte burrë dhe gjumi, si çdo burrë, e zinte më vonë se mua, fëmijën. Ai e kishte quar pa u ndier sebepciun në vendin e lig. Hallë Mara ndëzi fitilin e llambës. U bë dritë. Motrën e ngriq tëm, kurse derrin s'e qetësonim dot. Punë derrash.

— Do therur! — dëgjova vendimin e prerë  
të Hallë Marës.

— Thashë unë e ngrata, që do therë. Po kush  
ta therë? — ë përkrahu vendimin dhe Marija.

— Italian! — thirri Hallë Mara.

— Si, sinjora! — qëndroi gatitë Xhentilja.

— There! — tha prerazi ajo.

Xhentilja u huua. Ai u bë i shurdhër.

— Tumire derrin me djalin (me mua) dhe vuri  
thikën! — urdhëroi ajo.

Xhentilja lëvizi. Urdhrat e saj s'kundërshto-  
heshin. Ato, zbatoheshin. Mund, të kundërshtoje  
dhe mbretin dhe pushtetin, por jo Hallë Marën.

U ngrita dhe unë. Do isha çirak i kasap Xhen-  
tilles. Halla i lëshoi fitilin deri në fund llambës.  
U bë ditë fare. Unë mora llambën, Xhentilja ce-  
kuren dhe në banjë u bë kasaphana. Po ç'e do!  
Ishte tëpër vështirë të therej ai derr i poshtër.  
Ulërimat e tij ngritën pallatin, në këmbë. Lart  
dëgjohej bishti i fshesës apo petësi i ministreshës  
që rrihte tavanin dhe derrin nuk e vramë dot.

— Humbameno! — thirri Hallë Mara. — Dy  
burra dhe s'vritni dot një palo, derr!

Më erdhi keq, që na përbuzi kështu, le ta pro-  
vonte yetë, kur ishte kaq e zonja, por më erdhi  
mirë që çështja e derrit më futi dhe muaj në ra-  
dhën e burrave. Emri «burrë» ishte gjithçka për  
shtëpinë tonë!

Trokiti dera fort dhe ia behën të shqetësuar  
dhe të tronditur për fatin tonë gjitonët, pezakët.

— C'ka bo vaki, mor jahu? Cilin vranë? —  
pyeti Dajë Liu, tek lidhë fort ushkurin e shall-  
vareve.

— Hicgjo, — tha Hallë Mara, — një derr...  
— dhe s'arriti ta mbaronte ajo fjalën, kur peza-  
ku plak iku me vrap dhe në hollin midis hyrjeve

të aparatamenteve tonë u dëgjua një si rënkim - e mallkim i tij:

— Turbestrafkullah! Allah, allah, derr! —  
dhe pështymat e tij shpérndaheshin korridoreve.

Plaku iku me atë fjalën e gjatë e të ngatë-rruar turke, sa, dhe kur e shkruan, të duket sikur ngul e shkul gozhdë. Kurse Meti mbeti te ne. Kur mori vesh hallin tonë, u tall me ne duke bërë një dorë gallatë.

— Hajde, mendje, hajde! Derri do plumb, tal-jono!

— S'ka plumbi ma! — u shfajësua Xhentilja.

— Ka! — tha Meti dhe iku.

Tashti ai nuk tallej, e kishte seriozisht. Dhe pas pak erdhë me atë pushkën e tij të sajuar vetë.

Meti nxitoi për në banjë. Xhentilja me llambën në dorën ngritur lart, si me fanar deti, ndriçonte derrin e zi dhe vaskën e bardhë. Pushka në dorë të Metit rrinte drejt si vizore mësuesi, ndërsa llamba në dorë të Xhentiles lëvizte si mëçok i verdhë.

— Mbaje mirë! — tha Meti.

Nuk u dëgjua se ç'tha Xhentilja. U dëgjua vetëm krisma e llahtarshme. Derri u mek.

— Me shëndet, — tha Meti.

Gjithë pallati u zgjua. Apartamenti ynë u mbush plot. Kaq shumë njerëz njëherësh s'kishim pasur kurrë, as për kripë as për vajguri. Erdhën dhe koloneli, që pak më vonë ra nga kali, dhe ministresha, Madamë Detjá.

— Ku na u poftis ky derr! — u ankua Hällë Mara.

— E vrau me një të shtime, se asht mysliman, — sqaronë Marija nga Kallmeti të porsaardhurit.

— C'ka tē bëjë myslimani këtu? — pyeti koloneli, që s'kuptonte kush ish vrarë.

— Nga erdhë hajduti? — pyeti Madamë Detja.

— S'është hajdut, por derr, — sqarova unë. Nuk isha kot burri i shtëpisë.

Koloneli me ministreshën, tē shoqëruar nga Xhentilja, vajtën në banjë.

— C'hata! — thirri e tronditur ministresha.

— Ha, ha, ha, — qesha unë.

— Mos qesh, — porositi Marija nga Lezha.

— Është gjynah.

— Po, kjo pushkë nga u gjet? — pyeti koloneli duke hyrë në rolin e vet ushtarak. Ai donte ta kishte situatën në dorë.

— Pushkët i ka mbledhur qeveria. Ti do ta kesh pushkë ilegale, — shtoi i sigurt ai, duke iu drejtuar Metit. — Ma dorëzo menjëherë, se tē arrestojo!

Meti buzëqeshi lehtë dhe s'kuptohej, nëse e përqmonte apo e qësëndiste kolonelin.

Oficeri u kujtua që kishte zbritur i paarmatosur, kurse tjetri, Meti, kishte pushkë. Dhe c'pushkë, që vriste goxha derr. Por, nuk e dha veten, ruajti dinjitetin dhe nguli këmbë, në tē vetën, por dicka më ndryshe.

— Ma dorëzo, pushkën, se ndryshe tē denoncoj!

Arrestimin e kisha dëgjuar, denoncimin nuk e dija, por e mora me mend që do tē ishte vëllai i arrestimit.

— Jo! — tha prerazi Meti. — Jo! E kam bo, vetë, e do marr hakun je njëllait.

Koloneli u zverdh. U zverdh nga frika e hakut? S'bësoj, ai s'ishte armik, që tē merrej haku në tē. Patjetër që u zverdh, se nuk i shkoi fjala e urdhri i tij s'po zbatohej.

— Ti nuk je qeveri, — i doli papritur krah

djalit nga Peza Hallë Mara. — Ti je ushtri e ushtria ka pushkë tashti sa tē duash! Mos e nga djalin, dëgjove?

Ku e gjente Hallë Mara këtë kurajë, që e përbuzte kështu kolonelin? C'sekret tē tij dinte ajo, përveç atij turpit (tē cilin e dinte gjithë pallati), që nëna e tij plakë, tashti në pleqëri, ishte martuar me një tē kamur tē sapoardhur nga Amerika?

Koloneli hapi sytë, c'thoshte kjo plakë e shushatur kështu? Fytyra e tij e zverdhur nga inati dhe sytë e zez me kokërdhokë tē bardhë tē kujtonin diçka ata peshqit dekorativë në enën e madhe tē qelqtë me ujë tē Madamë Detes. Ai s'dinte, c'të thoshte: C'ishte kjo pushkë e bërë vetë?! Si mund tē bëhej belgjiku vetë?!

Meti shtrëngonte pushkën fort dhe s'e llëshonte. Tyta e saj ishte në një vijë me kërthizën e kolonelit. Ishte natë akoma dhe nata ka një sahat tē lig, ndaj koloneli iku e tha, sa përtë larë gojën:

— Tà rregulloj unë ty!

— U gjet Kola në punë, — tha Marija. Alamet oficeri e merret me derrin tim. — Dhe papritur filloj tē qante e tē këpustë kokrrën e lotit sa një gjyle topi. Punë grash. Vetë kërkoi tē vritej derri, kurse tashti qante.

Meti qeshi dhe më lëmoi flokët. Meti ishte bërë burrë tashti.

Xhentilja rrinte i heshtur si xhentil që ishte. Motrat s'bëzanin hiç.

Ramë tē flinim përsëri. Nata ishte e qetë. As derri, as gjelat s'dëgjoheshin, por mua prapëserapë s'më zuri më gjumi. Tashti isha burri i shtëpisë. Më kish joshur shumë kjo fjalë e Hallë Marës.

## **USTA SHAMET, I URTE KIAMET!**

Kafja në filxhan tashmë ishte ftohur, cigarja  
në buzë ishte shuar. Ne, unë me Thomanë, sapo  
kishim dalë nga një mbledhje e vështirë. Kishim  
shkarkuar nga byroja e partisë një shok tonin,  
se kishte marrë hak keqas ndaj një punonjëseje  
që e kishte kritikuar një herë. Ajo, shokun  
tonë të byrosë, e kishte pasë kritikuar më hak.  
Shoku ynë pa hak i ra më qafë tashti. Ajo kish  
ardhu para disa vjetësh me punë në ministri  
nga punëtorët e Kartografikes. Tek ne kishte  
mbaruar shkollën e lartë, natyrisht jo shkëlqye-  
shëm, se ishte dhe me fëmijë dhe më burrë ofi-  
cer, që bënte shërbime shumë. Sidoqoftë, ajo  
ishte grua me vullnet dhe e donte punën, ia  
bënte hyzmetin, sic thonë nikoqirët për shtëpi-  
në. Shokut tónë i kishin ecur mirë zaret, disa

aksione të ministrisë kishin dalë mirë dhe ai si drejtor korrte lëvdata. Ajo, tjetra, s'kishte inat me drejtorin e vet, domethënë me shokun tonë të byrosë, por nguli këmbë njëherë se ai përvetësonte punën e të tjerëve, meritat e të tjerëve. Shoku ynë s'ishte nga ata që duronte t'i shkelje kallon dhe as si disa nga djemtë e ekspeditave, që perifrazonin «Rikardin III» të Shekspirit kur thërret: «Shes mbretërinë për një kalë», duke thënë: «Fal ministrinë për gjeologjinë». Ai s'kishte aq shumë mallin e maleve sesa të parketit të zyrës. Dhe nuk bënte kurrë shaka si «Eshtë e rëndë nëpunësia — as i biri as e bija». Me siguri ai mendonte e këndonte nën buzë «Eshtë eëmbël nëpunësia — dhe i biri dhe e bija». Sidoqoftë ai qe «burrë i zoti» për disa punë dhe këtë «zotësi» e tregoi dhe me rastin e evidentimit të paaftësive në drejtori. Me shkathtësi të madhe ia qëndisi asaj shqipët e motivet e paaftësise, në fund të fundit, ajo kthehej në origjinë, andej nga kish ardhur, punëtore në kartografi. Por, siç e thashë qysh në fillim, byroja nuk e la kështu këtë muhabet dhe ndodhi e kundërtë: mbeti shoqja në ministri dhe iku ai tjetri nga ne. Historia e këtij targimi eshtë e gjate dhe unë s'kam ndërmend të tjerr lesh përfçorape me të.

— Kafja qe ftohur dhe cigarja u shua, se boshkë me Thomanë po kujtonim ngjarje të tjera si kjo e shokut tonë.

— Hakmarrja ka lindur që kur lindi pronaprivate, — tha Thomai, — dhe yetëm më të do shuhet, në komunizëm.

— Na çove larg, — i thashë unë. — Jo deri atëherë. Edhe sot ka shumë njërez që s'mbajnë mëri fare. Të paktën unë kam njojur disa të tillë. Një nga ata je dhe ti.

Thomai kishte qenë një nga shokët e byrosë,

që e kish kritikuar më rëndë shokun që përja+  
shtuam sot.

— Nuk besoj, më kundërshtoi Thomai. —  
Kam bindjen që mërinë e mbajmë të gjithë, por  
nuk e shfaqim. E mbajmë thellë në gji, si portofolinime para. Është tjetër gëshjtje që ca luftoja  
në me këtë të ligë të tyren, dhe ne jemi nga  
këta, kurse ca të tjerë e nixjerrin njëzet herë në  
ditë si shami hundësh. Nga këta që nuk e luftojnë  
ka më pak, një nga këta është dhe drejtori.

— Jo, bre Thoma! Ata që kam njohur unë,  
sjanë as si të parët, as si të dytët. Tek ata më-  
ria është shuar fare ose...

— Cudi! — tha tjetri. — Nuk më besohet.  
Ka ikur koha e shenjtoreve.

Dhe i tregova për Shametin, jo shenjtiri, pór  
njeriu.

Gjithnjë habitesha si i kishte mbetur ky emër  
minatorit tonë Shamet. Kujtoja se ishte nöfkëva  
paracukthi, si i themi ne në Himarë. Mendojat se  
ai bente ose kish bërë dikur shamatë shumë,  
ndaj i thoshin Shamet. S'qëndronte puna kështu.  
Ai e kishte këtë emër që kur kish parë përtë  
parën herë dritën e diellit. Ngushëlloheshat se do  
të këtë qenë foshnjë grindavec, gë qante e kërt-  
konte shpesh gji, gjë që përsëri e mbështeste  
dhe e justifikonte emrin e tij. Prandu hej të kish  
qenë foshnjë shamataxhi e gërnjar, shamet tamam.  
As kjo nuk ishte. Atij emrin ia kishin  
vënë jo dyzetditësh, kur hap sytë fëmija, por  
shumë shpejt, që para se të lindte, kur eëma ishte  
më barrë e burri e mori vesh që gruaja ishte  
shtatzënë. Babai i tij kish thënë: «Dëgjo, grua,  
po polle djalë, emrin do ia vëmë Shamet, se  
kështu e quanin tatëzotin tim, që ma vrau hasnil». Gruaja  
kishte pranuar heshtazi, le të lindte një  
herë djali, pa s'mbetej pa emër, mendoi ajo. Dhe

kështu i heshtur e i urtë si eëma, qëlloi dhe djali, që tashti kishte emrin zhurmëmadh.

C'i duam llafet, le t'i lëmë ato se janë fukarrallëk dhe le të futemi drejt e në thela, në ngjarjen që dua të mësoni d'he ju.

Punoja inxhinier bashkë me minatorin Shamen. E kisha mik dhe më donte si djalë. Ishte njëzet vjet më i madh se unë, vetë isha njëzet e trë vjeç. Ai ishte usta i vjetër, unë çirak i ri, inxhinier i ri fare. Ai dinte t'i kullundriste mirë punët e galerive, unë isha manar, që s'komandoja dot as veten.

Atë vit ai u bë drejtor i minierës. E ndiej që po ngatérrohem me usta Shamen (dhe unë si shokët, kështu e thërritja), po bëni durim t'i shkojmë udhës deri në fund. Para se të bëhej drejtor, ishte brigadier im. Kur ishte brigadier, ka ndodhur ajo që dua të them se i vuri vulën, që e bënë drejtor.

Në galerinë kryesore, në veriorin numër dy, ishte shëmbur oxhaku lidhës. Oxhaku ishte tapusur i téri, njëzet e trë metra plot me qymyr dhe kish zënë kalimin e katër shokëve tanë minatorë. Ishte avari më e rëndë që na kish ndodhur, jo si ajo që ju kam treguar një herë tjetër e që e zhbllokoi Shefqeti për Vit të Ri. Ishte avari që ne na kish bërë pikë e vrer dhe që qeverinë e kish sëkëlldisur shumë. S'ishte puna te plani, që s'po ecte, po të katër shokët që ishin murosur në nëntokë. Kishin kaluar njëzet orë dhe ata tashmë mund të kishin vdekur... I kish varrosur vetë mëma tokë, pa ndihmën e njeriut. Ata ishin një kurban i madh për minierën. Ishte një nga ato aksidente që s'duhej të ndodhë kurrë. Halli ishte që duhej të nxirreshin këta katër shokë nga fundi i dheut. Për ta kishte meraq të madh Partia, i prisnim ne dhe familjet e tyre.

Duhej tē nxirreshin patjetér nē sipërfaqe, gjallë ose vdekur, po procesi ishte i vështirë dhe gjithësia rrezikoheshin edhe ata që do ta hapnin, që do ta zhbllokonin oxhakun.

Asnjë nuk donte tē rrezikoheshin jetë tē tjera, ishin tmerrësish shumë dhë ata tē katër që prisin... Të gjithë ata që kishin tē drejtë tē vendosnin, kishin frikë së mos sakrifikohej jeta e atyre për tē cilët do tē vendosnin që tē hapnin oxhakun dhe askush nuk jepte dot urdhër nga xhepi i vet për këtë hall që na kish pllakosur tē gjithë. Nuk shtrohet çështja që s'kishte vendim fare për këtë. Jo. Komiteti i Partisë, që nē orët e para, kur u pa se avaria ishte ajo që ish, e rëndë sa s'bëhej më për ne, kish vendosur për zhbllokimin, por duhej që dikush nga shokët tanë minatorë ta merrte vetë përsipër këtë barrë dhë nga ana tjetër tē ishte i zoti i punës. Dolën shumë, që qenë gati tē vinin kokën nē rrezik për tē nxjerrë shokët e murosur nē galeri. Por ishin pak ata që qenë tē zotët e punës për një avari tē tillë. Ishte minierë e re dhë ne ishim tē rinj. Çështja prà shtrohej që tē nxirreshin patjetér ata tē katër, por me domoso tē mos ydiste më as i pesti. Të vetmit që iu besuá kjo qe Shameti. Ustai im kërkoi vetëm Haxhiun, një minator tiranas, nga ata tē Shupalit, për ta ndihmuar. Vetë Shameti ishte nga Tepelena, domethënë kish, punuar vite me radhë nē Memaliaj.

Aherë, kur mori përsipër tē çmuroste shokët, i tha Haxhiut:

— Si nē, e mosnjeri, o Haxhi. Short i rëndë ky yni. Por vetë e zgjodhëm e paçim fat e shpëtojmë shokët. Veç dëgjo, vuri veshin fjalës mirë, për një gjë tē bëj rixha: kur tē hasim nē tā, tē mos qash! Dëgjon ç'të thashë, tē mos qash, se,

për kokën e fëmijëve, do të të rrash. Nuk duar lot, sidon që t'i gjejmë...

Shameti ish nga ata burra që i bënte konak fjalës. Haxhiu kapërceu pështymën, kokrra e fitkut të Adamit në grykë iu bë e madhe sa një hurmë. Sytë iu lëngëzuan dhe tha:

— Për krytë ijes, s'do turpërohem, Shamet!

Ata të dy e bashkë me ta dhe gjithë miniera punuan dyzet e tetë orë pa pushim. Dhe në fund oxhaku u lirua dhe hyrja e galerisë u zbulua e doli në shesh. Shameti, zbriti i pari, i varur në litar nga arganelloja dhe i gjeti katër shokët të zënë dorë përdore. Ata dhe në vdekje mbaheshin fort, sup më sup, pranë njëri-tjetrit. Me sa dykëj, ashtu qenë lidhur pasi ishte zënë oxhaku. kishin provuar ta çonin dhe pastaj asfikësia i kish mbështetur për shkëmbi dhe kishin vdekur, gati më këmbë, si para pushkatimit ose kushedi... Aj i njoju të katër. Ata ishin nxirë, por shoku e njeh gjithmonë shokun, dhe në vdekje. Dhe, tek priste, të zbriste poshtë shokun e vet tiranas, Haxhiun, ai filloi të bisedonte me të vdekurit:

— Na vratë shpirtin, o vëllezër! C'do t'u them unë i ziù grave tuaja, si do t'i gënjej fëmijët tuaj, si do t'u dal përpara mëmave tuaja?! C'do t'i them, o Dëlo (iu drejtua të parit), babait tënd në Luzat?! Si do t'i pi kafen sat shoqëje në shtëpi për ty, o Vezir djali (i tha të dytit)?! Si do fi marr vetëm, pa ty, çunat në kinemë, o Nonda (i tha të tretit)?! Si do të luaj më tavllë me miq të tjerë, o Mete (i tha të katërtit)?! Si do bëjmë ne pa ju, o vëllezër?!. (Këto m'i ka freguar Haxhiu që, si kish zbritur poshtë, fshinte lotët dhe s'guxon te të takohej me shokët e vdekur dhe me Shametin, duke qarë.)

Pastaj gjëmoi galeria nga ofshama e Shametit, pastaj u përmbyss bota gjithë nga vajtimi i tij. Qante Shameti, dhe Haxhiu më tha që «Vallahi

nuk e di se si më erdhi, por që qante Shameneti...!

Si duket Shameneti dëgjoi hapat e Haxhiut dhe, tek vajtonte si asnjë burrë miniere deri më sot, i thirri:

— Hajde, Haxhi, hajde! Mos qofsha kurrë si sot!

Tjetri u afrua, pa shokët e vdekur sup më sup, pë Shamenetin me lot në sy, lotët ishin si ca kristale piriti, që të verbonin. Haxhiu pa lotët e shokut dhe ktheu kokën. Nuk donte ta shih-te, nuk duronte dot ta shihte Shamenetin ashtu, nuk donte ta shihte as Shameneti atë tek i kish sytë mbushur me lëng...

Dhe aherë Shameneti i tha:

— Bjermë, Haxhi, qëllomë fort, se sot më sheron!

Tjetri nuk foli, as shau as goditi. Por doli jashtë i trullosur, i shkrehur dhe thirri shokët dhe aherë minatorët panë Shamenetin me brazdën e lotëve nën sy; që shkiste në fagen dhe gushën e tij si damar floriri; dukej kështu ngaqë ndris-te e kullonte në fagen e nxirë nga qymyri. Kishin dëgjuar që loti është flori, por vetëm sot panë lotin e burrit për shokët, që vërtet është flori e shkuar floririt.

Më vonë, paskëtaj, Shamenetin, ustanë tim, e bënë drejtor të minierës. Natyrisht, jo vetëm për këtë që ju tregova, por dhe për të bëmë të tjera të tij. Nuk deshi, nuk pranoi të bëhej drejtor. E thirrën në Komitetin e Partisë, e urdhëruan. I thanë që komunisti i bindet urdhrit dhe ai zbatoi urdhrit...

Dhe tashti të vijmë tek ajo që ngamë në filim, se ka shumë njerëz që nuk mbajnë mëri. Shameneti është njëri, nga ata...

Një mesnatë vonë, drejtori i ri, Shameneti, vajti në minierë në ndërresën e tretë. Veshi rrobat e tij të minatorit që zbriti nën tokë. Ish-

te dimër dhe jashtë bënte ftohtë, kish rënë një cipë borë që qe bërë akull. Në galeri bënte ngrohtë, ligji i nëntokës ky dhe nga ana tjetër aspiratorët ngrinin një erë të nxehjtë si hambarthata. Është ajo era e majit, që vjen në mot të nxehjtë nga Saharaja dhe than drurët dhe shkurret, pret në mes dhe grurin. Ndaj andej nga Dumreja i thonë dhe hambarthata. Ne në fshatin tonë, në Breg, i themi mbarselise, se mbars lisat. Galeria qe e ngrohtë si me mbarselise.

E mori shtruar dhe filloi të kontrollonte frontet e punës drejtori i ri apo minatori i vjetër Shamet. Në një çip të traverbangut gjeti një minator që po flinte. Mbase dhe ajri i ngrohtë e ndihmonte të flinte rehat, si nuset e reja, që akoma s'kanë bërë gërnjë me vjehrrat. Por gjumi në galeri është mik i lig, se të ftohtët e merr nga trualli, nga tabani i galerisë, që është gjithnjë pothuajse i lagësht. Lagështirë. I erdhi keq për minatorin që flinte e do të ftohej pa e kuptuar as vetë. E pa që ishte i ri, po nuk e njuh. Në minierë vinin herë pas here kontigjente të reja nga Tirana, ca iknin, por të shumtët mbeteshin në punë atje. Mendoj për një çast se do të ishte ndonjë dembel që i fshihej e i bënte bisht punës, si qeni maces. Vërtet miniera, si asgjekundi, të bën tamam njeri, por ka dhe një lloj njerëzish që me zor të madh i lëmon zdrukthi i minierës. Janë nyja gjithë.

Dhe iu kujtua Shametit atë çast ai minatori tjetër, vite të shkuara, në Memaliaj, por i ri si ky sonte, që i bënte dredha shumë ballit të minierës dhe e vërtiste punën si Ali Xhixha 'në tel. Një ditë, kur ishte brigadier atje, në Memaliaj, e gjeti në sipërfaqe, pa hyrë në galeri. Ish meraçur për të dhe e kish pyetur «pse s'je në punë» dhe ai tjetri i kish thënë «më rrabin sho-

kët». Cudi, mendoi Shameti, ç'ishte kjo gjë që i gjetë minatorët që të rrinën shokun?! Skish dëgjuar të tillë sebep për të mos hyrë në galeri dhe ndaj e pyeti prapë: «Pse të rrahin, ç'u ke bërë?» Tjetri iu përgjigj: «Nuk e di. Nuk u puqet ylli më mua. Nuk e di ç'kanë.»

«Hajde të vemi te shokët», — kish thënë Shameti.

«Dë më rrahin prapë», — kishte ngulur këmbë tjetri.

«Kur je me mua, nuk të ngët dot njeri». — e kishte siguruar Shameti. Nuk ia fhoshte dot goja që s'të rrëh njeri kur je me mua. Dhe vërtet vajtë në galeri, të brigada, dhe nuk e ngau njeri. Aherë pyeti Shameti djemtë e brigadës: «Pse ia keni bërë gjakun dhallë këtij njeriu?! Ç'ju ka bërë?!»

Djemtë e brigadës kishin heshtur, «sikur u kish marrë perëndia gojën», më tregonte Shameti. Sa folët ju, që s'ishit atje, aq folën dhe ata. Po Shameti s'ishte nga ata që u zihen veshët e u mbyllen sytë kur është llafi për hallin e tjetrit dhe prapë kishtë pyetur:

«Ç'ju ka bërë ky djali që e ngitni dhe s'e lini të punojë?»

Dhe dikur njëri nga shokët e brigadës u prek dhe tha:

«Hic gjë s'na ka bërë. E di vetë ai.»

«Hic gjë! Ndaj e turpëroni?» — pyeti tallazhi Shameti.

«Ndaj e İbrahim», — i thanë ballazi ata. Dhe njëri tha: «Dhe baba im të ishte, të ngrihej nga varri, do ta rrjhja.» Dhe një tjetër shtoi: «Dhe djali im të ishte, do ta shqepja në dru. Se, që thua ti, brigadier, ky soj mileti ta bën borxh. Ky është mi farave. Ky është armik e kaptuar armikun. Gjykoje vetë ti. Ja ç'bën ky. Vjen në punë,

nuk e shkund lopatën asnë orë dhe kur fap ikën, zhduket pa u ndier fare, tamam mi i arave. Dhe fshihet. Dhe të fshihesh këtu nën dhe është gjëja më e lehtë. Urith. Ti e di mirë këtë. Zë një fole në galeri, një qoshe vagoni a ku di unë se ku, pse, pak vëra ka dheu? Kurse ne të tjerët, barkazi në llavë, si në qivur punojmë. Ne punojmë dhe, mirë bëjmë, atë detyrë kemi, kurse ky rrufjan fle në ndonjë qoshe. Kur kujtohemë për të, shohim që na mungon. Dhe në fillim kujtoheshim shpesh për të, po tashti... Ai mungon, ne bëhemë merak, mos e ka zënë llava nën vete, mos e ka shkelur vagoni, mos e ka vrarë guri. Se njeriu të varfër në të tilla raste për keq i vete mendja. Se, sido që të jetë njeriu, sado maskara të jetë, e më të lig burrë s'bën mëma tjetër se ky që është dembel, prapë njeri është. Dhe në nëntokë njeriu të bëhet më i dashur se vëllai. C'them dhe unë, sikur ti s'i di këto. Aherë vihemë ta kërkojmë, lëmë punën, se të pjell belaja, dhe, si ato motrat e dhembshura që kërkojnë vëllezërit e vegjël për t'u dhënë sillën a darkën, kërkoi. Kërkoi atje, kërkoi këtej, lër dhe punën, në dreq të vejë, vetëm ky të mos ketë pësuar gjë, se është njeri, që mos qoftë! Dhe, kur ne kemi menduar turpin për vete, që e lamë të vejë dëm dhe tabutin për të, e gjemë që fle si ujku 'në shtrungë, në mes të vagonit. C't'i bësh aherë, Shemet vëllai? T'i piç shurren! Ta rrähesh, thua, është pak! Ta tredhësh, e ka hak, por është burrë, i ligu, dhe s'ke ç'bën më tepër, ne vetëm e rrahim. E zbojmë nga galeria, nga fronti, se na tromaks e na prish gjakun dhe neve. Dhe kështu disa herë. Ne me tonën themi se e ka hallall drurin. C'do bëje ti po të ta bëj kështu unë, a ndojë tjetër, jo më ky i ligu i burrave? Ky pusht i pushtërye?»

Shameti kishte tuñdur kokëن, u kishtë dhënë hak shokëve me mendje të vet dhe u kish thënë: «Më duket se s'keni faj! I keni dalë borxhit. Si thuq ti?» — pyeti atë tjetrin, dembelin e burrave. Ai kish heshtur dhe aherë Shameti kish shtuar: «Puno mirë, si shokët, po në mës ik e plehëro arat, por jo minierën, se u zë frymën një rëzve. Ndryshe, dëgjomë mua, po mbete këtu e u bën hile e u prish gjakun shokëve, do t'u them të më thérresin dhe mua të të heq brekët e të të jap ca baca që t'i mbash mend për téré jetën.» «Baca» e Shametit ishte e madhe dhe e rëndësi putër ariu. Ai e kujtonte dhe këtë si fëmijët e tij, që kur i bënin zullum, kështu u hiqte brekët e u hynte mollaqeve me pëllëmbë. Paçka se ai tjetri ishte për të martuar, për usta Shametin gjithë burrat e minierës ishin si dje-matë e tij. Ai tjetri, thonë, u ndreq, megjithëse shok me Shametin nuk u bë dot për nga të bëmet e punës, por, për të mos i merakosur më shokët, u bë njeri pünëtor. Aq sa e qaste miniera. Se, në fund të fundit, gjithë Shametër s'bëhen dot. Ku Shameti mal me borë, e ku ai tjetri një grusht dhë më një dorë.

„Ky djalë, që e rrëhni shokët, iu kujtua Shametit atë çast tek po shihte si flinte këtë vërsnikun e tij në një çip të traversbangut, këtë solli ndër mënd kur pa pas kaq vitesh këtë minatorin tjetër, që nuk e njihte. Dhe mbasë inati i atij dembelit të Memaliajt e bëri që e zgjoi këtë tjetrin pak trëmbimthi, jo si babai djalin, por si vëllai i vogël motrën e madhe. Tjetri u zgjua mahmür i shushatur dhe gjithë inat. Tërbim fare. Ishte në gjumë të parë, më i rëndi i gjumëra e të natës, dha e më tepër në hënitokë, që është natë gjithnjë, si natë polare. — G'ke, mor! — tha i sapozguari, — G'ke që më prek?

— Çohu!... — i tha Shemeti. Deshi t'i thoshte: «Ngrehu, se do ftohesh», por ai tjetri s'pri-  
ti. E shkrehu shpejt koburen.

— Ç'dreqin ke që më zgjon, ç'je ti që më  
zgjon? Kafshë!

U neyrikos Shemeti me këtë pasha të vogël,  
që s'ia prishje dot gjumin në punë e të kërkonte  
me një fjalë dhjetë llogarira. Dhe mbasë për të  
parën herë me zë të fortë thirri, dhe e prezantoi  
veten:

— Jam drejtori!

Tjetri qeshi dhe me përgëmim e inat tha:

— Ik, or, qërou, në punë tate, se po marr, lopatën e ta bëj kurrizin më të butë se barkum!  
Drejtori, thotë! Ik, ore, se në punë time jam vëtë drejtor.

Minatori, që bënte gërnjë, ishte i ri, i fuqishëm  
dhe një kokë më i lartë se Shemeti, që s'ishte  
trupvogël. Po tashtë këta djemtë e rrinj rriten  
më gjalpë e marmelatë dhe të gjithë merren me  
basketboll. Ai nuk e njihte vërtet drejtorin, Sha-  
metin. Ca që ishte i ri në minierë, ca që Shemeti  
sa ishte bërë drejtor, ca më shumë që Shemeti  
s'kishte fare hije të rendë drejtori mbi vete. Mi-  
natori i ri mendonte: «Drejtor që të zgjojë punë-  
tor në ndërresën e tretë, në mes të natës,iku ka?  
E ha unë këtë kokërr ulliri? Jo po drejtor me  
rrrobat gjithë qymyr e djersë! Ik shitja ndonjë  
tietri! Drejtori bën gjumë tashti gushë më, gu-  
shë me guguftunë, drejtoreshën e tij, në krevat  
të shtëpisë e jo në shtrat të galerisë. Ik, ore, se  
na shkrive!»

Kështu mendoi minatori i ri për drejtorin e  
ri dhe vërtet mori lopatën ta çlodhë paksa në bri-  
njët e Shemetit. Po Shemeti, që vërtet nuk don-  
te shamatë, s'ishte trembur nga demat e jo do të  
trembej nga viçat. Deshi s'deshi, u bë shkak nga

minatori i ri të dëgjohej gërnja me të. dhe erdhën shokët e brigadës. dhe ia, hoqën lopatën nga duart minatorit të ri. Shemeti iku, nuk deshi të dëgjonte se si do të shfajësohej ai tjetri, që për pak i mori nderin. Shokët i thanë gërnjarit se cili që ai që e zgjoi, që kish bërë shtëpi minierën gjithë jetën e tij, i thanë turp e haram paç bukën e katut, bukën e minierës, se dhe ai tjetri minator ka qenë deri dy muaj të shkuar, minator si ne, dhe e vunë drejtor, çoban për ca si ti, që të nikoqirepsë më mirë këtë shtëpi, këtë minierë, që që e tyrrja, pra dhe e tij. Tjetri u turpërua dhe u tremb. Piste ta pushonin nga puna, mirë, kabull, po hajde bëj gjyq me drejtorë. Do më futin në burg, mendoi. I doli e dehura e gjumit, i iku dalldia, dhe priti një ditë ta pushonin, priti dy ditë ta therritinin, në gjykatë a në razon të policisë, priti tri ditë, kaloi një javë, por nuk po kujtohej njeri për të. Dhe kjo e shqetësonë më shumë. Haka, e vonuar, është, më e shënuar, është më e renduar. Dhe duke kujtuar që një çiban që s'cahet, ditë me radhë zë qelb më shumë, dhe kjo puna e tij kështu po shkonte. Nuk duroi dot, dhe vajti vetë në zyre të drejtor Shemetit pa e thirrur njeri. Vajti te drejtori, që një ditë patjetër do t'i a gjente anën për ta shkatëruar fare. Dhe kishte hak, se i kishte shitur shumë mend. I ra derës. I thanë nga brenda hyr. Dhe hyri e tha:

— Unë jam ai, — sikur të ishte një autoritet i njojur, të paktën zëvendësministër.

— Cili, more?! — u çudit Shemeti, që nuk e mbante mend fare këtë njeri, dhe për të parën herë e shihte, më dritën e diellit. — Ç'je ti, more?! — pyeti rishtazi.

— Unë, praf — tha tjetri përsëri. Dhe po habitej si nuk e njihni. Apo drejtor Shemeti bën-

te sikur nuk e njekte dhe po e përbuzte keqas... — Cili, bre! — nguli këmbë drejtori. — A ke emërt?!

— Unë, i gjumit, — tha tjetri me turp dhe uli kokën; nuk e shihte dot nësy drejtorin.

— Kush i gjumit? — pyeti mekanikisht Shemeti, që s'kuptonte dhe s'kujtonte dot ç'punë kishte ai me këtë njëri të gjumit dhe shtoi me të qeshur... — Cili i gjumit, o të bëftë mirë!

Tjetri e kuptoi, e ndjeu që drejtori je kishte harruar fare dhe i erdhi edhe mirë edhe keq që s'e mbante mend. Për drejtorin ai qenkësh një hig, përderisa s'e kujtonte dot... Kurse unë, kam një javë që vras veten...

— Unë, pra, ai, që atë natë, para një javë desh ju godita me lopatë. Kam një javë që pres të më pushoni nga puna. Më është bërë koka da, ullë e më shtrëngon e më shtypet zemra fort si shalë bigiklete...

— Si, çfarë?! — u habit drejtori, që s'e kuptoi krahasimin.

— Si shalë bigiklete; — përsëriti tjetri, pa sqaruar gjë, — dhe nuk durova dot më. Erdha vëtë, që të më pushoni... dhet t'ju kërkoj të falur...

Më në fund e kapi dhe Shemeti cili që. Që shi lehtë, i gjuar që tjetrin e kishte vrarë ndergjegjja:

— Ah, ti qenke ai i gjumit! — dhe qeshi prapë, por tashti fort, sikur dëgjoi ndonjë anektodë të thekur shkodrane.

Minatori i ri i futua. Tashti e humbi fare dhe tha me vëtë «kaq e pati dhe ky, s'qenka në rregull nga kaptina sot drejtori», dhe bëri të ik-te.

— Prit, bre, — i thirri Shemeti, — ku vete? — Tjetri u kthye. Atë natë të tremba ka, të zgjo-

va rrët e fët, ihatçë. Po sesi më erdhi, m'u kujtua një tjetër njeri kur të pashë, shok i Bilushit dhe ky mendova. S'desha të të tromaksja, jo, desha të të zgjojë se kisha frikë mos ftoheshe, e mërr brinjë më brinjë, ashtu siç flije ti. Paçka se duhej të të thosha se në punë njeriu s'duhet të flejë. Por kur je i ri në minierë, edhe gjumi të zë në fillim, qëllon më disa, si ti dhe si unë. Se, kurr fillova dhe unë punën, vite përpara, çoku flijat në fillim si ti atë natë, sa ma hoqën këtë zakon shokët.

Minatori i ri nuk e dinte që atë kohë që kujtonte drejtori, vërtet që mund ta kish zënë gjumi në galeri ndonjëherë, por kjo ndodhte se natën nxirrte qymyr për shtetin dhe ditën tërhiqte pàrmendën për arat e të atit. Reforma Agrare i kishte dhënë tokë babait dhe Shameti nuk i gëzohej dot kësaj tokë, ndaj ndihmonte baba në duke i hapur brazdat.

Minatori i ri këto nuk i dinte dhe ishtë i sigurt që ky po e gjenjente për t'i dhënë kurajë dhe për të mos i marrë erzin.

— Sa kohë ke që puhon të ne, se s'të kam parë? — pyeti Shameti.

— Kam një mua j e ca. I kam marrë dy pesëmbëdhjetësha rrogë këtu, — tha tjetri dhe, si i zënë në faj, shtoi. — Bashkë jemi parë një herë në mensë, te sporteli.

— Aha, shih, ti, shih! Ke një mua j e ca dhe parë bashkë qenkemi dhe unë s'të mbakam mend. Filloi harresa të më zërë dhe mua. E kam thënë një herë dhe kam hak, gjithë sëmundjet për drejtoret janë! Turp për mua që mbaj mend gjithë shtyllat e vagonët e minierës dhe kam filluar të harroj njerëzit e saj. Ik, or babë. Të goftë puna mbarë! Dhe herë tjetër, kur të takohemi poshtë, të të gjej astrit në këmbë, se ndryshe, po të gjeta

shtrirë, të ha miniera ty dhe jo, ti atë. Shyqyr që u njohëm, se qenke djalë me sedër dhe s'do të të harroj më...

Tjetri ngatjetoi dhe iku dhe e mori vesh që as mendja dhe as zemra e drejtorit s'kujtonte dot njeri për keq. Jo më të merrte hak mbi një fik aguridhë, siç ishte ai në minierë.

Dhe meqë tashti apo përmenda thënien e njo-hur të Shametit: «Gjithë sëmundjet për drejtorët janë», kini pak durim t'ju tregoj dhe ngjarjen e fundit për të.

Pas ca kohësh unë ika nga miniera, mbarova fakultetin, Shameti, mbeti atje drejtor dhe, kur unë apo kisha filluar punën në ministri, Shameti që shtruan në spital.

Me ta marrë vesh, kuptohet, u merakosa dhe vajta ta gjeja ustani të tim, drejtor Shametin. Takova mjekët, u interesova ç'kishte, ku s'të ve-te mendja me sëmundjet e këtij shekulli. Doktorët më thanë se kishte një sëmundje profesionale të njojur, silikozën. Ishin tridhjetë e pesë vjetët e minierës, në kushtet jo të Valiasit, por të Memaliajt fill pas Clirimt, dhe ato kishin bë-rë të vetën. Nuk ishin vitet e sotme, por ato kur minierat s'kishin as ajrim, as llambë elektriqe, as ujë e as elektrovozë. S'është halli që t'u bëj reklamë minierave, por për të thënë një të vërtetë, që të mos më qesëndisin minatorët e tanishëm se nuk i njihkam minierat. Sidoqoftë ai paguante me silikozën e vet haraçet e viteve të shkuara...

E takova mikun tim si vëllanë e madh që kthehet nga ushtria: U gëzua kur më pa dhe s'arrita t'i uroja të shkuara e shëndet të shpejtë, siç e do vendi, kur ma prijtë.

— Jam turpëruar me ty, inxhinier. (Ai edhe sot e kësaj dite inxhinier më thotë, paçka që

unë kam ndërruar zanat.) Kam kënduar në gazetë që je bërë shkrimtar, urime, inxhinier, fabebardhë. Dhe mos harro shokët e gjithnjë shëndet e besë Partisë!

Unë u hutova, erdha t'i uroja të sëmurit shërim, të shpejtë, kurse ai më uronte mua me një të tillë fjalë, që s'e kisha dëgjuar ndonjëherë e që është thelbi i jetës sonë «Shëndet e besë Partisë» dhe unë përsërita atë fjalën që them shpesh:

— Të gjithë bashkë, usta!

— Të lumtë goja! — tha ai.

E pyeta pastaj pér sëmundjen, a mërzitej shumë në spital. Më tha se ishte si në shtëpi pushimi. Gjithë të mirat. Shokët i vinin, miqtë e farefisi e shihnin, fëmijët e gruaja e gëzonin, doktorët e donin. Sa pér sëmundjet, ato venë e vijnë, ndaj kemi lërë, që të gëzojmë dhe të vuajmë. Se pa halle dhe gëzimi s'ka lezet. Veçse kjo sëmundja e tij s'ishte gjë fare. E pse, sëmundje është kjo? Pa një dhembje koke, pa një temperaturë, vetëm një kollë si, e pleqve a si e atyre që pinë duhan kaçak. Më thonë se do të më mbajnë ca këtu me qumësht, si kotelet e vocrra. U them se qumësht na japin dhe në minierë. Më thonë që duhet bërë një pushim mbi tokë, shoku drejtor, se vitet që ke punuar nën tokë e kanë bërë të tyren. U them pushimi i tepërt, e plak, e mpak njeriun. Çdo hallat, kur s'punon, fillon të ndryshket. Jo, më thanë ata, duhet pushim. Po, u them unë, duhet punë. Puna është lezeti i kësaj bote.

— Usta, — e ndërpreva unë, — duhen dëgjuar doktorët, se edhe ne në galeri të dëgjonim ty. Ti je usta i qymyrit, ata janë të shëndetit. Ti i gjen sëmundjen dhe ilagin minierës, ata njeriut. Janë të ndara ca gjëra, usta!

— Rri, or i uruar, rri, o inxhinier, të keqen!

Mos më fol si njeri i librave tashti, se i di më mirë unë këto punë. Nuk kam sëmundje, unë. Kam dyzet vjet në minierë dhe nuk jam shtrirë një herë, s'palosem kollaj unë... — dhe e zuri kolla e silikozës. — Kurse tashti m'u shpik kjo palo kollë, si kolla e mirë e gjiliminjve. E di ç'më shkoi mendja sot? Ia thashë edhe doktorit, por ai qeshi. Kushedi, mbase vërtet kam kollën e mirë të kalamajve, se kam dëgjuar që ca e kalojnë dhe në pleqëri, si puna...

Tashti mora inat unë. Ai ustai im, drejtor Shemeti, më fliste si ca gjuhëpashkruar, si ca analfabetë. Dhe ia përplasa:

— Ke dyzet vjet vërtet, por të kujtohet si më the njëherë për atë shokun tënd? Vit për vit shtrohej në spital dhe bënte rreze. Kur e pyeti njëherë doktorin së c'vegël nuk i punonte makinës së trupit të tij, doktori i kish thënë si me shaka: «Që nuk kë gjë, vërtet s'ke gjë, por dhe që pa gjë fare nuk je, vërtet nuk je!» Dhe ti kollën e ke...

Shemeti qeshi. E kujtoi dhe ai atë mikun e vet minator; pastaj u ngrys dhe vazhdoi mendimin tim:

— Dyzet vjet nuk jäm shtruar një herë, që në djep, s'e mbaj mend veten shtrirë. Por isha dyzet vjet minator. Me të më bërë drejtor, m'u shpifën dhe sëmundjet dhe spitali. Nuk kanë faj doktorët, jo, fajin e ka zanati i ri, drejtorllékun, inxhinier. Dëgjo Shemetin, ti gjithë sëmundjet për drejtorët janë! Mbaje mend e mos harro këtë ç'të thashë.

Ai é tha këtë me bindje të tillë, sikur të thoshte që ai ishte Shemet dhe Shemet do të vdiste dhe sikur kiameti të bëhej. Unë qesha. Ç't'i thosha atë të vërtetën e madhe që vetëm drejtorët kurrë nuk mund të vuajnë nga silikoza, se ata rrinë zyravë e jo galerive, ku merret silici. E di-

ja që ustai im s'do të më besonte, se nuk donte të besonte tjetër gjë dhe do të kujtonte se talle-sha me të. Meqë miqësinë me të nuk mund ta rrezikoja për një palo sëmundje, i thashë me të hedhur:

— Mbase, kushedi, usta, dhe punëtorët kanë sëmundjet e tyre.

— Jo, bre inxhinier xhani! Gjithë sëmundjet për drejtoret janë dhe pikë. Kështu i gjejmë dhe llafit konak. Dhe mos qofsha tridhjetë vjet komunist po nuk shkova të kërkoj në Komitetin Qendror, sa të dal nga ky spital, që të më heqin nga kjo punë e të më shpien prapë minator. Ke për të parë kur të shërohem e të bëhem xham fare...

Vërtet, disa muaj më vonë, ai bëri kërkesë në Komitetin Qendror dhe, kur i shkova për dasmë të djalit, ishte përsëri usta Shameti dhe jo shoku drejtore.

Dhe ju më thoni që s'ka njerëz në këtë botë që s'mbajnë mëri...

## PLAKÙ I DIELLIT

Mua më caktuan të shoqëroja të huajt. Pas dy ditësh, të pasnesërmen, zhvillohej ndeshja e futbollit midis nesh dhe italianëve. Gazetarët që e shoqëronin skuadrën miqë lqenë shumë. Midis tyre ishte dhei ai më i mocmi, që më ra shorti t'i përktheja unë. Pse pikërisht unë? Jo se detyra ime është të përkthej, as se italishten e kam mësuar qysh kalama në fshat, në kohën e luftës. Jo! Ka të tjerë burra më të zotë se unë pér italishten dhe që mbajnë shtëpinë me atë gjuhë. Atë zanat kanë. Po gazetari i mocëm, Rafaeli, kishte kërkuar një mbrëmje më parë, gjatë darkës së mirëseardhjes, që t'i plotësohej një dëshirë: t'i jepej mundësia të shkonte në fshatin tim, po, po, në fshatin tim të lindjes, në Bunovë.

Shokët që e kishin dëgjuar dhe përcjellë dëshirën e tij, ishin habitur. Pse pikërisht në Bunovë? Atë nuk e gjen në asnjë lloj harte të zakonshme. Kú e njeh i huaji? Bunova jonë s'është as Vlora ane-ane, as Korça plakë, bile as Këlcyra që bën verë të mirë nuk është.

Sido që të jetë, gazetari tha: «Dua të shoh Bunovën», dhe aherë shokët tanë u kujtuan që në ATSH punoja edhe unë që isha nga Bunova. Kuptohet, sollën ndër mend edhe atë që unë e dija italishten. Kjo bisedë u bë të hënën në darkë në hotel «Dajti», të martën në mëngjes unë u nisa me Rafaelin për në fshatin tonë. Ishte një udhëtim i papritur, tepër i këndshëm për mya jo vetëm se do provoja bollëkun e fshatit në teator, në muajin e kazanëve të rrushit, por sepse unë nuk jam gazetar i ATSH-së që gjedhelin gjithë dynjanë, por inxhinier i telekseve, që s'para lëviz, se jam i lidhur me aparaturën si shifrantët me radion.

Duhej të shkonim e të kthehem brenda ditës, se të nesërmen, të mërkurën, Rafaeli do të ndiqte në stadium ndeshjen. Dhe kjo vajtje-ardhje brenda së martës mund të arrihet, siç e arritëm, po të mos humbisnim kohën në qytetet gjatë rrugës. Rruga mbi dyqind kilometra deri në fshatin tonë është prej kohësh e asfaltuar. Asfalti na ndihmoi, ndryshe zor se e mbanim fjalën për udhëtim të tillë.

Kam kënduar kujtimet e një piktori të njohur anglez, mik i Bajronit, gravurat e të cilit janë dhe në Muzeun Kombëtar tonin, Eduart Lirit. Fshatin tonë ai e paskësh vizituar këtu e një shekull e gjysmë më parë. Bashkëfshatari im i lash-të, i shekullit të kaluar, që, si unë sot italianin, shoqëronte anglezin e mirë të atëhershëm, Kasnec e quanin, gjithë kohën, sa u vërtitet në këto

qytetet e Steres Evropiane të Perandorisë Osmane nga Selaniku në Manastir, i thoshte Lirit: «Kur të shohësh Bunovën ti, atëherë do të shushatesh fare, Bunova Jonë është çështë, asì i Jonit, plazhi i perandorëve të Bizantit.» Këtë e tregon Eduard Liri, nuk e shpik unë. Piktori akademik anglez aq shumë u mallëngjye me fshatin tonë, aq e pëlqeu, sa, siç thotë yetë, për Bunovën i foli gjatë, e gjerë edhe mbretëreshës së Anglisë, Viktorisë, së cilës i jepte mësim vizatimi. Mbësime këtë Liri i mirë padashur na bëri një shërbim të keq se, qysh prej aso kohe, për shumë vite Anglia ra në sevda me fshatin tonë. Nejse, kjo është histori tjetër e le, ta lëmaë për tjetër herë. Por këto që ju them, po ju rastisi të vini nga ne, mund t'i gjeni edhe në muze, jo kombëtarin, po në atë të fshatit tonë. Ndaj, që ta ngas tregimin, halli im ishte i madh. Muai më hante meraku që ç'ti thosha këtij gazetarit të huaj. Fshatin tim e njihte, paçka se në kohën kur bëhej Lufta Italo-Greke. Unë s'isha aq i gojës si bashkatdhetari im i hershëm Kasneci, se edhe italiani nuk ishte si piktori i hershëm anglez, që Bunovën e pa për herë të parë. Kur i sheh për të parën herë, të habitin shumë gjëra në jetë, jo më Bunova Jonë, që pa shaka është e bukur shumë!»

Rrugës, si një ciceroni turistësh, i rrëfeja Rafaelit për qytetet dhe qendrat që përshkonim. Për Durrësin dhe mozaikun e Arapajve, më tha: kur të kthehem, le të ndalemi pak, tashti s'kemi kohë. Kur pa Lushnjën, pyeti: Çështë kjo? Ishtë shpjegova. Nuk e mbahte mend. Fieri tha se kishte ndryshuar shumë. Vlorë — do bëhet qytet i bukur. Is pëlqeu. Dhe, padashur, fare instaktivisht, unë përsërita atë shprehjen e njëqind e pesëdhjetë viteve të shkuara: «Kur të shohësh Bunovën, aherë do habitesh!» Ishte e qartë që

tek unë fliste zëri i të parëve, trashëgimi klasik. S'thonë kot dardha nën dardhë bie, por unë jam dhe për atë që dardha e ka bishtin prapa. Rafaeli qeshi kur i thashë se do të habitej me Bunovën. Nuk foli, ishte e qartë që ishte injeri i gjëzdisur shumë një botë, s'kisha për ta habitur kurrë me fshatin tonë. Ai s'ishte lalëzoti im, që të mendonte se Bunova Jonë hahet me vilajete të mëdha, për të mos thënë pashallëqe të mëdha. Vërtet ne kemi kooperativë të pasur, aq të pasur sa, sikur përdy vite me radhë të mos bëhet kokërr ulliri dhe të mos bjerë një cërrë shi, prapëseprapë bëshkëfshatarët është mi 'kanë' një fond të paprekshëm që u siguron nga njëqind e tetëdhjetë lekëhtë vjetra të cardhura përditë pune. Që t'ju mbushet mendja juvë më mirë, po ju them që këtë vit, që ishte tërë madh përbujqësinë, ata zien nga një kuintal raki përburrë, ose nga një çerek kuintali përfrymë. Po meqë gratë dhe fëmijët nuk e pinë, qaris i burrave. Ç'i do llafet, te ne u bës ajo që thotë barba im në fshat (tek ai dhe them i tregojt italianin): «Narë mori të kegen dhe Kalifornia! Hallall e pacim!»

Po 'hajde t'i shpjegosh Italianit, qoftë! Dhe gazetaritë zot fondin e paprekshëm, ditët e punes! Me gazetarët sportivë humbet mendjen dhe shkenca. Them 'gazetarët sportivë, se i tillë ishte edhë Rafaeli.

Me gjithë vështirësitet për të lidhur llafin me të, në këtë lëmë, u përpoqandhe diç bërat që t'a diljal mbanë. Mëm jë fjalë, u përpoqat të shpjegoja ç'ishte fshati ynë sot. Duke ngulur këmbë në atë që fshati që duket s'do kallaiz dhenevatje, sic thotë lalëzofii, tashti 'eshtë prokopia vetë! E ndjeva që riuk pati shumë merak për ç'i thosha, atij s'i interesonin i haberët përfshatin, sepse papritur, në të dalë të Vlorës, më pyeti:

— Ku eäkeni mësuar italishten, në shkollë?

— Jo, — i thashë unë, — në luftë e kam mësuar.

— Si në luftë! — u çudit ai. — Ju jeni kaq i ri. Nuk e besoj të keni qénë ushtar me nel. Keni të drejtë, — e miratova unë, — kam qenë i vogëlsvërtët, shtatë-tetëvjeçar.

— Po atëherë?! — tha ai dhe me habi dhe me bindje bashkë.

— Kam pasur hyzmeqar, bujk domethënë, major Luixhin, — u përgjigja unë qetë, sikur të bisedonim pér futbollistin Vinjola.

— Si bujk?! Qysh hyzmeqar?! Çfarë majori?! — më ktheu ai i habitur me tri fjalë të shkurtër tra pyetësë, sikur t'i binte me tri goditje të fortë derës së mendimeve të mia.

— E pashë që duhej ta sqaroja gjatë dhe, meqë kishim edhe gati dy orë rrugë, se shoferi ynë e çon te shtruar që italiani të shihte sa më shumë, filllova të tregoja!

— Pasi mbaoi Lufta Italo-Greke, ne u kthyem në fshat. Fshati u dogj i téri.

— E dogjën grekët, — tha ai i sigurt.

— A, jo, — kundërshtova unë, — edhe ata, edhe italiänët. Fshati ynë u bë front i Luftës së Dytë Botërore. Kush mundi e dogji, — shtova dhe, pa arritur që të thosha se tre vjet më vonë e dogji edhe gjermani, ai më ndërprenë!

— Kur që lufta me grekun, ti ishe në fshat?

— Jo, çfarë fshati! Atje s'mbeti injeri. Të thashë, ai u bë front dhe ne na përzunëm ikëm muhaxhirë. Ca ndaluat në Vlorë, te Xhamia Muradije, ca në Tiränë dhe të shumtët në Shkodër. Familja jonë vajti në Shkodër. Na kanië mbajtur shkodranët në pëllëmbë të dorës. Mikpritës jemi të gjithë, po si shkodranët s'ka. Ata kanë shok-veten pér ta qëzuar mikun në çdo hall e të keq.

pastë. Po pate ndonjëherë hall për vdekje, në Shkodër ndalu; — bëra shakë tunë më italianin. — Dhe sot e kësaj dite veni e vijmë me ata që na mbajtën aherë me bukë e me shtroje. Kur gjermani i ra grekut dhe kapitulloi Greqia, ne u kthyem në fshat. Fshati ishte shuar i gjithi. Nuk ka dhembje më të madhe sësa një fshat i tërë i djegur. Vdekja është e rëndë, por një fshat i gjithi i vdekur, i djegur, është kujë e madhe shumë. «Më mirë të kishim qëndruar në Shkodër, është për të qarë e vënë vajin», — tha aherë nëna ime. — Do na vdesin fëmijët për bukë. — shtoi ajo. Babai ia ktheu: «Është i dhembshur guri yt, domethënë shtëpia jote.» Bëmë ç'bëmë, mbuluam shtëpinë, kuptohet, me rrasha guri. Se shtëpisë së djegur, kur është e gurtë, i bie kulmi por themelët e muret i mbeten. Kur erdhi gjermani, që më keq, se ai u vuri minat. As nam, as nishan nuk mbeti.

— Po! pohoi italiano. Unë kujtova se më dha të drejtë se minimi është më i rëndë se diegia, por ai e kishte gjetkë merakun. — Dhe para Luf-tës më grekun ashtu i kishit shtëpitë, të mbuluar me gürë, si Gjirokastra? Dhe vërtét, ju të gjithë kishit ikur aherë. Në fshat s'kish imbetur njëri, vetëm disa qenë pa zot dhe pula kishte. Mjerim i madh.

— Kur u kthyem nga Shkodra, nuk gjetëm as qen, as pula, — i thashë unë. — Bile, më-mëzonja ime, gjyshja, nuk vajtonë shtëpinë por gomarin e barrës, që nuk është gjetëm më. «I ziu ti, o xhan, i ziu ti, o vapori në mes detit që të bëri Italia brodo e ushqeve ushtritë», — qântë ajo.

Gazetari qeshi; brodo është një supë napolitane.

— Po ju në atë kohë, kur ne kishim ikur, paskeni qenë në fshat?! — pyeta unë i habi-

tur. — Kujtova se keni qenë më vonë, aherë kur partizanët vranë tenente Moretin. Ç'ishit ju aherë, kur bëhej lufta, major si Luixhi?

— Ushtar, — tha gazetari. — Kur erdhëm aherë në fshatin tuaj, shtëpitë ishin të mira. Bënte dimër i madh...

Ai nuk vazhdoi më tej. Mua m'u kujtua që, kur u kthyem, s'gjetëm as dyer, as dritare. Gjithë ç'ishte dru, që djegur. Me siguri ngaqë ishte dimër i madh...

Po nuk i thashë gjë mikut gazetar për këtë.

— Po mirë, italishten si e mësove? — pyeti tashti jo italiahi, por shoferi ynë, që e ndiqte bisedën tonë. Ishte e qartë që italishten e merrte vesh mirë. Ishte radha ime të habitesha. Shoferi që i ri fare, e shumta sa gjysma e moshës sime, pravatyt te njëzet e dy, e shumta njëzet e tre vjeç.

— Mirë unë, po ti nga e di? — pyeta unë gati si me inat. — Apo mëqë je shofer turistësh?

— Pak nga televizori, pak nga radioja, — tha tjetri.

— Ju punoni në Radiotelevizion? — pyeti gazetari, që, siç dukej, përpiquej të kapte ndonjë gjë nga fjalëkëmbimi, ynë shqip, duke treguar me sy nga magnetofoni im. Unë qesha. Dukej sheshazi se e ngatërronte shqipja dhe magnetofoni profesional, që e kisha marrë hua të regjistroja ndonjë këngë të re të fshatit.

— Jo, — i thashë, — unë jam inxhinier teksis, por shoferi ynë kuptoka italishten dhe më pyet mua si e kam mësuar.

— Ah, po, vërtet. Pse nuk vazhdoni? — m'u drejtua mua dhe njëherësh iu kthye shoferit: — Ju me siguri e keni mësuar në shkollë!

Kishte në këtë sigurinë e tij edhe një dozë të lehtë ironie e zhgënjimi. Ai dhe për mua nuk

bindej dot, që gjuhën e tij, të huaj pér mua, nuk e kisha mësuar në shkollë. Po nevrikosesha me të dhet nga ana tjetër po bëhesha xheloz që qendra e gravitetit po'anonte nga shoferi.

— Jo, more! — tha shoferi. — Çfarë shkolle? Autodidakt.

— Interesant! — tha gazetari italian. Ishte dhe ai njëfarësoj diplomati. Ata, diplomatët, e kanë zakon që shpesh, kur nuk duan të japid mendimin e vet pér mirë a pér keq pér diçka të caktuar, të lëshojnë atë shprehjen asnjanëse, as mish as peshk, hermafrodite, «interesant».

Vërtet interesant po zhvillohej kuvendi ynë, por ja që ne u ngjitëm fajes së malit përpjetë atje te qafa ku duket deti Jonian. Dhe sa herë shoh Jonin, mua më zë jo makina, por dalldia e mallit pér fshatin, që më bën fjalëshumë, troç muhabetin, llafazan. Aherë nuk mbahem dot. Është era e Jonit apo aroma e fshatit, nuk e shpjetgoj, por mund të flas pa pushim. Tashti s'kishte nevojë të më pyeste e as të më kujtonte njeri. Ishte fëmijëria ime që më merrte pér dore e më çonte në shtëpinë e kujtimeve të veta.

Dhe unë fillova:

— Ju thashë pak më parë, që ne u kthyem kur kapitulloi greku. Pamë ç'pamë e mbuluam shtëpinë. Ishim ngushtë fare, si gjithkush kur kthehet nga mullaxhirillëku, por, sidqoftë, ullinjtë s'i kish djegur dot lufta dhe si pér inat, diçka bënë atë vit dhe ndërtuam llatat me vaj me karroqet e misrit te lebërit e Luminët të Vlorës. Na u gjendën si vëllai vëllait në ditë të keqe. Se, besoj që e kuptioni, sinjori, që vaj mund të kesh det, por buka e mban shpirtin e njeriut. Buka është nëna e jetës. Vitët e luftës genë vitët e urisë pér ne të gjithë këndej. Dhe, sikur të mos mjaftonte uria, pér atë vit na u'desh

të mbanim dhe ata që na vinin nga ishujt grekë, nga Strakënaja, nga Othonusi, nga Dimali. Atje kish plasur ziq e vdekjes nga uria dhe ata çanin detin e vinin refugjatë te ne... I mbajtëm me bukë si mundëm. Nënat tona hoqën nga copa jonë e bukës e u dhanë fëmijëve të Greqisë dhe vathët e unazat e florinjtë të nuseve greke nuk pranuan t'i merrnin për bukën që ndamë. Kish halle e halle ajo kohë...

— Nuk besoj se grekët e uritur ju mësuani italishten, — më ndërpreu gazetari. — Ata mund t'ju mësonin greqishten.

— E saktë, — thashë unë. — E drejtë, por dëshqitëtregaja me këtë që në ato vite lufte ndodhnik gjëra të habitshme. Tjetri një herë të vinte si fitimtar që pastaj kthehej në lyspar. Herë vinte ushtar e pastaj kthehej në yzmeqar. Sa për italishten... he! Nuk paske qenë aherë kur barbaim vau tenenten, tenente Moretin? — dhe u kujtova që pak më parë ia kisha përmendur këtë. — E di pse e vau? Në behar të dyzetedyshit, ai tenentja, deshi të merrte burrat e fshatit në milicinë fashiste, deshi t'i vishtë milicë. Tenentja e njihte mirë historinë, ai ishte shefi i SIM-it dhe e dinte që burrat tanë qenë trima; gjyshërit e stërgjyshërit tanë kishin shërbyer stratiotë në Mbretërinë e Napolit dhe në Republikën e Venedikut. Ishin balli i ushtrive. Por ai harronte që në Tiranë ishte krijuar Partia dhe komunistët punonin edhe në fshatin tonë. Im atë kishte zanat, qe shofer e iku. Kurse nja gjastë burra të rinj tenentja dha urdhër t'i vishtë me zor.

— Fashistët janë të poshtër, — tha gazetari. — I njoh mirë.

— Ata s'pranuan, — vazhdova unë. — I thanë, si burri burrit, se u pëlqen të jenë më

mirë fshatarë sesa milicë. I mori me revole në dorë, i arrestoi. Ata deshën të arratiseshin. Në male sapo kishin dalë partizanët e parë. Fashistët i kapën dhe i vranë si tradhtarë të Perandorisë. Aherë u krijua njësiti guerril i fshatit. Ata formuan çetën partizane. Me ta ishte dhe babai im. Ata ia kënduan tenentes te Visha. I lau hesapet...

— A, Visha, përrua i thellë shumë, — tha gazetari.

— E, atje e pa llahtarën tenentja, — thashë unë.

— I fortë qenke, për besë, — më ndërhyri shoferi, që po e humbiste durimin. — E tirke muhabetin më keq se plakat leshin. Ti sikur s'je i'nxonier, por profesor! Bjeri, more, shkurt, si e mësove italishten?

— Me radhë, — e qetësova unë, — bëj durim. Cdo gjë me sira. Kur kapitulloi Italia, në shqattor të dyzetetreshit, ne kishim çetën tonë partizane. Italianët e fshatit tonë donin të iknin në Itali. I kishte marrë malli për vendin e tyre. Germani po vinte. Ai vërtet po vonohej ca sa të mbërrinte te ne, i ishte hapur punë rrugës, por ishte më derë. Po trokëllinte dhe zëre se kish hyrë brenda. Disa nga ushtarët italianë u bashkuar me çetën tonë partizane, të shumtët thanë se ishin lodhur nga lufta dhe parapëlayen të rrinin në fshat. Ku e kishin detin në pëllëmbë të dorës, Të prisnin, mbase u dilte fati e gienin ndonjë varkë e canin detin. Atëherë prindërit tanë, këta ushtarë jetimë të Perandorisë i morën në mbroitje. Sikur të ndodhë që dikush të kallëzonte ushtarët e tij, ai digjiej fshatce me gjithë c'kish. Lincohei, sinjor! Të tjerët, ata që i besuan gjermanit dhe vanë iu dorëzuan atij, shkuant dëm të gjithë. Humbën të ritë e tyre kot, për dhjamë qeni.

— Të shkretët! — tha gazetari. — Na gënjen.

— Ne, ballistë nuk kishim. Se, kur u vra te-  
nentja, sikur nuk mjaftonte shkatërrimi i Luf-  
tës Italo-Greke, Perandoria na vuri flakën e na  
dogji përsëri fshatin. Le që c'them dhe unë, si-  
kur zbuloj Amerikën! Asaj lufte ne digjeshim vit  
për vit. Një mot më vonë, si kapitulloi Italia,  
gjermani, për të tretën herë tashti, na e hodhi të  
gjithë fshatin në erë. I njohëm të gjitha, edhe  
minat, edhe flakëhedhëset. Ishim mësuar të digi-  
nim meratë e barit për kullota, tashti u mësuam  
me diegjet e shtëpive. Kishte nga ata budallenjtë  
e fshatit tonë që thoshin se ushtarët e botës mba-  
se e kanë zakon të tyre djegien e shtëpive, si  
ne djegien e merave.

Prandaj s'kishim hiç ballistë. Se nuk kish  
mbetur njeri te ne pa u gjakosur e pa rënë në  
hasmëri me ushtritë e huaja. E, megjithatë, kur  
ushtarët italianë mbeten jetimë e pa njeri në dv-  
nia, ne i morëm në mbrojtje. Asnjë nga ata ha-  
llexhini që mbeten në fshat nuk iku dot në vat-  
rën e tij.

— Të mjerët ata, — tha gazetari, — të gjithë  
vdiqën!

— Kush tha se vdiqën? Jo! — kundërshto-  
va unë. — Asnjë nuk vdiq, ne i mbajtëm me bukë  
sa qe lufta e nuk i shitëm te gjermani. Kur  
mbaroi lufta, puthën duart e plakave tonë dhe  
vanë shëndoshë e mirë të çmalleshin me njerëzit  
e tyre në Itali.

— A?! — tha gazetari me mëdyshje.

— E, — thashë unë me bindje, — kështu  
ka ndodhur.

— Po pastaj? — pyeti përsëri ai.

— Çfarë pastaj!? — u përgjigja unë i hutuar.

— Hic, me robërit hyzmeqarë mësova italishten.

— Intersant, — tha gazetari, duke përdorur

përsëri, atë shprehjen asnjanëse të diplomatëve, as mish as peshk, që nuk shpreh asgjë.

— Asgjë interesante, — ngula këmbë unë! — Më e rëndomta gjë, të mësosh gjuhët e huaja në luftë. Një moshatar imi më vonë mësoi gjermanishten me një rob austriak të Vermahtit. Unë pata fat, se kisha mësues një major, Luixhin, që, kur kish qenë civil, pati qenë profesor letërsie në Napoli. Burrë i shtruar dhe çoban i mirë fort. Prej tij mësova vargjet e Dantes, përpara se të mësoja të Naimit.

— Si çoban i mirë?! — pyeti italiano i çuditur.

— Ja, ashtu, çoban, si gjithë ata që rrojnë me bagëtitë, — thashë unë, — Na ruante kopenë. Po t'i jepje bukë, hante, po të harroje t'ia shpijë, edhe ai harronte. Më rrjhte nëna kur harrohetësha në llojë me shokët dhe nuk i çoja Luixhit bukën në mal. Kurse ai më mbronte. I thoshte nënës: «Zonjë, mos e rrih djalin se është i vogël, i shkreti! Në këtë luftë harron i madhi shumë gjëra, jo një fëmijë, sinjora!» Ai ma mësoi italishten me shkollë, unë ia mësova shqipen si munda, si fëmijë që isha. Ca më tepër që unë as alfabetin tonë nuk e dija, se ato vite shkolla në fshat u mbyll e unë s'kisha arritur të veja në klasë të parë. Ishim miq për kokë me Luixhin. Majori që mësues i zoti, por edhe për çoban s'ia hante qeni shkopin. Nuk i dështoiasnje pëlla e as i hëngri ujkunë një sheleg. Ishte më i miri çoban i gjithë hyzmeqarëve, përderësve italianë, sa na kish zhili gjithë fshati. Dhe në luftë të del ndonjë fat në derë, Luixhi ishte fati ynë.

Gazetari s'pyeti më. Iu shua kureshtja... Nën këmbët tona shtrihej deti, mbi kokat tonë ngrihen Malet e Vetëtimave. Ne i qemë afruar fshatit, po arrinim objektivin e caktuar nga gaze-

tari mik. U bë qetësi, tashti as shoferi nuk ndërhynte më në ndonjë batutë të mençur dhe dëgjohej vetëm kondicioneri i «Pezhosë». Unë po mendova t'i tregoja gazetarit se qysh ca kohë, në vitet e luftës, patëm për shërbesë dhe atë oficerin amerikan që ra nga aeroplani me parashutë. Doja t'i jepja një fakt ngushëllues nga Amerika. Por ndërrova mendje, se kujtova që do të ma merrte për sajim, për të mos thënë provokim, pavarësisht nga qëllimi im i mirë.

Në Heliates, që është lagje apo njëfarë katundi para se të mbërrish në fshatin tonë, mu tek Qafa e Diellit, se edhe katundit të vocërr apo lagjes Diell i thonë qysh në kohët pagane, gazetari kërkoi të ndalonim. Mendova se ndalesa e tij këtu lidhej me ndonjë kujtim, se Heliates nuk është fshati ynë, ku duhej të shkonim. Ai është fare pranë fshatit tonë, shpesh numërohet si lagje e tij, por, sidoqoftë, nuk është Bunova jonë. Ai kërkoi të ndalonim, mosha bën të vetën, dhe ne ndaluam.

Nuk rri dot, ndërkohë që gazetari çlodhet, pa ju thënë dy fjalë për Heliatesin. Në biseda mund ta keni dëgjuar që quhet Ilias. Ca kujtojnë e thonë se i vjen emri nga Iliaz Pashai, që ishte vendas, këtej dhe e vranë si renegat të turkut bashkëvendasit e vet. Kjo ka ndodhur në vitet e Tanzimatit, kurse fshati i vogël është disa qindra vjet të paktën para kësaj në dokumentet e lashta. Ca thonë që e ka nga shën Ilia. Ju siquroj se dhe kjo s'është kështu, se ai, po në këto dokumente latine e bizantine, del kështu siç ju thashë unë: Heliates. E, sipas një mikut tim, gjuhëtar i shquar, kjo do të thotë Diell. Ca më tepër që dhe qafa ndarëse, kryesore e tij, nga pjesa tjetër e krahinës, quhet po kështu: Qafa e Diellit... Dhe ja, përballë nesh, pikërisht nga kjo

qafë, po vinte një plak i moshuar. Rrobat i kishte allafrënga, kurse në kokë mbante një qylafë të zi bellushi, astrahankë, që tashmë prej kohësh janë reliktë të rralla shumë. Çudi si nuk ia kishin marrë ata të muzeut etnografik.

— Njatjeta, djemo! — përshtëndetë ai.  
— Chall ju zuri? —  
— Për ktheva gazetarit të huaj se plaku interesohet se ç'nevojë kishim, që kishim ndaluar. A donim ndihmë.

— Asgjë, — tha gazetari. Dhe pastaj, sikur u kujtua farrë papritmas përdicëka, pa malet rrëth e bëqank, që jë mberthënë si potkuat detin dhe mukthyer mua. — Pyeten, ju lutem, plakun a ka qenë gjatë Luftës Italo-Greke (këtu?)

Më erdhi inat me të! Si dukëjat ai s'më besonte mua. Por inatet në këto rastë duhen lënë mënjanë dhe duhet bërë detyra.

Dhe ia përktheva plakut ç'kërkonte miku.

— Jo, — tha plaku. — Ikëm muhaxhirë në Shkodër. Atëherë bëra kurbetin e fundit. Unë sapo isha kthyer nga Australia dhe nuk më bënë këmbët, të dilja përsëri në kurbet. Isha dhjetë plak, i kisha shkuar, të gjashtëdhjetat, Kurse i tashti jam plak i plakur, dhe më ka harruar ivdekja adresën. Meqë s'doja, të dikja, italiane ët më futën bran e në autoblindë e më shpunë shëndoshë, më mirë ku deshën.

Mua më erdhi të keshja. M'u duk gjëja më e çuditshme dhel më e pabesueshme që pondë-gjoja përluftën. Kurbet më autoblindë. Gazetari po priste me habi të përktheja. Unë si kërkova të falur dhjetë i thashë përmato që thoshte-plaku. Ai nuk foli, kurse plaku nëntëdhjetecavjeçar, më mos ishte njëqind, vazhdoi:

— Komanda italiane, për të shfajësuar veten para të madhit të vet, ne na quajti si biçim se-

bepçinj që humbën këtu, ato ditët e para, luftën me grekun. Deshën të na syrgjynosnin në Itali, por qemë shumë milet e s'na mbante dot vaponi. Na shpunë në Shkodër. Shyqyr që na çuan atje, te vellezërit tanë shkodrianë, e zumë miq të besës atje! Se kam dëgjuar që ca gjitonë tanë i shpunë në ca nisi të Afrikës e humbën përfare.

— Fjalët e plakur përputheshin me të miat. Kjo më gëzoj paçka që atë ditë Shkodra u lakuva si shumë.

— Ashtu ka qenë, këtu s'kishte njeri fare nga vendasit, — tha gazetari, duke m'u drejtuar mua dhe hodhi sytë tutje nga udha që të çonte në Bunovë. — Atë dimëri nga manastiri i fshatit tuaj na griu me top Jorgaqi!

— Fjalë me konak, — e mbështeti plaku, — Kija inatin, por jepi hakun. Topçi si të grekut s'pjell nëna. Në kazan, të mishit ta hidhnin gjilen.

Potkoi i maleve sikur po ngushtohej. Dielli kishte marrë rrugën përfi në det. Vapa, megjithatë, që e madhe. Dëgjohej cinxëri që këndonte.

— Çtu shushatëm kështu, — u hodh plakunë m'u drejtua mua: — Më turpëruat, o djem, me mikun. Ju jeni lodhur nga udha, kurse unë ju mbaj me llafe. Urdhéroni në shtëpi të pimë një kafe. Ja tek enkam, sa të zgjaç krahun.

Shtëpia që na tregoi plaku, vërtet ishte fare pranë. Po shoferi ma bëri me shenjë; do vonoheshim. Unë bëra sikur nuk kuptova. Më erdhë inat që ai donte të më tregonte mua detyrën time. Aherë shoferi tha: italisht:

— Zotnia plak na fton t'i shkojmë në shtëpi, sinjor, por unë ju kujtoj se do vonohemi.

— I huaj është dhe shoferi? — pyeti plaku. Unë nuk arrita t'i përgjigjesha, se gazetari tha në formë të prerë:

— Të shkojmë!

— Ku? — pyeti shoferi.

— Si ku? Te zotnia plak! — tha gazetari.

Plaku përpara dhe në pas tij, arritëm në shtëpinë mikpritëse. Ai hoqi shandallat me gomë, deshëm t'i hiqni dhe në këpucët, por ai tha:

— S'ka gjë, o miq, mos i hiqni brashnjat. Se tromobili juaj është shtëpi tamam, kuti sapuni.

U ulëm në divanët rrëzë murit. Në një këndonte radioja. Përballe kishim ekranin e televizorit që heshtte: s'kishte ardhur alkoma ora e tij.

Erdhi nikoqirja e shtëpisë, mbahej mirë dhe nuk qe aq plakë sa mund të mendojë tek shihje bashkëshortin e saj. Na uroi mirëséardhjen. Tha që t'ia bënim kabull që do na shërbente ajo, e valfrâ plakë, se nusen e kishte në punë, mblidhnik ullinjtë e parë të sivjetëm.

Nikoqirja plakë, na shtroi mësallën. Na pruri fakinë. Na gostiti me llokume.

Plaku i tha së shoqës:

— O zonjë e madhe, qëndro një çikë më miqtë, sa të vete t'u pres një pite mjaltë.

Italiani po shihë i çuditur shtëpinë. Cdo gjë e rë, e pastër dhe në vendin e vet. Ai vendosi aparatin fotografik në pëqi, si fëmijën.

Plaku u kthye atë çast. Pitet e majltit kullo-nin qelibar të verdhë mbi pjatat farfuri të bardha borë.

Gazetari u çudit fare.

— Fantastike! S'kam ngrënë kurrë mjaltë nga zgjoi, por vetëm nga dyqani. — tha ai.

— Edhe unë, — shtoi shoferi.

— Ju bëftë mirë! — uroi plaku i plakur. — Qëndroni për drekë, — vazhdoi ai. Dhe urdhëroi nikoqiren: — Shtrona të hamë, o zonjë e madhe!

Shoferi hapi sytë. Po prisheshin të gjitha planet, por nuk kundërshtoi.

— Faleminderit, — tha gazetari. — Si sot s'jam kënaqur kurrë. Faleminderit shumë!

Falënderimin ia mora vesh, por s'po kuptoja përsëri përdrekën që do të hante, pra do të rrishim, këtu, apo përmjaltin që hëngri.

— Me këto që kemi, jeto, — tha plaka. E pata tepër vështirë të gjeja idiomën e kësaj fjalë, të ngrohtë të nënave tonë. Jeton! Si munda e përktheva. Le të m'i falë kusuret miku, por mësuesi im i parë, Luixhi, këtë s'ma mësoi dot në italishte.

— Zemëri e bardhë! Shëndet me gjithë ç'ke! — uroi plaku gazetarin dhe ngriti gotën e rakisë e e ktheu me fund.

— Dhe aherë, — ai nuk tha në luftë, — rakinë e kishit të mirë. «Metaksaja» e grekëve, dhe rakia juaj ishin ilaq.

Shoferi më shkeli syrin. Njerëzit e fshatit s'i paska hasur aherë, por rakinë e paska gjetur.

— Vërtet, — e miratoi plaku. — Aso kohe rakia ishte sa përlilaç. Po tashti kemai sa t'ju bëj banjë të gjithëve. Ju laj me raki. — Dhe u ngritis rrët e fëtë solli bidonin njëzetlitrash.

— Faleminderit. No! — tha italiano. — Ikim, — m'u drejtua mua. — Ç'surprizë e bukur sot!

U ngrit. I la kartëvizitën plakut dhe iu lut që, po, të qellonte të vente në Itali, ta kërkonte me atë adresë.

— Kur të viç prapë, — unë kujtova se plaku do të thoshte që s'do më gjec më këtu, por udhës për atë botë, por jo, ai vazhdoi, — mua këtu më ke. Bujrëm! Ti qofsh mal me lule, o sinjor, por sa për në Itali s'më ke më, s'më bëjnë këmbët. Jam plak i plakur shumë për udhë të, gjatë. Të thashë dhe parë që s'ia kam pëqej vitesh ngenë kurbetit.

— Kisha mall përgjigjet vise, — tha italiano.  
— Kam shumë kujtime këndeje. Na u vranë shumë, shokë atë vit.

— Edhe grekër qamet u vranë, — iu përgjigji plaku, sikur deshi ta ngushëllonte.

— Kanë shumë kujtime, — nguli skëmbë gazetari përsëri. — Por si kjo ditë e sotme s'besoj të kemëri. Ju falenanderit!

Gazetari u ul t'i puthte duart plakës në prag të derës. Unë prita që plaka ta kundërshtonte, janë zakonë që po i harrojnë nikoqirët tona. Por jo, plaka e la dhe ai ia puthi. Duart e saj mbabin erë mjaltë portokallesh. Kur ai po i puthte duart, plaka tha:

— Kanë hequr keq, orëzezëtë. Mbetën bonjakë në dyer të botës.

U ndamë më plakun e plakur, që na përçollë deri të makina. Shoferi i hqiqi gurin mbajtës rrotës. Nga njëra pale u dëgjuat «Mirupafshim» dhe nga ana tjetër plaku që thosh «Mirë se të viñi».

Shoferi deshi të vazhdonte rrugën tonë, atë për ku ishim, nisur, për Bunovë, kur gazetari nxitoi e tha:

— Kthehuni, ju lutem. S'ka nevojë, jo. Herë tjetër do të vij, të rri disa ditë këtu. Herën tjetër në Bunovë.

Unë nuk mora vesh pse ndërroi mendje ai. Dhe tashti vërtet e bëra si ai bashkëfshatar i im i lashtë, që i thoshte piktorit të mbretëreshës së Anglisë, Viktorisë: «Kur, të shohësh Bunovën.»

— Zotëria plak që burrë i zoti, — i thashë, — por po të njihni bërbën tim! Po s'vajtim, do të shqetësohen se fmos na këndodhur i ak-sident!

— Bisedoni në telefon, u kërkoni të falur ba-

shkëfshatarëve tuaj dhe barbës së nderuar. Do vij patjetër herë tjetër!

Ai nguli këmbë në të tijën. Miku është mik. dhe duhet dëgjuar. Por shoferi, për të parën herë përkrahu kërkësën time dhe shtoi:

— Sinjor! Ja dhe një çikë dhe zëre se erdhëm. Është, gjynah të kthehem nga rruga. Ja, tek ajo kthesa atje është Ura e Benet dhe pastaj në xhep kemi Bunovën.

Se si e fuste Bunovën në xhep, nuk e kuptova, por po erdhe në Urë të Benet, në fakt, zëre se ke ardhur, në fshat.

— Ura e Benet! — thirri gazetari.

— Po, — tha shoferi.

— Vemi!

U nisëm përsëri. Arritëm tek Ura e gurtë e Benet dhe vërtet Bunova jonë na verbonte përballë me shtëpitë e saj të bardha. Po perëndonte dielli dhe qelqet e dritareve llamburitnin, sa të mbylleshin sytë instinktivisht.

— Ndalo! — thirri gazetari.

— Paska huqe shumë, — më tha shoferi mua për mikun, — Nazeli i madh.

— Sa bukur! — tha gazetari; për fshatin apo për detin dhe diellin që po shtrihet si mace mbi të, nuk e kuptova.

Ai u mbështet mbi parmakët e gurtë të urës, që ngajnjë shumë me bedenat e kalave, dhe filloj të këndontë një si këngë të lashtë, pak në të zvarritur, gati si një vaj, që me vështirësi i merrishin vesh fjalët.

— Qenka si Klaudio Vila, — tha shoferi.

Unë se kisha mendjen të shoferi, por po përpinqesha të zbërtheja ç'po këndonte italiani. Dhe u trondita, e pabësueshme! Po t'ia vije veshin mirë asaj kënge, ajo ishte si ajo kënga jonë e «Urës së Qabesë».

E çuditshme, se si mund të kishin dhe italia-nët një këngë të tillë. Kënga, po ta përktheje, ishte kështu:

*Vaj për ne, si do i vejë hallit,  
mbetëm tek Ura e Beratit.*

*Fati ynë si fat i korbit,  
mbetëm tek Ur' e Dragotit.*

*Mbemë, more, vëllezër, mbemë,  
këtu tek Ura në Benë!*

Lapidari në krye të urës vërtetonte atë që këndonte gazetari, Rafaeli, Këtu ishte bërë luf-të e madhe.

Unë dhe shoferi heshtëm. Ai lëshoi një of-shamë të thellë, një «oh» të fortë dhe kënga pushoi. Iu mbushën sytë me lot.

— Faleminderit, zotërinj, — tha ai. — Ju lut-tem, ikim!

S'kish nevojë për mençuri të madhe, i kthy-ëm kurrizin Bunovës sime dhe, deshëm s'de-shëm, ia mbathëm për Tiranë.

... Skuadra italiane e fitoi ndeshjen me sku-adren tonë të futbollit. Vinjola i tyre bëri gol. Unë s'qeshë i zoti ta fshihja mërzitjen time dhe gazetari italian, Rafaeli, më tha:

— Mos u mërzit! Ju humbët në futboll, por fituat në politikë.

— Kemi kohë, sinjor, që kemi fituar në po-litikë, — i thashë unë prerazi, sikur merrja ha-kun e ndeshjes së humbur.

— Jo, — tha ai, — nuk e kam aty fjalën. Më keqkuptuat. Por ti harrove ditën e djeshme. Më fal që po ju drejtohem me «ti», por ju jeni fëmija im në moshë. Më çove te një plak zotni që as e njihje dhe as të njihste. Nuk më bëri përshtypje vetëm mikpritja e tij. Kjo njihet edhe nga të tjerët për ju shqiptarët. S'më hutoi shtëpia e

tij e re. E bukur ishte, por shtëpi të mira gjen në shumë fshatra të Evropës. Jo, jo! As televizori dhe as frigoriferi. Ka shumë njerëz në punë zotnia plak dhe i blen. (Ai kishte regjistruar gjithçka në mendjen e vet). Por nuk e di, a e vure re bibliotekën e tij? — pyeti ai papritur, duke dale në një shteg që s'e kisha çuar imendjen kurre dje.

— Ah, po! — i thashë unë, si për një gjë të rëndomtë, si për një djep a një vazo lulesh që i ka fshati me bollëk. Dhe vetëm atëherë solla ndër mend që të televizori i plakut të plakur ishte i vendosur në një të ndarë të bibliotekës, sa një faqe muri, që mund të kishte nja pesëqind libra. Nuk më gabon syri në punë librash.

— Jo «ah, po», — u tall ai me mua, — jo! — Shko në çdo fshat të Evropës, jo më të Italisë, po ku të duash, shko, veç jo në shtëpi të priftit e të mësuesit, por të bujkut apo të çobanit dhe s'ke për të gjetur kurre bibliotekë si tek ai, zotnia plak. Më besoni, nuk ju bëj qejfin. Jo! Them atë që kam parë kudo. Ndonjëri mund të ketë një raft me libra, por do të jenë librat e shko llave të kalamajye. Të gjesh Danten dhe Shekspirin në ato shtëpi, e pamundur! E pabesue shme! Absolutisht e pabesueshme! Ai plak jetonte me Danten në një dhomë. Dantja dëgjon urimin e tij, përditë. E kuptoni ju, i dashur koleg shqiptar, se ç'keni arritur të bëni me njeriun? Të pabesueshmen!

Unë u habitave që më tha koleg. Unë s'jam gazetar, as shkrimitar, jam thjesht inxhinier. Por, me siguri, ngaqë i përktheva atij, gazetarit, këto ditë,

— Mrékulli! — vâzhdoi ai. — E di që s'do më besojë njeri po të shkruaj për këtë. Por unë kam në film fotografinë e Dantes, librave të tij, me

plakun e Heliates. Ja ku i kam! — dhe më tregoi aparatin fotografik, që më solli ndër mend shkrepjet e tij në dhomën e plakut.

— Me Plakun e Diellit, — i thashë unë, duke i kujtuar etimologjinë e emrit të fshatit.

— S'më kish vajtur mendja, — tha gazetari.

— Plaku i Diellit! Gracie!

Tutje kodrave të kurorës së Tiranës po perëndonte dielli. Ai po shkonte të flinte gjumin midis steresë sonë dhe gjitones latine. Ai kishte hak të flinte. E kishte hak të flinte. E kishte bërrë ndershëmrisht punën e tij të përditshme. Edhe gazetari do të flinte i qetë atë natë. M'u duk se ishte njeri i ndershëm!

Plakun e Diellit

## PËRTEJ TRIMËRISË

Nuk e kam njojur fare këtë njeri për të cilin dua t'ju rrëfej. S'jam takuar me të asnjeherë, por për një kohë të gjatë e kam hasur përherë në bisedat e kolegëve, shokëve dhe profesorëve të tij.

Në të gjitha fotografitë që kam në dorë, ai gjithnjë të buzëqesh, duket i gjëzuar, aq sa dhe gjyzlykët e gjerë nuk ia fshehin dot shkëlqimin e gazit të syve. Duket i mrekulluar ngajeta. Dhe vërtet, më njëzet e shtatë vjeç ai u bë Doktor i Shkencave i Universitetit Suedez të Upsalës, më të vjetrit në Skandinavi. Doktorë kaq të rinj dhe Suedia vetë i ka me gishta.

Deri vonë s'kisha dëgjuar kurrë për të, për talentin e tij të madh në lëmin e kimisë. Zakanisht te ne, vitet e fundit, është bërë zakon të dëgjojmë shpesh e të ngazëllehemë për fëmijët tepër të talentuar në muzikë. Në shkencë, ai për të cilin do t'ju tregoj, ishte i pari i brezit të vet. Qe më i zoti i të gjithëve.

Nuk jam punonjës i shkencave të sakta. Vështirë e kam të gjykoj dhe të flas për të si i tillë, por kam dy vjet që mbaj në duar tri letrat e tij dërguar profesorëve të vet. Këto letra më shtyjnë të shkruaj patjetër për të. Këto letra më djegin duart dhe shpirtin. Në to ndihet dashuria e madhe e pashoqe për jetën, ndihet guximi i tij i rrallë.

Mund t'i zbukuroj këto letra, askush nuk më pengon dot, mund t'i bëj më ngacmuese nga ç'janë, por këtë nuk e bëj dot, kurrsesi! Më vjen rëndë.

Ai njeri për mua jeton përtëj trimërisë. Në kohë rreziku e halli për popullin dhe kombin tend gjithsecili mund dhe duhet të bëhet trim. Dhe për të drejtën e njerëzve trimat duhet të jenë të shumtë. Por në historinë, në natyrën e guximit të Fishikut, kështu e quajnë atë për të cilin kam marrë penën sot, trimat janë të jashtë-zakonshëm.

Nuk di nga ta filloj tregimin tim për të. Ndoshata do të ishte më e udhës ta nisja menjëherë më letrat e tij, të paraqitja thjesht letrat e tij njerëzore dërguar mësueses së vet. Ndoshata kështu mund të ishte më mirë? Por, ashtu siç desha unë të dija kush ishte ky njeri, që shkruante të tillë letra në kushte të vecanta, ma do mendia që dhe ti, miku im i mirë, ke një dëshirë të tillë. Le të të plotësohet ty dëshira jote!

Docentin Niko e njoh prej kohësh. Banon në një shkallë me mikun tim Çetin, minatorin e vjetër, ustani të parë në minierë. Kur vete te Çeti për vizitë, shpesh më thoshte që të bëj durim e të pres sa ta thérresin se është te komshiu, te profesor Nikoja. Familjarët e urtë të ustait tim, Çetit, ia ngrenë gjithnjë, pjacën më lart docent Nikos. Ata i thonë atij pérherë vetëm Profesor. Dhe, me sa kuptoj unë, ata kanë të drejtë. Pra, shpesh Çetin më është dashur ta kërkoj te Nikoja dhe kështu jam njojur edhe me të.

Kur më ranë në dorë letrat e Fisnikut, heroit të tregimit tonë, vendosa të pyesja për të pikërisht Nikon.

Pimë tok kafen te Çeti. Nikoqirja e shtëpisë, e shoqja e Çetit, diçka amvison në aneksin e kuzhinës. Lan, me sa duket, enët, përderisa dëgjoj ujin e çezmës që këndon me dizonancë të plotë. Televizori jep emision për inkasit e Kolumbisë.

— Fisniku? Domethënë, ju keni në dorë letrat e tij? Ju kanë bërë përshtypje dhe doni të shkruani? — pyet docenti më një mall e dashuri që dallohet lehtë në zërin e tij. Ai shuan më nxitim cigaren në tavllë dhe thotë, gati grarishë: «Sa fmirë!»

— Po. Janë letra që më kanë mahnitur. S'janë gjë fare këto historitë e inkasve para tyre, — i përgjigjëm unë duke treguar ekranin e televizorit.

— Ai ishte Kolomb në shkencë dhe Promete në jetë, — ma ktheu docenti.

— Pse Kolomb? Çfarë ka zbuluar? — ndër-

hyn Çeti, tashmë i lidhur fort me kureshtjen për të panjohurin e letrave.

Docent Nikoja harron tashmë që pyetjet e para qenë të miat, se mua pikërisht më duhet të di diçka për Fisnikun. Fillon e sqaron Çetin, ustanë tim të minierës.

— E di si është puna, Çet? Fisniku u mor me kiminë kuantiqe, që është sot kimia më e lartë, truri dhe fjala e fundit e saj: kimia e matematizuar.

Çeti dëgjonte me vëmendje, me sy e veshë hapur, por unë e shihja që ustait tim ky fakti i matematizimit të kimisë nuk i thoshte gjë. Sot edhe shollët e këpucëve i presin me matematikë. Metodat matematikore janë në modë kudo.

— Usta, — ndërhyra unë, — kjo kimia/kuantike e Fisnikut është si të shfrytëzonim minierat e qymyrgurit me puse të thellë dhjetë mijë metra.

— Mos, bre! Ku i ka vajtur mendja! — tha Çeti i hutuar dhe i gjëzuar njëherësh.

— Tamam kështu. Keni të drejtë, — miratoi docenti dhe tashti u drejtua tërësisht nga unë. Ai qe asistenti më i aftë në katedrën tonë, për tu specializuar në këtë fushë. Kish studuar përfizikën e trupave të ngurtë. Vetëm për një vit mbaroi dhe kursin e plotë të kimisë inorganike dhe njëherësh përsosi dhe dijet e tij në matematikë. U bë, kësisoj një trinomi i fizikanit, kimistit, dhe matematikanit. Në shumë nga pedagogët dhe kolegët e tij, qemë të sigurt përfshesitë e tij. Por ne jemi, në, të tjerët janë të tjerë, ata do të vendosnin dhe ishim, në hall a do të pranohej, vallë ai një ciklin e studimeve pasuniversitare të Universitetit të Upsalës? Ata, atjë në Suedi, në katedrën e njobur në botë të kimisë, nuk i njihnim dhe s'dinim se si do ta prisnin asistentin tonë.

— Po gjuhën e vendit a e dinte? — pyeti i merakosur Çeti.

— Jo, — tha docent Nikoja, — ai zotëronte shumë mirë anglishten. Sidoqoftë, ai u nis për në vendin e asnjanësisë tradicionale, që në shkencë nuk është e tillë. Për kundrazi, në lëmin e shkencës, nga anoi ajo, anon shumë herë dhe kandari. Fisniku u nis për atje dhe ne prisnim letrën e tij të parë. E dinim që do t'i shkruante patjetër shefes sonë të katedrës. Do ta keni vënë re me siguri, që të gjitha letrat i drejtohen asaj. Ai kishte respekt e dashuri të madhe për të. Ish-te bash ajo, që e kish spikatur që në shkollë të mesme talentin e tij. E kish vlerësuar e njohur në olimpiadat e kimisë që bëhen te ne. Ajo përgjerohej për të, ndërsa ai linte kokën pas saj.

Letra e parë e shumëpritur, më pullat e postës suedeze, vërtet erdhi nga Upsala, por jo nga Fisniku. Atë na e dërgonte profesori i njohur Loudin. Kjo letër ishte gjëzim dhe ndër i madh për ne. Midis të tjera sh, në atë letër ai ngulmonte për përgjigjet e sigurta, tepër të sakta, të Fisnikut ndaj pyetjeve që i kish bërë ai vetë, Loudini. I vinte mirë që me asistentin tonë mundi të bisedonte si një i barabartë me të barabartin. Dhe se në luftën e Davidit me Goliathin profesorit suedeza, laurant i çmimit Nobël, Loudinit të madh, nuk do t'i pëlgente kurrë të ishte në rolin e Goliathit para këtij Davidit të urtë shqiptar, që e kishte bërë përvete. Shkenca u takon të zotëve. Dhe nuk më ikën nga mendja që kolegu suedeza e imbyllte letrën me pyetjen që na gjëzoi pa masë në katedër: «A do të na vijnë në institut kolegë të tjera nga Shqipëria? Pas njohjes fatlume me kolegun e ri të vendit tuaj, do të prisnim më shumë dëshirë shokë të tjera të tij. Ai na ka entuziazmuar të gjithë!»

Kështu na shkruante nobelisti i largët. Dhe ju siguroj që komplimente të tillë janë fort të rralla në gojën e shkencëtarëve të kimisë kuantike. Ju e dini që matematikanët janë të ftohtë në vlerësimë. Sëmundje profesionale.

— Po pastaj, — pyeti usta Çeti, — ç'u bë me çunin tonë?

— Histori e gjatë, — ia ktheu docenti.

— Paçka, sa të përgatitë nikoqirja hazëret e veta, na e thuaj si vajti puna e tij, — nguli këmbë ustai im i mirë, duke ma lehtësuar shumë barrën mua.

— Shokët tanë, të ambasadës na thanë se në fakultet qarkullonin gojë më gojë fjalët e profesor Loudinit që «Shqiptari i turpshëm di të përgjigjet në kimi me saktësi matematike, qind pér qind».

— A, më i lumtë! — thirri Çet ustai.

— Fantastike, — thashë unë i përfshirë nga rezonanca e entuziazmit të ustait tim.

— Nuk kaluan vite, por vetëm nja dy-tre muaj dhe atje në Upsalë, — vazhdoi docenti, — u vunë në garë profesorët kush do ta kishët për asistent asistentin tonë. Emri i tij filloi të përmendej në raportet mujore të Institutit Suedez të Kimisë dhe rezultatet e tij në kërkime vunë në sedër dhe në sëkëlldi shumë nga vendasit. Në mbarim të semestrit të parë, Profesor Gailais, që udhëhiqte tashmë doktoraturën e tij, i tha ambasadorit tonë: «Të jesh udhëheqës i një kërkuesi e zbuluesi si Fisniku juaj, që kombinon një kapje të shpejtë e të qartë të problemit, pra me një intuitë të jashtëzakonshme, me një vullnet e punë të pashoqe këmbëngulëse e të frytshme, është kënaqësi e veçantë. Lum si ju për të tillë djem!»

— Vërtet, lum si ne! — tha ustai im i drejtë.

— Pak më vonë ne morëm letrën tjetër të Institutit Suedez, ku theksuhej se Fisniku, me studimin e tij, po jepte një kontribut të rëndësishëm në një fushë që i takon frontit më të përparuar të kimisë kuantike.

— Xham fare! — ndërhyri përsëri ustai entuziast.

— Jo tamam, Çet, — kundërshtoi docent Nikoja.

— Qysh jo tamam?! — u habit Çeti, që deri tashti kish pasur për çdo shfaqje të tij të ngazëllimit vetëm miratimin ose pohimin e docentit. — Ç'do të thotë kjo jo tamam!?

— Ja kështu, jo tamam! Atje në Skandinavinë e fjordeve po e njihnin Fisnikun si një mendje të ndritur në kimi. Ai filloi të merrte pjesë në kongreset ndërkombëtare të kimisë dhe fizikës dhe shkenca jonë shqiptare po dilte e një niveli me të tjerat në këto forume nëpërmjet dijes dhe mençurisë së Fisnikut. Dijet tona po zinin vend në sofrën e kimisë botërore. Me siguri që për disa nga të huajt kjo pranohej nga halli e jo nga malli, por q'e do, që këtu te ne, në disa nga ambientet tona shkencore, filluan të dëgjoheshin zërat, që, me sa dukej, ky Fisniku u kish hedhur, si i thonë, trutë e gomarit profesorëve pleq të Suedisë, përdërtisa po i jepnin një rëndësi të tillë.

Dhe, meqë kjo nuk zhuri dot vend se ishte fare absurdë, thanë që janë miqtë e tij këtu, në katedrën tonë, që po i fryjnë së tepërmri rezultatet e tij.

— Turp! — mori inat ustai i urtë Çet. — Turp!

— Quaje si të duash, Çet, por të paaftit tanë nuk e duronin dot affësinë e tij. Në u gjëzoheshim sukseseve të tij në Upsalë, ata hidhëroheshin e zemëroheshin prej tyre. Nejse, dhe ne shokët e

tij' nuk e hanim bukën thatë. Luftuam dhe u përpoqëm që gjërat të viheshin në vendin e vet.

— Mirë keni bërë. Për të vërtetën dhe njeriu e punës fjala e mbarë s'është kurrë e tepërt! — tha Çeti. Tashti ishte radha e tij të miratonte të bëmet e të tjerëve.

— Ashtu është, Çet. E vërteta s'ka nevojë përaministi. Ata që kishin frikë se mos u hapte punë të tjera, telashe për hesap të tyre, thanë që shkenca me të cilën po merrej Fisniku, atje larg, në Veri, qenqësh shkencë për shkencë dhe u takonte viteve dy mijë, ndaj po harxhoheshin paratë e popullit, koi për specializimin e tij. Dijet e tij i shkin stoli që s'do t'i vlenin fort vëndit tonë sot. Dhe kërkuan me të madhetë kthehej në Shqipëri, pa i mbaruar studimet.

— Maskarenjtë! — tha Çeti.

— Mos e prish gjakun, usta, — u përpoqau në ta qetësoja minatorin e vjetër, — edhe në komunitëm, kù barazi do të ketë nëntë gjithë fushat, në aftësi s'do të arrihet!

Çeti më pa më dyshim, me siguri që për të unë gabojë.

— Këtë nuk e them unë, usta, e ka thënë Lenin.

Çeti heshtti, kurse dëcenti vazhdoi:

— Kur ata, marifetçinjtë, kërkënin kthimin e tij, erdhni një letër nga Franca, Po, po, nga Franca dhe jo nga Suedia tashti. Akademiku Matsón, njëri nga patriarchët e kimisë kuantike, sapo kish të lexuar në Kanada një ligjëraturë të Fisnikut, të mbajtur në kongresin e fundit ndërkombëtar të kimisë dhe i kish bërë kaq përshtypje trajtimi i guximshëm dhe largpamës i problemit, sa që shprehej se këmbeti pa mend nga një autor kaq i ri. Për gjithçka është e bëtuar dhe shkruar e zezë në të bardhë dhe ndaj më mëbetet të

thém vetém se jam plak tašti e do më ngelet pëng përgjithnjë që një artikull të tillë si ky i kolegut shqiptar nuk do të mund ta shkruaj kurë mës.

Dhe paskëtaj heshtën dhe ata që e kishin smirë e zili. Fisniku qe mal i lartë shumë, që ata s'i ngjiteshin dot.

— E drejtë zhytet, por nuk imbytet, — tha Çeti i mirë.

— Shqiptari ynë i admirueshëm, siç e thërritni suzedëzët, Fisniku ynë, zbuloi ligjshmërinë dhe klasifikoi strukturat e spinorbitaleve për secilën nga tetë klasat e lëndëve të kimisë kuantike (këtë çka thoshte docent Nikoja as Çeti as unë nuk e kuptuam, por e pranuam në heshtje si diçka të madhe, si një aksiomë që s'ka nevojë për vërtetëm). Ashtu si çdo proton ka elektrone, ashtu dhe strukturat e lëndës së re të qëmtuar nga Fisniku kanë çifte të përhershme elementesh.

— Pak a shumë si për çdo burrë që ka një grua, — e vulgarizova unë problemin.

— Diçka e tillë, përafërsisht, — u pajtuadocenti.

— Eh, — tha Çeti. — Patjetër ka kujtar atë që, për çdo fëmijë që vjen në këtë botë ka një nënë dhe një baba. Do ta këte pasë marrë malli për prindërit. Po fëmijë a ka?

— Interesant! — tha docenti. — Nuk më kish vajtur mendja të kjo. Vërtet kishte një vajzë të vogël.

— Esheh! — tha Çeti: — Dashuria për njërexit e mban njeriun. Ajo të jep gjithçka dhe ajo t'i merr të tëra.

— Kushedi! Ndoshfa! — tha docent Nikoja. — Rëndësi kishte që zbulimi i tij i ligjit të „Ciftëzimit“ ishte një zgjidhje e rrallë, qe e konceptuar qartë dhe saktë.

— Thjesht, — ndërhyra unë, — dhe madhështore! Këtu është çelësi magjik i shkencës.

— Magjia e shkencës i kushtoi jetën! — tha me keqardhje docenti.

— Si i kushtoi jetën? C'pësoi?! — u habit téré ankth Çeti.

— Shpesh njeriu në jetë vihet në provë. Por provë aq të rëndë si ajo e Fisnikut rrallë mund të ketë. Ai qe nga ata të paktët që sfidonte vetë vdekjen. Apo jo? — pyeti docenti, duke m'u drejtuar mua. — Të tjerat ju i dini nga letrat e tij.

— C'ndodhi më tej me të? Pse nuk flisni?

— u shqetësua Çeti.

— Lexoni, ju lutem, letrat e tij më mirë. Atje është téré e vërteta.

— Këndoji! më urdhëroi Çeti... — Këndozi, bre bir, të thashë!

Dhe unë këndova tri letrat e tij më zë, që të dëgjonte Çeti, docenti dhe nikoqirja e shtëpisë, që tashmë e kishin fikur televizorin dhe vëndin e inkasve të lashtë e kishte zënë biseda jonë, për Fisnikun e ri. Të tria letrat i drejtohen shefes së katedrës.

Letra e parë, Upsalë, 26 shkurt 1982. (Zbulimi i sëmundjes së pashërueshme.)

### *E dashura shqja...*

Uroj që të jeni mirë me shëndet ju dhe familja juaj si dhe gjithë shokët tanë të fakultetit. Nuk kam marrë akoma ndonjë përgjigje se si u vendos për problemin e pjesëmarrjes në Kongresin IV Botëror të Kimisë Kuantike. Para ndonjë javë ishte këtu në Uppsala ambasadori ynë në

*Stokholm* dhe *kaluam një drekë me dy profesorët, *Loudinin* dhe *Galaisin*. Të dy palët mbetën shumë të kënaqur. *Shqipëria* dhe *kimia qenë simbiozë e këndshme. Gjatë bisedës ambasadori u tha profesorëve për mundësinë për t'i ftuar në Tirananë. Atá sugjeruan që, në qoftë se është e realizueshme, të vijnë nga fundi i shtatorit. Gjatë beharit janë të zënë. Unë e di që, zakonisht, te ne miqtë i presim në sezonin e verës, por mendoj se në këtë gast nuk ka ndonjë gjë që s'bëhet. Për suzedezët shtatori ynë është verë e shkuar verës. Tashti që po ju shkruej letrën, këtu është temperatura minus njëzet gradë. Shtatori ka dhe të mirën tjetër, që ju mund të organizoni për ta një apo dy leksione me kolegët dhe studentët tanë një sallën e Rektoratit. Sidoqoftë ju e dini vetë më mirë dhe, po qe se do të vini këtu për kongresin e ardhshëm, aherë mynd ta bëni vetë këtë ftesë për kolegët tuaj të këtushëm. Kjo do të ishte zgjidhja, më e goditur. Le të shpresojmë!...**

... Tani më falni që do t'ju shqetësoj duke ju shkruar, jo si zakonisht, lajme të gëzuara. Është fjala për shëndetin tim. Krejt rastësisht vajta për vizitë te mjeku i syve, për të gjetur numrin e saktë të syzeve të reja që kisha ndër mend të blija. Me numrin e syzeve të vjetra disti kishin filuar, të më ladheshin sytë gjatë leximit. Dhe, siç e merrni me mend, mua më duhet të lexoj «*bajagi*» dhjetë-dymbëdhjetë orë në ditë, pa folur për eksperimentin. Mjeku okulist zbuloi një hemorragji të lehtë në kapilarë. Nuk i vura rëndësi. Kuptohet që, kur sytë lodhen, do të kenë dhe hemorragji të lehta në kapilarë. Por okulisti më porositi për analiza të menjëherëshme të gjakut. Përparrë mjekëve të gjithë jemi fëmijë dhe unë u binda. I bëra analizat dhe rezultoi që unë vuaj nga një sëmundje e pashërueshme gjaku

(leucemia), e cila mund të ketë disa muaj që ka filluar dhe nuk e paskam kuptuar. E çuditshme është se unë ndihem akoma mirë, përvëç njëfarë pagjumësie që kam pasur kohët e fundit. Po, cili njeri që largi atdheut, larg miqve e dashamirësve, larg shokëve dhe fëmijës dhe u ngop më gjumë!

Diagnoza është përfundimtare, «vendim i prerre i gjuqit dhe i paapelueshëm», dhe u konkludua pas pesë ditësh, në spitalin e Upsalës, që është ndër më të mirët dhe më modernët në botë. Është e pamundur të gabojnë. Me keqardhje, por kështu është. Gjynah! Kriteret, e punës këtu janë të tilla, që mjeku e vë në dijeni të plotë patientin se çfarë ka, dhe se qysh do procedohet. Për këtë s'bëjnë përjashtime ngado që, të jesh. Me siguri kjo bëhet që njeriu të mos gjendet gafil para vdekjes dhe, c'ka për, të thënë a përtë lënë të tjerëve ta bëjë në kohë.

T'ju them të drejtë, në fillim u trondita dhe u habita njëherësh. E vështirë është të përshkruaj se q'mendoja e nuk ia vlen barra qiranë të zgjatem, në këtë pikë. Jeta, është luftë dhe lufta, ka viktimat e veta. Një çast mendova se «syri i keq», siç thotë populli, e bëri punën e vet. Gjithnjë jam çuditur me atë zili e smirë që kanë shumë njerëz përpunët e tjetrit. Dhe ndaj mëje kjo ka ndodhur si në Tiranë, si këtu. Zilia nuk njeh kufi. Pse ndodh kjo? Pse ka njerëz që nuk gëzohen me gëzimet e të tjerëve? Ci pengon vallë? Para një muaji, në mbledhjen e përgjithshme të institutit, profesorët tanë deklaruan se unë qenkësha më i përparuari nga të gjithë. Mbështetje i merituar vlerësimi, u falemnderit atyre, por mua më endhi rëndë. Lavdërimet e kurimet duhen, patjetër janë të nevojshme, goftë dhe në lëmin e shkencës, por unë u sku-

qa si vajza kur ia shfaqin dashurinë në publik. Dashuria dhe përgëzimi në shkencë kanë nevojë për intimitet. Ndoshta më e mira punë në përkrahjen e shkencetarëve të rinj është përkrahja pa bujë, pa mbledhje të mëdha. Përkrahja juaj ndaj meje gjithnjë ka qenë e tillë si e një nëne për djalin e saj. Kjo ngrohtësi dhe ky respekt më duhen mua.

Njeriu, sigurisht, nuk ka pse të niset nga paragjykimet boshe, jo «syri i keq», jo «syri i mirë». Kjo do të jetë dhe si pasojë e gjendjes sime të nderë e të shqetësuar shpirtërorë. Sëmundja i ka këto! Vëçse mua më duhet të marr një vendim për të ardhmen time, për punën e kam fjalën, për të cilën nuk ngûrroj të kërkoj, si gjithnjë, në qoftë se është e mundur, mendimin dhe ndihmën tuaj. Nuk ngurroj ta kërkoj se e di që as ju nuk do të ngûrroni të më ndihmoni.

Së pari, do të dëshiroja që mundësishët askush, ose sa më pak veta që të jetë e mundur, të marrin vesh për këtë sëmundjen time të ligë. Vetëm ata që duhet të jetë e nevojshme ta dinë. Rezonanca e një lajmi të tillë do të krijonte rrathë të tillë, që s'do të ishin në dobi të punës sime. Një rreth i madh i njerëzve të shqetësuar për hallin tim do të ma shtonte shumë ngarkësën emocionale. Kërkimi që po bëj, ju e kuptoni më mirë se kushdo atje, kërkon që gjithë energjitet dhe ndjenjat e mia të vihen në një rezultante të vetme, në atë të eksperimentimit që kam filluar. Koha nuk pret. Sahati po bie dyshëdhjetë!

Së dyti, mendimi i mjekëve këtu është që së mundja është kapur në një gjendje pak a shumë të hershme, si të thuash në fillimet e veta, ndaj disa, dy deri katër vjet jetë më garantojnë! Se ç'bëhet më vonë, askush nuk mund të thotë gjë, s'ka ar-

*dhur ende koha e profetëve të kancerit! Shumë në ecurinë e sëmündjes varet nga vëtë individi. Për pünën time dhe kjo amplitudë kohe, dy deri katër vjet; s'është pak. Në fund të fundit tamahqarillku është fukarallék.*

*Tani unë do të dal nga spitali, por do të jem nën kontrollin e vazhdueshëm të mjekëve. Ka shumë rëndësi, ngulmojnë ata, trajtimi i parë i sëmündjes. Ilaqet shoqërohen me analiza të përditshme gjaku. Keq më vjen që do të humbas një kohë të vyer me to, por jam i detyruar të lëshoj pe, që të fitoj kohën tjeter...*

*Në një gjendje të tillë, aspak të këndshme, unë jam para një dileme: Perspektiva e largët është e qartë, fshati që duket s'do kallauz, prandaj kohën që më ka mbetur çdo njeri do të dëshironte ta kalonte pranë familjes, njerëzvë të afërt, pranë nënës, dhe fëmijës, tok më shokët e kolegët, në vendin e lindjes, në vendin e vëtrës...*

*Në shikim të parë ky arsyetim duket më i drejtë, veçse kjo të çon në konkluzionin e qurtë, që unë duhet të ndërpres gjithçka dhe të kthehem menjëherë në Shqipëri. Në këtë rast e keqja më e vogël është se humbas kontrollin e domosdoshëm të mjekëve të këtushëm dhe ndoshta dhimundësinë e sigurimit të të njëjtave ilaqe. Sido-aftë kjo dhe mund të kapërcehet. Ana tjetër dha e keqja më e madhe është se kësaj i thonë «dorëzim para armikut» dhe lënje në mes e punës së nisur, që profesorëve këtu u duket se është më shumë sukses. Unë nuk dua as të dorëzohem, as punën e nisur ta lë pa bitisur. Ndotti të mund të thotë se c'kuptim ka të vazhdohet puna, të sakrifikohet kështu kjo pak kohë që më ka mbetur. Kur edhe perspektiva më e afërt është në pikëpyjetje të madhe! Nuk duu t'i ngjoi të mbeturit që kapet pas një fije kashte, megjithëse në*

luftë për jetën njeriut, edhe kjo mund t'i falet. Por unë kam qejf të besoj dhe të shpresoj se, mbas procesi i sëmundjes do të zgjatë qoftë, dhe një çikë, sa të, më lejojë të mbaroj punën e filluar dhe pse jo, përkundrazi, të gjëzoj edhe pak jetën time, familjen time dhe t'ua shpërblej njerëzve të mi dhe Partisë besimin, konsideratën, mundin dhe kujdesin që kanë treguar gjithmonë përmua. Nuk besoj se egoizmi ka petk të tillë! Apo jo?

Për të vazhduar punën dhe kurimin këtu, më shkon ndër mend t'ju kërkoj juve dhe shokëve në Tiranë një favor tjetër, që mund të dëaket absurd e mbaseri tepruar, por gjithsesi unë kam besuar dhe besoj në dashurinë dhe respektin e njeriut për njeriun, kjo lëshëtë ajo diçka për të cilën luftuan prindërit tanë, populli im, ndaj pa druajtje ju lutem të më ndihmoni që të ndërqet mundësia e ardhjes këtu në Upsalë, gjatë periudhës prill-qershori, e gruas dhe vajzës sime të vocërr. Për këtë do të kërkoj, vetëm lejen e udhëtimit të tyre, sepse unë jam në gjendje nga puna që jam angazhuar në institut, t'i paguaj, vetë shpenzimet e udhëtimit dhe t'q mbaj këtu pa as më të voglin shpenzim nga shteti. Halli im nuk ka pse t'i bëhet barrë e re vendit tim. Cili do qoftë rezultati, ju falënderoj qysh më parë për interesimin tuaj. E di që ju do të bëni gjithçka përkëtë.

Ky variant do të më lehtësonët në shumë drejtime: — pavarësisht nga e ardhmja, unë do të kem kështu pranë më të shtrenjtët e mi, gjatë kësaj kohe veçanërisht të çmuar, që mjekët më sigeurojnë se unë do të jem akoma mirë dhe i afëtë për punë. Vetëvetiu do të kem mundësinë të vazhdoj mjekimin dhe kontrollin e rregullt, i pashqetësuar nga meraku për ta (do të jetojmë

së toku) dhe, mbi të gjitha, do të kem të gjitha mundësitë të përfundoj punën për tezën e doktoraturës. deri në fund të qershorit. Nuk është kohë e vogël, janë nëntëdhjetë ditë, janë dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë orë. Autoreferatin mund ta shkruajt në Shqipëri gjatë beharit dhe vjetës dhei në muajin nëntor të ktheshëm përsëri këtu vetëm sa tën mbroj doktoraturën. Nisur nga rezultatet e mbara të kërkimit që po eksperimentoj, instituti më ka akorduar bursë edhe për një vit tjetër, që e jepin në cilëndo periudhë. që do të më duhet. Ata më jepin një vit të tërë, kurse mua do të më mjaftonte një muaj, vetëm nënitori. Ndërkohë, në qershor jam ftuar, si dhe ju, të marr pjesë në kongresin e andhshëm të kimisë, ku do të jem i lumenj t'ju shërbëj si «gida» a cicëron i Stokholmit. Dhe ka shumë gjëra në muzetë e këtushme që do t'ju pëlgenin. Por le të mos e shes kaun para se ta ther!

Deri tanë nuk t'kam thënë askujt për gjendjen time. Njeriu kur ka një gëzim dhe s'e mban dot përvete, jo më një hali të madh. Nuk jam egoist, por jam i detyruar të veproj kështu. Shokët e ambasadës më dinë që jam në spital për disa analiza, por nuk dinë rezultatet! Merren me mend vetë, as shokut tim më të mirë, Gjergjit, nuk ia kam thënë. Nesëri kam ndër mend stë shkoj në Stokholm për t'i dhënë këtë letër një shokut që vjen në Tiranë dhe mund t'u lë të nënkuptojnë diçka shokëve të ambasadës. Gjergjit do t'i them më vonë, patjetër do t'i them por jo tashëti, kur dhe vetë nuk jam mësuar me gjendjen e re. Eai më tepër që ai është shumë i ndjeshëm e karrizik të preket më shumë se unë vëtë.

Sigurisht, merret me mend lehtë, që askujt në institut nuk do t'i them për këtë dhe asnjeri nga të familjes dhe të afërmët e mi nuk do të

doja ta dinte këtë, të paktën gjatë këtij viti, sa të mbroj disertacionin. Ju shkrova gjatë dhe sigurisht që ju shqetësova. Ma bëni kabull, por nuk e merrni me mend se sa u lehtësova tashti, përderisa nuk kam ndër mend t'ua them këto të tjerëve! Më falni! Ju rëndova shumë. Barra që ndava sot me ju është tepër e rëndë. Por një ditë ju do ta mësonit këtë dhe aherë, po t'ju thoshin të tjerët, do të më vinte turp para jush, për gjithçka të mirë e fisnikë keni bërë për mua në jetë!

Për mua qëndrimi këtu në spital është i vështirë psikoligjikisht; kudo kobalt dhe rreze, por, kur mendoj netët e vona i vetëm në konvikt, besoj se nuk do ta kem të lehtë. Por nga natyra më duket se kam qëlluar optimist, natyrish, jo nga ata «ku rafsha, mos u vrafsh». Në qoftë se arrihet që të vijnë këtu gruaja me vajzën, do të jem jo vetëm optimist, por edhe me «fat»! Le të shpresojmë! Grekët e vjetër më duket se thoshin që shpresa e mban njeriun!

Këto ditë, këtu në spital, kam lexuar veprën e shokut Enver «Rreziku Anglo-Amerikan për Shqipërinë» dhe jam kënaqur. E mahnitshme! Një mori gjérash e faktesh i mësoja për herë të parë dhe me ç'kurajë! Për gjendjen time të vëçantë ato janë, me plot gojën, burim force e frymëzimi për burrërinë dhe optimizmin e shqiptarit në çdo situatë. «Let's hope for the best», — më thonë mjekët. Unë them ashtu qoftë.

Tani po e mbyll më në fund këtë letër kaq të gjatë, dhe një herë më falni për shqetësimin. Shumë të fala të gjithëve, shokëve dhe mique, familjes suaj dhe kolegëve. Uroj të shihemi në qershori në kongresin e kimisë këtu. Mirë ardhshi!

Përshtendetjet dhe respektin tim  
Fisniku

Letra e dytë. Stokholm, 28 mars 1982 (Prognoza e sémundjes dhe përgatitja për kongres.)

### E dashura shoqja...

Nuk di si t'ju falënderoj për ndihmën dhe kurajën që më keni dhënë në këto ditë të jashtëzakonshme. Tamam, ashtu siç e thoshit në letrën e fundit, unë vërtet e ndiej veten më të lehtësuar dhe më optimist. Më dhatë krahë dhe besim. Ju jam mirënjojës. Nga letra juaj dhe nga biseda me ambasadorin mësova si të veproj për çështjen e ardhjes së familjes këtu dhe në fakt ashtu po veproj.

Tani unë ndihem çuditërisht mirë dhe ilaqet që kam marre e kanë «normalizuar» gjendjen. Të premtën e kaluar ishte dhe shoku i ambasadës në Upsalë dhe bisedoi gjatë më një nga mjekët që më ka në mbikëqyrje. Për diagnozën, fakteqësisht, nuk kanë asnjë dyshim, por prognoza mbetet një pikëpyetje e madhe. Unë kam lexuar, ndërkohë, gjithë ç'kam mundur rrëth kësaj sémundjeje, aq sa mjekët, sigurisht duke më bërë qejfin, më tonë se unë tashti di sa ata vetë dhe ndaj asgjë nuk më fshehin. E vërtetë është, ashtu siç thoshit dhe ju në letrën tuaj të fundit, se ka raste që sémundja zgjat me vite. Sa mirë do të ishte, sa shumë ide do të realizoja! Në Upsalë, bile, ka pasur, thonë, nja dy raste që u ka zgjatur sémundja deri 15-20 vjet! Nga sa kam lexuar vetë, del se tetëdhjetë për qind e rasteve jetojnë deri tre-katër vjet, vetëm njëzet për qind e kalojnë këtë limit. Qofsha në këta të fundit! Sidoqoftë iluzione s'ka pse të kem, se pse shumica dërrmuese janë rrötull tre vjetve! Pavarësisht nga kjo, fakti i ekzistencës reale dhe të rasteve të zgjatura të bën të shpresosh pas tyre.

Kështu që pozita ime tashmë është e tillë:  
Shpresë dhe optimizëm se sëmundja do të zgjatë  
disa kohë, dhe, ndërkaq, ndonjë progrès a zbulim  
në trajtimin dhe kurimin e saj mund të ndodhë  
në botë.

### Boll me sëmundjen!

Kam biseduar me profesorët këtu dhe më është  
bërë qejfi që ranë dëkord me shpejtimin e përfundimit  
të studimeve, por pa bërë asnjë tolerim,  
pa hequr asnjë presje nga plani i paraqit-  
kuar më parë... Lëmoshë nuk dua. Kështu, besoj  
se punën përt tezën do ta mbaroj në qershori, pas  
taj mbrojtjen do ta bëj në nëntor.

Nuk ka as tri ditë që në institut erdhi tele-  
grami nga Tirana për pjesëmarrjen tuaj në kon-  
gres. U gëzova pa masë, do të takohemi e do  
të çmallemi dhe pres që të njoftoni se kur edhe  
sa kohë parashikoni të qëndroni në Suedi, në  
mënyrë që të organizojmë me kohë vizitat në  
institucionet shkencore e kulturore e të tjera me  
interes për ju. Këtë punë e kam pleqëruar edhe  
me profesorët e kolegët e institutit dhe ita, si  
përherë, janë gati të na ndihmojnë.

Ashtu, siç e kam pasur ndër mend (edhe tanj  
kështu mendoj), në kongres unë do të mbaj një  
të ashtuquajtur «poster», pra një lloj kumtesë  
aktive, e cila, në vend që të lexohet «ex katedra»,  
paraqitet me «çarçafë» të mëdhenj (si projektit  
e arkitektëve) dhe diskutohet me pjesëmarrësit e  
interesuar që të rrinë përqark, si rrëth tavolinës  
së rrumbullakët. Kjo praktikë pune është tepër  
efektive, jo se është në mëdë sot, por bën të mun-  
dur realizimin e pjesëmarrjes së gjallë e më dis-  
kutime të shumë më tepër njerëzve sesa me rrug-  
ën tradicionale. Natyriشت, kjo ka më shumë «te-  
lashe», se ka pyetje e përgjigje më tepër, ca më  
shumë që duhet të jesh «hazër xhevap!»

Planet e mia hëpërhe këto janë, tash ti po kthehem përsëri te ju. Me shëndet dëshiroj dhe uroj të jeni mirë të gjithë, ju dhe tërë familja. Punë besoj se keni plot. Tani po afron 1 Maji dhe patjetër fakultetin do ta kene caktuar të marrë pjesë në pàrakalimin tradicional. Lum si shokët! Besoj se ata, shokët tanë, të gjithë janë mirë me shëndet e me punë. Shumë të fala të gjithëve. I përqafoj me mall. Nga Jani kam marrë tani vonë një letër dhe do t'i përgjigjem shpejt.

Me Gjergjin u takuam sápo erdha në Stockholm dhe biseduam gjatë. Ai është interesuar për çështjen e vendit për spacializim në fizikën teknike dhe së shpejti do t'ju informoje. Është shumë mirë me shëndet dhë punën e ka vënë në vijë. Ju bën shumë të fala. Ai ende nuk di gjë përmua dhe në gjallérinë e tij duhet të marr pjesë sikur s'kam asgjë. Nuk kam ndër mend t'ia them tanë hallin tim, ndoshta mund t'ia them kur të kthehem në Tirane! Ngurroj ta lëndoj dhe atë, por e di që i duhet thënë, se s'do të jetë mirë ta marrë vesh nga të tjerët!

Police përfundoj letrën duke ju uruar dhënje herë shëndet e gjithë të mirat, gëzuar festën dhe mirupafshim në qershori në Upsalë. Shumë të fala të gjithë njerëzve të shtëpisë dhe veçanërisht djalit tuaj, të cilat po i afrohen edhe provimet e maturës, ku me siguri do të dalë xham, fare, sic thopë studentët tanë.

Juaji, Fisniku. Përshtëdetje!

Mirë ardhshi!

Letra e tretë. Upsilon, 28 qershor 1982. (Sëmundja bën të vetën dhe kongresi.)

### *E dashura shoqja..,*

Së pari uroj, të jeni mirë me shëndet ju dhe të afërmit tuaj. Më erdhi jashtëzakonisht keq që nuk erdhët në Upsilon në Kongresin e Kimisë Kumanike. Sa ju kemi pritur! Profesorëve dhe kollegëve të mi këtu u kisha folur shpesh për ju dhe ata në fakt qenë tepër të interesuar të vinit dhe emri juaj, i një gruaje shkencëtare nga Shqipëria, kish bërë përshtypje të veçantë. Fatkeqësisht, në botë ende nuk e njojin si duhet vendin tonë. Pjesëmarrja juaj në kongres do t'i bënte shërbim të madh qoftë dhe për këtë fakt.

T'ju them, të drejtën, mua më erdhi shumë keq që s'erdhët thjesht si nxënësi për mësuesin e vet, si njeri që kisha nevojë në këto çaste të ndieja fjalën e ngrohtë të nënës për birin. (Mos po e taproj me këto krahasime? Jo, kurrsesi, jo!) Pavarësisht ngaljo, dhe i shkëputur nga rrëthanat që e penguan ardhjen tuaj, këtej, të cilat unë skam si t'i saktësoj, e pra dhe mund të gaboj në vlerësimin e tyre, unë mendoj se nuk u veprua drejt. Në aktivitete të tillë ndërkombëtare, veçanërisht në fushën e shkencave natyrore, numri i grave dhe vajzave pjesëmarrëse është zakonisht mjaft i vogël. Emancipimi i bujshëm i gruas në këtë lëmë të jetës edhe këtu në Suedinë e triditave është akoma larg. Kësidoj, kuptohet përshtypja e veçantë që krijoj regjistrimi juaj paraprak si referues në Kongres.

Nejse, gjëra që ndodhin te ne, por që do të ishte mirë të mos ndodhnin. Sigurisht, mosardhja juaj nuk mund të rrëzojë faktin se gratë në vendin tonë i kanë të gjitha mundësitë dhe praktik-

kisht njëlloj me burrat janë aktive në çdo sferë të punes, të prodhimit dhe të kërkimit shkencor, por prapeseprapë nuk qe hiç mirë që ai i shi bre, Jani, erdhë, kurse ju, jo! Kjo punë mbaroi tani, mend përtjeter herë, por keto gjëra auhen parë më gjerë dhe më thelli.

Me Janin kauam mirë në përgjithesi. Ai duhet t'ju ketë treguar tashmë vetë me hollesi si i kaluam këto ditë. Në kongres, sic ju patu shkruar, unë u paraqita me një «poster», i cili u vlerësua mjaft dhe, me gjithë skontot që i bëj këtij vlerësimi të madh, edhe vetë jam i bindur që në fakt ai përbën punën më të mirë timen gjatë kësaj kohe që jam në Suedi.

Me shëndet kam qenë «shumë mirë», pasi vërtet ndihemi fare mirë, por e keqja është se mendimi për çka kam nuk më shqitet kollaj dhe, natyrisht, shpesh ma prish, humorin dhe qetësinë. Po që pësoj si ai që thonë se e ka mizën nën kësulë! Por ardhja e gruas dhe Valbonës më kanë lehtësuar jashtëzakonisht. Këtë borxh, që ju ndihmuat me aq dhembshuri e vëmendje, nuk ju laj dot.

Sic mëptha Jani dhe sic më kanë thënë dhe disa të tjerë shokë këtu, në Tiranë qenka përhapur goxha lajm se çfarë kam unë, e tjera. Nuk quditëm, jemi vend i vogël. Veçse deri tani, unë nuk i kam thënë ende për këtë Gjergjit, bile dhei Janit ia kundërshtova; gjendja aktuale e mirë imja patjetër duhet të ketë bërë ta besojë, se ç'kish dëgjuar qenë vetëm llafe. «Llafe, imzot, llafe», — sic thoshte Hamleti. Por, natyrisht, këtë punë unë nuk mund ta fsheh për një kohë të gjatë, «minarja në thes nuk futet», — themi ne shkodranët. Kur të vij në Tiranë, më duhet t'u them shokëve dhe t'u kërkoj të fjalur. Ky «sekret» po më lodh shumë.

Profesorët e mi kanë biseduar me mjekët këtu dhe ata më kanë sugjeruar të më bëjnë një transplatin total të palcës së kurrizit. Unë për këtë nuk jäm ende i vendosur, se për më tepër, kjo shqërohet edhe me disa vështirësi të tjera, të cilat do t'jua them më vonë. Sidoqoftë, kjo është njëfarë shprese e re, një semaforë jeshile dhe, në e bëfsha e del për mirë, ia vlen mundimeve. Kjo punë, po u bë, mund të realizohet dimrin që po vjen. Pra dhe mbrojtja e doktoraturës dhe transplativi njëherësh. Daltë për mirë.

Tashmë kam përfunduar piunën me eksperimentimin dhe tezën time dhe këto ditë po shkruaj dy artikujt e fundit lidhur me to. I pari është ai që paraqita në kongres e që do të botohet në «Intern Journal of Quantum Chemistes», në numrin që i kushtohet kongresit dhe tjetrin, që ka të bëjë me absorbimin e  $H_2$  në sipërfaqe Bori, që akoma s'kam vendosur se ku do ta botoj, ma kanë kërkuar gjermanët dhe japonezët. Sidoqoftë, tanimë situata është fare e qartë dhe tezën mensiguri do ta mbaroj, siç i përnxitova afatet, në tetor.

Profesorëve këtu u është bërë qejfi shumë përftezen që u bëtë për të ardhur në Tiranë, por kohën se kur do të vijnë ende nuk e kanë vendosur përfundimisht. Galais duket se do të jetë atje, ashtu siç patëm menduar njëherë, në fund të shtatorit, ose në fillim të tetorit. Loudini e ka më pak të qartë se nuk ka caktuar akoma në caktivitetë ndërkombëtare do të angazhohet gjatë kësaj kohe.

Për studentin e ri që mendohet të dërgoni, deri tashti s'është bërë gjë. Zyrtarët përkates thonë se s'kanë mundësi t'i gjejnë vend këtë shtator. Vitin tjetër, ndoshta poç Vecse, kur qemë në qytetin Sinkoping, ku ka një universitet teknolo-

logjik të njohur dëhe për mendimin tim shumë të mirë, biseduam me kolegët në Fakultetin e Fizikës dhe Teknikës së Matjeve, ku merren gjerë mëfizikën e trupit të ngurtë të aplikuar dhe në disa drejtime të për interesante edhe përi nevojat e vendit tonë. Nga biseda paraprake del se ata janë dakord përtu pënruar për studime atje, por duhet të bëm dhe ne dakord se Sinkopingu është ca si larg nga Stokholmi. Kyi rast i kësaj bise është provë evfaktit që këndej është më lehtë «të merret i kalaja nga brenda», njoftimi përmjet solidaritetit të shkençtarëve, sesa nëpunësve, që duhen pasun gjithmonë parasysh.

Qershori qe me siguri njëmuaj i bukur në Tiranë. Gazetat përgjigjet Kongresin e Bashkimeve Profesionale i kemivtarë dhe i kemi lexuar, ndërsa për sesionin e Kuvendit Popullor rendesë kanë arrdhur. Është shtoj qëndra e strukturave. Një sihariqë madhi i shpejtë ulja e rete çmimeve përmirë një numër artikujsh ushqimore të konsumentëve gjerë dhe shërbimet komunale, që ka më ka gëzuar fort dhe më bën krenar e më ballëhapët përtë folur e treguar përvendin tonë, përsistimin tonë, përrarritjet tona me një dinamikë krejt të kundërt me botën e këtejshme. Vërtet vend i vogël jemi, por të bëmet i kemi të mëdha!

Këto ditë duhet të jenë ditët e fundit të pravimeve në fakultet dhe ju do të jeni lodhur shumë, ca më tepër që ka pasur pròvimet e maturës edhe djali, por që nuk besoj t'ju ketë shqetësuar, se ai ka intuite të mrekullueshme në shkencat e sakta. Ju bëj shumë të fala juve dhe gjithë shokëve tanë. Unë do të kthehem më 19 korrik në Tiranë dhe mirë ju gjetsha të gjithë!

I juaji, me mall e respekt,  
Fisniku!

Mbarova së lexuari letrat. Nikoqirja e shtëpisë ishte hutuar dhe tryezën e kish lënë zbrazët. Çeti tha vetëm kaq:

— Fisnik qe dhe Fisnik mbeti.

— Mbrojti doktoraturën në tetor dhe në pranverë vdiq. Por ai i shkeli të gjitha afatet, — tha docent Nikoja, — dhe të gjithëve na mbeti në mendje ajo që na shkroi në telegramin e ngushëllimit Prof. Galais: Vetëm njerëzit vërtet të mëdhenj mund ta vazhdojnë pünën si ai, pas një goditjeje të këtij lloji.

— Këta janë trima që s'vdesin kurrë, — tha nikoqirja e shtëpisë, një gjë të vërtetë shumë dhe tepër të njohtur.

Jashtë kishte filluar bora si në Upsalë dhe me vete mendova që Fisniku ishte nga ata që e kalojnë kufirin e çdo gëximi, luftojnë e punojnë përtëj trimërisë...

**KOHA**

## VITI I BORËS

«Vështirësitë nuk ju trembin, ashtu siç nuk ju tremb bora e madhe që bie në këto bjeshkë të larta dhe për një kohë duket sikur ju izolon, siç nuk ju trembin ortekët e mëdhenj e të përbindshëm që rrokullisen poshtë nepër këto hone të thella. Me gjithë këto vështirësi të mëdha të natyrës së ashpër të bjeshkëve, ju nuk lëvizni këtej.»

ENVER HOXHA

### *Fillimi i matjes së viteve*

Vitet janë si njerëzit. Ato kanë biografinë dhe emrin e tyre. Ka vite të mbara e të shënuara, ashtu siç ka dhe njerëz të mirë e të dëshiruar. Ka vite të sarta, të prapa, që të bëjnë dëm, siç ka dhe njerëz noprani e të rëndë, që mos të rënshin për hise. Ka dhe vite të tmerrshme, siç ka dhe njerëz të ligj. Vitet, si njerëzit, kanë dhe

emrin dhe mbiemrin e vet. Emri i tyre është ajo radha kronologjike para dhe pas erës së re, që i vë vulën koha me matrikullin e saj dhe mbiemri i tyre, si një paracukth a nofkë, është ai që i ngjitin njerëzit.

Gëzohemi e festojmë kur kujtojmë vitin e Pavarësisë, vitin e Themelimit të Partisë, vitin e Çlirimt; atë të dritës, (të elektrifikimit), të lindjes apo të martesës sonë a të të afërmve tanë. Por ka dhe vite të shumta të hidhura kiamet (në të shkuarën të ne, në të sotshmen në botë). vite të urisë e të zisë për bukë, të kolerës e të mortajës, të grüpit spanjoll e të Honkongut, të tërmetit dhe të kometës (*Nëndëqind e dhjetë viti. vitinë që shkoi komiti*), thotë kënga dhe ja tanimë doli dhe viti i borës. Viti i acarit, viti i taratit, që nuk varen kurrsesi as nga vuillneti e as nga dëshira e njerëzve.

Viti që kaloi, 1984-a, ishte për bujqësinë një vit thatësire; si për baraspeshë, ky i sivjetmi, 1985-a, kam bindjen se do të kujtohet shpesh si: Viti i Borës.

Më 11 janar të këtij viti, ditën e diel dhe ditën e Festës së Republikës, qelli, si u shkarkua mirë mbi Veriu, nderi çarçafët e bardhë të borës mbi të gjitha trojet tonë. Pas kaq vitesh në Tiranë fëmijët rrëshqitnin mbi borë. Gjë e rrallë e gati e pangjare. Unë them çarçafët, paçka se ata ishin jorganë e dyshekë të trashë dëbore. Por zakonisht jorganët e dyshekët janë ngjyrë tjetër, qofshin për pajë nusesh e qofshin për mbulojë plakash, e ca më shumë të ngrohin; ndaj le, të themi, çarçafët e bardhë të dimrit. Nuk mbeti pëllëmbë vend nga Joni, e përtëj Alpeve që të ishtë e gjelbër a e murrme, sic, është druri e guri, dheu e balta. U krijua një peizazh i stërmadhë i bardhë ballkanik e gati mbarëevropian. Me plot

gojën mund të ngülmhoj, të nxjerr dhe unë një fjalë të re dhe të them të paktën: vendi ynë u kthyen në një bornajë pa fund. (Aq sa dhe kur e shkruan të duket sikur të futet itë ftohtët në trup.).

Humbën mendjen shkencëtarët e botës me këtë palo dimër. U ngaterruan gjithë qendrat sinoptike më të, dhe pilotët s'gjenin dot më pikë orientimi. Mbretëri e ftohtësisë së bardhë. Ca thanë bori si kjo Evropa paskësh njëqind vjet që s'paskësh parë, ca thonë pesëdhjetë e të tjerë thonë jo më pak se një çerek shekulli. Bori dhe vetëm bori. Acar dhe thëllim!

Vendit iu hap shumë punë me të, Evropën e trömaksi fare! Një hall i madh na zuri të gjithë. Por në halle duket dhe një herë fuqia jonë. Në të këqësë në rrezik trimi duket që është trim. Shumë gjëra pati këto ditë, oveç panik jo. Të ftohtin më të madh e patën krahinat e Veriut. Në ndihmë të tyre erdhi tërë vendi.

I ftohti pölar zbriste nga Alpet. Mbësë nuk e taproj, por këto dy javët e para të janarit ekranit i vogël i televizorit u bë dritarja më e madhe e shtëpive tona. Njerëzit mblidheshin rrëthij si për të parë një ndeshje ndërkombëtare futbolli apo si për të parë Festivalin e Gjirokastrës. Por as ndeshjet, as festivalet nuk janë përditë, kurse bora filloj e s'pushoi e rritej ditë për ditë. Filloj nga disa centimetra e shkoi në disa metra. Të matësh trashësinë, e borës me kate shtëpish, këtë janar e mësuam. Sa të rrojmë do të mësojmë! «Në Tropojë e në Kukës ka rënë dy kate borë, në Peshkopi një kat, por në Lurë e në Kala të Dodës dy!» Këto që dëgjonim e shihnim në ekranin e televizorit, s'ishin sajesa e as metaforë poëtësh. Ishin e vërteta e hidhur e borës së bardhë. Bukuri që vret, — tha njëherë Migjeni për borën

dhe pati tamam hak. Ajo e tillë është. Por në ditët tona, në ditët e Partisë, bora është dhe ajo «bukuria», që bashkon e aftron njerëzit, që forcon vëllazérinë e një ideali.

Në çdo kohë ka qenë trim shqiptari, në kohën tonë ai është i pathyeshëm. Ai nuk është sot vëtëm trim, se dhe trimat mund ta humbasin luftën (siç kemi humbur dhe ne shumë beteja në historinë tonë), por ai është i pathyeshëm dhe u ngript edhe këtë dimër si mal i lartë mbi motin e lig, mbi acarin e egër dhe ortekët e rëndë. Ai u ngript mbi ta dhe fitoi, sepse më e fortë, se bora e tërmeti është forca e njerëzve tanë, të cilët, të edukuar nga Partia me mësimet e shokut Enver, nuk i mposht asnjë vështirësi.

Diçka nga ky heroizëm masiv i popullit në ditët e ortekëve po hedh dhe unë në letrën e bardhë si... bora. Ku dhemb dhëmbi, wete gjulta. Këto ditë fjala më e përdorshme e shqipes u bë bora dhe atë e lakuam kaq e kaq herë. Bashkë me shokun tim Dritëro Agollin kaluam pesë ditë e pesë net në krahinat e Veriut.

Shumë gjëra i pamë vetë, shumë i dëgjuam nga të tjerët e mjaft syresh i pamë me sytë dhe i ndiem me zemrat e njerëzve fare të panjohur.

Shtypi dhe televizioni i pasqyruan gjerë ato që ndodhën. Këto cka dua të tregoj unë, janë të hedhura shpejt në kartë dhe afati i shkurtër i daljes në botim nuk më jep rast të thellohem në to, zgjedh faktin a ngjarjen më të goditur. Do të kalojë koha dhe këtë do ta bëjmë të gjithë, se e kemi për detyrë. Do të sedimentohen ngjarjet dhe do të kristalizohen mirë në kujtesë, dhe ato që do të mbeten si të tillë në kuletën e mendjes, besoj se do të jenë vërtet të rëndësishme. Por, duke pasur frikën dhe shqetësimin e njojur, që njeriu prej natyre (dhe shkrimitari

si i tillë) ka një veti të çuditshme që harron shpejt, bille ka rrezik që dhe shumë nga të vërtetat e këtyre ditëve të harrohen shpejt si gjithë të tjerrat, ndaj po nxitoj t'i them siç i ndiej tan, flakë pér flakë. Se, kur vjen behari me lule, dimri me cule nuk kujtohet më. Ashtu siç heqim palltot e pardësytë e i varim në raftet pér dimrin tjetër kur vjen behari, ashtu dhe kujtimet pér të mund t'i varim diku në raftet e harresës...

Por, të mos e zgjatim më, le të nisim udhëtimin...

gjatë që është komuniteti i përgjithshëm i kujdesave së cilët  
është që dëshiron të rikthehet shqiptarët. Dhe që dëshiron  
të rikthehet shqiptarët është që dëshiron që t'i rikthehet  
shqiptarët. Dhe që dëshiron që t'i rikthehet shqiptarët  
është që dëshiron që t'i rikthehet shqiptarët. Dhe që dëshiron  
që t'i rikthehet shqiptarët. Dhe që dëshiron që t'i rikthehet  
shqiptarët. Dhe që dëshiron që t'i rikthehet shqiptarët.  
Dhe që dëshiron që t'i rikthehet shqiptarët. Dhe që dëshiron  
që t'i rikthehet shqiptarët. Dhe që dëshiron që t'i rikthehet  
shqiptarët. Dhe që dëshiron që t'i rikthehet shqiptarët.  
Dhe që dëshiron që t'i rikthehet shqiptarët. Dhe që dëshiron  
që t'i rikthehet shqiptarët. Dhe që dëshiron që t'i rikthehet  
shqiptarët. Dhe që dëshiron që t'i rikthehet shqiptarët.  
Dhe që dëshiron që t'i rikthehet shqiptarët. Dhe që dëshiron  
që t'i rikthehet shqiptarët. Dhe që dëshiron që t'i rikthehet  
shqiptarët. Dhe që dëshiron që t'i rikthehet shqiptarët.  
Dhe që dëshiron që t'i rikthehet shqiptarët. Dhe që dëshiron  
që t'i rikthehet shqiptarët. Dhe që dëshiron që t'i rikthehet  
shqiptarët. Dhe që dëshiron që t'i rikthehet shqiptarët.  
Dhe që dëshiron që t'i rikthehet shqiptarët. Dhe që dëshiron  
që t'i rikthehet shqiptarët. Dhe që dëshiron që t'i rikthehet  
shqiptarët. Dhe që dëshiron që t'i rikthehet shqiptarët.

### Në udhëtim nëpër mbretërinë e borës

Ditën e hënë, më 14 janar, e lamë me Dritë-

ronë të niseshim dy brigada me shkrimtarë dhe  
piktorë për në Kukës dhe Pukë. Dhe Kukësi dhe  
Puka janë të izoluara nga bora. Rruga s'është  
hapur. Mundësia e vetme e vajtjes atje është he-  
likopteri (këto ditë helikopteri u bë mjet popu-  
llor). Por në të nuk pranojnë shumë udhëtarë.  
Vend në të ka së pari për ndihmat, mjekët, sho-  
kët e udhëheqjes, shtypin dhe televizionin. Ca  
më tepër që shpesh nuk dihet a mund të ulet dot  
helikopteri në ato anë. Ditët e tjera helikopterit  
iu hap punë dhe për ushqimet dhe bukën e të  
ngujuarve në fshatra të veçanta nga masivet e  
borës.

— Pilotët e helikopterëve janë bërë miqtë, më të vyer sot, — tha Dritëroi, që ka rrezik ta shkruaj dhe unë «drejtori», si e thërritnin rëndom matjanët dhe dibranët.

— Po të jetë për miq, kam disa prej tyre, qysh në Qytetin Stalin, — u mburra pa u kuptuar unë.

— Aherë bisedoje më ta që të na marrin më shumë shokë nga brigadat e shkrimtarëve dhe artistëve, — shfrytëzoi rastin ai.

— Tashti do të ishte më mirë që dhe ne të ishim me ta, dhe të shkruanim diçka dhe përpunën e tyre, — ndërrova fjalën unë.

— Për kë? Për shkrimtarët dhe artistët, të shkruajmë?! — u habit ai.

— Jo, për pilotët, — sqarova unë.

— Do të kesh rast, — tha Dritëroi.

Po rasti nuk erdhi. Qenë të tjerë që e lanë borxhin tonë për ta. Ne të dy vendosëm të niseshim për Peshkopi. Ca lajme yinin që ishte hapur Qafa e Buallit, ca të tjera që ishte mbyllur prapë dhe, më të shumtë, që nuk që hapur fare. Tëlevizioni në mbrëmje e dha të mbyllur, vëçse punonin hakshe traktorët e buldozerët përtat hapur.

Për shkrimtarët, dhe piktorët e tjerë, biseduam, dhe një herë me shokët e avacionit dhe ata u pajtuan që të merrnin dy brigadat, një për të nesërmen në Kukës dhe tjetrën të pasnesërmen në Pukë. U zgjidh dhe çështja e Lidhjes. Përsa i përket Pukës, djemtë aviatorë kishin një «hilje» të vogël, zanati. Ata shpresonin që brigada jo-në e Pukës, deri, të pasnesërmen, më 16 janar, mund të mos nisej fare me helikopter (do të kur sehej për ndonjë udhëtim tjetër të nevojshëm, sepse autokolona që drejtonte zëvendësministri i Mbrojtjes, Simon Ballabani, sapo kishte kaluar

Gëomsiqen dhi, kushedi, ndoshta arrinte ndërkokë në Pukë dhe hapej udhë. «Hilja» nuk eci. Artis-tët vajtën më helikopter atje, sepse rruga e Pukës u hap jo pas dy ditësh, por pas katër ditësh të tjera.

Si siguruan mjetin e transportit për shokët, filluan të interesoheshim dhe për mjetin tonë. Shokët e Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës na premtuan «Aro» me zinxhirë. E fjetëm mendjen. Morëm gozhupët, dhe kokoret në një repart ushtarak. Ata na dhanë një të shkurtër si për shoferë (e mbajta unë si bir shoferi) dhe tjetrin të gjatë si xhybe dervishi (e mbajti Dritëroi si nip bektashish). Në të ftohtin minus 17 gradë celsius të Dibrës dollomaja e dervishit vleu më shumë. Gjetëm dhe këpucë me qafa e gjizme gjahtarësh në miq e shokë. Të tillë vetë nuk kishim, se në Tiranë prej kohësh e kemi hëmbur edukatën e dimrit. Por këtë vit për një dimër të tillë dhe shumë të tjerë nuk e patën këtë edukatë. Gjynah, se u dashka shumë!

Në mbrëmje u thashë në shtëpi që do të niseshim të nesërmen për në Peshkopi. Televizori jepte lajme me dëborë dhe traktorë kudo. Të nesërmen ishte e martë dhe prisja që nëna të më kujtonte për sahatin e lig. Ajo nuk e kujtoi, por tha, me shikiimin mbërthyer pas ekranit: «Orëzëzëtë njerez, ç'vuajnë!» Në ekran të televizorit vazhdonte të binte borë e madhe Al-pesh, që dukej sikur i bënte karshillëk asaj bardhësisë së oborrit të pallatit mbuluar po ashtume borë Tirane. «Djalí im, sevdalli udhëtimesh, tha: «Sa mirë, o bâbë! Lum si ti. Ç'e do që kemi filluar shkollën, se do vija dhe unë me ju. Por s'ka gjë, se do t'ju shohim në televizor», — ungushëllua ai.

Ime shoqe tha e qetë: «Po shkoj të të për-

gatit ndërresat. Po të androj dhe një palë çorape leshi të vjetra.» Nëna ime ndërhyri: «Lemi mua xharapet, se i ormis u.»

Pas pak, si mbaruan lajmet, ra telefoni. E mori gruaja receptorin.

— Të kërkon shoku Simon Stefani nga Puka, — tha ajo.

Sic dukej dhe shokët atje në Pukë kishin parë lajmet në televizor si mbarë Shqipëria.

— Caci! — dëgjova zërin e shokut Simon, dhe më erdhi mirë që e filloi bisedën me trajtën intime të emrit tim. — Si ia çoni asaj Tirane?

— Faleminderit, mirë. Po ju asaj ane? — pyeta unë, dulke krijuar kot së koti një dialog me rimë, si e ka zakon një piktor i njohur yni.

— Dëgjo, — vazhdoi ai, — sa po biseduam dhe me shokun Rita Marko dhe thamë që s'po i shohim shkrimtarët. Mirë shtypi dhe Radio-Televizioni po e bëjnë punën e vet, po shkrimtarët ku janë? A nuk do të ishte mirë të nisnit ca shokët këtej? (Si më dëgjon, qartë?) Të jetonin e të shihnin me sytë e shpirtit ç'po ndodh. Ku të gjesh heroizëm më të madh se ky për librat tuaj!

— E drejtë, shoku Simon. Dhe thonë pastaj se nuk ka telepati, — qesha unë dhë i tregova për dy brigadat që do të niseshin në Kukës dhe në Pukë. — Veçse, — shtova unë, — shokët e avacionit nuk qasin dof shumë shokë shkrimtarë në helikopter se s'kanë mundësi.

— Thuhaju të marrin më shumë! Këtu ka ngjallje dhë akte heroizmi për të gjithë. Të fala shokëve! Mirë se të na vini! — uroi ai. Në ritmin e fjalës se tij ka diçka të prerë, por të ngrohtë si prej punëtori.

— Të fala të gjithëve! — thashë unë.

— C'merak që ka Partia, o jetë! — u dëgjua zëri i mëmës sime, që, me sa dukej, i drejtohej djalit tim.

“Ditën e së shpejti, që do t’i kthejë përmes shtatës së mëngjesit, nuk po vinte.”

“Ditën e së shpejti, që do t’i kthejë përmes shtatës së mëngjesit, nuk po vinte.”

“Ditën e së shpejti, që do t’i kthejë përmes shtatës së mëngjesit, nuk po vinte.”

“Ditën e së shpejti, që do t’i kthejë përmes shtatës së mëngjesit, nuk po vinte.”

“Ditën e së shpejti, që do t’i kthejë përmes shtatës së mëngjesit, nuk po vinte.”

“Ditën e së shpejti, që do t’i kthejë përmes shtatës së mëngjesit, nuk po vinte.”

“Ditën e së shpejti, që do t’i kthejë përmes shtatës së mëngjesit, nuk po vinte.”

“Ditën e së shpejti, që do t’i kthejë përmes shtatës së mëngjesit, nuk po vinte.”

“Ditën e së shpejti, që do t’i kthejë përmes shtatës së mëngjesit, nuk po vinte.”

“Ditën e së shpejti, që do t’i kthejë përmes shtatës së mëngjesit, nuk po vinte.”

“Ditën e së shpejti, që do t’i kthejë përmes shtatës së mëngjesit, nuk po vinte.”

“Ditën e së shpejti, që do t’i kthejë përmes shtatës së mëngjesit, nuk po vinte.”

“Ditën e së shpejti, që do t’i kthejë përmes shtatës së mëngjesit, nuk po vinte.”

“Ditën e së shpejti, që do t’i kthejë përmes shtatës së mëngjesit, nuk po vinte.”

“Ditën e së shpejti, që do t’i kthejë përmes shtatës së mëngjesit, nuk po vinte.”

“Ditën e së shpejti, që do t’i kthejë përmes shtatës së mëngjesit, nuk po vinte.”

“Ditën e së shpejti, që do t’i kthejë përmes shtatës së mëngjesit, nuk po vinte.”

## Nisja

E patëm lënë të niseshim në orën shtatë të mëngjesit. Makina e ministrisë nuk po vinte. U interesuam ç’kishte ndodhur. Asgjë, veçse shoferi që do të nisej me ne kishte marrë ose urdhër të ri ose i kish dalë ndonjë hall. Nuk besoj të ishte punë frike. Shoferi tjetër u gjet me vështirësi. Por nuk po gjendeshin zinxhirët e gomave për borë. Sa të gjendeshin zinxhirët, unë u ktheva prapë në shtëpi, të merrja dorezat. (Kur nuk i përdor, kështu harron.) U kujtova për to kur pashë Dritëronë që ia mori një palë të tillë të sojme mikut tim të vjetër, Teodor Laços.

Vajta në shtëpi. I gjeta dorezat. Te pragu i derës nëna më pyeti:

— Po takim a more? — Unë qeshant, — Pse qeshj — tha ajo, — shpirti me shpirtongrohet!

— E, moj zë uruar, — i thashë unë, — tashti vetëm mëzja nia mungon, — Mirë, jeto! Si të duash ti! Sahat i mbarë! u tërhoqi e uroi shpejt nënë ime.

Dhe vërtet, sahati qe i mbarë Shkuam dhe erdhëm si kokrra e mollës. Dhe sa për mezen kur futa dorezat në çantën time të vjetër të gjëologut (deri në Qafë të Buallit nuk m'u deshën), gjeta në të bukë, djathë, vezë të ziera dhe një grusht ullinj të Bregut. I kishte yënë gruaja e dhembshur, pa më thënë fare. Më erdhi për të qeshur përkujdeje të saj, se m'u kujtua buka e mbështjellë, në gazetë që i vihet gjithnjë cunit kur shkon në shkollë. Por nuk ishte për të qeshur. Në Qafë të Buallit ato na vlejtën mjaft. I shfrytëzoi, sidomos, shoferi që na çoi në Dibër, Dashamir e thonë, një ezmer i giatë flokëkaçurrel.

Brigada e krijuesye për në Kukës kishte vajtur, tashmë, në aeroport, pra do të niseshin. Më fund dhe «ekipi» ynë i Dibrës u niş, pasi kishim bërë një okë muhabet për dëborën dhe pa sojat e saj, dhe pasi kishim pirë një çerek duzinë me kafe, nga ato që s'të bëjnë dëm fare përshtëndetin në klubin modest të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve.

### ***Udhëtimi***

...Nga Ura e Milotit në Grykën e Matit fillonte bora tamam. Ajo tashti të impononte respekt. Makina nuk shkiste më mbi asfaltin me dëborë e akull të shkrirë nga frötat e makinave, por lëvizte lart mbi karrahatat apo vëtullat e dëborës. Gu-

rët e kilometrazhit kishin vënë nga një çallmë të ngjeshur bore dhe dukeshin si gurë varri myslimanësh. Pastaj çallmat e tyre rriteshin mbi bazamentin e cimentos dhe të kujtonin ata «njerëzit» prej bore të qiliminjve, që dukej sikur ruanin rrugën. Më tej ata filluan të ziheshin për dorë, dhe nga Shkopeti bashkoheshin të gjithë në një varg të lartë bore, që s'ishte gjë tjetër, veçse mur bore pa fund, paralel në të dyja anët e rrugës. Tashти kurrsesi «Aroja» jonë s'kishtë rrezik të dilte matanë bordurës së rrugës... Ne u siguruam nga gremisjet...

Në Shkopet Dritëroi kujtoi kovaç Hazizin, që tashti ka vdekur, i cili, me dhjetë fëmijët e tij, e kaloi jetën hidrocentraleve (shoferi ynë reciton vjershën e kryetarit të Lidhjes për të dhe çuditet dhe vëtë autorit). Dritëroi vazhdon të tregojë se si u njoft me kovaç Hazizin kur u lëshua uji në turbinën e hidrocentralit dhë qysh në mendjen e tij mbeti jo uji që vërvshonte e shkumbëzonte me inat, por kovaçi i urtë më fëmijët e tij që nuk përbaheshin prëj gjëzimit. Kovaçi më vonë ë bë hero. Por këto i ka shkruar e do t'i shkruaj me siguri përsëri Dritëroi; unë kujtova të shoqen e Hazizit kovaç, që mbahet djepin më foshnjën pranë farkës së kovaçha riës, tek i ndihte të shoqit. Kuptohet, në fillimet e hidrocentralit, kur s'ishte kapur akoma çerdhja për fëmijë, se kantieri ishte kryesisht me burra shumë e gra fare pak. I kishin thënë aherë gruas së kovaçit: «Do të verbohet çuni, moj shoqe!» Ishte përgjigjur gruaja-nënë: «Jo, more shok! Ai kështu merr dritën e centraleve.» Dhe, si përtëqenë konsekiente deri në fund, në këtë të drejtë të saj, më vonë, një vajzë, që i lindi atje, ia vuri emrin Centrale. Ta gjëzojë emrin e bija e kovaç Hazizit!

...Ja tuneli i Fierz-Shkopetit. Gryka matanë duket si ekran i gjërë kinemaje. Tuneli i errët, nëpër faqet e të cilët fanari i makinës zbulon stalaktitet dhe stalagmitet e akullit dhe gryka e bardhët tij që të verbojnë. Disa dhi të paktashfaqen matanë. Kërkojnë ndonjë gjeth të harruar nga murlatni mbi majat e shkurreve dhe çajnë me guxim shtratin e borës. Të ngjajnë si ai që kërkon gjilpërën në mullar të barit. Mündim i kothë. Të shkretat dhi! Nuk di sepse më sjellin ndër mend teatrin e hijeve që bënim kur ishim të vegjël. Me një çarçaf gjithë arna, të varur në një nga bodrumet e pallateve të «Moskatit» dhe me një qiri të vocërr pas çarçafit, lëviznim gishterini të tanë të mardhur dhe krijonim ca figurina nata. Lodra që i kanë harruar fëmijët sot.

... Ia marrim në kthesë. Ulëzës: E lëmë latë, në të majtë dhe e mbajmë vrapin drejt Burrelit.

— Drejt Brukselit! — bën shaka shoferi ynë, duke na zbuluar dhei anën e t'gëzuar të karakterit tervet.

Eshtë shenjë e mirë kur njériu ka humor dhe në të tillë mot. Makinës i vumë zinxhirët. Një histori më vete kjo. Zinxhirëti qenkan tepër të sojmë, importi, dhe duhen kursyer, se ministria i paska blerë, në Athinë me njëqind dollarë! Çfarë nuk dëgjon; qoftë dhei për pünë zinxhirësh të thjeshtë, pa pllaka; zinxhirësi tata, të zakonshmit, që lidhin qentë e stanit, ditën më drekë, në Kurvelesh. Rrotat e makinës qenkan qenër, që duhen lidhur e shtrënguar mirë, në borë me zinxhirë, se ndryshe hanërtëvzotët! Domethënë ne!

Papritur rruga delqe zënë nga një shembje dheu. Pragje të mëdha guri, mbi një metër kub, që s'i lëvizim dot. Atodukën si çar gjatë hu-tuar e të përgjumur, të murmëletë rendë shumë,

që janë shtrirë në rrugë dhe s'dinë të ngrihen. Lëtargji dimërore përtat. Herë pas here shembeni gurë të tjerë. Shenja është e freskët fare, vetëm disa minuta më parë duhet të ketë ndodhur, përderisa përinercinë e grëvitetit bien ende gurë të vegjël. «Mos e nga ariun, se ndryshe të shuan», kujtoj një përrallë dhe largohemi më tej. Presim të vijë edhe ndonjë makinë tjetër, që të shtohemi si brigadë, përtë hapur rrugën...

— Tashti më duket, — méditon shoferi ynë, — se ky dimri i këtij viti po ia bën mat dhe vetë Matit!

— S'është puна te dimri, — ndërhyri Dritëroi. — Jo! Dhe për shembjet e rrugëve dhe për orteqet e sivjetme fajin më të madh nuk ë ka bora, por ne, që po i presim pyjet pa mëshirë. I paguajmë haraçin vetes.

— Kell hak, — mbështet shoferi. — Pyjet duhen ruajtur si sytë e ballit.

— Përpara pyjet mbi udhën e kalimtarëve dhe shtëpitë e fshatit ishin si vakëf. Në Vuno, në fshatin tonë, në kurorën e pyllit të fshatit, ku s'bie borë pothuajse kurrë, janë disa gurë kufiri që u themi qivure. Brenda tyre as dhen nuk futim, dhe jo më sëpatën, — vazhdoj utë.

— Kësaj ane, — sqaron Dritëroi, që e njeh mirë këtë krahinë, — lidhni besë të mos pritej pylli dhe i thoshin turçë itifak!

— Duhet të shkruani përkëtë! — na këshillon me të drejtë shoferi. (Bëri mirë «Zëri i Popullit» që e ngau me artikull të thekur këtë punën e pyjeve dhë ortekëve më 24 të janarit.)

Ne jemi harruar në hallin e pyjeve... Dhe ja, pas nesh po vjen një kope e paktë lopësh dhe një bari. I thërresim që t'i ruhet shembjes. Ai është bërë çakërrqejf. Gati bërtet: «Lopët s'janë merrota, por nuk kambë, e gjunjë shtegun.» Dhe

papritur, si në tym, lëshon: «Mish dhe raki duhet sot dhe i thue plaç dimarit,» Nuk e ka keq me të vetën, po ne s'ia kemi ngenë pér shaka!

Bariu i ka lidhur poturet (një palë kilota ushtarake të dikurshme) dhe këpucët me ca lloj dollakësh tepër origjinalë, me mushama të tejdukshme, ndoshta nga celofoni i serrave dieollore. Ndihma dhe gatishmëria e tij nuk mjaftojnë pér të lëvizur gurët e mëdhenj të rrugës. Ai na lë shëndetin dhe ikën të çojë lopët në theriore të Burrelit.

Tek po largohet, shoferi ynë e kujton:

— Ruaji lopët se mos t'i çan ujku!

Vërtet, në Milot dëgjuam nga shoferët që vinin nga Burreli e Mirdita se «kish plasur ujk i madh».

— Jo, mor dashamir, — ia kthen çobani, me atë epitetin e zakonshëm në të folmen e shumë njerëzve, kurse shoferi ynë hâp sytë e nuk u beson veshëve. Nga e di ky çoban matjan, i panjohur fare, emrin e tij «Dashamir?!» — Jo, — vazhdon çobani i lopëve, duke rrahur fort pëllëmbën mbi vithet e holluara të tyre. — Jo. Këto të uruara janë përcinsanin e jo pér shejtaninoksanin! Dhe ka të drejtë shumë se tashti ngre përpjetë, me të dyja duart, si në ca valle të Ansamblit të Ushtrisë, pushkën që ka me vete. Vettëm tashti e vumë ne që bariu qejfli ishte i armatësuar! Natyriشت, ishte me shërbim.

Project to buy historic residence of Dr. J. P. Morgan from his widow --  
the residence will be given to the city of New York as a public park.

**Patat skandinave**

Më vonë, e sëdomos të nesërmen, në rrashin e Klosit e të Sufit pamë shumë njerez tjerë me armë. Nuk qehë as ushtarë e as çobanë, por gjahtarë që bënин batërdinë në rosa e ipata të egra. Ato të mjerat kanë çarë mes këtij dimri hapësirat nga Skandinavia deri të Kurdaleia (viset e Matit). Janë të lodhura, me pupla shumë e mish pak. Sepse «puplat kanë dhe jatak dhe jorgan», na tha njëri prej gjahtarëve vendas. Ato kërkojnë ushqim në ndonjë prroskë, vijë uji të pangriri. Si ushqehen, ato e dinë, por ku ushqehen, e dinë gjuetarët dhe i qërojnë hesapet me to. Këta gjahtarët i mbajnë cifte apo tekët të mbështjella me pështjellak, apo

futur brenda në trasta si në këllëf. Thua se janë sazexhinj fshati, që mbajnë brenda në to klarinetën apo violinën, të mbrojtur me kujdes nga zborina e acari, që të mos ua zërë bora e lagësht.

Një patë e vrarë, që na treguan, kishte dy unaza metalike, një në këmbë e tjetrën në qafë, E para nga Stokholmi, e dyta nga Magdenburgu. Ku binte ky qytet, që kish diçka të përbashkët me Burgajetin e vetë Matit, gjahtari nuk e dinte. E hodhi kollaj lumin e mosnjohjes së gjeografisë me fjalët: «Ç'rëndësi ka si quhet vendi ku i kanë vu myhirin. Rëndësi ka që unë di vendin ku vriten patat!» Dhe qeshi.

Në rrugë takuan edhe kompozitorin Naim Gjoshi, nga Belshi i Elbasanit, që punon prej dy mbëdhjetë vjetësh në Burrel. Në krah mbante armë gjahu. Ai ka bërë këngën që këndohet «Kush je ti, që më tremb dhentë?» dhe ne bëmë shaka me të (ai pranon shaka) me një epigram dyvargësh «Kush je ti, që grive rosat, Jam Naimi, djalë i Gjoshajt».

Sidoqoftë, unazat e vogla në qafë («si i kanë futur, xhanëm», habitej ai gjuetari i «Magdenburgut»), apo në këmbë të shpendëve polarë duhen ruajtur e duhet njoftuar edhe Muzeu i Shkencave të Natyrës në Tiranë, që të lidhet me ato vise e shtete ku i kanë prangosur të zeztë fluturakë kontinentalë.

## Ortekët

... Vazhdonim të prisnim atje te buza e shembur, anë xhadesë. Filluan të na mardhën veshët dhe rrasëm më thellë kokoret. Kur s'punon në të ftohtë, të hyn tartakuti, ndaj filluan të përplasnim dhe këmbët si në një valle labe, bodrumçe. Pritëm e pritëm dhe më në fund u dukën punëtorët e mirëmbajtjes së rrugëve. Diskush do t'i kishte njoftuar. Këto ditë ata e kanë marrë rrrogën me hak. Si ata kësaj radhe s'ka pasur punë kurkush. Lajnë gjithë rehatinë e të-rë behareve. Pas pak erdhi dhe drejtori i parkut të Burrelit, një djalosh i ri, që emrat na i dinte, po ne nuk e mësuam dot të tijin. Ai kontrollonte rrugën nëse ishte e gatshme për të ka-

luar autobusët me udhëtarë. Shembja që po pastrojnë punëtorët e mirëmbajtjes dhe ne, tok me ta, ia lëkund besimin dhe e leqendis. Nuk është dorëzuar akoma bora as në këtë rrugët e urtë të Burrelit.

Dhe kjo vithisje e dheut këtu, në mes të udhës së Matit, pranë Burrelit, të rikuhton ortekët; ortekët e vërtetë, që kanë vrarë njerëz dhe përlarë gjë të gjallë, që kanë shkulur shtëpi e stalla. Dëmet më të mëdha, ato në njerëz, ne i patëm këtë janar vetëm nga ortekët. Ata janë si tërmeti, nuk ka ç'u bën dora e njeriut. Ata vërsulen si forca të verbra të natyrës. Në rrëthim e Matit, veçanërisht në Martanesh d'he në fshatrat kufi me Mirditën, shokët e rrëthit i larguan nga shtëpitë e veta dhe çuan të bujtnin në fshatrat pranë disa dhjetëra familje. Bujtësit u pri-tën si vëllezër e shkuar vëllezërve. Ata s'qenë muhaxhirë. Ata qenë si në shtëpitë e veta, se e tyrja është gjithë Shqipëria. Dhe u lidhën mi-qësi të reja, krushqi të reja, dashuri të reja. Vëllazërimi i njerëzve duket më shumë se kurdo në hallet e përbashkëta. «Ortiqet kanë punën e tyre, — na tha një plak dibran ca ditë më vonë, — ne kemi tonën!»

Prej ortekëve (dhe vetëm prej tyre) ne patëm gjashtëdhjetë viktima. Vetëm Franca në Evropë pati zyrtarisht mbi treqind të vdekur. Ata që e pësuan atje, nuk i mori orteku, po ngrinë kallkan nga të ftohtët rrugëve, strehëve, të harruar, metrove dhe nënurave. Vdiqën endacakët pa plang e pa shtëpi dhe pleqtë e plakat të vetmuara në dhomat e lakullta pa ngrohje. Të vjen keq, dëshpërohesh shumë për ata që vdiqën dhe turp për Evropën e qytetëruar!

Kujtova ortekët. Shumë shpejt i kujtova.

Më vonë këtë fjalë do ta hasnim përditë. Ortek! Rimon me termek, siç i thonë malësorët e Veriut tërmetit. Mos vallë dhe orteku do të evoluojë një ditë me mbaresën «t» dhe do të bëhet «ortet?» Diçka që do të bjerë në orën tetë, do të mendojnë ata që do të vijnë. Por orteku nuk ka orë. Ai nuk është si orari i trenave, që vjen në këtë apo atë orë dhe të merr. Jo! Ai s'ka as orar as besë. Ai është përbindësh.

Te, nje i qumishevike kur që i zbuluan se gjatë  
kohës së vjetra 1962 është: "Të fshatarët  
që kohës së paktë i që vende me veshje  
i njerëzit që tani i bënë qëndrueshmëri  
më pakë se paktë". Një vjet më vonë, i cili  
merret me një qendrueshmëri e vogël, e  
fshatarët që dëgjoi që vjen e pranishëm  
një vjet i fushitës së dhjetorit. Në këtë vjet  
merret veshi brezi, i cili i ngrënët në mënyrë  
poenë e lëvizjeve, e përfshin edhe veshin e  
vendit. Në vjetin e tretë, që i tregim  
merret me veshin e brezit. Në këtë vjet

merret veshi brezi, i cili ka një kujdes  
e madhi për veshje, i cili çon se veshja  
merret me veshin e brezit. Në këtë vjet,  
merret veshi brezi, i cili ka një kujdes

e madhi për veshje, i cili çon se veshja  
merret me veshin e brezit. **Tregimi i këtij brezi**, i cili  
merret veshi brezi, i cili ka një kujdes  
e madhi për veshje, i cili çon se veshja  
merret me veshin e brezit. Dhe në vitin  
1967, kur në dhjetor rata të  
merret veshi brezi, i cili ka një kujdes  
e madhi për veshje, i cili çon se veshja  
merret me veshin e brezit. Më  
merret veshi brezi, i cili ka një kujdes  
e madhi për veshje, i cili çon se veshja  
merret me veshin e brezit. Në këtë vjet,  
merret veshi brezi, i cili ka një kujdes  
e madhi për veshje, i cili çon se veshja  
merret me veshin e brezit.

Erdhën fshatarët e i nxorën në mengjes, kur  
panë dhe s'u besuan syve që shtëpia nuk bënte më  
hixje mbi dhe. Fshati pati për një natë një shtëpi  
më pakë se tetë frymë mangët. Të tetë i nxo-  
rën nga varri i borës, të tetë ishin të vdekur.  
Vetëm njëri mungonte, i zoti i shtëpisë, që është

natë nuk ndodhej aty, se kishte vajtur për një sebep gëzimi në Kukës.

Bashkëfshatarët i bënë gati xhenazet,<sup>1</sup> por s'mund t'i futnin në dhe pa u ndarë me ta dhe i zoti i shtëpisë. Vendosën të prisnin nikoqirin. Fatkeqësi më e madhe për një njeri s'ka si bëhet. Tetë të vdekur në një derë: grua e fëmijë bashkë, më të shtrenjtët njerëz të tij. I la shëndoshë e mirë e tani po e prisnin në tabut.

Vajtën dhe e morën burrin fatlig. I thanë për ç'i kish ngjarë, nuk besoi. Erdhi. I pa! U pataks! U shushat iu drodh keqas buza e mjekra nga dhembja, por lot nuk nxori.

Burri i fortë di ta mbajë veten. Dhe aherë, kur i dridhej buza, tha vetëm këto fjalë: «Të më ruajë zoti, të mos më luejë mendja e kresë. Miqtë shëndoshë!»

Dhe burri qëndroi e mbeti burrë. Nuk e ruajti zoti mendjen e tij, por forca e tij e rrallë dhe përkrahja e shokëve dhe e miqve. Dashuria për jetën.

Dhe për inat të ortekut dhe të vetë perëndisë ai ngriti përsëri shtëpinë e re në anën tjetër të malit. U martua rishtazi, jo nga qejfi, po nga halli, që fisi i tij të mos shuhej. Thonë se tash-ti ka fëmijë të tjerë me bark tjetër. Dhe e bën përsëri jetën, atje ku ish, në vendin e vet, në fshatin e vet.

### *Qafë e Buallit, qafë e keqe!*

Më në fund arritëm në Burrel. Në të hyre të tij marrim me vete dhe poetin e ri Kudret Isaj.

Plakut Pjetër Buđi (bustit të tij), të kopshti i rrallë botanik i Burrelit, bora i ka arritur dëri në mes. Gurabardhi, fshati i tij i lindjes, është izoluar. Vërmia e rrallë e Pjetër Buđit të fut në shpirt një trishtim të ftohtë.

Ruga Burrel-Peshkopi është e zënë, nuk ka lohet. Ajo ka një thember Akili, Qafë e Buallit. Atje thonë se është mbretëria e erërave, të tjerë thonë «Drejtoria Qëndrore e Erërave». Kur vajtëm atje, u binda që ishte qafë e ciklonëve. Shpejtësia e erës, që ngre borën e vthatë dhe e përplas këtu si rrerën në shkretëtirë, duke formuar sope si male bore, është 100 kilometra në orë. Kám provuar e jam rrahur e kam mardhur nga erë me bore, nga erë me shi, nga erë me rërë e dhë, por këtu rrithesh e mpihesh nga erë me cifla akulli, njësoj si me cifla stralli. Këtë s'e kisha provuar dhe ja érdhi dita që e mësova çështë në Qafë të Buallit. Nga Dibra rrugën përpinqen ta çajnë dibranët, kësaj ane matjanët.

Dhé ja kështu, zhyt-mbyt në déborë, ne çajmë tashti përatje tok me sekretarin e parë të Matit, shokun Zyliftar Durmishi. Meqë jemi njérëz të letrave, nuk i rrifihet pa ardhur me në dhe shokut Kastriot, sekretarit të propagandës. Matanë Qafës së Blallit po përpinqet tok me shokët e Dibrës të çajë dhe shoku Vangjel Çërrava, sekretar i KQ të Partisë, që po punon tashmë disa ditë në Dibër, për të ndihmuar nga afër.

Kemi marrë me vete dhe një tufë fletë nderi, përatë që po dallohen për trimëri e guxim në Qafë të Buallit. Ato janë të paplotësura. Doti plotësojmë në vend. Rrugës, përmbi Plan të Bardhë, takojmë «Tatrën» me rruspëçeliku, që rrafshon borën. Shoferi paska dyzet e tetë orë pa zbritur nga makina.

— Ndaloje! — urdhëron Zylyftari shoferin: — Ta pjetkim një çikë këtë shokun e «Tatrës», — na drejtohet neve.

Zbresim: E takojmë. Thérresim fort. Era, s'lë lë të dëgjohesh.

— A je lodhë? — pyesim ne.

— Nga pak, shoku sekretar, — përgjigjet ai,

— Po ju burra?

— T'i japim një fletë nderi, — kujtohet dhe vendos në çast Zylyftari.

Frym erë e rreptë, inatçeshë e madhe. Detyrohem të futem brenda në gaz dhe shkruanj: «Shokut... (nuk ia di emrin shoferit, atë le ta plotësojë Zylyftari ose Kastrioti që e njohin), përguxim e vetëmohim, për shpirt luftarak e frymë të lartë mobilizimi në mposhtjen e rrebeschëve të borës, në çarjen e rrugës te Qafa e Buallit. Mat, 15 janar 1985.

Ia jap Zylyftarit dhe kësisoj e firmos vetë sekretari i parë i rrethit. Ky motivacion i improvizuar në murlan do të shërbejë dhe për traktoristët e tjera, punëtorët e rrugëve, të ndërlidhjes dhe të policisë. I njëjti motiv, i njëjti heroizëm; por do t'i ndërrrohet vetëm dita dhe vendi, guri i provës së madhe të tyre.

Dhe herë pas here do të lidhet me fjalët:

— Të çahet Qafë e Buallit!

— Të çahet Bulqiza!

— Të çahet Batra!

— Të çahet Martaneshi!

— Të çahet Gurët e Skënderbeut!

Makina jonë s'ecën dot më. E lëmë dhe, me këmbët që me zor i komandojmë, arrijmë në pikën kulmore të Qafës së Buallit. Tek etim nën dritën e projektorëve të traktorëve, për habinë time kujtoj pse quhet Qafë e Buallit. Kësaj ane buaj e bualica s'ka. Këtu s'është Myzeqe më

gjole e këneta të djeshme. Në mal të Çikësë e shëtë Maja e Qorres, që paska dalë se ka mbetur e harruar atje një dele qorre. Ka dhe Qafë të Gomares gjetkë, se ka shkarë e rënë gomarja në të. Zor të ketë rënë këtu bualli, kur vendi nuk e njeh. Kam përshtypjen se çobanët dibranë, që e njohin mirë Shqipérinë, tek kanë parë tèrbimin e kësaj Qafe në dimër, kanë kujtar inatin e buallit dhe i kanë yënë këtë emër. Megjithëse, të them të drejtën; po të ishte për punë inati, duhej t'ia vinin Qafë e Arikut. Ndoshta, në lashtësinë e mesjetës së hershme, para Buzukut, për arbrin e këtushëm, si bualli si kau, ishim një. E sa për qetë, Dibra ka boli. Do parë g'hotë i urti Buzuk, në «Mesharin» e tij. Mbaj mend që ai përmend magjarin e Krishtit, por kaun e përmendës dhe buallin e qerres sikur s'i ka. Me siguri Frang Bardhi me fjalorin e tij mund të na sqaronë tamam, por në Qafë të Buallit fjalor të tillë s'gjen dot.

Era na ka çarë ibuzët, na ka verbuar sytë. Futemi të marrim një afsh zjarr nëndërtesën e peshores së kromit. Takoherëmi me disa traktoristë. Këtu punojnë tëtëmbëdhjetë traktorë, por disa janë prishur, kurse të tjerëve ose u janë djegur llambat e fenerëve ose kanë ardhur fare pa driztë dhe s'punojnë dót natën. Janë pikërisht të zotët e tyre, këta traktoristë, që hasim rrëth porit me zjarr në peshore.

— Sikur të mos kishim këtë bablokun këtu (ai tregon zjarrin që bubullon); do kishim dalë me tabut këndeji! — thotë njéri prej tyre.

— Mos e thuej njat llaf, — ia pret tjetri, — se ne dhi tabutet i kemai djegë fashhti.

Vërtet. Këta kanë djegur këtu çdo lloj druri e shkurreje, jo më tabutin e vdekjes.

Pas pak këta burra të rinj e të fortë do të

ndërrojnë shokët që punojnë me traktorët me drita. Të shkonte mendja që tetë traktorët që punonin, me uturimën e tyre, do ta mbulofin ulërimën e murlanit. Hic! Tashti dëgjohet vetëm murlani. «Cikloni», thotë njëri nga traktoristët. Ata ngrihen, na japijn dorën dhe thonë:

— Po shkojmë me grahë buldozët. Tun gjatjetat!

Çfarë s'dëgjon këtu. Na tashti dhe shkurtimin e papritur gjuhësish të buldözerit. Buldoz! Thua se po shkojnë t'u hipin e të çajnë borën me baldosat!

Telefoni me Bulqizën ka një orë që s'punon më. Diku është këputur filli. Alo, Peshkopia! Alo, Bulqiza! Sinjal s'ka! E pra, vetëm një kilometër më tej duhet të jenë shokët e Bulqizës me shokun Vangjel Çerava në krye, që përpiken të çajnë e të häpin rrugën drejt Burrelit. Atje me ta është dhe shefi i shtabit të borës për Matin. Bora e meriton shefin e saj. Një fjalë e urtë e ketyre viseve thotë se «të kujt janë berrat, e atij është dhe bjeshka».

Këtu, në Qafë të Buallit, bora formon së pë e pirlje të mëdha deri tre-katër metra trashësi. Duhet të hipësh mbi kabinën e traktorëve, që të shohësh se ç'bëhet matanë rrugës. Ti e pastron tashti borën me të gjitha mjetet dhe për pesë minuta ajo zihet prapë. Në Qafë krijohet një «tapë» masive bore që s'hiapet kollaj. Sapo rruga çahet matanë, s'kalojnë as dhjetë minuta dhe na thotë dikush, një zë që s'kuptohet i kujt është, një zë prej bore, se rruga prapë u zu. Prapë luftojnë ta hapin, si Kalanë e Rozafës. Këtu mund të përdoret tamam fjala që thotë që «çfarë nuk e sjell moti, e sjell sahati, e çfarë nuk e sjell sahati, e sillka dekika!»

“Ditën e sotme qëndrosh, jo më tashmë nuk kemi  
mbushur më shumë se 50% e përgjithshëm të  
përgjithshëm, por qëndrosh, jo më tashmë nuk  
kemi mbushur më shumë se 10% e përgjithshëm.”

“Ditën e sotme qëndrosh, jo më tashmë nuk kemi  
mbushur më shumë se 50% e përgjithshëm, por qëndrosh,  
jo më tashmë nuk kemi mbushur më shumë se 10% e përgjithshëm.”  
Sipas Zdravka Todorovit, qëndrosh është përgjithshëm, jo më tashmë  
nuk kemi mbushur më shumë se 50% e përgjithshëm, por qëndrosh,  
jo më tashmë nuk kemi mbushur më shumë se 10% e përgjithshëm.”  
Sipas Todorovit, qëndrosh është përgjithshëm, jo më tashmë  
nuk kemi mbushur më shumë se 50% e përgjithshëm, por qëndrosh,  
jo më tashmë nuk kemi mbushur më shumë se 10% e përgjithshëm.”

**Traktoristet e brazdave të akullit**

“Ditën e sotme qëndrosh, jo më tashmë nuk kemi  
mbushur më shumë se 50% e përgjithshëm, por qëndrosh,  
jo më tashmë nuk kemi mbushur më shumë se 10% e përgjithshëm.”

“Traktoristet ‘ë ndërruar, si njerëz prej bora,  
vijnë në dhomën e vogël të telefonit të peshores! Piqemi me ta dhe ata ngrohen nga fjalala e  
ngrohtë dhe nga zjarri.”

“Kastrioti pëlton në fletët e nderit emrat e  
atyre që shquhen në këtë luftë, me plot gojen  
luftë, mbi të tjerët.”

“Vëri të gjithë! — thotë Dritëroi. — Këtu,

Dhe shokët sekretarë të Matit nuk tregohen  
dorështrënguar në fletëlavdërimet. Dhe mbushen  
ato me emra nga gjithë krahinat e Shqipërisë.  
Deda i SMT-së së Matit, Dashamiri, traktorist

Halili i Dibrës, Pali i ndërlidhjes, Ndueja i Mirditës. Hasani traktorist, shoferi i Fierit, Vangjeli i Fierit. «Shih se mos është i Beratit ky shoku. Mos harroni buldozeristin e bonifikimit të Beratit. Ai është burrë i zoti dhe ka bërë punë fortë pastër», thotë Zlyftari.

Unë kujtoj dhe një inxhinier të Gjeofizikës së Fierit, që sapo e kisha hasur me traktoristët e tij në furtunë dhe shqota s'na linte të njihnim njëri-tjetrin, veç nga zëri. Ai kishte hedhur shallin kokës si bokshanë gratë e Bregut dhe mbi të kishte kasketën si shoferët e Dhërmikut. Shalli i mbronte qafën dhe sytë. Gati veshje e beduinëve të shkretëtirave. Sillni ndër mend shallin e famshëm të Jaser Arafatit, dhe thoni tamam ai! Gjynah që s'dallohen kështu këta djemtë e Gjeofizikës së Fierit dhe në punët e naftës...

Bisedojmë dhe urojmë shokët traktoristë për punën e madhe. Përqafohemi dhe ndahemi me ta. Rruga e Bulqizës vazhdon të jetë e myllur. Ne s'çajmë dot më tej. Kthehem i mbrapa. Na shogëron dhe na rreh era si me tupan alarmi. Erë dhe vetëm erë. Borë dhe vetëm borë. Peizazhi përreth me ndriçimin e fenerëve të traktoreve, me murlanin dhe cingërimën e borës së thatë si xham kristali i thyer, të kujton peizazhet hënore.

Kthehemët në Klos, që tashti është bërë me emër si limeri i autokolonës së madhe, që pret atje të hapet rruga, e të marrë lejen nga kontrolli rrugor për t'u nisur për Peshkopi.

Duhet pritur sa të qelet më në fund rruga. Njerëzit në Qafë punojnë natën pa pushim.

Arrijmë pranë Qafës e Buallit, që konsiderohet Brinjal e Shqipërisë. Arrijmë përsëri në qytetin e Vlorës, që është qyteti i dytë më i madh i Shqipërisë. Në qytetin e Vlorës, që është qyteti i dytë më i madh i Shqipërisë, nuk ka gjithashtu një qytet i madh, por qyteti i dytë më i madh i Shqipërisë. Në qytetin e Vlorës, që është qyteti i dytë më i madh i Shqipërisë, nuk ka gjithashtu një qytet i madh, por qyteti i dytë më i madh i Shqipërisë.

Në qytetin e Vlorës, që është qyteti i dytë më i madh i Shqipërisë, nuk ka gjithashtu një qytet i madh, por qyteti i dytë më i madh i Shqipërisë. Në qytetin e Vlorës, që është qyteti i dytë më i madh i Shqipërisë, nuk ka gjithashtu një qytet i madh, por qyteti i dytë më i madh i Shqipërisë.

**Të nesërmën, nisemi përsëri**

Qafë e Buallit qenka hapur natën vonë. Nisemi qëmienatë, që të mos detyröhemi të kthehem prapë, që të mos na zihet rruga përsëri.

Po na harxhoben zinxhirët. Arrijmë pranë saj dhe Qafë e Buallit përsëri është e zënë. Po na humbet durimi, Hej, bela! Është një baticë dhe zbatisë e çuditshme e borës, aspak ritmike si ato të detit. Kjo baticë-zbatisë herë e hap rrugën (nuk hapet vetë, por nga njerëzit tanë) dhe herë e mbyll (këtu po, është meritë e zonjës borë)!

Është ditë me diell. Autokolona, me kokën pranë Qafës e me bishtin diku shpateve të Plantit të Bardhë, ecën avash. Njëzet a tridhjetë makina, pa rimorkio, se nuk përdoren dot ato

në këtë udhë të ligë, duken sikur po shullëhen në diell. Rrugës ka shumë rimorkio (bile dhe makina) të lëna janës saj. Autokolona është ngarkuar me miell, me karburant, me qymyr, me dru dhe me ç'të duash, deri dhe me cigare dhe kafe. Cigaret janë siguruar në një makinë-frigorifer! Çfarë s'bën vaki tashti!

«Aros» sonë me vështirësi i lëshohet rruga. Padashur bëhemë dispeçer të rrugëve. Dhe përsëri thembra e Akilit, historia e vjetër (deri kur kështu?), rruga është zënë në Qafën e Buallit. Ajo nuk kalohet kurrsesi me mjete. Shtabit matjan i borës na thotë: «Prisni! Koha është e mirë dhe rruga për dy-tri orë do hapet!»

Ne s'presim dot më. Kjo rrugë po na turpëron, në Bulqizë na presin. Vendosim të lëmë makinat më këtë anë dhe të çajmë me këmbë matanë, të paktën deri te ndërtesa e doganës. Më tej, nga Bulqiza e tutje, na thonë që rruga është e hapur. Dogana është ajo ndërtesa e mikrolaboritorit të cilësisë së kromit të Bulqizës dhe Batrës. Shoferrëve tanë u lëmë bukën dhe çantat tona. Sido që të ndodhë, ata të jenë me barkun plot. Ata bashkohen me shoferët e skodave të autokolonës, dhe qajnë hallin tonë, si do ta çajmë vallë borën më këmbë. Ne qajmë hallin e tyre, se do të mërdhijnë keqas në kabinat e makinave. Jashtë makinës s'qëndron dot se të pret kokën era. Pór atë nuk i shua jhë motorët, i mbajnë ndezur. Po e fike tashti motorin, puthu më Milon, nuk e ndez dot më. Ndahemë dhe më shokët e Komitetit të Partisë të Matit, të cilët n'a qetësojnë: «Mos kini merak për shoferët! Edhe po nuk u hap rruga, i sigurojmë ne!»

... Përsëri erë, stuhi, borë, cingor dhe bardhësi që të verbon. Detyrohemë të ulim llapushet, e

kokoreve, mbërtuhehem i shtrëngohemi mirë dhe ecim ngjitur fare, pranë njëri-tjetrit, si vëllezërit siamezë. Unë me gozhup, shoferi dhe Dritëroi, si plaku Mere i «Njeriut me top», me «xhyben e dervishit». Kudreti me grupin e mjekëve të rinj të Ministrisë së Shëndetësisë na bëjnë nder duke na lënë të çajmë borën. U bëj shenjë me dorë të dalin përpara.

Nuk bëmë as dyqind metra, që të duken si dyqind kilometra, dhe hasemi me shokët e Dibrës. Ata kanë dalë të na presin. I kanë njoftuar matjanët. Domethënë telefonat punojnë. Gjatë natës edhe telat qenkan lidhur.

S'kemi kohë dhe as mundësi të bisedojmë. Rrokim duart dhe çajmë, vetëm çajmë përpara. Bora na përplaset brisk në fytyrë. Të zihet fryma. Ndaloj një çast dhe aherë Rakipi, djalë i rritur maleve të Dibrës, që ia di hilen rrebeshit, më thërret rrëzë veshit: «Kthejeni kryet në drejtim të kundërt me erën!» Një fjalë goje! Sapo e kthej kokën, nuk shoh dot përpara. Dhe në borë, po nuk pe ku hedh këmbën, të merr dreqi. Unë bëj t'i them që kam çarë dikur Polin e Veriut në minus pesëdhjetë gradë! Bëj t'i them, por s'ia them dot, se copat e akullta të borës të zënë fytin. Mirë që kam hequr vjet, në «pleqëri», bajamet, se me këtë akull që kam thithur, do të ishin tërbuar sa të më hanin dhe mua tashti. Ec, Anastas, i them vetes. Ecim dhe s'ndalojmë (jo si në këngë).

Më në fund mbërritmë në doganën e Qafës së Buallit, Në të djathjtë na e bën me sy peshorja, mikesha jonë e mbrëmshme. Futemi brenda. Shkundim gozhupët dhe kokoret. Ato kanë ngirirë dhe mezi hiqen nga trupi. Pas pak akulli prej tyre shkrin pika-pika. Sikur shtrydhen lëveret e lara. Dhe neve na ngrohet gjaku. Zjarri në

sobë këndon. Shoh sahatin tashti që lirova dorën nga dorezat. Nuk paska kaluar as një orë nga minuta kur i lamë makinat.

— Kallkanosëm. Më keq se në Devoll, — thotë Dritëroi.

Na erdhi gjuha dhe humori.

— Ç'do gënjejmë kur të kthehem, — them unë.

— Kemi të drejtë, — më mbështet njëri nga mjekët e rinj.

Dhe, vërtet, padashur mund të gënjesht. Ke bërë një kilometër rrugë dhe të duket sikur ke ecur një javë në mes të murlanit apo të ciklonit, siç thonë djemtë e sinoptikës. Si të doni ju.

Hipim në makinat e Dibrës dhe nisemi. Një djalë që udhëton me ne është nga Kuçi dhe aty për aty stisim, pa e kuptuar as vetë, një këngë, që perifrazon diçka atë të Grykës së Kuçit. Po ju pëlqeu, dëgjojeni:

«*Qafë e Buallit, qafë e keqe*, — fillova unë,  
*Plot me gracka dhe me leqe*, — shtoi me shaka Dritëroi.

*S'na qëllove me dyfeqe*, — pasoi ai i Kuçit.

*Po me acar e orteqe*, — ia preva unë.

*Qafë e Ujqet, qafë e dreqet*, — futet shoferi në valle,

*Qafë e Buallit, qafë e keqe*,» — vulos Kudreti këngën.

Kaq. Dhe kështu, me këngën më të re të kësaj qafe, i afrohemë Bulqizës.

Kemi lënë pas Planin e Bardhë. Qafën e Buallit dhe udhëtojmë drejt Fushë-Bulqizës, Gurëve të Skënderbeut, Urës së Qytetit, Valikardhës dhe Malit të Voles. Të gjitha këto toponime

lidhen me një «etimologji», me luftërat e Skënderbeut.

Mjafton edhe vetëm një udhëtim si ky, që ta marrësh me mend pse Skënderbeu u bënte pritë osmanëve pikërisht këtu, në këtë grykë. Ai e dinte dhe e njihte mirë gjeomorfologjinë e kësaj ane. Ndaj pajtohem, për këtë rast, që ai mund të ketë qenë edhe dibran.

Dhe meqë jam këtu, në trojet e lashtësisë, dua të mos gaboj që të them atë që më thanë mjافت matjanë se Plani i Bardhë, fshati i bukur, nën Qafë e Buallit, u quaka kështu meqë në të bënte planet e veta të bardha, të suksesit, vetë Kastrioti. Nuk besoj dot. Pranoj që ai mund të jetë dhe matjan sa është dhe dibran, po Plani i Bardhë duhet të jetë patjetër nga një Plang, ku ka rënë «g», gjë e zakonshme në shqipe, dhe mbeti Plan. Kurse i bardhë se ai gjithnjë kështu është: në dimër nga çatitë mbuluar me borë dhe në verë nga shtëpitë e bardha në sfondin e kuq a të murrmë të magmatitëve. Qafë e Buallit është dhe qafë e kromiteve. Merreni si hipotezë, por kam të drejtë!

Dhe vetëm për një gjë sa vjen e më shumë po bindem, si për një aksiomë që s'ka nevojë të vërtetohet dhe që e them plot gojën si ai në atë këngën «Topi bam, e Muçua tutje!», po qe se Skënderbeu s'është as dibran e as matjan, por hasjan a krutan, beteja e Torviolit është zhvilluar se s'bën kësaj ane. Përderisa këtu ka një Kala të Voles, pra në lashtësinë mesjetare latine një Torre të Voles, që shqipja e shkrin dhe e bën Torviol ose **Torvol**, pse ta kërkojmë aherë këtë fushë lufte të bekuar krahut të Domosdovës, apo se duhet, siç thotë emri i saj, domosdo, atje!

Nejse, boll më me historinë, le të flasim për hallet tonë sot. Në Bulqizë takojmë minatorët.

Nuk ka nevojë të prezantohemi si një pesëmbëdhjetë-njëzet vjet të shkuar, kur bënim takime me lexues këtu dhe qendra e zërit gjëmonte: «Në qytetin tonë kanë ardhë shkrimtarët... Moi humbni rastin me i takuel!» Jo! Ata na njohin dhe shumë prej tyre i kemi miq të vjetër. Puset e prodhimit janë blokuar nga akulli. Zona «D» nuk punon. Shumë minatorëve u ka zënë në fshat bora rrugën dhe s'kanë ardhur. Për janarin nxjerrja e kromit do të jetë larg shumë nga plani. Ata janë të shqetësuar pér borën, por shqetësohen dhe pér kromin.

„Ndoshta, po të hapet ndonjëherë tuneli në pér Qafén e Buallit, që nuk është ëndërr a utopi shkrimtari, por nevojë që do ta zgjidhë koha jorë, aherë dhe prodhimi i mineralit s'do të blokohet si tashti, në mos që do të shtohet disa herë dhe njerëzit s'do të merohen kështu si këtë dimër me të! Aherë, pa merak, mund t'i themi asaj: «Plaç, moj Qafë e Buallit, se ne jemi marshallah!»

Tek këmbejmë llafim e duhanin, sa pimë kafen me minatorët dhe shohim dhe pallatin e kulturës, pas dy orësh në Bulqizë vjen autokolona e madhe që lamë shpatit perëndimor të Planit të Bardhë. Me ta është dhe makina jonë me targë Tiranë dhe me shofer Dashin në timon.

— Ia hudhëm! — na thotë ai i gëzuar. Thua se ua hodhi të dy poleve bashkë, të Veriut dhe të Jugut.

## Ditët dibrane

Peshkopia, vetë qyteti, është vend i bukur. Edhe kur është minus tetëmbëdhjetë gradë, atje s'të pret tartari e ngrica e ftomës. Qyteti i Peshkopisë s'ka erë fare, Peshkopia s'ka suferinë, Peshkopia s'ka rrëbeshe thëllimi. Atje vendi është i mbrojtur mirë nga të gjithë «trëndafilit» e erëravë. Ata që e kanë ndërtuar aty, të părët, kanë qenë njerëz të mençur, që e kanë ditur ku është shfrojera dhe ku është limeri i murlanit. Kanë qenë njerëz që ia dinë mirë hilet dhe inatet motit! Pa diskutim kanë qenë shumë më të zotë sesa ata që ndërtuan qytetin e Bulqizës, përdërisa janë si dy zona të ndryshme, klime. Peshkopja vënd i mbarë është Bulqiza e rë, fort e prapë përmotin e vet. Këto ditë prove të një vendi duhet t'i bëjnë dhe urbanistët të korrigojnë vete!

Sa qemë në Peshkopi, vajtëm edhe në Blatë, në postën e kuffirit dhe takuam ushtarët e rimj. Kënduam me ta këngët e tyre. Burrë më i zoti përkëngët doli Dritëroi.

Tëk këndojuam «Zjarret që ndezi Partia, Prushë e flakë i mban rinia», pyes komisarin si quhet ai që ia merr këngës («Gramozë» e thërrësin), po ai që ia skthen («Erzen», më përgjigjet komisari). Nuk vazhdoj më gjatë me emrat e djemve. Këtu takon gjithë gjeotoponiminë e Shqipërisë, sepse vetë ata janë ushtarë të ardhur nga mbarë krahinat e Republikës. Njëri prej tyre qen ka nga Ersekë dhe paska mbaruar shkollën e mesme bujqësore në Korçë. E pyeta në e kish parë atë pemën unikale të dafinës së butë, të sjellë nga Stambolli; në Cerckë, pranë Leskovikut. Nuk e kishte parë, që nga fshatrat e Dishniciës, I thashë që sikur secili prej tyre të mbillte

këtu, në fshatin kufitar, pemë nga më të bukurat e llojeve të krahinave të tyre, aherë do të bëhej këtej një zabel për merak, më i larmishëm dhe sesa pylli dekorativ i Burrelit. Dhe kur të rriteshim e të bëheshin gjyshër, do t'u thoshin nipërve e mbesave, kur të binte udha këtyre viseve a kur të vinin enkas nga malli për to: —

— Ja, kjo është pema e Gramozit, kjo është e Erzenit... Kurse kjo këtu është ajo që kam mbjellë unë. Mirë?! — Xham fare, — më dhanë të drejtë. djemtë kufitarë.

Ne u kënaqëm me ta. E harruam dhe borën dhe të ftohtin. Filluam ta ndienim veten të rinj si ata. Biseduam me ta si baballarë me djemtë tanë. Kishim mall të dyja palët. Na gjëzoi biblioteka me librat e fërkuar mirë nga duart e tyre. Lexonin shumë. Pëlqyem rrugullin në fjetore. Pastërti nga mund të marrin 'shembull hotel-xhijtë tanë. Ata kishin hapur me krahë rrugën deri në kufi. Sopet e borës anës saj deri në kufi shkonin. Matanë tij, rruga s'dallohej, kishte vetëm shtuat bore me gjurmë lepujsh dhe dhelprash. U njohëm me historinë e pasur të postës dhe tha më me bindje, jo t'ju bënima qeifin, që kësaj historie do t'i shtoheshin dhe trimëria e sakrificat e tyre më këtë vit të borës.

Ushtarët pukjanë dhe kuksianë na thanë se kishin marrë lajm nga shfëpia dhe të afërmët i kishin mirë. Kufitarët na falënderuan që s'i harruam dhe ata në këto ditët dibranë dhe shtuan, si me turp, se e udhës do ishte që, përvèç meshit t'u shkonin herë-herë dhe shkrimitarët e piktorët e Peshkopisë. U kthyem nderet e urimet dhe, kur u takuam me djemtë dhe burrat e artit dhe letërsisë në Dibër, u thamë dhe këtë vërejtjen e dëshirën e mirë të kufitarëve. Duhej që më të gjallë e më të shkathët të tregoheshin ata në këto

ditë të hallit. Të mos prisnin kur të kujtoheshin të tjerët për ta.

U ndamnë me djemtë e kufirit si me çunat tanë.

Rinugës përnë Maqellarë, kooperativë nga mëtë mëdhatë e vendit, shohim vetëm të rinj, vajzë e djem, që thyejnë monotoninë bezdisëse të borës. Vetëm ata janë që e gjallërojnë këtë hapësirë të zbardhëlleme. I sheh mbi çati shtëpish dhe shkollash tek pastojnjë (na thonë) për të tre-tën herë jastëkët e borës. Duken pak të çuditshëm atje majë çative për sytë tanë «kryeqytetas» dhe mua, më kujtohet fëmijëria, kur hipnim kështuçative tona, jo për të hequr borën, se atë pothuajse nuk e njohim fare nga brigjet tona, por kur zihej oxhaku, fogollari, siç i themi në në fshatin tonë, njëloj si arbëreshët e Italisë. I sheh ata të rinj me qerre ngarkuar me bar, e silazh përlopët. I sheh të ngarkuar vëjtë me lakrat, e mëdhë, që mezi shkulën nga bora. Fusha në këto lakra të mëdha të mbuluara nga bora ngjan me një furre të gjere nën qill mbushur më saqë dëbore ose po deshët dhe si fushë «beteje» mbuluar me mburoja dëbore.

I sheh vajzat dhe djemtë si amvisojnjë të sigurt stallat. Të nesërmen, në Plenumin e Jashtëzakonshtëm të Partisë të rrëthit, mësuam që barinjtë e rinj dhe stalleret e rëja këto ditë kallkani e acari kanë punuar ditë e natë, me nga tri ndërresa. Asnjë dështim të mos kemi në këtë mot të lig. — kjo qe nisma e tyre. Lumata viçare ata qengja për këta kujdestarë që kanë.

Të rinjtë hapin rrugët. Të rinjtë sjellin shtypin. Ata bien dhe bukën nga furra. Ata janë kudo, ku duhet vrulli dhe mendja, shpirti dhe krahu i tyre. Kur i shikon kështu të papërtuar, të kudondodhur, të zgjuar e që dinë t'u dalin mba-

në të gjithave, thua me vete «Sipas vendit dhe kuvendi!». Janë situatat që kalojnë që i bëjnë të tillë?! Po edhe jo! Sepse këta e kanë fituar tashmë edukatën e punës, të vështirësive dhe të dëborës. Çështja është që llavën e magmës së vullkanit të heroizmit të tyre ta bëjmë të lëvizë në çdo kohë e mot, të mos ngurtësohet për asnje çast. Çështja është që jo vetëm halli, por edhe malli t'ua japë këtë forcë organizuese shëmbullore këtyre djëmve e vajzave si topa dëbore, të bukur si moshë e tyre, të shëndetshëm sa t'u thuash gjithnjë «Marshallah e plastë syri i keq», që kaq të njomë koha jonë i ka rritur e bërë të pjekur si baballa-rët e nënët e tyre.

Në zyrat e Maqellarës na kënaqi shpirtin sekretari i byrosë së partisë me punën e kujdesin që bëhej atje, sidomos për njerëzit dhe blegtorenë. Ata i kishin marrë me kohë masat dhe dimrit ia kishin, vënë kufirin të thana. Asnjë njeri të sëmurë, asnje dështim.

Kam frikë se nuk do të më besoni, por është interesant fakti që më pak se kurdo të sëmurë pati këtë muaj në Dibër e gjetkë. Është mobilitimi i qelizave dhë indeve të organizmit që e përballon këtë mot — do të thoni ju. Ashtu është, por është mbi të gjitha kujdesi i Partisë.

Jo larg, por sot në mëngjes herët, para se të vinim, në këto fshatra, tek bisedonim me sekretarin e parë të rrëthit, shokun Faik Kopaçe për shqetësimet e ditës dhe itinerarin tonë, Komiteti Qendror i Partisë interesohet për hallet e rrëthit. Mori një telefon dhe biseduan me shokun Ramiz Alia dhe përsëri ai (për të satën herë vallë Partia) na porositi, me atë zërin e ngrohtë dhe të afërt prej vëllai, që bëhej më i ngrohtë në këtë açar, e thëllim: «Bëni kujdes mbi gjithçka për

njerëzit. Mos harroni dhe kromin, se dhe ai përnjerëzit na duhet.»

Në Bulqizë minatorët përpinqeshin të kapnin planin. Kishin mbetur shumë mbrapa me prodhimin, jo vetëm për faj të motit, por dhe të kusureve të organizimit e drejtimit. Bora vërtet mbulon gjithçka, por zbulon e u heq jorganin atyre që s'mendojnë me kohë për të.

Pamë e dëgjuam shumë shokë në Dibër, blemë shumë tregime e histori. Disa të pakta po juarrëfej kësaj here:

90. *Schistosoma mansoni* Schist. 1851 se divide em:

shokësh. Në këtë mënyrë, qëndrueshmërisht, nuk ka një vlerë e madhe që s'kishte qenë atë fshat. I thanë se e shumta përnjë orë arrinte atje. Fshatarët vendas i thanë përdhjetë minuta nga xhadeja e madhe. Harronin borën. Grupi i vogël i njerëzve me kameramanin e ri udhëtoi tetë orë në shqotë e borë. Leqet e rrugës malore ishin zënë. Vendasit ganin borën, kameramani ruante aparatin si foshnjën në gji. Mes përmes leqet nuk çaheshin dot. Ecën e ecën dhe në mug sosën. Qenë të lodhur e të këputur dhe në të hyrë të fshatit u doli një grua. I ngjatjetoi dhe e ngjatjetuan.

### *Shtëpia së cilës iu hodh çatia për gjashtë orë*

Telekronisti me një grup shokësh u nis përnë fshatin malor. Ishte i ri dhe tjetër herë s'kishte qenë në atë fshat. I thanë se e shumta përnjë orë arrinte atje. Fshatarët vendas i thanë përdhjetë minuta nga xhadeja e madhe. Harronin borën. Grupi i vogël i njerëzve me kameramanin e ri udhëtoi tetë orë në shqotë e borë. Leqet e rrugës malore ishin zënë. Vendasit ganin borën, kameramani ruante aparatin si foshnjën në gji. Mes përmes leqet nuk çaheshin dot. Ecën e ecën dhe në mug sosën. Qenë të lodhur e të këputur dhe në të hyrë të fshatit u doli një grua. I ngjatjetoi dhe e ngjatjetuan.

— Urdhëroni te na, sa të pini nji kafe, t'ju terim teshat, — i ftoi ajo në shtëpi burrat.

— Faleminderit, — tha kameramani, — por e kemi me ngut se duam të vemi tek ata që u janë shembur shtëpitë nga bora.

— Mirë po batni, — i përkrah ajo. — E ju lumshin kambët që po na sajdisni në këtë qamet! Po ju tirdhnoni, bre burra, nji herë te na! — shton ajo gati me maraz.

— C'na polli me këtë shoqe! — bën shaka njëri nga udhëtarët.

Ajo dëgjon dhe, si qesh e ngjesh, thotë:

— Na ka pjellë belaja me motim, bre vllazën këtë vit.

— Mirë, mori motër, faleminderit! Po ku janë ato dy shtëpitë që u shembën? — pyet kameramani. — A kemi kohë të arrijmë me ditë në to?

Eshëtë halli te dita, te xhirimi i kronikës, se e di që zor të keni tashti dritë elektrike këtu. Eshëtë ky hall që e detyron kameramanin ta refuzojë ftesën e kësaj gruaje mikpritëse.

— Po ja ku e keni njanën! — tregon papritur gruaja shtëpinë përbri, atë të cilën i ka ftuar deri tani. — Kjo u shemb dje. Kjo u shemb dje e u ndreq mbramë.

— Si kjo?! — çuditet kameramani. Dhe vërtet eshtë pér t'u habitur, sepse shtëpia që tregon ajo eshtë e mbuluar me çati po se po, por me dyshek bore përsëri. Fshatarët vendas, që e kanë shoqëruar, kameramanin deri këtu, qeshin nën mustaqe.

— Kjo e jona, bre shok! Ani, s'keni faj ju që habiteni. Dhe ihe boll jena hutue kur na e ngritën vllaznit tanë kulmin e shtëpisë fët e fët, pér gjashtë orë. U gdhimë dje zbuluem e na gjeti nata mbuluem.

— Ndérkaq terdhi kryetari i këshillit të katundit, u takua me burrat, qortoi ata bashkëfshatarët e tij që nuk bënин zë dhe bindi kameramanin që vërtet kjo shtëpi ishte një nga ato të dyja që ishin shembur dje në mëngjes.

Vetëm kur u futën, brenda, si kaluan pragun e gruaja u dha kafen; panë lart materët dhe tra-ët e rinj dhe tjegullat e reja, të çatisë (tavanin s'iash kishin vënë akoma). E kuptoi edhe kameramani që ishte hedhur çati e re.

— Ta gëzoni kulmin e ri! — uroi kameramani.

— Faleminderit Partisë, dhe shokut Enver! Marrshin nga ditët tonë! — iu përgjigj nikoqirja e shtëpisë.

— Të lumtë goja dhe na e bëj hallall ngurrimin, — vazhdoi kameramani.

Dielli s'i kishte bërë akoma bisht turnit të tij të dites dhe ai filloi të xhironte menjëherë atë c'kish ndodhur me këtë shtëpi.

— Dhe vetë u habitëm fort si ndodhi kështu, — e ngau përsëri gruaja gëzimin e saj. — Josall ne gratë, por, për besë, dhe burrat nuk besuen. Në sabah herët me çati të rrënueme e një darkë në votrën tonë apét. Ne s'patëm kohë të idhnoreshim hic kur na u shemb shtëpia; se na e rregulloi Partia për gjashtë orë. Na i hoqi dertet me melhemin e vët!

Burrat e ardhur dëgjonin. Burrat e shtëpisë diku punonin. Kamera xhironte dhe zjarri në vater gjëmonte. Rrobat po thaheshin; gjaku po ngrohej. Gruas së shtëpisë i këndonte shpirti. Ajo ishte e mbarsur me një gaz të rrallë, me gëzimin e shtëpisë së re, që ia vithisi orteku e ia ngritën vëllezërit e saj bashkëfshatarë, djemtë e Partisë, për një ditë.

„Fshati ishte i vogël, lajmi për miqtë e ardhur arriti shpejt te gjitonët. Dhe erdhën atë kom-shinjtë, që për kështu i kish pllakosur një hall: u ishte shemburiçtia dhe ndrequr kësisoj, si kjo shtëpi, ku pinim kafen e tretësinoritë!“

„U takuan miqtë e ardhur me fqinjet dhe aherë komshiut plak foli e tha: „Po ju tregoj nji gjasend që kam për tu kallëzue nipave kur të bahan burra.“

(Kameramani hapi magnetofonin e vocërr të dorës, sa një paketë cigareje, që s'kuptohej e as dëgjohej fare nga të tjerët.)

— Na asht prishë shtëpia dhe njihet motit. Më ka pasë tregue baba, që plakut të tij i ra përtokë shtëpia prej ortekut. Prej asaj dite plaku i plakut tem ngriti nji kasolle dhe atje u martue e lindi babën tem. Baba jem atje përplasi kryet së pari dhe atje gëzoi së pari me nanën tonë. Në atë kasolle u martuen dhe atë, se s'mundën me ba shtëpi të re.

Dhe na fëmijët e babës atje kemi le e jemi rritë. Veç kur erdhi Partia, na erdhi e mbara dhe bamë shtëpinë tonë dhe atje u martuem na e na lindën vocat e cucat tona e nipat e mbesat tona. Dhe murlani na e ka përla pullazin e shtëpisë e na mbetëm në të katër muret. Plakut të plakut, babës dhë neve, na u deshën gjashtëdhjetë vjet me gatitë shtëpi të re. Partia na e ngriti dje, hop e për nji ditë! Nji kjo asht përralla e historia që do t'u tregoj nipave, or miq e dashamirët tanë. Ju lumshin kambët që erdhët!»

Dhe pastaj plaku i moçëm iu drejtua nikoqires:

— A po ke, moj fisnike, ndopak ujë të bekuem?

— Mos më korit, o babë! — tha ajo dhe nxo-

fi rakinë prej kumbulle të zier dy herë dhe plaku uroi:

— Shëndetin e Partisë dhe të miqve! M' i bani falëmeshëndet Enver Hoxhës!

Telekronistit iu mbushën sytë me lot. I dë-  
kej si ëndërr. Dhe hallim që e shqetësonte tashti,  
«a do ta besojnë vallë këtë telereportazhin e tij»,  
e harroi. Një gjë që ndodh, s'ka pse të mos beso-  
het.

— Të gjitha që nuk mund t'i lëshohet  
dëshirat e mësuarve, e kësaj qytetarëve.

— Të gjitha që nuk mund t'i lëshohet  
dëshirat e mësuarve, e kësaj qytetarëve.  
Të gjitha që nuk mund t'i lëshohet  
dëshirat e mësuarve, e kësaj qytetarëve.  
Të gjitha që nuk mund t'i lëshohet  
dëshirat e mësuarve, e kësaj qytetarëve.  
Të gjitha që nuk mund t'i lëshohet  
dëshirat e mësuarve, e kësaj qytetarëve.

— Të gjitha që nuk mund t'i lëshohet  
dëshirat e mësuarve, e kësaj qytetarëve.  
Të gjitha që nuk mund t'i lëshohet  
dëshirat e mësuarve, e kësaj qytetarëve.  
Të gjitha që nuk mund t'i lëshohet  
dëshirat e mësuarve, e kësaj qytetarëve.  
Të gjitha që nuk mund t'i lëshohet  
dëshirat e mësuarve, e kësaj qytetarëve.  
Të gjitha që nuk mund t'i lëshohet  
dëshirat e mësuarve, e kësaj qytetarëve.

— Të gjitha që nuk mund t'i lëshohet  
dëshirat e mësuarve, e kësaj qytetarëve.  
Të gjitha që nuk mund t'i lëshohet  
dëshirat e mësuarve, e kësaj qytetarëve.

shqipëri që dëgjoi që kishte mbi dy metra. Në këtë rast që dëgjoi që kishte mbi dy metra, shqipëri e dëgjoi që kishte mbi dy metra. Në këtë rast që dëgjoi që kishte mbi dy metra, shqipëri e dëgjoi që kishte mbi dy metra. Në këtë rast që dëgjoi që kishte mbi dy metra, shqipëri e dëgjoi që kishte mbi dy metra. Në këtë rast që dëgjoi që kishte mbi dy metra, shqipëri e dëgjoi që kishte mbi dy metra. Në këtë rast që dëgjoi që kishte mbi dy metra, shqipëri e dëgjoi që kishte mbi dy metra. Në këtë rast që dëgjoi që kishte mbi dy metra, shqipëri e dëgjoi që kishte mbi dy metra. Në këtë rast që dëgjoi që kishte mbi dy metra, shqipëri e dëgjoi që kishte mbi dy metra. Në këtë rast që dëgjoi që kishte mbi dy metra, shqipëri e dëgjoi që kishte mbi dy metra. Në këtë rast që dëgjoi që kishte mbi dy metra, shqipëri e dëgjoi që kishte mbi dy metra. Në këtë rast që dëgjoi që kishte mbi dy metra, shqipëri e dëgjoi që kishte mbi dy metra. Në këtë rast që dëgjoi që kishte mbi dy metra, shqipëri e dëgjoi që kishte mbi dy metra. Në këtë rast që dëgjoi që kishte mbi dy metra, shqipëri e dëgjoi që kishte mbi dy metra. Në këtë rast që dëgjoi që kishte mbi dy metra, shqipëri e dëgjoi që kishte mbi dy metra. Në këtë rast që dëgjoi që kishte mbi dy metra, shqipëri e dëgjoi që kishte mbi dy metra.

### **Plaka e urtë dhe djemtë e kufirit**

Në fshatin N. borë kishte rënë mbi dy metra. Fshati është lart 'në malet e Dibrës. Atje ku dhe dimrat e tjerë s'jellin borë përmposht. Por borë si kjo e sivjetmja vërtet nuk mbahej menjë. Nënhé Shimja kujton që, kur ispi karië pasë vrarë burrin djenatë e shkinës, kishte pasë siklet bore si ky. Ajo kujton nipi që i punojnë 'në Bulqizë 'enë Tiranë. I janë lutur kaq herë ata që të dalë dhe ajo dimrit 'në shehër, 'në qytet, por plaka s'ka dëgjuar. Po moshatarët e tsaj pse dalin herë pas herë dimrit me bujtë? Ani, ata me të tyren, plaka Shime me jetë vjetën. Kush do ta mbajë pastaj (po iku ajo) votrën ndezur 'në këtë kullë? Tha me mend kulla dhe iu kujtua që atë mot, kur

i vranë burrin, ranë dhe ortekët. Njëri syresh përlau me rob e me gja të gjallë konakun e Axhemit. Axhem i kishtë pasë konakun në brinjë të malit, bash atypari ku është posta e kufirit tonë.

Dhe i dridhet e i ligështohet zemra plakës Shime, se kujton «vocat e nañave, ushtarët, që po mardhin në atë brinjë të mallkueme, tue ruejtë kufirin prej hasmit».

Ngrihet plaka e urtë, vishet e mbathet mirë. Mbulon trupin e imët prej plake dhe kokën e imët, si kokë foshnje, me bokshanë e rëndë prej leshi të thurur vetë, vë dhe rrathët në këmbë (gë mezi i gjeti se ia kanë trazuar nipat dikur) dhe niset për tek ushtarët e kufirit në postë.

Nuk e preu në besë rruga. Vajti mirë e tñairë dhe ushtarët u habitën.

— Ç'deshe, moj nanë, në këtë qamet? Ç'hall po ke? A ke ngelë pa zjarr në votë? A s'ke dru, a? Apo s'ke miell më ba kulaçin? — e pyetën ata me të folmen e saj dhe shqetësimin e tyre.

— Jo, vocat e nanës. Jo, ju pastë nana! Të tana i ka nana; se dimnit të sertë duhet me i dalë zot qysh në beharin e butë. Dhe drutë m'i kanë pre djemtë tok me ju edhe miellin ma ka dhannë kooperativa.

— Po ç'ëmirë, të solli aherë, moj mëmë? Apo pate mall që të jepnim alarmin për ty, se të përgjilan suferina e të ganariu, — e përpinq ta kalente, në shaka shqetësimin e vët komandanti i ri lab, i postës.

— Jo, or bira! S'kam moshë ma përslojna të tillai. Nuk kam ardhë përtë keqen teme, por përtë mirën, tuej. Erdha unë e ngrata se juas pata fort merakun. Nji këtupari, ku keni ju kullën, ka pasë qenë konaku i Axhemit, i atij nafakëpa-kut, që e imsheli bona nën vete me gjithë kaq llaballëk. Dhe thashë me ardhë e me ju lutë

që të dimnoni këtë dimër në kullën timë, se atje as era nuk fryn e as vorteku nuk vjen. Bujrëm te unë, vocat e nanës, me sahat të mbarë! Ushtarët e prekën shushatën nga përkujdesja dhë dhëmbshuria së plakës. Ajo s'kishtë përtuar e kish rrezikuar veten e saj për të ardhur tek ata me këtë ftesë që u jepte konak të sigurt. Shtangën ushtarët dhe u mallëngjyen sa nuk flisnin dot.

— A po baj gabim, a? — pyeti paka Shime, e trembur, tek pa që ata të tërë heshtnin. Dëgjohej vetëm era që ulërinte jashtë.

— Jo, moj mëmë, jo! — gati thirri komandanti lab. — Ti s'po bën tashti gabim. Ty të falem nderit e rrofsh e gjëzofsh gjithë ç'ke! Por ke bërë gabim që u nise për këtej nga ne në këtë mot të lig.

— Ani, iu lehtësua shpirti plakës. — Ani! Mos kimi dert për mue se unë plakë jam e kam hangër tamlin tim. Ju të jeni mirë si kokrra e mollës e na të gjëzojmë dheun tonë, trojet tona. Bujrëm, bre!

Dhe plaka u ngrit bashkë me djemtë e kufirit. Ndoshta komandanti s'do të kish vendosur ashtu siç bëri, po të mendonte më gjatë, ndoshta ai duhej të pyeste diku më lart për atë që po bënte, por ai e shpërnguli postën e kufirit, atë ditë të dimrit të madh, në kullën e fortë të plakës Shime.

Dhe u bë plaka me dy palë djem, një palë të gjakut e të barkut të saj, minatorë në Bulqizë e mësues në Tiranë, e një palë të gjakut dhe barkut të nënave të tjera shqiptare, kufitarë, që janë që të gjithë të një gjiri e të një zemrë, të nënës Partit.

Unë jam i sigurt që kulla e plakës Shime do të quhet nesër nga ushtarët: «Posta dimërore e

kufirit», a mbase, pse jo, më shumë ka të ngjarrë të thonë «Posta e Nanës Plakë». Emër i bukur!

Kjo ndodhi më njëmbëdhjetë janar të këtij viti në fshatin N., në një nga shtatë malet e Dibrës.

— Të gjitha qytetarët e shtatë shtetërore kanë qenë saktë se nuk mund t’konsiderojnë këtë posta si një përgjigje e rafaleve. —  
— Të gjitha qytetarët e shtatë shtetërore kanë qenë saktë se nuk mund t’konsiderojnë këtë posta si një përgjigje e rafaleve. —  
— Të gjitha qytetarët e shtatë shtetërore kanë qenë saktë se nuk mund t’konsiderojnë këtë posta si një përgjigje e rafaleve. —  
— Të gjitha qytetarët e shtatë shtetërore kanë qenë saktë se nuk mund t’konsiderojnë këtë posta si një përgjigje e rafaleve. —  
— Të gjitha qytetarët e shtatë shtetërore kanë qenë saktë se nuk mund t’konsiderojnë këtë posta si një përgjigje e rafaleve. —  
— Të gjitha qytetarët e shtatë shtetërore kanë qenë saktë se nuk mund t’konsiderojnë këtë posta si një përgjigje e rafaleve. —  
— Të gjitha qytetarët e shtatë shtetërore kanë qenë saktë se nuk mund t’konsiderojnë këtë posta si një përgjigje e rafaleve. —  
— Të gjitha qytetarët e shtatë shtetërore kanë qenë saktë se nuk mund t’konsiderojnë këtë posta si një përgjigje e rafaleve. —  
— Të gjitha qytetarët e shtatë shtetërore kanë qenë saktë se nuk mund t’konsiderojnë këtë posta si një përgjigje e rafaleve. —  
— Të gjitha qytetarët e shtatë shtetërore kanë qenë saktë se nuk mund t’konsiderojnë këtë posta si një përgjigje e rafaleve. —  
— Të gjitha qytetarët e shtatë shtetërore kanë qenë saktë se nuk mund t’konsiderojnë këtë posta si një përgjigje e rafaleve. —  
— Të gjitha qytetarët e shtatë shtetërore kanë qenë saktë se nuk mund t’konsiderojnë këtë posta si një përgjigje e rafaleve. —  
— Të gjitha qytetarët e shtatë shtetërore kanë qenë saktë se nuk mund t’konsiderojnë këtë posta si një përgjigje e rafaleve. —

— Posta e Nanës Plakë, — përgjigjet qytetarët e shtatë shtetërore, — është një posta e rafaleve, që nuk mund t’konsiderohet si një përgjigje e rafaleve.

qëndron e qëndrueshme. Në këtë mënyrë, qëndrueshme është qëndrueshme e dashkave, qëndrueshme e dashkave së bashku me dashkave tjetër. Në këtë mënyrë, qëndrueshme është qëndrueshme e dashkave, qëndrueshme e dashkave tjetër. Në këtë mënyrë, qëndrueshme është qëndrueshme e dashkave, qëndrueshme e dashkave tjetër. Në këtë mënyrë, qëndrueshme është qëndrueshme e dashkave, qëndrueshme e dashkave tjetër. Në këtë mënyrë, qëndrueshme është qëndrueshme e dashkave, qëndrueshme e dashkave tjetër.

Shumë i lindjej si qëndrueshme e dashkave, qëndrueshme e dashkave tjetër. Në këtë mënyrë, qëndrueshme është qëndrueshme e dashkave, qëndrueshme e dashkave tjetër. Në këtë mënyrë, qëndrueshme është qëndrueshme e dashkave, qëndrueshme e dashkave tjetër. Në këtë mënyrë, qëndrueshme është qëndrueshme e dashkave, qëndrueshme e dashkave tjetër.

Shumë i lindjej si qëndrueshme e dashkave, qëndrueshme e dashkave tjetër. Në këtë mënyrë, qëndrueshme është qëndrueshme e dashkave, qëndrueshme e dashkave tjetër. Në këtë mënyrë, qëndrueshme është qëndrueshme e dashkave, qëndrueshme e dashkave tjetër. Në këtë mënyrë, qëndrueshme është qëndrueshme e dashkave, qëndrueshme e dashkave tjetër.

### Babë e bir

Shumë i lindjej si qëndrueshme e dashkave, qëndrueshme e dashkave tjetër. Në këtë mënyrë, qëndrueshme është qëndrueshme e dashkave, qëndrueshme e dashkave tjetër. Në këtë mënyrë, qëndrueshme është qëndrueshme e dashkave, qëndrueshme e dashkave tjetër.

Kur bota mbulohet me borë, dhitë u dashkan ruajtur, që të mos pinë, nga etja e madhe, asnjë gllënjkë ujë dëbore. Se, po pinë kësisoj, dështojnë dhe nuk pjelli këcintë bukur në pranverë.

Dhia, që aq mirë e përballon dimrin, paska një huq; qenka shumë nazike në të pjellë. Ruajini pra dhitë nga të pirët e ujit të dëborës.

Këtë, që e mësova këq vonë, vetëm këtij dimri në Mat, babai i Kastriotit, stallier i kooperativës malore të Krej-Lurës, e dinte qysh kur kishte lerë. Ndaj në ditët e paratë janarit të sivjetshëm, si çdo janar tjetër, u qëndronte ditë e natë dhive mbi kokë.

Kastrioti, nxënës i klasës së tretë të shkolles së mesme, shtatëmbëdhjetëvjeçar, në këtë kohë që shkollat ishin mbyllur, pastroi e qëroi me djemtë e fshatit borën në pullazet e shtëpive e nga shtigjet e rrugëve të mëhallave të fshatit. Hoxhi dhe borën dhe qirinjtë e akullit që vareshin në çatinë e shkollës, paçka se ajo ishte mbyllur akoma. Kudo në Veri bën i ftohtë i hidhur, po Lura është mbi të gjitha.

U kthyesh i lodhur pasdite vonë në shtëpi. Kish te luftuar gjithë ditën me mbretërinë e bardhë. Pyeti nënën tek i shtroi bukën, paçka se babanë e dinte ku ishte.

— Po baba, a hangri drekë, oj nanë?

— Jo, bir, se e ka humbë mendjen atje në vathë me dhitë e katundit.

— Do jetë lodhë baba, oj nanë, — tha djalii.

— Lodhë? Boll, besa, se si ky dimën kurremos ardhë ma! Por asht tue ma ndjellë zemra se po kthehet. Asht vakti që po shkojnë barinjtë e tjerë me i zanë vendin.

— A ma jep bukën t'ia çoj në vathë, oj nanë? Se po shkoj ta ndih ka pak tatën.

— Po ti hanji çapë bukë për vete, të pastë nana! Se ai zene se ka ardhë.

— Po ha me tatën! — vendosi djali dhe iku të ndihmonte babanë.

U takuan babë e bir. Këmbyen llafet e të reja ve të borës të fshatit dhe ato që kish thënë radioja për viset e tjera. Hëngrën bashkë atë q'u kish vënë zonja e shtëpisë dhe iu gjezuan dhive, që edhe sivjet dimrin po e nxirrin të fortë e pa asnje dështim. Shkrinë e ngrohën borën në zjarr, dhe shuan etjen e bagëtisë me të.

Erdhën barinjtë e tjerë për t'u këmbyer me

ta. Djali i tha babës të ikte se po shërbente e po kalonte ai sonte natën me shokët.

— Ik, babë, se je lodhë. Mos ki dert për gjanë e gjallë, se po e vigjëlojmë si me qenë ti, — iu lut djali të atit.

Ngulën këmbë dhe barinjtë e tjerë. Dhe babai iku pa merak e i qetë se, si thotë fjala, «bëmë, o babë, të të ngjaj». Dhité i la, në dorë të sigurt, i biri me barinjtë e tjerë ish si ai trimi me shokë shumë.

...Pranë vathës u dëgjuan ulërima ujqish. Lukunia e tyre donte prehë dhish pëlla. Dy barinjtë e tjerë, që kishin armë e diniin hile e usta llék, për ujqit, dolën në përgjim. Kastrioti mbeti në përkujdesjen e dhive të urta, që ishin trembur e currufiasur, fare nga ulërima e ujqërye. Dimri i kishte shushatur, ujqit po trembin keqas. Një dhi polli nga frika kecjin e saj të, vodcërr. Djali po mundohej të ngrohtë, vogëlushin e leshtë...

Kaloi dhenjë copë herë dhe fap, papritur, siç vjen gjithnjë e keqja, hajdutce, u lëshua e rra orteku e mori me vete Kastriotin bashkë me gjënë e gjallë. U kthyen turravrap barinjtë. Në drej të venë të mallkuarit, ujqër! U munduan duke këruar, në këmbën e bortë të malit. Djalin e kishte fshehur orteku me pesë metra borë përsipër. Këruan e këruan barinjtë dhe nxorën dhi e nxorën cjepl, e pastaj e gjetën dhe atë Kastriotin me kecin e sapolerë, të palëpirë nga dhia nënë, në gji të djalit, si ajo nëna që shtrëngon fort çilimiun. Keci ishte i ngrohtë kurse kurmi i djait qe ftohur tashmë dhe s'e ngrohte dot asgjë, veç tokës.

Ja kështu iku e na la këtë dimër Kastriot Rajti i Krejtit të Lurës, në krye të punës për njerezit.

1. Kështu vdiq kësaj here dhe Xhelali i La-  
shkizës. Kështu ra dhe Sali llogaritari. Jo për  
hall të vet, po për hall të popullit. Për ta ka  
shkruar «Zëri i Popullit» dhe akti i vëtëmohimit  
të tyre dihet. Xhelali ishte komunist dhe ikû  
të çonte përositë e organizatës-bazë në mëhallën  
e vet dhe vajti e s'arriti dot te gruaja dhe fëmi-  
jët e vet. E hëngri bora. E vrau orteku.

Na la për të mos u harruar kurë.

Kështu u nis dhe Sali Deda, llogaritari, t'u  
shpinte rrogat shokëve të tij sharrëtarë në male,  
që «t'u gëzoheshin kalamajtë». Dhe ai mund të  
mos nisej, njerëzit 'nuk vdesin' për një rrögë,  
por ai u nis se ia donte shpirti që të mos i shkon-  
te mendja ndokujt atje në male se vetëm për  
mot të mirë vjen llogaritari Sali në majat e lar-  
ta.

U nis dhe nuk sosi. E zuri orteku në mes  
të udhës. Por sosi nderi dhe guximi i tij dhe  
i gjithë atyre që vanë për udhë dhe s'erdhën  
më dhe ai guxim tepron dhe për ne të tjerët,  
që të jetojmë me nder si ata.

## *Cuni i vogël dhe helikopteri*

Këtë çka do t'ju them tashti, më tregoi një djälë gazetar dhe atij ia patën rrëfyer të tjerë.

Në Val të Martaneshit u zutnë rrugët e shtigjet. Njeri as shkonte, as vinte dot në Val! Kjo ka ndodhur dhe herë të tjera me të, janë mësuar kështu, por këtë janar është zonë dhe mullinjtë. Ngriu akulli në vijat e ujët dhe mokrat nuk bluanin dot.

Nuk është se atje fshatarët mbeten pa bukë fare, se malësia e asaj ane ia din hilën motit dhe përmjë ditë të keqë i ruani mënjanë dhe zahrenë dhe thesin e miellit. Por sidoqoftë, mërkü për ata që mbeten pa lidhje me të tjerët që i madh për Partinë dhe qeveria nisi nga Tirana

helikopterin me bukë Tirane dhe gazetat e ditës. Çoi disa kuintalë bukë helikopteri dhe çau tutje nga Biza. Morën vesh malësorët (nëpërmjet gazetës) se q'bëhej dhe me gjitonët, dhe gëzimi i tyre qe i madh sa asnijëherë, asnijë mot e kohë, s'u kish ndodhur t'u vinte buka nga qielli. As si në përrallë (buka binte nga qielli), bile as në ciklin e kreshnikëve nuk e has. E papritura qe e këndshme shumë, saqë njerëzit harruan motin e borës dhe thanë: «Asaj dite që erdhi buka nga qielli!» Ata e dinë mirë që nuk qe qielli, por qe Partia që ua pruri bukën me helikopterë. Dashuria e Partisë për ta dhe e tyre për Partinë zuri hapësirat qiellore.

...Gëzuan malësorët, por gazi dhe hareja e fëmijëve qe jashtë çdo fantazie. Aty plaku i Vtitit të Ri me krahë hekuri u pruri bukën e bardhë, si kjo borë e malit, të pjekur me korent në fabrikën e Tiranës dhe jo në furrën e fshatit apo në saçin e vatrës. Cili fëmijë në botë nuk gëzohet me dhuratën? Ca më tepër këta, ciliminjtë e Valit, që ajo u vinte prej vetë kryeqytetit! Kishin hak ta mbanin mend atë ditë, se të pak-të janë ata shokë të tyre që mund të thonë: «Ej, çuna, ne kemi provue nji herë bukë të rame nga qielli!»

Thashë pak më parë që të tilla histori nuk ndodhin jo më në përralla, por as në ciklin e kreshnikëve, mor po as zanat e Mujit e të Halilit nuk e përfytyronin dot një gjë të tillë, kur ndihmonin beniaminët e tyre.

Dhe kur kujtoj ciklin e kreshnikëve, sjell ndër mend borën që mbush nga kreu në fund të bëmat e kreshnikëve dhe që nuk haset hiç tek epope-të madhështore të Homerit. Kush është më e vjetër, vapa e madhe e Itakës së Odisesë apo bora e ftohtë e maleve të Jutbinës? Njësoj, do

të thoni ju. ashtu them dhe unë. Njësoj, por dielli i ngrohtë i Mesdheut nuk ka qenë kurrë ndonjë e ligë fatkeqe për njerëzi. Bora dhe sidomos kjo bora polare, si kjo e sivjetmja, ka qenë dhe mbetet një gur prove i madh për forcën, vitalitetin dhe mençurinë e njeriut. Prandaj kreshnikëve, që shok kishin veten, u duhej një gur i tillë prove, që të hynin në këngët dhe plakët e artë të kujtesës së popullit.

...Dhe njeriu i parë luftën e parë mbi dhë e ka pasur me ngricën! Dhe acarin. Me diellin kurrë, atij njerëzit i janë falur si perëndisë! Kujtoni luftën e njeriut, më akullnajën e fundit Vyrmsmer, për të zotëruar shpellat. Luftën me ariun dhe akullnajën, ku ai fitoi e u bë zot i shtëpisë së parë, shpellës, se kish zbuluar zjarrin. që e largonte ariun. Dhe kështu ia mori të keqen dhe akulli dhe ariu atij dhe njeriu i parë i Kremazonit në Francë apo Gajtanit te ne u bë zot i Tokës.

...Le ta lëmë lashtësinë parahistorike në punën e vet dhe ne le të kthehem i në punët tonë të kthehem te fëmijët e sotëm të fshatit Val dhe buka e qiellit.

Sado bukë sfungjer të lehtë të kish hedhur helikopteri, sikur dhe gjithë atë që prodhon kombinati ushqimor në Tiranë, patjetër që një ditë do të mbaronte. Dhe vërtet në Val ajo sosi shpejt dhe malësorët vazduhan të kënaqeshin me atë bukën e tyre të shijshme. paçka se jo Tirane. Po halli qe se një çun i vocërr. një kerr. ra në sevda me bukën e qiellit, me bukën e helikopterit dhe po i gërnjarej e shamatohej një ditë s'ëmës, duke përplasur këmbën përtokë gjithë inat.

Çuni qe katër vjeç dhe për të, si për çdo cun e gocë të kësaj moshe çdo gjë që fluturon hahet,

ca më tepër që ai kish disa ditë që e vërtetonte këtë.

Plaku i shtëpisë, babëzoti, i tha nuses, nënës së djalit:

— Çka ka çuni që po ankohet?

— Nuk ka gja, babë. Por po më kërkon bukë tajaresh.

— Jo, tatë, — e korrigjoi çuni të ëmën, — unë due bukë balone.

Qeshi plaku, qeshi dhe nusja me të birin. Për çunin e vocërr, buka që u kishin prurë më helikopter ishte bukë balone.

Dhe e urdhëroi plaku nusen që të siste hollë një trastë me miell dhe t'i bënte çunit një kulaç të mirë si për festë, tamam bukë balone. U kënaq çuni dhe pushoi ankimet. Nusja e urtë e gatoi kulaçin e sojmë për merak, dhe unë e di mirë që çuni i vogël bukës për festa një ditë do t'i thotë tamam 'bukë balone'. Dhe dó të ngatérrohen gjuhëtarët që do të vijnë e do të thonë nga doli kjo fjalë në Martanesh? C'etimologji ka? Mbësë njëherë do të kujtohen ata, gjuhëtarët: e ardhshëm, e do të këndojnë këtë historinë e çunit të vocërr të Valit. Kushedi!

## *E p i l o g*

Dimri po ikën dhe shumë gjëra shpejt do të harrohen. Dhe do ta hedhim prapa krahëve këtë dimër me atë fjalën e urtë «Të shkuara të harruarar!»

Do të fillojnë vërshimet e ngrohta të pranverës.

Por ka gjëra që s'do të harrohen dhe s'duhën harruar kurrë për shumë nga ne.

Për mua do të mbeten gjithnjë të gjalla shunë nga ato që jetuan në këtë kërthizë dimri dhe, midis tyre, edhe letra që Plenumi i Komitetit të Partisë të rrëthit të Dibrës i dërgoi shokut Enver Hoxha. Ajo është një pjesë e asaj

dashurie, besimi dhe force të popullit për Partinë, të popullit për shokun Enver.

Me këtë letër mbyll dhe tregimet për vitin e borës.

### I dashur shoku Enver,

Janë mbushur 17 vjet nga dimri i vitiit 1967, kur Ju, i dashur shoku Enver, ishit midis nesh në ato ditë të vështira të tërmetit të madh. Ne nuk i harrojmë kurrë këshillat dhe kujdesin Tuaj të veçantë, që na frymëzuan për të përballuar dhe zhdukur tërë pasojat e asaj fatkeqësie të natyrës brenda një kohe të shkurtër; i ngritëm të reja shtëpitë e rrëzuara, i bëmë më të bukura shkollat e shkatërruara, i ndërtuam stallat e bagëtive dhe gjithçka që vithisi natyra. Edhe atëherë pati plot akte heroizmi të njerëzve tanë. Heroizmi i atyre ditëve vazhdoi dhe u përtéri sot në përballimin e vështirësive të mëdha të motit të keq, të acarit dhe ortekëve të dëborës. Të tilla janë aktet heroike të komunistit Xhelal Hysa, të të riut Kastriot Rajta e të punëtorit Sali Deda, që ranë në krye të detyrës. Kudo zien puna, edhe mbi tokë edhe nën tokë. Kooperativistët, burra e gra, të rinj e të moshuar, me komunistët në ballë, përlleshën me borën mbi tokë për të mbrojtur jetën e njerëzve e për të mos u dëmtuar blegtoria; minatorët e Bulqizës luftojnë me akullin që ka ngrirë në hyrjet e galerive dhe në kolonat e puseve të minierës, që të realizojnë prodhimin e kromit. Dëmet që shkaktoi dëbora po mënjanohen me shpejtësi. I hapëm të gjitha udhët e 182 fshatrave, çliruam nga bora 253 km rrugël 'nationale që lidhin Peshkopinë me zonat, pastruam të gjitha çatitë e shtëpive, stallave dhe objekteve social-kulturore, ndreqëm 80 për qind të banesave dhe godinave të tjera të

dëmtuara. Brenda një dite në Gjoricë u hodhëm çati të re shtëpive të prishura. Nënë Merjeme Stafa, kur kapërceu pragun e ri, tha: «Ne nuk patëm kohë të idhnoheshim; para se me u idhnue, na erdhi pranë Partia dhe na i hoqi dertet.»

Kudo uniteti i popullit rrëth Partisë, me Ju në krye, i dashur shoku Enver, u ngrit si mal mbi ortekët. Përballimi i fatkeqësive të tillë të natyrës mund të bëhet realitet vetëm në Shqipërinë socialeste të epokës së Partisë, pasi në të kaluarën te ne as që mund të mendohej që njerëzit të ndihmoheshin kësosoj nga toka e nga qielli me kolona... automjetesh e helikopterë. Solidariteti socialist i të gjitha rrëthgjeve të tjera na ka shtuar më shumë forcat dhe besimin për t'i kapërcyer me sukses të gjitha vështirësitë.

Dëbora e madhe që ra, me gjithë vështirësitë e shumta që na krijoi, nuk na gjeti të papërgatitur, nuk na befasoi, sepse, si kurdoherë, i kishim marrë me kohë masat për furnizimin me artikuj ushqimore të zonave të thella malore për të cilat Partia dhe Ju personalisht keni treguar dhe tregoni kujdes të vazhdueshëm. Prandaj edhe në këtë momente Ju kemi pranë si ngaherë dhe nga mësimet Tuaja shumë të çmuashme marrim forca e trimërohemë për t'i mposhtur si gjithmonë vështirësitë. Kjo punë vetëmohuese e të gjitha masave punonjëse, me komunistët në krye, do të vazhdojë gjatë gjithë viti për realizimin dhe tejkalinin e detyrave në të gjithë sektorët.

Përballimi i vështirësive të motit të keq na ka shërbyer dhe do të na shërbejë për të rritur më tej fryshtën sulmuese në punë dhe me këtë temp luftarak do të punojmë për të realizuar me sukses të gjitha detyrat e vittit 1985. Do të realizojmë dhe do të tejkalojmë planin e prodhimit dhe të eksportit të kromit dhe gjeologët do të

konkretizojnë një vendburim të ri kromi të pasur, prodhimin e përgjithshëm industrial do ta plotësojmë 101 për qind. Në sektorin e bujqësisë, në grurë do të marrim 26.5 kv për ha, 40 kv për ha misër, 120 kv për ha patate, do të tejkalojmë prodhimin e frutave me 7000 kv. Me masat e mërra për sigurimin e numrit të krerëve e trajtimin e blegtorisë mbi baza më shkencore premtojmë për realizimin e detyrave të planifikuar.

*I dashur shoku Enver,*

*Ju premtojmë se brenda muajit janar do të mënjanojmë të gjitha dëmet me forcat e vetë rrethit tonë.*

Nuk ka ortek, nuk ka tërmët që e prek as s'ua një fije floku unitetin e çeliktë të popullit rrëth Partisë, me Ju në krye, i shtrenjti shoku Enver, këtë forcë kolosale, që mposht të gjitha vështirësitë, të çfarëdo natyre qofshin!

*Ju paçim jetëgjatë sa mali i Korabit në krye të Partisë sonë heroike, i dashur shoku Enver!*

Janar 1985

## **REMBRANDTI NË SHQIPËRI**

Në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë është dhe portreti i «Cifutit shëtitës» të Rembrandtit. Për ata që janë kureshtarë të dinë se si u gjetet në Shqipëri, po e tregoj historinë e zbulimit të tij.

Rembrandt Harmenag Van Rijn nuk është fshat që ka nevojë për kallauz. Ai është mal i lartë në «Tokat e ulëta» të Evropës. Ai është nga të fundmit kollosë të asaj epoke që, siç thoshte Engelsi, «kishte nevojë për titanë dhe lindi titanë». Lindi më 1606, në Leiden të Holandës, vdiq më 8

tetor 1669 në Amsterdam. Sa qe gjallë ishte i varfër sa s'thuhet dhe pati një thes me fatkeqësi ky bir i mullixhiut të Leidenit. Kur ishte tashmë autor i madh i qindra portreteve, għendjeve në gur, kompozimeve dhe vizatimeve të mirēnjoħura, kur kishte ringjallur «Danajēn» dhe vēnë në lēvizje «Rojat e natēs», kur ishte mjeshter i madh botēror me shkollēn e tij, më 15 korrik 1656, bashkia e Amsterdāmit e futi në listën e borxhlinjve që s'qenē tē zotē t'i lanin borxhet. Bash atē ditē kur ai mbushte rrumbullak pesēdhjetē vjeç!

Nuk kam ndér mend tē bēj jetēshkrimin e Rembrandit e as tē ngas krijimtarinē e tij, pas Shekspirit ai ēshté artista pēr tē cilin ēshté shkruar më shumē. Jo, nuk e kam kētu hallin, puna ēshtē qē krahas disa dhjetéra muzeve më nē zē tē botēs qē kanē fatin tē kenē veprat e tij, tashti sē fundi dhe ne u ngazällyem tē zbulonim nē Shqipëri një portret tē mrekullueshēm tē nxjerrē nga dora e mjesħtrit gjenial.

Rembrandti nē Shqipëri. Një dëshirë, ēnderr apo e vērtetē? Një e vērtetē e bukur, qē vien pērséri nga Shkodra. Kjo kryeqendér e madhe, e la-shtē e Ilirisë dhe e Arbit, ruante deri vonē kri-jimin e Rembrandtit, pēr tē cilin do tē flas më poshtē. Me kêtē rast dëshiroj, qysh nē fillim tē falēnderoj gjithë shokét qē me dashuri më ndihmu an nē kêtē kérkim!

Dëgjuam vite më parë qē kishim një Rembrandt dhe u gëzuam, kérkuam ta shihnim, mësuam qē s'qenkësh më dhe u hidhheruam. Jo se nuk besuam, por se dëshiruam tē nxirrej deri nē fund e vērteta, kérkuam!

Dihet se aty nga fillimi i nēntorit 1945 erdhì nē Shkodér Ilia Ehremburgu dhe vizitēn e parë e béri te shtepia e Kakariqëve, një familje

e njohur në Shkodër, tregtarë, mecenatë të artit dhe koleksionerë pikturash e antikash. Sipas kujtimeve të atyre që e shoqëronin atë ditë — «sapo erdhi, ai kërkoi menjëherë të viziton familjen Kakariqi». E quan atje dhe «ai për dy orë plot pa me kureshtje të madhe pikturat dhe veprat antike, shënoi me hollësi shumë herë, diçka dukej se kërkonte, por s'mori gjë. Doli pak si i pezmatuar nga shtëpia. Ne nuk dinim ç'kërkonte ai». Se ç'kërkonte atë ditë në Shkodër, mund ta marrim me mend kollaj po të sjellim ndër mend që ai ishte shkrimitar dhe pikturoglabërues i madh, koleksioner me emër i pikturës dhe ca më shumë kur mësojmë që ishte mik i gazetarit të njohur amerikan L.C. Sulzberger, që kishte parë Rembrandtin në Shkodër në fund të vitit 1938. Gazetari amerikan në kujtimet e veta në vitet 1934-1954, të mbledhura në librin «Nëpër turbullirat e historisë» (Paris, 1971, f. 70), shkruan e thotë se «Në Shkodër vajti për drekë në një familje parie dhe nga jashtë shtëpia dukej e vjetër, por brenda ajo ishte një mbretëri e lusit antik; kishte divanë, kolltuqe, qilima të Turquistanit dhe Afganistanit. I zoti i shtëpisë, një fisnik i mocëm, plot autoritet, i kishte kryer studimet në Paris. Ai na serviri një drekë evropiane. Ai na tregoi pikturat e tij, ndër të cilat unë me habi, i mrekulluar, pashë një Rembrandt». Kur ishin shokë në Moskë, në vitet e Luftës së Dytë Botërore, gazetari i «Nju-Jork Tajmsit», Sulzberger, këtë duhet t'ia ketë thënë me siguri dhe shkrimitarit çifut Ehremburgut. Ja pra ç'donte «ujku në vathë» të Kakariqëve, dashin përcor — Rembrandtin. Me sa duket, del e qartë që rusi në Shkodër piu kafen e Kakariqit, kërkoi gjatë, por s'e gjeti dot atë që kërkonte

në muret e pinakotekës shkodrane; e përcollën më  
 të thatë dhe, siç e kanë zakon ca e ca, ka men-  
 duar që e ka gënjer amerikani çifutin rus." Por  
 e vërteta është se gazetari Sulzberger e kish  
 parë tamam Rembrändtin në Shkodër. Ai nuk  
 ishte as axhami në këtë punë, por as i pari që e  
 zbuloi xhevahirin shkodran. Kleri katolik ven-  
 das, në një listë të kryevepravë që kishte qyteti  
 dhe që duhej t'u kalonin muzeve të Vatikanit,  
 shënonte në një regjistrim të vetin, bërë në vitin  
 1937, edhe «Çifutin shëtitës» të Rembrandit të  
 Kakariqëve. Kurse patrioti i njohur, artisti pio-  
 nier i fotografisë shqiptare, Kel Marubi, e fo-  
 tografoi për merak, më 1937, portretin me gjithë  
 kornizën e vet (me sa duket, origjinale muzeale),  
 ku shquajnë qartë me shkronja kapitale: «Rem-  
 brandt-Harmenag Van Rijn — 1606 — Leiden —  
 1669». Kjo fotografi sot ruhet në fototekën Ma-  
 rubi, pranë arkivit të Komitetit Ekzekutiv të KP  
 të rrethit të Shkodrës. Pra, Kakariqët e patën  
 veprën, por në kohën e pushtimit fashist men-  
 dojmë ta kenë fshehur duke pasur frikë se mos  
 ua rrëmbeni. Ata duhet ta kenë hequr nga  
 korniza origjinale (ajo që shohim në fotografi-  
 në e Marubit), e kanë mbështjellë kanavacën rü-  
 lo dhe diku e kanë ruajtur me kujdes, siç ruan-  
 nin kambialet e vjetra, diplomat apo kontratat  
 tregtare në traditën e tyre familjare. Pas viteve  
 të luftës asnje nuk është pa më të varur portretin  
 në shtëpinë e tyre. Kjo krijoj dhe mendimin e  
 përhapur shumë që atë ose e rrëmbyen, ose hum-  
 bi përfare.

Si erdhi ky Rembrandt në Shkodër dhe ç'u  
 bë me të më vonë?

Mark Kakariqi, i zoti i portretit, ishte një  
 njeri i fantaksur për kohën e vët. Ai bënte treg-

ti, shëtiste botën, thuhet që në kohën e Luftës Civile në Rusi kishte shoqëri tregtare në Moskë e Odesë, më 1912-1913 e shohim në fotografi me Ismail Qemalin, më vonë shkruante artikuj për ekonominë, bile predikoi që shpëtimi i fshatit shqiptar ishte rritja e shpendëve që bota t'i blinte si frëngu pulën, dhe njëherësh blinte, mblidhje e krijonte pinakotekën më të pasur shqiptare të kohës së vet. Flitet që ai kishte rrëth 10-12 kryevepra të mjeshtërve evropianë të shekuje 16-19. Në një fotografi të dhomës së ngrënies së tij të vitiit 1935, po e Kel Marubit, shohim sergjenët e pasur me shandanë antikë, pushkë e pisqolla të lara me argjend, enë të çmueshme, statuetka të bukur, qeramikë japoneze dhe dy tablo, një kompozim mesjetar që nuk dallohet mirë dhe një autoportret të rrallë të Romeninos, piktor i njohur i shekullit të 16. Kjo dhomë nuk është pinakoteka që ka parë Sulzbergeri. Merret me mend ç'mund të thuhej andej, kur në dhomën e ngrënies kishte një begati të tillë. Nga të dhënët gjore na del se portreti i plakut të Rembrandtit ishte te Kakariqët qysh pas Luftës së Parë Botërore. Kështu që mund ta themi pa frikë se ai e siguroi atë ose në Perandorinë ndërkontinentale Ruse, ose në atë kontinentale Austro-Hungareze. Princët binin nga dynjallëku dhe me siguri di-kujt prej tyre ai ia bleu me para në dorë ose me mall në anije...

Në kërkim të identifikimit të portretit shkodran, studiuam me vëmendje rrëth dyzet albume me riprodhime të veprave të Rembrandtit të galerive e muzeve të Evropës, Amerikës, Australisë dhe Japonisë. Në asnjërin prej tyre (botime të viteve pas Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore) nuk hasim në riprodhimin e portretit

tonë (dhe nuk qenë pak riprodhimet që pamë, por mbi dy mijë). Të paktën, një gjë kemi, pak a shumë, të sigurt: ai vërtet nuk figuron në muze-të e botës pas Luftës së Parë Botërore, pra nuk është kopje.

Thamë pak më lart se Kakariqët e fshehën për një kohë të gjatë, por trashëgimtari i Mar-kut, Gjovalin Kakariqi, e nxori veprën përsëri në dritë, ditën e 15 shkurtit 1968, kur ia shiti Galerisë Kombëtare në Tiranë. Është po ai, i fotografisë nga Marubi. Pronari i ri e shiti portretin për Rembrandt, siç qe vërtet. Punonjësit e Galerisë nuk i besuan («Çne Rembrandti në Shkodër?!), ca më tepër që ndonjë nga të komisionit kishte dëgjuar që dhe një diçka, e cila mendohet si e Rembrandtit, kishte fluturuar me kohë. Por, për të qenë korrektë me çmimin që e blehë, shkruan në pasaportën e veprës që siguruan: «Portreti i shkollës së Rembrandtit.» Pra u mor ustai për çirak. Dy muaj më vonë, ai që e shiti vdiq dhe s'pati më njeri të ngulte këmbë për të vërtetën që në Galeri ishte Rembrandti. Punonjësit e saj e futën pastaj në fondin e rezervave të pik-torëve anonimë, ku qëndron dhe sot, krahas Ticianit, Ribieros dhe të tjerëve piktorë të shquar. Është detyrë e kolegëve tanë mjeshtër e studiuës të arteve figurative që të përcaktojnë me gojën plot autorësinë. Por kjo është tjetër gjë.

Dihet prej shumëkujt fatkeqësia e madhe e autorëve të shquar të piktureve botërore, që vep-rat e tyre shpesh nuk i nënshkruanin. Rembrandti nuk është përjashtim dhe portreti shkodra-n pa siglën e tij nuk është përjashtim. Përkundra-zi. Ne numëruam dhe rezultoi se në rrëth 600 riprodhime portretesh të tij, mbi 150 ishin pa siglën e njohur «RHL» ose thjesht «Rembrandt».

Në këto riprodhime portretesh kemi vetëm përcaktimin e studiuesve dhe pronarëve të tyre dhe gjithnjë mendimin bërë «rreth viteve...» Megjithatë, ato janë të gjitha rembrandtiane: megjithatë, edhe portreti ynë është po ashtu, i Rembrandtit.

Mirë, ky është portret i penelit të mjeshtrit të madh holandez, c'ta tjerrim më! Po kur doli nga dora e tij? C'vit u krijua? Vitet 1620-1630 janë ato të rinisë dhe të fillimit të krijimtarisë së tij. Në këtë kohë ai s'ishte ende usta e as e njihte njeri për profet në fshatin e tij, kështu që atij i shërbijnë përmodel vetëm babai, nëna, xhaxhai e halla, nuk ka para të paguajë modele të tjera e as i porosit kush punë atii. Kemi një galeri të tarrë portretesh të gjeniut të rime një model falas, që është babai. Herë e pikturnon thjesht si baba, herë si shenjtor, herë si officer, herë si nëpunës, herë me shapkë e herë kokëzbuluar, herë me mjekër të gjatë e herë të shkurtër, herë me pelerinë e herë me kryq në qafë (sa i ndërron rekuizitën); por ai gjithnjë mbetet babai i tij. Më 1630 babai i vdes, ndërsa ai vazhdon ta kujtojë dhe ta piktuarojë, të paktën deri më 1635 me siguri me të njëjtin vrull. Ishte pa dyshim respekti e dashuria përmë të atin, por dhe ajo thelbësorja, që ai njihte çdo hojëz e nerv, çdo pore të portretit të dhimbur të mullixhiut të shtrenjtë. Nga mesi i viteve tridhjetë fillon periudha e portreteve të reja, sipas modeleve të gruas së parë, Saksias, që herë e kemi (gjithnjë në stilin e tij) si qenie mitologjike, herë si Danajë, herë si Flora e shpesh edhe thjesht si grua të tij. Në vitet dyzet fillon periudha e portreteve të djalit të vet, Titiusit, që vazhdoi gjatë kështu. Kurse në vitet pesëdhjetë periudha e

gruas së dytë, Hendrikës. Pra, kemi në krijimtarinë e tij kryesisht «dhjetëvjeçarë familjarë» me portrete të modeleve familjare. Natyrisht ai bëri dhe me qindra vepra të tjera jofamiljare, të cilat qenë me porosi dhe shumica e të cilave mban siglën e tij RHL. Pa harruar këtu, po përkundrazi duke e theksuar që model mbi gjithë modelet e tij gjithë jetën i shërbeu vetja e vet. Nuk ka, besoj piktor në botë që të ketë aq shumë autoportrete, (mbi gjashtëdhjetë i njohim ne) sa ç'ka punuar Rembrandti. Ishte varfëria që e bënte atë të kishte për kryesore modelet familjare fias. Eshtë aq e vërtetë kjo, sa në Luvër kemi parë një portret djaloshi të tij, nën të cilin me rëntgen atelieja e restaurimeve të Luvrit zbuloi një portret të pambaruar të nënës. Pra i erdhi porosia dhe ai në çast shfrytëzoi telajon, ku sapo kish punuar. Porositësi nuk priste, kurse nëna gjithnjë pret...

Duke e parë me kujdes dhe duke e krahasuar portretin e Shkodrës me atë të krijuar nga mjeshtri në një gjysmë shekulli të veprimtarisë së tij, ne kemi krijuar bindjen që plaku i kësaj vepre, me sa duket, eshtë portreti i babait të Rembrandit, i bërë në vitet 1629 deri më 1635. Pas këtij viti nuq hasim në modelin tamam të babait të vet në portretet e tjera. Do të na pëlqente të ishte i vitit 1632 dhe kësisoj, në këtë vit të zbulimit të tij të kishte dhe 350-vjetorin, por le t'i lëmë dëshirat mënjanë.

Portreti ynë, mbi të gjitha, ngjan me ata çka krijoj artisti mbi bazën e «modelit» baba dhe më shumë të kujton kryeveprat e tij të periudhës së parë, si «Eremitin» 1630, «Engjëllin që ndalon Abrahamin të sakrifikojë djalin» 1635, «Filozofin në këmbë 1633, «Simonin» 1631, «Mësinë»

1634 apo 1635. «Dy filozofë që diskutojnë» 1628. «Shfaqjen e Krishtit në tempull» 1631. «Shën Jozefin» të 163... «Kthimin e Judës...» 1629, serinë e dhjetëra portreteve të «Babait të Rembrandtit» 1629-1634. «Ringjalljen e Lazarit» 1630, «Shën Pjetrin në burg» 1631, «Filozofin te shkallët» 1631 e shumë të tjera. Në të gjitha këto vepra të mrekullueshme hasim të njëjtin model, të njëjtat tipare ose shumë të afërta me këto të portretit shkodran të Rembrandtit. Se ç'ka qenë gjenia e Rembrandtit në portrete, na e thotë gjeniu i proletariatit, Karl Marksi, kur shkruante: «Do ishte më se e dëshirueshme që njerëzit që kanë qenë në krye të Partisë, të lëvizjes qoftë para revolucionit, si zyrtarë të pikturoheshin, më në fund, me ngjyra të ashpra, si ato të Rembrandtit në tërë vërtetësinë e vet reale. Në të gjitha përshkrimet e deritanishme këta njerëz nuk paraqiten kurrë me pamjen e tyre reale, por vetëm me atë zyrtare, me kontura në këmbë e me aureolë rrëth kokës. Në këto portrete të transformuara në mënyrë të ekzaltuar si ato të Rafaelit humb gjithë vërtetësia e paraqitjes.» (K. Marks, F. Engels — «Mbi letërsinë dhe artin», Tiranë 1976, vol. I f. 16). Pra Rembrandti ishte mjeshtër i pashoq i së vërtetës së madhe të pasqyruar me ngjyra të ashpra (rembrandtiane), sic është vetë e vërteta.

Portreti i plakut (të Shkodrës), që ne do ta quajmë «Çifuti shëtitës», sipas traditës gojore kakariqase apo klerikale, por që në stilin e Rembrandtit mund dhe do ta quajmë pa merak «Portreti i Mendimtarit plak», apo «babai i Rembrandtit», është me plot gojën i tillë, një burrë i mençur, i dalë nga populli pak i vuajtur, mendimtar me ballin e madh si një rrasë guri e bardhë, pse jo, si gurët e mokrës që bluante mijellin në mullirin e vet, me mjekrën të bujshme të thinjur e gjithë hijeshi si tërë shenjtorët e moçëm.

Rembrandti dhe në këtë portret vë vulën e vet të madhe të vizatimit ballazi të modelit duke ringjallur kështu Xhton e madh të dy shekuje më parë dhe ngjyrat e thella të Ticianit. Edhe në këtë portret ai veçohet si mjeshtër i karaktereve të forta, i dritëhijeve të fuqishme dhe i gjerrësisë së mendimit njerëzor. Modeli i tij është i mendimtarit të vuajtur, që ka mësuar shumë ngajeta, paçka se shpesh i zhgënjiyer dhe që ka ç'u mëson tashti të tjerëve me përvojën dhe moshën e tij. Nuk është zotni, por njeri i thjeshtë, nuk është rob a skillav, por krenar e i panënshtuar. Është një nga pleqtë fisnikë, të dashur e të mirë të popullit. Një gjysh i rrallë a baba i shkëlqyer, që do të donte ta kishte kushdo në sojin e vet. Linjat e portretit janë aq të ngrohta, plot ndje një e dhembshuri, që mund t'i takojnë vetëm babit të vet, mullixhiut plak dhe që nuk e mistifikon dhe as e zbuluron.

Po të flisnim me gjuhën e kritikut të arteve figurative, do të thoshim pa mëdyshje se në portretin shkodran ndihet dhe një herë e fuqishme paleta karakteristike rembrandtiane. Një kolor i ngjeshur, i ashpër, gjithë dritë e hije, sidomos në ballin e lartë, hundën e hollë dhe mjekrën e hedhur plot dritë dhe sytë e thellë dhe buzët e mbërthyera me hije. Në të gjitha këto ndihet një velaturë, një trajtim gjithë lëng jetësor, që ruan transparencën dhe zbulon okrat e ndezura dhe kafet e errëta, aq karakteristike të mjeshtrit të madh. Shquan sidomos ky portret për atë të vencantën e Rembrandtit, kontrastin e thellë që krijon midis pjesëve të ndryshme të fytyrës, ku spikatin veçanërisht balli ashtor, sytë e thellë dhe mjekra e bukur. Të gjitha këto bëjnë që në këtë portret të shohim, mbi gjithçka, të ringjallur

dramën e madhe të mendimtarit të popullit në epokën e tij dhe tragjedinë e botën e brendshme të turbulluar të vetë autorit, të shohim vdekjen e babait dhe boshllékun që i la pas. Mendojmë që portreti ka shumë mundësi të jetë një evokim i babait të vdekur, i punuar diku midis viteve 1630, kur vdiq plaku dhe 1634, kur u martua autori, sepse aty ndihet drama e vetmisë dhe e krenarisë së Rembrandtit.

Së fundi, pothuajse si gjithë portretet e Rembrandtit, edhe yni është punuar në kanavacë me bojë vaji, ka përmasat e zakonshme për veprat e mjeshtrit holandez, 45 x 54 cm. Është i ruajtur në përgjithësi mirë; paksa i dëmtuar në anën e djathtë të sfondit, pak i tymosur nga zgjyra e shekujve. Është i ringjitur në një kanavacë tjetër më të re (pra kanavacë e dyfishtë), me saduket jo nga autori, por nga pronarët e mëvonshëm, për ta ruajtur mirë, praktikë e njojur kjo në mbrojtjen e piktureës së kavaletit. Korniza e vet, të paktën ajo e Kakariqëve, që shohim në fotografinë e Marubit të vitit 1937, nuk gjendet më.

Me sa d'uket, siç thamë në fillim, Kakariqët, për ta ruajtur, e bënë rulo, i gjetën kamaren e fshehtë e të thatë, e bashkë me të zhdukën dhe kornizën, për të humbur gjurmaët, në mos qoftë diçka më banale, që të ketë përfunduar në zjarrin e oxhakut. Korniza do të kishte vlerë, sepse shpesh në to vihen vulat e dyllëta të galerive e e muzeve dhe kështu mund të binim në ndonjë gjurmë të saktë të origjinës nga ka ardhur te ne. Nejse; ne kemi xhevahirin, kuti tjetër i gjejmë. Artisti gjenial mbapse deshi të përjetësonte babanë, që ta ruarin shekujt, siç e ruajtën. Dhe koha jonë bëri që Galeria e Arteve e Tiranës të ketë një Rembrandt. Dhe çfarë Rembrandti! Një margitar të rrallë!

## NJERIU I NJEQIND E DHJETE FYTYRAVE

Kur ishim fëmijë, në ato vitet e para të qirimit, shpesh luanim me plakat guri dhe kush fitonte prej nesh kish kënaqësinë t'i merrte shokut ndonjë copë filmi me artistë kinemaje. Të gjithë artistët ishin të huaj, nga të Çine-Çitasë deri të të Hollivudit. Ndërronim aso kohe një Sharlot me dy ose tre «i Holli me të Trashin», një Gari Kuiper me dy Linstroken, pesë Tom Tylerë me një Tarzan. Emrat e tyre i njihnim, portretet e tyre i shihnim përditë në copat e filmave që kishim, në duar, por filmat e tyre nuk i shihnim dësh. Nuk kishin prindërit tanë të holla për një luks të tillë, për biletat kinemaje. Ç'është e vërteta;

ngandonjëherë çanim nëpër këmbët e të rriturve, para syve të portierëve, vjedhurazi, për të parë ndonjë film në kinema, kontrabandë... Aherë kam parë për të parën herë Kadri Roshin, që punonte si biletashitës, në kinema «Gloria», sot «Republika», në Tiranë dhe çoku na fuste ndonjëherë, më të rrallë, për mik, pa biletë. Kadriu s'mban mend, por i vogli nuk e harron dot më të madhin...

Më vonë, ky pasioni ynë për portrete artistësh vazhdoi e u rrit në dashurinë për filmin dhe teatrin. Ishte vite më vonë, kur filloj te ne të flitej për këtë ose atë artist të huaj, që ishte njeriu i dyzet fytyrave, i pesëdhjetë fytyrave, deri dhe i njëqind fytyrave. Ishin rolet që kishin luajtur ata në filma. Sa për filmin, artistët tanë shqiptarë nuk kishin aso kohe asnjë «fytyrë», sepse s'kishim fare kinematografi tonën. Dhe, pa kaluar mirë një çerek shekulli nga filmi ynë i parë artistik «Tana», ku Kadriu luajti rolin e parë, ne sot flasim me gojën plot, për artistin e njëqind e dhjetë fytyrave, Kadri Roshin.

Kur ishim ne fëmijë, njihnim vetëm artistët e huaj. Fëmijët sot njojin, si prindërit e vet, artistët tanë. Portretet e tyre nuk i sheh në xhepat e pantallonave të shkurtra të çunave, por në albumet e nxënësve të shkollave dhe në xhamat e makinave, të vëna nga shoferët, sevdallinj të kinemasë. Kanë ndryshuar kohët, kanë ndryshuar dhe zakonet e lojërat e fëmijëve.

Kemi dëgjuar shpesh, e shumë nga ne e dimë që Demosteni, oratori i madh i Greqisë së Lashtë, vuante nga belbëzimi. Atij i merrej goja dhe me të tillë huq zor e kish të mbante fjalime, ndaj, për të mundur të shkoqiste fjalët, thonë që përditë të tëra ushtrohej buzë lumit e anës detit për të dëgjuar jehonën e fjalëve të veta. U mundua shumë greku i shquar dhe arriti një ditë atë që

kërkonte, forcën aktoreske të oratorit. Por në fund të fundit Demostenit i mjaftonte dhe kaq, boll të hidhte në papirus mendimet apo idetë e tij dhe prapë do të mbetej në histori si një mendimtar i zoti, si shumë grekë të mençur të tjerë.

Kujtoni tashti sa vështirë, gati të pabesueshme, e ka pasur Kadriu ynë, të cilil në fëmijérinë dhe rininë e vet po kështu i merrej goja dhe luftoi të bëhej jo orator, po aktor. Dhe ç'aktor se, një nga më të zotët e skenës dhe të ekranit tonë! Konkurroi për të hyrë në trupën e Teatrit Popullor dhe dy herë radhazi u rrëzua në provimet e artit, për cemin më fatkeq për teatrin, atë të mbajturit të gojës. Ç'vullnet dhe dashuri për teatrin kishte ky njeri, që të kapërcente gati të pamundurën! Dhe arriti atë që dëshiroi prej vitesh:

Dua të tregoj diçka ngajeta e tij, jo për t'i bërë biografinë, po për të argumentuar atë çka sapo thashë, punën dhe mundin që i është dashur për artin. Dhe si për çdo gjë, por mbi të gjitha për artin, duhet punë, punë dhe sakrifica. Ai lindi në fshatin e djeshëm, të humbur, të Ballshit, jo në atë të përpunimit të thellë të naftës, siç është sot. Dymbëdhjetë vjeç mbeti jetim, pa nënë; gjashtëmbëdhjetë vjeç, sikur nuk i mjaftonte vdekja e nënës, mbeti dhe pa baba. Më i vogli nga fëmijët, më shëndetligu ndër ta, detyrohet të fillojë punën si punëtor krahu në Kavajë. Pas disa muajsh, si rolet në premiera të reja, ndërron zanat e bëhet pjatalarës në Durrës. Pastaj kthehet e bëhet cirak e shegert (besoj se e kuptioni pse aq bukur e luan Osipin te «Hlestokovi») gjithnjë i uritur, vazhdon punëtor ngarkim-shkarkimi i cimentos. Punon dhjetë deri dymbëdhjetë orë çdo ditë. Gjatë Luftës Nacionalecimtare arrestohet e burgoset disa muaj nga pushtuesi. Punon pastaj biletashitës në kinema «Gloria», ku e kam parë

dhe së pari. Pastaj Kadriu u fut punëtor teatri dhe prej andej shkoi për stundime në shkollën e lartë dramatike, ishte një dëcka pa precedent, ai kishte bërë vetëm shkollën fillore!

Gjithsesi kjo jetë tepër e zyrtë, por bukur shumë e pasur me ngjarje, njerëz, jetë, e ndihmoi dhe e ndihmon që të jetë mjaft realist në lojën e tij.

Në gjashtëdhjetë vjet të jetës së vet, gjysmën, plot tridhjetë, i ka kaluar si aktor i Teatrit Popullor. Po të krahasohet dhe me më të riun e aktorëve të sotëm, ai e ka filluar punën si artist, pa dyshim, ca si vonë, tridhjetëvjeçar, por ama në këto tri dekada të jetës prej aktori ai ka punuar me një merak të tillë, sikur ka dashur të mbushë atë boshllék që i qe krijuar në këtë vonesë kaq të madhe. Dhe kjo përpjekje e tij që ta mënjanojë këtë vonesë duket qoftë dhe me faktin që ai luajti në tridhjetë vjet të dhënjë dhjetë role, në teatër dhe tridhjetë në kinematografi. Pra gati cdo vit nga tri role. Tepër për një kohë të shkurtër, vetëm për një njeri, qoftë ai dhe aktor i talentuar shumë. Në këto role ai luajti nga të gjitha llojet e karaktereve njerëzore, nga përfaqësuesit e të gjitha klasave, nga figurat dhe personalitetet e të gjitha kohërave të historisë, nga më të mirët deri te më të ligjtë. Sillni ndër mend Kadriun dhe vetveti do të kujtoni Abdyl Frashërin e Haxhi Qamilin, Ezopin dhe Arturo Uinë, Hamletin dhe Jagon, Bektash Shkozën e Murat Bëncën, Marko Ruvinën e Mithat Beun e shumë e shumë të tjera, që po t'i renditnim, do të zinim faqe të tëra. Por, siç është i kursyer Kadriu për veten e vët, le të jemi dhe ne të kursyer në listat për të.

Artisti i Popullit Kadri Roshi është nga artistët më të dashur të skenës dhe ekranit tonë. Naty-

risht, nuk është i tillë vetëm për numrin e madh të roleve, kurrsesi jo! Ka dhe aktorë të tjerë që mund të kenë shumë role, bile mbasë dhe më tepër se ai; por që nuk kanë mundur, ta skalitë portretin e tyre në pllakën e gurtë të kujtesës së popullit. Kadriu është i tillë, ai është i dashur për çdo shtëpi tonën, se ka botë të madhe ndjeshash, ka jetë ngajeta jonë, ka dëshirat dhe ëndrrat e gjithsecilit prej nesh, se ai është nga ata që janë majaja që mpiks brumin e bukës së artit.

Ndoshta është forca e madhe e fjalës së tij që, siç thotë regjisori ynë Piro Mani, ka një vlerë vepruese të pashoqe. Dhe merreni me mend, pikërisht ai, që nuk shqiptonte dikur tamam fjalën është sot mjeshtër i fjalës së kënduar. Nuk gaboj që them i fjalës së kënduar, se vërtet gjuha jonë shqipja jonë, merr ritmin e këngës, merr ngjyrat e saj, kur del nga goja e tij. Në fjalën e tij ka kaq gjerësi e hapësirë polifonike, sa shpesh të kujton këngët labe a harmoninë e zileve e këmborëve të tufave të Nemërckës dhe Malit të Gjerë. Cili e dëgjoi një herë recitimin e poezive të Naimit nga Kadri Roshi dhe i harroi? Cilit i kumboi një herë në teatër fjala e tij dhe s'deshi ta shijonte prapë? Cili pa filmat e tij dhe përtoi t'i shihë përsëri?

Ai dhe shokët e tij më të shquar të skenës dhe ekranit arrijnë atë që thotë shoku Enver Hoxha se «... për ne bukuria qëndron në radhë të parë në interpretimin e artistit në mënyrë sa më të përsosur, sa më natyrale, sa më afër njeriut, aë takohet realisht në jetë, në punë, në përpjekje, të shkrirë me mendimet dhe me aspiratat e tij. Për ne, jashtë këtij realiteti të pasqyruar edhe në ekranet tona, nuk ka bukuri. Po nuk pati këto karakteristika, po nuk u panë në sytë e tij ajo

bukuri dhe freski mendimi, ajo pastërti e jetës së njerëzve tanë, artisti, sado i bukur që të jetë fizikisht, nuk vlen.»

Një nga këta njerëz të afirmimit të së bukurës sonë socialiste, të shpirtit të pastër në art është dhe Kadri Roshi. Pa dyshim, ai nuk shquhet për bukuri fizike apolloniane, por ka bukurinë e madhe të shpirtit dhe mendimit të njeriut që i do dhe sakrifikon për njerëzit, të artistit që çdo gjë të mirë të tij e ka vënë në shërbim të popullit. Është kjo bukuri e pashtershme shpirtërore prej artisti të vërtetë, që e bën atë të shprehet, siç tha në ditën e kremit të gjashtëdhjetëvjetorit të lindjes, se artistët shqiptarë kanë fatin e madh që të frymëzohen e të edukohen nga jeta e popullit tonë të mrekullueshëm, nga Partia dhe shoku Enver, që i respektojnë e i vlerësojnë aq shumë; për të gjitha artisti mbetet një borxhli i përjetshëm, që s'e lan dot kurrë! Kështu thotë artisti Kadri dhe ne do të shtonim se borxhe të tillë si ai paçim dhe ne miqtë e dashamirët e tij gjithë jetën tonë.

Unë nuk jam njeri që kam zili kurrikend, por, tek shoh e dëgjoj Kadriun, nganjëherë them me vete: «Ja, të tillë fat të kesh në minierën e thellë të artit, siç e ka ai, që në çdo rol gjen një damar floriri.»

Në një shkrim për portretin e tij nuk bën dot edhe artikullin edhe tregimin, nuk krijon dot një simbiozë të tillë. Por, ashtu siç thyen kornizat e skematizmit Kadriu, le të guxoj dhe unë të dal ca jashtë disa kanoneve. ... Kam qenë në Libohovë shpeshherë. Atje kam parë për herë të parë koburen e Avni Rustemit, jo atë me të cilën vrapu Esad Pashën në Paris. Atje kam prekur gunganë me të cilën Avniu mbulohej netve në malet e Tepelenës tek bënte zanatin e mësuesit. Atje kam

parë Kalanë e Ali Pashë Tepelenasit dhe varrin e Shanishasë, motrës së tij. Atje, tek shikoja rrënojat e kullës së tij, kam marrë me mend gjëmimin e sahatit të Libohovës, që thonë se dëgjohej deri në Gjirokastër e Delvinë. Atje kam ngrënë bukën gjithë aromë e shije të furrëxhinjve Libohovitë, që janë mjeshtrit më të aftë të gatimit të saj në Shqipëri! Thonë se sekreti i asaj buke është tek ai uji i jashtëzakonshëm, akull e i lehtë sa s'bëhet më, që buron te rrapit i lashtë i madh sa një mal i Libohovës. Megjithatë duhet të them se ujëra si këto ka shumë, furrëxhinj si libohovitet ka pak. Por ç'lidhje ka kjo Libohovë me Kadriun, do të thotë dikush: Kadriu ka lindur në Ballsh, por tatën e mëmën i kish nga Libohova dhe këtë e mora vesh një viti, kur pashë muzeun e saj dhe zbulova që Muhin Roshi, gjyshi i Kadriut, na kish pasë luajtur në «Besën» e Sami Frashërit deri dhe në qytetin e Janinës, në kohën e xhonturqve, më 1908. Mbës atij Muhinit të Roshet, gjyshit që luante teatër deri në vilajet të Janinës, i ngjan Kadriu? Sido që të jetë, ai pasion i tij aq i madh për teatrin me siguri lidhet edhe me këtë traditë familjare libohovite për teatrin.

Kadri Roshi është si një sfunjjer që s'ngopet kollaj me lëngun e jetës artistike. Ca kohë më parë ai na tregonte pse s'ishte i kënaqur kurre nga vetja e tij si aktor. Pak a shumë i kishte ndodhur kjo ngjarje:

Krahas teatrit, që është vetëjeta e tij, do shumë dhe natyrën. Dhe nga kjo dashuri për natyrën i ka lindur prej kohësh ajo «hobi», siç thonë anglezët, për peshkimin.

Kishte dalë një ditë për peshkim në Brezhdan të Beratit. Jo tek Ura e Osumit, as tek Ura e Pashait në Gorrice, por te rezervuari i Brezhdanit. Në Berat xhirohej filmi, deri në Brezhdan

një orë punë është më këmbë. Nuk e dinte apo bënte sikur nuk e dinte, se, kur vjen puna për peshk dhe Artistët e Popullit «harrojnë» diçka nga rrëgullat, por puna është se në rezervuar nuk duhej peshkuar, se sapo ishte lëshuar peshku në të. Ç'ta zgjatim, Kadriu hodhi grepat dhe e zuri rojtari i rezervuarit.

— Ç'bën, more, kështu? Ku ke marrë leje që gjuan këtu? Nuk e di ti, që sapo kemi lëshuar peshkun? — thirri rojtari.

— Nuk e di, — u shfajësua Kadriu. — Ku ta di unë i varfri. Unë nga Tirana. Pashë rezervuarin, ujë plot, takova fëmijët, i pyeta a ka peshk, më thanë «peshko, or xhaxhi, peshko» dhe ja erdhe ti e më zure, erdhe ti e më qorton.

— Ashtu?! — u çudit rojtari me naivitetin e artistit. — Erdha unë e të qortoj! Ç'qortim, more? Nuk ke turp, pse kalamaqërit beson ti? Ka zot vendi, dëgjon?

— Më fal, or mik, nuk e dija... — deshi ta merrte me të mirë rojtarin e sertë Kadriu.

— C'mik, more?! — kundërshtoi me tërsëllëm rojtari. — Nga na dole mik! Gjuan, peshk kontrabandë dhe më thua mik! Mik thuaju shokëvë të tu ti, jo mua. Dëgjove? Dëgjova, thuaj!

— Dëgjova! — tha Kadriu.

Kaq deshi ai që të vinte maraz me roitarin. Si nuk e njohu fare? Ku vanë gjithë atë filma? E kuptoi, ishte i zhveshur nga brezi e lart dhe me kapelë kashte mbi krye. Zor që ta njihte edhe shoku i tij i ngushtë Lazër Filipi. Veshi shpeit e shpejt këmishën, hoqi kapelen e kastës dhe, duke tërhequr gjithë zemërim filispanien, tha si për vete, por që ta dëgionte dhe ai tjetri, rojtari: «Tërhiq, Tare, tërhiq. Se atje kam peshkun e ngordhur unë!»

— Ou! — tha rojtari. — Edhe tallesh tashti!

Më luan dhe teatro. Nuk është ashtu siç thua ti, o kontrabandist rezervuari, jo! Ai në film i thotë «Gérmo, Tare, gérmo, se atje kam qënин e ngordhur unë!» Ja kështu i thotë e mos shit mend kur nuk e di.

— Jo, more! — bëri sikur u habit Kadriu dhe e pa me atë shikimin gjithë tërbim e ironi që sheh ai kulaku i filmit «Përballimi» kur i gjejnë grurin.

Vetëm tashtri rojtari e vuri re kush ishte. E njohu që ishte artisti i filmit që pëlqente aq shumë dhe tha:

— Pika mua! Pika, o Ahmet, me kë bëj mhabit! Po ti qenke kulaku, bre! Po ti qenke i ligu që fshihte grurët, a të hëngërshtë grurët! Ec përpara! — urdhëroi si me inat, duke vënë buzën në gaz rojtari. Kadriu, që më në fund arriti të «demaskojë» veten dhe t'i bëhej i njohur rojtarit, i tha:

— E, më në fund më njohe. Dhe thua se s'më ke mik. Po mua më ke çdo javë mik në shtëpinë tënde, herë me film e herë me teatër në televizor.

— Llaf me mend, — i dha të drejtë rojtari artistit, — llaf me konak. Mik të kam dhe ç'mik se! Për ty kalamajtë lënë mësimet e zihet plaka me ta, që në vend të këndoja një detyrat e mësueses shohin xha Kadriun, herë si vritesh e herë si ngjallesh. Pa, pa, pa, ç'burrë i zoti që je, për çdo javë ndërrohesh si me magji!

Kadriu qeshi. U gëzua dhe s'i vinte hiç keq që e zuri ky rojtar.

— Hajde! — i tha rojtari. — Hajde, aman, për darkë sonte tek unë! Do të kënaqen cilimini të dhe do patakset gjithë fshati për një mik si ti.

Dhe artisti vajti për darkë te miku i ri. Gë-

zoi me fshatarin rójtar, me fémijét dhe gjitonët e tij. U bë vetvetiu një mbrëmje e gjatë «tematike», një nga ato diskutimet krijuarës më të bukura për teatrin dhe kinematografinë, sa t'ia ketë zilinë dhe klubi i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në Tiranë, jo më vatra e kulturës e fshatit.

Dhe, tek darkonin fémijét bashkë me nikoqiret e shtëpisë, Kadriu përsëriti atë frazën e njojur të kujdestarit te filmi «Lulëkuqet mbi mure»: «Hani, ju, hani!» Dhe shtoi nga xhepi, jashtë ske-narit të filmit: «Po unë pa peshk mbeta!» Qeshën fémijét, qeshën dhe nikoqiret. Dhe padashur do-la tek ajo, që në disa raste Kadriu i përsërit fjalët dy herë: «Hani, ju, hani», «Gërmo, Tare, gërmo!» etj. Mos kjo është forma relikte e fosiliuar a mbasë një lloj atavizmi i kohës kur atij i merrej goja? Jo! Nuk është, natyrisht, kjo. E shumta, nëse i ka vlejtur kjo ish-dobësi e tij ndonjëherë në teatër, është vetëm në rastin e rolit të Mithat Frashërit tek «Epopeja e Ballit Kombëtar» të Shevqet Musarajit... Ja pra kjo përsëritje e qëllimitë e tij bëhet kur di se si, dhe fjalë fare të rëndomta, të zakonshme sa s'ka ku të vejë më, t'i bësh me jetë, t'i gjallërosh, t'i rritësh, t'i bësh të peshojnë rëndë si gurë.

Kadri Roshi ka gjermuan tërë jetën në malin e artit dhe ai ka qenë minator me fat, se në çdo rol ka zbuluar damar floriri. Në këtë minierë të pashtershme të artit shqiptar të realizmit socialist, të jetës sonë, ai ka për të hapur dhe shumë galeri të tjera. Vitet e moshës së tij nuk e largojnë, por e afrojnë sa vjen e më shumë me zemrën e minierës së arit, të artit për popullin.